



**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave**

**Republika e Shqipërisë**

**Programi i Zhvillimit Rural 2014 - 2020**

**i**

**Instrumenti të Asistencës Parazgjërimit (IPA)**



**28 Maj 2015**

## PERMBAJTJA

MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE .....	I
REPUBLIKA E SHQIPËRISË .....	I
DRAFT .....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
<b>1. TITULLI I PORGRAMIT IPA II TË ZHVILLIMIT RURAL NË SHQIPËRI.....</b>	<b>1</b>
<b>2. VENDI PËRFITUES .....</b>	<b>1</b>
2.1 SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E PROGRAMIT .....	1
<b>3. PËRSHKRIMI I SITUATËSS AKTUALE, ANALIZA SWOT DHE IDENTIFIKIMI</b>	<b>1</b>
<b>NEVOJAVE.....</b>	<b>1</b>
<b>3.1. Konteksti i përgjithshëm social-ekonomik i shtrirjes gjeografike .....</b>	<b>1</b>
<b>SHQIPËRIA KA NJË SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME PREJ 28,748 KM<sup>2</sup> DHE NJË POPULLSI PREJ 2,787,600 BANORËSH, NGA TË CILËT 1,390,000 JANË FEMRA (2013). DENSITETI I POPULLSISË ËSHTË 97 BANORË PËR KM<sup>2</sup>.....</b>	<b>1</b>
3.2. Performanca e sektorëve të bujqësisë, pyjeve dhe atij ushqimor .....	4
3.3. Menaxhimi mjedisit dhe i tokës .....	19
3.4. Ekonomia rurale dhe cilësia e jetës.....	23
<b>3.6. Tabela e treguesve të kontekstit .....</b>	<b>31</b>
Shënim: : = jo në dispozicion; e = vlera e parashikuar; p = i përkohshëm; PR 2013 = Raporti i Progresit për Shqipërinë 013 (SWD(2013) 414 finale).....	38
<b>4. ANALIZA SWOT – PËRMBLEDHJE E ANALIZAVE TE MËSIPËRME .....</b>	<b>39</b>
4.1. Bujqësia, pyjet, industria ushqimore (tabela të veçanta për çdo sektor të përzgjedhur për mbështetje).....	39
<b>4.2. Administrimi i tokës dhe mjedisi.....</b>	<b>43</b>
4.3. Ekonomia rurale dhe cilësia e jetës.....	44
<b>4.5. Sinteza e analizës SWOT në lidhje me objektivat e zhvillimit rural dhe bujqësor të IPA II .....</b>	<b>46</b>
<b>5. REZULTATET KRYESORE TË NDËRHYRJEVE TË MËPARSHME.....</b>	<b>47</b>
<b>5.1. Rezultatet kryesore të ndërhyrjeve kombëtare të mëparshme: Shumat e disbursuara, përmbledhje e vlerësimeve, mësimet e nxjerra.....</b>	<b>47</b>
<b>5.2 Rezultatet kryesore të asistencës së BE-së, shumat e disbursuara, përmbledhje e vlerësimeve, mësimet e nxjerra .....</b>	<b>48</b>
5.3. Rezultatet kryesore nga asistenca shumëpalëshe, shumat e disbursuara, përmbledhje e vlerësimeve, mësimet e nxjerra .....	50
<b>PËRSHKRIMI I STRATEGJISË .....</b>	<b>54</b>
6.1. Përshkrim i strategjisë ekzistuese kombëtare të zhvillimit rural .....	54
6.2. Identifikimi i nevojave dhe përmbledhja e strategjisë së përgjithshme .....	55
<b>6.2.1 Identifikimi i nevojave.....</b>	<b>55</b>
<b>6.2.2 Përshkrimi i strategjisë së programit IPARD II .....</b>	<b>58</b>
6.3. Bashkëveprimi mes ndërhyrjeve të propozuara të IPARD dhe Dokumentit Strategjik Kombëtar .....	62
6.4. Përmbledhje e logjikës së ndërhyrjeve, duke treguar masat e përzgjedhura për IPARD, objektivat sasiore .....	64
<b>7. 7. TABELA E PËRGJITHSHME FINANCIARE.....</b>	<b>65</b>
7.1 Maksimumi i kontributit të BE-së për fondet IPARD për vitet 2014-2020, në EURO .....	65
7.2 Plani financiar sipas masave në EURO, 2014-2020 .....	66
7.3 Shpërndarja e buxhetit paraprak sipas masave për periudhën 2014-2020 .....	67

7.4. Monitorimi i buxheti paraparak i kontributit të BE-së sipas masave për periudhën 2014-2020, në EURO.....	68
7.5 Shpërndarja në përqindje e kontributit të BE-së sipas masave për periudhën 2014-2020 .....	68
<b>8. PËRSHKRIMI I SECILËS MASË TË PËRZGJEDHUR.....</b>	<b>69</b>
8.1. Kërkesat në lidhje me të gjitha apo disa masa .....	69
<b>8.1.1. Standardet kombëtare minimale që aplikohen për Programin .....</b>	<b>69</b>
<b>8.1.2. Përkufizimi i zonave rurale.....</b>	<b>69</b>
<b>8.1.3. Kriteret e pranueshmërisë të aplikueshme për të gjitha apo disa masa .....</b>	<b>69</b>
8.1.4. Kontrolli dhe verifikueshmëria e masave .....	71
<b>8.1.5. Shënjestrimi i masave.....</b>	<b>72</b>
<b>8.1.6. Procedura administrative për përzgjedhjen e projekteve të investimit .....</b>	<b>73</b>
8.2 Përshkrimi i Masave .....	74
<b>8.2.1 Masa ‘Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore’.....</b>	<b>74</b>
<b>8.2.2 Masa ‘Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit’ .....</b>	<b>81</b>
<b>8.2.3 Masa ‘Diversifikimi Fermave dhe Zhvillimi Biznesit’.....</b>	<b>87</b>
<b>8.2.4 Masa ‘Asistencë Teknike’ .....</b>	<b>94</b>
<b>9. RRJETI KOMBËTAR I ZHVILLIMIT RURAL .....</b>	<b>97</b>
<b>10. INFORMACIONE LIDHUR ME BASHKËVEPRIMIN E IPARD ME MASAT E FINANCUARA NGA BURIME TË TJERA (KOMBËTARE OSE NDËRKOMBËTARE).....</b>	<b>98</b>
10.1. Kriteret e demarkacionit të IPARD me mbështetjet e dhëna nga fushat e tjera të IPA-s.....	98
10.2. Bashkëveprimi i IPARD me instrumentet e tjera financiare.....	99
10.3. Kriteret e demarkacionit dhe bashkëveprimi i masave IPARD me politikat kombëtare .....	100
<b>11. PËRSHKRIMI STRUKTURËS OPERATIVE, PËRFSHIRË MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN.....</b>	<b>101</b>
<b>11.1. Përshkrimi strukturës operative (Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD) dhe funksioneve kryesore të tyre .....</b>	<b>101</b>
<b>11.2. Përshkrimi i sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit, përfshirë përbërjen e parashikuar të Komitetit Monitorues .....</b>	<b>104</b>
<b>12. PËRSHKRIMI PËRMBLEDHËS I STRUKTURËS SË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT.....</b>	<b>107</b>
<b>13. REZULTATET E PROGRAMIMIT, PËRFSHIRJA E AUTORITETEVE DHE ORGANEVE PËRKATËSE SI DHE E PARTNERËVE TË PËRSHTATSHËM EKONOMIKË, SOCIALË DHE MJEDISORË.....</b>	<b>109</b>
13.1. Masat për përfshirjen e autoriteteve, organeve dhe partnerëve përkatës .....	109
13.2 Partnerët e konsultuar - përmbledhje .....	110
13.3. Rezultatet e konsultimeve – Përmbledhje.....	112
Rezultatet e konsultimeve jepen në Aneksin 6. ....	112
<b>14. REZULTATET DHE REKOMANDIMET E VLERËSIMIT EX-ANTE TË PROGRAMIT ...</b>	<b>112</b>
<b>14.1. Përshkrimi i procesit .....</b>	<b>112</b>
<b>14.2. Përmbledhje e rekomandimeve .....</b>	<b>113</b>
<b>RAPORTI I PLOTË I VLERËSIMIT EX-ANTE ËSHTË PJESË E ANEKSIT 8. ....</b>	<b>117</b>
<b>15. KËRKESAT E KUADRIT LIGJOR TË IPA-S MBI KOMUNIKIMIN, VIZIBILITETIN DHE TRANSPARENCËN .....</b>	<b>117</b>
<b>15.1. Veprimtaritë e parashikuara për informimin e marrësve potencialë të mbështetjes, organizatave profesionale, partnerëve ekonomike, socialë dhe mjedisore, organeve të përfshira në promovimin e barazisë mes grave dhe burrave si dhe OJQ-ve lidhur me mundësitë e ofruara nga programi dhe rregullat e përfitimit të financimit. ....</b>	<b>117</b>

15.2 Veprimtaritë e parashikuara për informimin e marrësve të kontributit të BE-së.....	118
15.3. Veprimtaritë për informimin e publikut të gjerë lidhur me rolin e BE-së në program dhe rezultatet e tij.....	119
<b>16. MËNYRA E PROMOVIMIT TË BARAZISË GJINORE DHE MOSDISKRIMINIMIT PËRGJATË TË GJITHA FAZAVE TË NDRYSHME TË PROGRAMIT (HARTIMIT, ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT) .....</b>	<b>119</b>
16.1. Përshkrim i mënyrës se si do të promovohet barazia gjinore gjatë fazave të ndryshme të programit (hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit).....	119
16.2. Përshkrim i mënyrës se si parandalohet diskriminimi në bazë të seksit, racës, origjinës, besimit fetar, moshës, orientimit seksual, gjatë fazave të ndryshme të zbatimit të programit.	120
<b>17. SHËRBIMET TEKNIKE DHE KËSHILLIMORE .....</b>	<b>121</b>
<b>18. ANEKSET .....</b>	<b>122</b>
<b>ANEKSI 1. PËRKUFIZIMI STABILIMENTEVE TË VOGLA DHE TË MESME.....</b>	<b>122</b>
<b>ANEKSI 2. PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË RENTABILITETIT EKONOMIK .....</b>	<b>123</b>
<b>ANEKSI 3. LISTA E ZONAVE RURALE .....</b>	<b>123</b>
<b>ANEKSI 4. LISTA E ZONAVE MË PAK TË AVANTAZHUARA MALORE/ZONAT MALORE ME PËRQINDJE MË TË LARTË MBËSHTETJEJE .....</b>	<b>127</b>
<b>ANEKSI 5. ORGANIGRAMA E MA-SE DHE AGJENCISE IPARD.....</b>	<b>133</b>
<b>ANEKSI 6. REZULTATET E KONSULTIMEVE - PËRMBLEDHJE.....</b>	<b>134</b>
<b>ANEKSI 7. STANDARDET MINIMALE KOMBETARE.....</b>	<b>139</b>
<b>ANEKSI 8. RAPORTI VLERESIMIT EX-ANTE (DOKUMENT I VECANTE).....</b>	<b>151</b>

### Lista e Shkurtimeve

<b>AA</b>	Autoriteti Auditit
<b>QIB</b>	Qendrat e Informimit Bujqësor
<b>ALL</b>	Lek Shqiptare
<b>AZHBR</b>	Agjencia Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
<b>QTTB</b>	Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
<b>PVP</b>	Programi Vjetor i Punës për Hapjen e Thirrjeve për Aplikime
<b>CEB</b>	Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>CSP</b>	Dokumenti Strategjik Kombëtar
<b>DEU</b>	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
<b>DG</b>	Directorate-General
<b>DPVPR</b>	Drejtorja e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale
<b>BERZH</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>BEI</b>	Banka Evropiane e Investimeve
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>EURO</b>	Monedha e BE-së
<b>Eurostat</b>	Zyra Statistikave të Komunitetit Evropian
<b>EUSAIR</b>	Strategjia Bashkimit Evropian për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit
<b>FAO</b>	Organizata e Ushqimit dhe e Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara
<b>FWA</b>	Marrëveshja Kuadër
<b>PBB</b>	Produkti Brendshëm Bruto
<b>GHG</b>	Gazrat Serë
<b>GIZ</b>	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
<b>GVA</b>	Vlera e Shtuar Bruto
<b>HACCP</b>	Analiza Rrezikut dhe Pikave Kritike të Kontrollit
<b>U&amp;D</b>	Ujitje dhe Kullim
<b>IFAD</b>	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë
<b>INF</b>	Institucione Ndërkombëtare Financiare
<b>FMN</b>	Fondi Ndërkombëtar Financiar
<b>INSTAT</b>	Instituti Statistikave
<b>IPA</b>	Instrumenti i Asistencës së Parazgjerimit
<b>IPARD</b>	Instrumenti i Asistencës së Parazgjerimit për Zhvillimin Rural
<b>RN</b>	Rajon i Ndërmjetëm
<b>ISARD</b>	Strategjia Ndër-Sektoriale e Bujqësisë dhe Zhvillimit 2014-2020
<b>LAG</b>	Grupet Lokale të Veprimit
<b>NQV</b>	Njësitë e Qeverisjes Vendore
<b>LED</b>	Zhvillimi Ekonomik Vendor
<b>AFP</b>	Anketa e Fuqisë Punëtore
<b>AMSJ</b>	Anketa e Matjes së Standardeve të Jetesës
<b>NGJ</b>	Njësi Gjedhi
<b>AM</b>	Autoriteti Menaxhues
<b>MADA</b>	Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore
<b>BMA</b>	Bimë Medicinale dhe Aromatike
<b>MBZHRAU</b>	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

<b>SMK</b>	Sistemet e Menaxhimit dhe Kontrollit
<b>MIS</b>	Sistemi Menaxhimit të Informacionit
<b>MS</b>	Shtetet Anëtare të BE-se
<b>MT</b>	<i>ton</i>
<b>ZKA/NAO</b>	Zyrtari Kombëtar Autorizues/National Authorising Officer
<b>OJQ</b>	Organizatat Jo-Qeveritare
<b>KKIPA/NIPAC</b>	Koordinatori Kombëtar IPA/National IPA Coordinator
<b>NUTS</b>	Nomenklatura e Njësive Territoriale Statistikore
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>PPP</b>	Fuqia blerëse
<b>PR</b>	Rajon kryesisht rural
<b>SA</b>	Marrëveshja Sektoriale
<b>SME</b>	Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
<b>SWOT</b>	Forca, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet
<b>UAA</b>	Sipërfaqja Bujqësore Aktive
<b>PNUD</b>	Programi Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
<b>Standardet e BE-së</b>	Standardet e BE-së në fushat e mbrojtjes mjedisore, shëndetit publik, shëndetit të kafshëve dhe bimëve, mirëqenies së kafshëve dhe sigurisë në ambientet e punës
<b>USAID</b>	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim e SHBA-ve
<b>TVSH</b>	Tatimi Vlerës së Shtuar
<b>WB</b>	Banka Botërore
<b>SHPU</b>	Shoqatat e Përdoruesve të Ujit

# 1. TITULLI I PORGRAMIT IPA II TË ZHVILLIMIT RURAL NË SHQIPËRI

## Programi Zhvillimit Rural 2014-2020 i Republikës së Shqipërisë nën Instrumentin e Parazgjerimit II

### 2. VENDI PËRFITUES

#### 2.1 SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E PROGRAMIT

Tabela 1. Rajonet NUTS (niveli I, II, ose III) të mbuluara nga Programi

Niveli NUTS	Kodi nëse aplikohet	Përshkrimi
NUTS 1		Republika e Shqipërisë


### 3. PËRSHKRIMI I SITUATËSS AKTUALE, ANALIZA SWOT DHE IDENTIFIKIMI NEVOJAVE

#### 3.1. Konteksti i përgjithshëm social-ekonomik i shtrirjes gjeografike

SHQIPËRIA KA NJË SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME PREJ 28,748 KM<sup>2</sup> DHE NJË POPULLSI PREJ 2,787,600 BANORËSH, NGA TË CILËT 1,390,000 JANË FEMRA (2013). DENSITETI I POPULLSISË ËSHTË 97 BANORË PËR KM<sup>2</sup>.<sup>1</sup>

Shqipëria është e ndarë në 12 qarqe administrative të nivelit 3 NUTS (qarqe) dhe 373 komuna dhe bashki të nivelit 1 NQV. Shumica e njëjësive NQV 1 janë me madhësi të vogël me vetëm 8 bashki me popullsi mbi 50,000 banorë, në të cilat është përqendruar 34% e popullsisë së përgjithshme.

Në përputhje me përkufizimin e OECD në nivelin NUTS 3, *pesë qarqe janë kryesisht rurale, pesë janë mesatarisht rurale dhe dy kryesisht urbane*. Në 2013 qarqet kryesisht rurale janë (Dibra, Gjirokastra, Korça, Kukësi dhe Lezha) ndërsa qarqet mesatarisht rurale (Berat, Elbasan, Fier, Shkodra, Vlora) përbëjnë 91.6% të territorit dhe 63% të popullsisë në Shqipëri, shifër që është pranë mesatares së BE-së (përkatesisht 90.9% dhe 59%). Qarqet kryesisht urbane - Tirana dhe Durrësi, - përbëjnë 8.4% të territorit dhe 37% të popullsisë. Densiteti i popullsisë në qarqet kryesisht rurale është përafërsisht sa gjysma e mesatares së vendit (56 banorë për km<sup>2</sup>) ndërsa në qarqet mesatarisht rurale është lehtësisht më e ulët se mesatarja kombëtare (85 banorë për km<sup>2</sup>).



<sup>1</sup> Të dhënat e paraqitura në këtë seksion janë marrë nga INSTAT.

Shqipëria është *vend kryesisht malor* me afro dy të tretat e territorit të saj të shtrirë në zona malore. Tetë qarqe NUTS 3 me një popullsi të përgjithshme prej 1 milion banorë janë të vendosura tërësisht ose kryesisht në zona malore.

Gjatë periudhës së marrë në konsideratë nga censusi 2001-2011, *popullsia e Shqipërisë ka pësuar një rënie me 269,000 banorë, ose 8.8%*. Faktorët kryesorë që kanë kontribuar në rënien e popullsisë janë *rënia domethënëse e shkallës së lindjeve dhe emigracioni*. Vendi ka një nivel pozitiv por në rënie të rritjes së popullsisë (5 lindje për 1000 banorë në 2012). Vlerësohet se rreth 500,000 Shqiptarë kanë emigruar gjatë periudhës 2001-2011, të shtyrë kryesisht nga faktorë ekonomikë si dhe së fundi për arsye të bashkimit familjar. Vitet e fundit, ka pasur një fluks në rritje të kthimit të emigrantëve, kryesisht nga Greqia dhe Italia. Të dhënat e censurit tregojnë se në periudhën 2009-2011, 73,000 persona janë rikthyer në Shqipëri, nga të cilët 70% janë vendosur në zona rurale.

*Shqipërisë është mes vendeve me popullsinë më të re në Evropë, ku mosha mesatare është 33 vjeç*. Por pavarësisht këtij fakti, treguesi i plakjes së popullsisë është duke u rritur me ritme të shpejta. Gjatë periudhës së marrë në konsideratë nga censusi 2001-2011, numri dhe përqindja e popullsisë nën 15 vjeç ka pësuar rënie domethënëse, nga 29.3% në 2001 në 20.7% në 2011 dhe përqindja e popullsisë me moshë 65 vjeç e sipër është rritur nga 7.5% në 11.3%.

Në vitin 2012, popullsia brenda grupmoshës nga 20 deri në 64 vjeç llogaritej në 1,615,600, ose 9.7% më pak se në 2007<sup>2</sup>. Përqindja e popullsisë brenda kësaj grupmoshe me arsim të mesëm 35.1% ndërsa ajo me arsim të lartë ose edukim të mëtejshëm 14.8%. Përqindja e femrave me arsim të mesëm llogaritet në 8.1% më e ulët krahasuar me meshkujt, ndërsa përqindja e femrave me arsim të lartë llogaritet në 2% më e lartë. Përqindja e atyre që janë larguar nga shkolla është shumë e lartë, ose 35%.


Lindjet e gjalla kanë ardhur gjithnjë e në rritje duke arritur 77.1 në vitin 2012, gjë që e vendos Shqipërinë mes vendeve me mesataren më të lartë ndërmjet vendeve të parazgjerrimit.

Në 2012, PBB-ja e Shqipërisë kapte vlerën prej 9,370 milion Euro. PBB-ja për person e fuqisë blerëse është sa 30% e mesatares se BE-së.

Pas një dekade me rritje të madhe ekonomike, kryesisht për shkak të remitancave, si dhe nga hovi i ndërtimeve dhe eksportet e lëndës së parë, në 2009 filloi rënia në rritjen e PBB, duke arritur nivelin më të ulët prej 1.6% në 2012. Programi i qeverisë për vitet 2013-2017 synon mbështetjen e burimeve të reja të rritjes në prodhim, energji, turizëm dhe agrobiznes si sektorë prioritarë.

Stabiliteti i çmimeve dhe i kursit të këmbimit është ruajtur pavarësisht mjedisit jotë favorshëm. Gjithsesi, deficit buxhetor mbetet relativisht i lartë në nivelin prej 3.5% të PBB-së dhe *borxhi publik vazhdon të rritet*, duke arritur nivelin e 62.9% të PBB-së në fund të 2012. Një nga sfidat e mëdha në fushën e politikave është konsolidimi gradual dhe i qëndrueshëm fiskal me qëllim garantimin e shlyerjes së pagesave publike të prapambetura dhe frenimin e akumulimit të borxhit publik.

Ngadalësimi ekonomik ka ndikuar negativisht investimet, me një rënie të kapitalit bruto të



<sup>2</sup>Eurostat.




trupëzuar që nga viti 2008 (-4.7% në 2012). Si pasojë e uljes së kërkesës dhe rritjes në përqindje të huave me performance të dobët (22.5% në 2012) ka pasur një tkurrje drastike në rritjen e kreditimit nga 43.8% gjatë 2008 në 7.4% gjatë 2012.


*Përqindja e popullsisë ekonomikisht aktive* brenda grupmoshës 20 deri 64 vjeç rezultoi të ishte 73.4% gjatë 2012. Gjithashtu, u konstatua edhe një *boshllëk gjinor i madh*, ku veprimtaria e femrave ra me 20 % krahasuar me atë të meshkujve. Gjatë 2012, numri i të punësuarve brenda grupmoshës 20-64 vjeç rezultoi 1,023,800 e barabartë me një përqindje punësimi prej 63.4%. Edhe numri i të punësuarve me eksperiencë ra gjatë 2012 me 8.7% më pak se gjatë 2007<sup>3</sup>.

Në 2012 shkalla e *papunësisë ishte në nivelin prej 13.9%*, ose pak më e lartë se në 2007. Shkalla e papunësisë së meshkujve ishte më e lartë se e femrave. Shkalla e papunësisë së të rinjve u rrit në mënyrë domethënëse krahasuar me 2007 në nivelin prej 27.9% 2012. Gjithashtu shkalla e papunësisë afat-gjatë rezultoi e lartë në 2012 me 10.8% dhe me tendencë në rritje.

Vlera e shtuar bruto (GVA) e sektorëve të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit rezultoi në masën 1,614.8 milion EURO gjatë 2011. Vendi që zënë *bujqësia, pyjet dhe peshkimi ka ardhur në rritje* gjatë periudhës 2007-2012 si pasojë e një shkalle më të lartë rritjeje të këtyre sektorëve. Gjatë 2012, kontributi i bujqësisë llogaritet të jetë 20.6% e GVA-së, kundrejt 19% gjatë 2007. Gjatë 2012, përqindja që industria zuri ishte vetëm 11%, ndërtimi 9% ndërsa shërbimet 59% (Grafiku 2).



Në Shqipëri përqindja e të punësuarve në sektorin primar është shumë e lartë. Gjatë 2012, numri i të punësuarve në bujqësi, pyje dhe peshkim ishte 529,000, ose 51% e totalit. Numri i të punësuarve në bujqësi pësoi rënie gjatë periudhës 2007-2010, por duke filluar nga 2011 ka qenë sërish në rritje (Grafiku 3).



Gjatë 2012, *sipërfaqja aktive bujqësore (UAA)* ishte 1,201,290 ha, duke përfaqësuar 41.8% të të gjithë territorit të Shqipërisë. Sipërfaqet arë llogariten në 51.5% të UAA-së, kullota 42.1% dhe ajo me bimë shumëvjeçare 6.4%. Krahasuar me 2007, *sipërfaqja aktive bujqësore* është rritur me 7% si rezultat i rritjes së sipërfaqes arë dhe kullotë<sup>4</sup>.

Sipas Censurit të Bujqësisë<sup>5</sup> i zhvilluar në 2012, në Shqipëri rezultuan 324,000 ferma. Nga të cilat, 232,700, ose 79%, gjenden në zonat kryesisht ose mesatarisht rurale ndërsa 21% në zonat urbane.

*Sipërfaqja mesatare e fermave bujqësore është shumë e vogël* - 1.20 ha (2012). Rreth 46% e fermave kanë një sipërfaqe nën 1 ha, ndërsa 86% e tyre nën 2 ha.

<sup>3</sup>Të dhënat mbi punësimet dhe papunësinë janë marrë nga Eurostat.

<sup>4</sup>Burimi: Eurostat.

<sup>5</sup>Të dhëna paraprake.

Në Shqipëri situata e *pronësisë dhe e përdorimit të tokës paraqitet shumë e fragmentarizuar*, me një mesatare prej 4.1 parcelash për fermë dhe me sipërfaqe mesatare të parcelës prej 0.26 ha. Tregu i tokës bujqësore (shitja dhe qiramarrja) është pazhvilluar si pasojë e: perceptimit të tokës bujqësore si aktivi më i sigurt (social safety net); pretendimet e pazgjdhura mbi pronësinë; procedurat e tejzgjatura dhe të kushtueshme të transaksioneve të tokës bujqësore; gabimet e lidhura me regjistrimin e titujve gjatë reformës së shpërndarjes së tokës bujqësore si dhe aftësisë ulët për të përfituar kreditim. Programi kombëtar i Konsolidimit të Tokës Bujqësore është përgatitur gjatë 2013.

### **3.2. Performanca e sektorëve të bujqësisë, pyjeve dhe atij ushqimor**

Sektori i bujqësisë në Shqipëri ka qenë në rritje të vazhdueshme. Shkalla vjetore e rritjes ka variuar nga 2.7% deri në 7.9%, në varësi kryesisht të kushteve të motit. Gjatë katër viteve të fundit sektori ka pasur një rritje më të madhe se sa pjesa tjetër e ekonomisë.

Produktiviteti i punës në bujqësi i matur sipas GVA-së për njësi vjetore pune (AWU) ka rezultuar të jetë rritur në mënyrë domethënëse me më shumë se 46% gjatë 2011 krahasuar me 2007. Megjithatë, kjo është sërish e ulët krahasuar me mesataren e BE-së si dhe krahasuar me 10 vendet e reja anëtare të BE-së (EU-10). Gjatë 2012, në Shqipëri, produktiviteti i punës qe 3,615 Euro për njësi vjetore pune (AWU) krahasuar me 6,914 Euro për AWU të regjistruar në EU-10<sup>6</sup>.

Shqipëria ka një deficit shumë të lartë tregtar të produkteve agro-ushqimore. Vlera e importeve është 6.7 herë më e lartë se vlera e eksporteve. Gjatë 2007-2012, eksportet agro-ushqimore, edhe pse me një bazë të ngushtë, kanë regjistruar një rritje të lartë prej 72%. Deficit tregtar i produkteve agro-ushqimore është rritur me 35%, por gjatë katër viteve të fundit rritja e deficitit ka qenë e vogël. Në 2012, eksporti i produkteve bujqësore drejt BE-së kapi vlerën e 40 milion Eurove ndërsa importet atë të 313 milion Eurove.

Megjithëse ekziston një tendencë pozitive për konsolidimin e fermave konkurrueshmëria e sektorit të bujqësisë është ndikuar negativisht nga madhësia e vogël e fermave bujqësore. Madhësia e fermave është rritur nga 1.14 ha në 1.20 ha gjatë 2007-2012. Segmenti i fermave rentabël të orientuara për prodhim për drejt tregut ka qenë gjithashtu në rritje. Megjithatë, fermat në Shqipëri janë kryesisht ferma të subsistencës (vetë-mbajtjes) dhe shumica e produkteve bujqësore janë të destinuara për konsum vetjak. Mes fermerëve ekziston një mungesë tradite si dhe dëshirë e kufizuar për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Numri i grupeve të prodhuesve dhe shoqërive të bashkëpunimit bujqësor (kooperativave) është i vogël pavarësisht përpjekjeve të disa prej donatorëve për të nxitur bashkëpunimin mes fermerëve lidhur me veprimtaritë e furnizimit dhe marketing-ut.

Sipas statistikave të MBZHRAU, rreth 1.6 milion persona jetojnë në ferma, nga të cilët 47% janë femra. Rreth 96% e fermerëve janë meshkuj. Vetëm 4% e fermerëve janë femra, pavarësisht faktit se femrat janë fuqia kryesore e punës në ferma.

Struktura e moshës së fermerëve është gjithashtu përkeqësuar. Numri i fermerëve të rinj nën 25 vjeç ka rënë dhe llogaritet të jetë vetëm 1%, ndërkohë që 33% e fermerëve janë mbi moshën 65 vjeç (2012).

Të dhënat e anketimeve të ndryshme tregojnë se në Shqipëri aftësitë e fuqisë punëtore në bujqësi janë reduktuar si pasojë e plakjes, emigrimit dhe mungesës së mundësive të të

<sup>6</sup>Burimi: Eurostat.

punësuarve rishtas për tu arsimuar apo trajnuar. Vetëm 3% e fermerëve janë me arsim të lartë universitar, 37% kanë arsim të mesëm ose, ndërsa 63% e tyre kanë arsim tetëvjeçar, fillor ose asnjërin prej tyre. Rreth një e treta e fermerëve janë të arsimuar në fushën e bujqësisë. Gjasat janë që këta janë fermerët e vjetër në moshë, të cilët në të kaluarën janë arsimuar në shkollat bujqësore profesionale.

Fermtat në Shqipëri kërkojnë intensitet të lartë pune, ndërkohë që niveli i përparimit teknologjik është i ulët. Një përqindje e lartë e fermave kanë mekanizim të vjetër, si dhe ndërtesa bujqësore apo ambiente ruajtje të papërshtatshme. Intensiteti i ulët i kthimit të kapitalit nga prodhimi ka rezultuar në produktivitet të ulët, kosto prodhimi relativisht të larta, cilësi të ulët, humbje dhe fitime të pakta.

Përmbushja e standardeve mjedisore, sigurisë ushqimore dhe mirëqenies së kafshëve vazhdon të jetë e ulët. Një përqindje e lartë e fermave bujqësore nuk arrin t'i përmbushë këto standarde si pasojë e burimeve financiare të kufizuara për të përmirësuar ambientet apo teknologjitë si dhe e mungesës së ndërgjegjësimit apo njohurive të këtyre standardeve. Zbatimi i legjislacionit është ende i dobët, gjë që zvogëlon nxitjen për të investuar në përmbushjen e këtyre standardeve.

*Investimet në bujqësi janë shumë të ulëta* si pasojë e shkallës së vogël të saj, kufizimet në burimet vetjake të fermerëve, dhe vështirësive në huamarrje. Në 2011 akumulimi buto i aktiveve afatgjata në bujqësi llogaritej në vetëm 60.4 milion Euro ose më pak se 4% e GVA-së.

*Sistemi bankar* është ndërmjetësi kryesor financiar në Shqipëri. Përqindja e kredive të dhëna sektorit të bujqësisë është shumë e ulët – më pak se 5% e totalit të portofolit të huave në Shqipëri. Furnizimi me kredi i bankave për bujqësinë kufizohet nga problemet strukturore që sektori ka, përfshirë madhësinë e fermave, plakjen e fermerëve, mungesën e aktiveve që mund të shërbejnë si kolateral, tregui pazhvilluar tokës, mungesa informacionit lidhur me situatën financiare të aplikantëve, etje.

*Industria e mikrofinancimit* vlerësohet se është e shtrirë tek 2.4% e popullsisë dhe në përafërsisht 80% të vendit. Industria e mikrofinancimit u jep hua sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SMEs), përfshirë të papunëve dhe subjekteve start-up, dhe disa prej këtyre institucioneve ofrojnë gjithashtu edhe asistencë teknike për sipërmarrësit (trajnime ose studime).

*Sistemi i arsimit bujqësor profesional* përfshin 9 shkolla të mesme të cilat mbulojnë fushat e mëposhtme: prodhim bimor (në 9 shkolla), prodhim shtazor (në 1 shkollë), veterinarin (në 2 shkolla), agro-biznes (në 5 shkolla), silvikulturë, prodhim lënde drusore dhe mobilierish (në 1 shkollë), mekanizim bujqësor (në 2 shkolla). Arsimimi në nivel universiteti në shkencat bujqësore ofrohet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) dhe Fakulteti i Bujqësisë së Korçës. UBT-ja është universiteti i vetëm i specializuar në ofrimin e studimeve universitare dhe pas-universitare, kërkimit shkencor, trajnimeve dhe ekstensionit në fushën e bujqësisë dhe përpunimit ushqimor.

*Shërbimi i ekstensionit bujqësor* është pjesë e strukturës së varësisë së MBZHRAU. Ky shërbim mundëson dhënien e informacionit, këshillimit dhe trajnimeve fermerëve dhe agrobiznesit. Në total ky shërbim ka 290 punonjës në nivel qendror dhe vendor. Në nivel qarku, shërbimi i ekstensionit është pjesë e 12 Drejtorive Bujqësore të MBZHRAU, në të cilin janë të punësuar specialistë të 3-4 llojeve të ndryshme fushash – në perimtarin, drufrutorë, blegtori, si dhe më pak ekonomistë bujqësorë. Shërbimi i Ekstensionit ka në përdorim 120 Qendra të Informimit Bujqësor (QIB) në nivel vendor, të cilat mbajnë lidhje të drejtë-për-drejtë me

komunitetin e fermerëve – ku më të mëdhatë gjenden në Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë, me një mesatare prej 14 punonjësish në secilën prej tyre.

Brenda shërbimit këshillimor kryejnë veprimtarinë e tyre pesë Qendra të Transferimi të Teknologjive Bujqësore (QTTB) të vendosura në – Fushë-Krujë, Korçë, Vlorë, Lushnjë dhe Shkodër, të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin e kërkimeve të aplikuara në fusha të ndryshme të bujqësisë. QTTB-të mbështesin MBZHRAU-n në formulimin e strategjive dhe hartimin e skemave kombëtare, transferimin e teknologjive tek bizneset bujqësore dhe ato të përpunimit ushqimor, furnizojnë me material të certifikuar mbjellës për disa prej farave dhe fidanëve etje. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në QTTB-të është 280.

Shërbimi publik Këshillimor (Ekstensionit) dhe Qendrat e Transferimit të Teknologjive përcjellin informacion çdo vit tek rreth 20% e fermerëve dhe agro-bizneseve. Çdo vit, më shumë se 8,000 fermerë asistohen nga stafi i shërbimit të ekstensionit për të zbatuar dhe përfituar nga skemat kombëtare të mbështetjes.

Problemet kryesore me të cilat përballet shërbimi ekstensionit publik janë: (i) numri i kufizuar i specialistëve (mesatarisht, një specialist për 1,700 fermerë) si dhe angazhimi i tyre me një sërë detyrash jashtë fushës së tyre specifike; (ii) mbështetja e pamjaftueshme financiare në formën e investimeve në qendrat e informacionit bujqësor dhe kostove operacionale për të përmbushur veprimtaritë e ekstensionit; (iii) mosha e madhe e specialistëve të ekstensionit dhe aftësitë e tyre të ulëta në fushën e teknologjisë së informacionit; (iv) kapacitete të kufizuara në menaxhimin e fermave, planifikim biznesi dhe marketing, si dhe në dhënien e mbështetjes dhe asistencës teknike në sektorë të tjerë (si p.sh. përpunuesve, tregtarëve të shumicës, tregtarëve të pakicës); (v) dhënie e ulët/e pamjaftueshme e asistencës veçanërisht në zonat malore/ato të largëta; (vi) rritja e njohurive për sa i përket funksionimit të zinxhirëve të vlerës (nga prodhimi deri tek marketingu) si dhe përfshirja e njohurive mbi ekonominë e fermave dhe menaxhimin të biznesit në të gjitha programet kërkimore dhe ato të ekstensionit.

*Përpunimi ushqimor* është një sektor ekonomik relativisht i vogël në Shqipëri. Gjatë 2011 GVA-ja e industrisë ushqimore kapte vlerën e 64.4 milion Eurove me një total të punësuarish prej 14,000 personash. Në industrinë e përpunimit ushqimor operojnë përafërsisht 2000 kompani, 95% e të cilave janë mikrosipërmarrje. Industritë më të rëndësishme të përpunimit ushqimor në Shqipëri janë prodhimi i miellit dhe i bukës, prodhimi i pijeve jo-alkoolike, si dhe përpunimi i mishit dhe qumështit.

Zhvillimi i sektorit të përpunimit ushqimor në Shqipëri është i kufizuar nga një numër faktorësh, disa prej të cilave lidhen me pamjaftueshmërinë e lëndës së parë, mungesën e homogjenitetit në lidhje me sasinë dhe cilësinë e saj, integrimin jo të zhvilluar vertikal mes prodhuesve të lëndës së parë dhe industrisë përpunuese, mungesën e burimeve për përmirësimin e cilësisë përmes futjes në përdorim të sistemeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Futja në përdorim e sistemeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore ka filluar, por deri tani vetëm në kompanitë e mëdha të përpunimit. Investimet për përmbushjen e standardeve të mbrojtjes mjedisore dhe trajtimit të mbetjeve janë të pakta për momentin

Në mënyrë të ngjashme me prodhimin primar, rritja e sektorit të prodhimit ushqimor pengohet nga burimet e brendshme të kufizuara të sipërmarrësve dhe vështirësia e tyre për huamarrje.

Në 2012, *pyjet dhe tokat e tjera të veshura me pemë* mbulojnë 1,041,390 ha, ose 36.2% të territorit të përgjithshëm në Shqipëri. Rreth 51% e pyjeve janë në pronësi të shtetit, 47% - të qeverisë vendore dhe 3% - në pronësi private<sup>7</sup>.

Vendi ka pesë lloje pyjesh: me shkurret mesdhetare, pyje lisi, pyje ahu, bredhi Mesdhetar, dhe zona alpine. Nga sipërfaqja totale e pyjeve, 47% e përbëjnë pyjet e larta me ahe, lisa dhe ato me pishën e zezë si varietetet kryesore. Zabelet përbëjnë 29%, dhe 24% janë të kategorizuara si pyje me shkurre.<sup>8</sup>

Pyjet e disponueshme për furnizim me dru (FAWS) mbulojnë 513,460 ha, nga të cilat 95% janë në pronësi të institucioneve publike dhe 5% në pronësi private<sup>9</sup>.

Kontributi i pyjeve në ekonominë e vendit ka mbetur i vogël. Shumica e trupave drusore të prodhuara në Shqipëri përdoren për ngrohje. Produktet (BMA) dhe shërbimet jo drusore janë një burim i rëndësishëm të ardhurash në zonat rurale në Shqipëri. Janë 23 rezervate gjuetie (në pyje dhe laguna), me një sipërfaqe prej rreth 35,000 ha.

Menaxhimi i pyjeve është decentralizuar përmes transferimit të rreth 50% të sipërfaqes së pyjeve dhe kullotave njësisive të qeverisjes vendore të cilat janë përgjegjëse për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve, krijimin e organeve administrative dhe teknike për të kryer inventarizimin e pyjeve dhe hartimin e planeve të investimeve. Komunat janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve lokalë në përputhje me planet e menaxhimit. Në disa zona, janë të organizuara shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve të cilat kanë të drejtën e përdorimit të tyre për veprimtari të tilla si kullosa, marrja e druve të zjarrit dhe mbledhje e bimëve medicinale dhe aromatike (të drejtat e përdorimit nuk përfshijnë të drejtën për të shitur lëndë drusore).

### *Prezantim i detajuar i sektorëve prioritarë të përzgjedhur*

#### *Mishi dhe Produktet e Mishit*

Shqipëria ka traditë të gjatë në mbarështimin e *blegtorisë*, veçanërisht në mbarështimin e bagëtive të imta<sup>10</sup>.

**Tabela 3.1: Kafshë bujqësore**

Blegtori	2007	2008	2009	2010	2011	2012
	‘1000	2007=100				
<b>Gjedh</b>	<b>498</b>	<b>94</b>	<b>86</b>	<b>85</b>	<b>85</b>	<b>86</b>
Lopë	358	91	89	90	89	90
<b>Të imta</b>	<b>2,619</b>	<b>96</b>	<b>93</b>	<b>95</b>	<b>92</b>	<b>96</b>
Dele	1,809	97	95	97	95	98
D. qumështi	1,390	96	95	97	98	101
Dhi	810	94	88	88	87	92
Dhi qumështi	614	98	93	93	94	99

<sup>7</sup>INSTAT.

<sup>8</sup>WB, *Financimi Inovativ për Menaxhimin e Qëndrueshëm të pyjeve në Ballkanin Jugperëndimor*.

<sup>9</sup>Ministria e Mjedisit.

<sup>10</sup>*Studim i Sektorit të Mishit*, Studimi u përgatit në vitin 2010 dhe u azhurnua në 2013 nga Projekti “Përgatitja për strategjinë ndër-sektoriale të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga FAO.

<b>Derra</b>	<b>159</b>	<b>110</b>	<b>109</b>	<b>112</b>	<b>111</b>	<b>108</b>
Dosa	12	88	81	81	75	75
<b>Shpendë</b>	<b>9,494</b>	<b>114</b>	<b>117</b>	<b>118</b>	<b>130</b>	<b>133</b>
Pula	5,938	106	109	111	139	126

Burimi: INSTAT 2013

më të rralla. Ferma delesh janë 47,000, ndërsa 23,500 janë ferma dhish (2012). Prodhimi vazhdon të jetë shumë i fragmentarizuar, me shumicën e fermave të gjedhit, të imtave dhe të mbarështimit të derrave të vogla, ose shumë të vogla.

Numri i përgjithshëm i krerëve në 2012 ishte 937,000, nga të cilat gjedhët përbëjnë 48%, të imtat 28%, shpendët 11%, njëhundraçet 8% dhe derrat 5%.

Numri i gjedhëve në 2012 ishte 498,000, ose 14% më pak se në 2007. Numri i të imtave ishte 2,619,000, ose 4% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë. Madhësia e tufës së shpendëve është rritur me 33%, duke arritur kështu 9,494,000 në 2012.

Për vitin 2012, totali i prodhimit të mishit ishte 150,000 ton. Prodhimi ra në 2008, por pati një rritje modeste gjatë periudhës 2009-2012. Gjedhi është nën-sektori më i madh i prodhimit të mishit, me 69,000 ton (46%) ndjekur nga ai i prodhimit të mishit nga të imtat – 48,000 ton (32%). Të dy këta sektorë regjistruan rritje gjatë periudhës 2009-2012.

Ekziston një kërkesë e fortë vendase për produkte blegtorale duke qenë se drithërat, mishi dhe produktet e qumështit përfaqësojnë pjesën kryesore të konsumit ushqimor të konsumatorit Shqiptar. Konsumi vjetor i mishit është rritur duke arritur 66 kg për person në 2012.

Eksportet e mishit janë të ulëta, ndërsa importet mbeten të larta dhe të qëndrueshme gjatë viteve të fundit në nivelet 36,000 ton në 2012, që korrespondon me rreth ¼ e furnizimit të brendshëm. Për më tepër, kemi një rritje të importeve të bagëtive të gjalla, veçanërisht derrave dhe gjedhëve. Importi i shpendëve është gjithashtu i lartë duke arritur 23,900 tonë në 2012, ose 65.7 % të totalit të mishit të importuar, ndjekur nga importi i derrave (10,901 ton në 2012 ose 30% e totalit të mishit të importuar). Arsyeja pas nivelit relativisht të lartë të importit të mishit të pulës është kostoja e ulët e mishit të importuar.

Prodhimi i mishit të gjedhit është i përqendruar në qarqet e Fierit (16%), Elbasanit (15%), Tiranës (10%), dhe Korçës (9%), të cilat së bashku përbëjnë më shumë se gjysmën e prodhimit total. Shumica e fermave që mbarështojnë gjedh nuk janë të specializuara në prodhimin e mishit dhe materiali gjenetik i kafshëve në përgjithësi nuk është i orientuar karshi atij për prodhimin të mishit me cilësi të lartë. Racat e gjedhit për mish nuk mbarështohen në Shqipëri, gjë që shpjegohet nga kostoja e lartë e racave të pastra të gjedhit për mish si dhe mungesa e njohurive mbi teknologjitë mbarështimit dhe po ashtu praktikat e dobëta të menaxhimit të fermës.

Fermat e gjedhëve që prodhojnë mish janë të orientuara drejt tregut të produkteve të freskëta, duke qenë se industria e përpunimit të mishit përdor kryesisht mish importi në ngrirje të thellë i cili është shumë më i lirë. Duke qenë se shumica e fermerëve nuk janë të specializuar në prodhimin e mishit dhe iu mungojnë burimet financiare për blerjen e ushqimit të kafshëve, kafshët theren përpara se të arrijnë peshën e mjaftueshme, gjë që redukton të ardhurat.

Në fushën e mbarështimit të gjedhit, dominon sistemi i prodhimit ekstensiv. Ushqyerja e blegtorisë bazohet kryesisht tek foragjeret dhe kullota/livadhe duke u plotësuar me koncentrate ushqimore dhe minerale. Zhvillimi i sektorit të blegtorisë ka rritur kërkesën për ushqime kafshësh dhe tagji. Prodhimi i foragjereve është rritur dhe sipërfaqet e kultivuara kanë arritur në 209,000 ha gjatë 2012. Në fermat më të vogla, foragjeret korren shumë shpesh me dorë dhe ekzistojnë probleme me barërat e dëmshme dhe kushtet e ruajtjes së kashtës.

Makineritë për prodhimin e foragjereve nuk janë të zhvilluara, por gjithsesi shërbime me makineri private për prodhimin e foragjereve dhe korrjen janë të disponueshme. Në përgjithësi, ekziston nevoja për të përmirësuar cilësinë e foragjereve dhe për të rritur disponueshmërinë e farërave me cilësi të larta gjenetike të bimëve foragjere, të cilat përshtaten me kushtet lokale.

Përdorimi i kompostove ushqimore ka ardhur në rritje. Vlerësohet se 80% e prodhimit përdoret nga fermat intensive të shpendëve, dhe 15% nga prodhuesit komercialë të qumështit/gjedhit. Disa prej kompanive prodhojnë vetëm për nevojat e tyre, ndërsa të tjerë e tregtojnë një pjesë të prodhimit. Kompanitë kryesore prodhuese kanë pajisje dhe teknologji moderne si dhe sisteme të certifikuara për kontrollin e cilësisë. Tregu i kompostove ushqimore është i përqendruar dhe çmimet janë të larta.

Në Shqipëri, mbarështimi i deleve dhe dhive zhvillohet kryesisht në zonat më pak të favorizuara, ku një veprimtari e tillë shpesh është e vetmja mundësi dhe për pasojë jep një kontribut thelbësor në ekonominë rurale. Prodhimi i mishit nga të imtat (dele dhe dhi) është i përqendruar në qarqet e Vlorës (18%), Korçës (16%), Elbasanit (12%) dhe Gjirokastrës (11%), që së bashku përbën 57% të totalit të prodhimit. Në disa qarqe, *fermat e të imtave* janë të specializuara kryesisht në prodhimin e qumështit, ndërsa në disa të tjera – prodhohet në mënyrë të kombinuar mish dhe qumësht. Të ardhurat nga mishi merren nga shitja e qengjave dhe e atyre të remontit. Pësia mesatare e qengjave në therje është në shumë raste tepër e vogël; fermerët i shesin qengjat shumë herët, duke qenë se çmimet ngrihen përpara festave fetare, ose të tjerë që janë të përqendruar më shumë tek qumështi përpiqen që ti shesin qengjat sa më herët. Fitimet e fermave variojnë gjerësisht në varësi të cilësisë së praktikave të menaxhimit të fermës.

Sistemi i prodhimit është i bazuar zakonisht në kullota (sipërfaqe të mbjella) ekstensive dhe në punën intensive. Ushqyerja e deleve mbështetet në ushqyerjen e lirë, veçanërisht në kullota, si në dimër ashtu edhe në verë. Gjatë verës përdoren gjithashtu edhe sipërfaqet e sapo korrura. Dhitë gjithashtu varen pothuajse plotësisht nga ushqyerja në kullota, veçanërisht në sipërfaqet me shkurre dhe zabele. Tagjia e mbledhur nga pemët e lisave/dushqeve përdoret kryesisht në dimër. Produktiviteti ndikohet negativisht nga pamjaftueshmëria e ushqimit, veçanërisht gjatë dimrit. Në përgjithësi, gjatë dimrit fermerët e përshtasin madhësinë e tufës sipas disponueshmërisë së ushqimit të sezonit.

Burimet e kullotave, përfshirë pyjet dhe tokën bujqësore, janë shumë të rëndësishme për prodhimet nga të imtat. Natyra shqiptare kanë një larmi bimësh të ndryshme dhe habitatesh që kafshët që kullosin mund ti përdorin. Problemet kryesore të lidhura me kullotat janë: (i) menaxhimi i dobët i tyre, kullotja pa kriter dhe prerja e pyjeve, të cilat kanë rezultuar në produktivitet të ulët dhe rritje të erozionit; (ii) mungesa e ujit në kullotat verore; (iii) hapësira të kufizuara për kullotat dimërore; (iv) problem me pronësinë dhe mungesa e kontratave afatgjata të qirasë; (v) mungesa e zbatimit të rregullave mbi kullotat pjesë e fondit e komunave/shtetit.

Për sa i përket gjedhit dhe të imtave intensiteti i akumulimit të kapitalit nga prodhimi është i ulët. Shumica e fermave përdorin pajisje dhe teknologji të vjetruara. Gjedhët mbahen në stalla primitive me regjim të lidhur, shpesh edhe pa dritare. E gjithë puna nga ushqyerja tek largimi i plehut bëhen me dorë. Fermat më të mëdha të specializuara, më së shumti ato të qumështit se satë mishit, kanë kushte më të mira, por shumica përdorin ndërtesa të vjetra për stalla, me disa përshtatje. Shpesh në to mungon elektriciteti, stallat janë në errësirë dhe shumë pak ferma kanë instalime për largimin e mbetjeve, kjo kryesisht sepse puna e krahut është e lirë në këto zona.

Për sa i përket të imtave në disa prej kullotave verore, për të strehuar kafshët përdoren strehime shumë të thjeshta. Gjatë dimrit kafshët strehohen në ambiente më të mira, por sërish të thjeshta. Të imtat e fermave të subsistencës shpesh mbahen në ferma. Këto ferma nuk kanë vende të përshtatshme depozitimi për plehun apo plehun e lëngshëm, gjë që ka ndikim negative mbi ambientin.

*Prodhimi i mishit të derrit* ka qenë i qëndrueshëm për periudhën 2007-2013 me një output vjetor prej 16,000-17,000 tonësh, ose 11% e totalit të prodhimit të mishit në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe, importet kanë qenë në rënie dhe plotësimi i nevojave me prodhimin vendas në rritje. Rreth dy të tretat e prodhimit janë të përqendruara në 3 qarqe - Lezhë, Shkodër dhe Fier. Teknologjia dhe produktiviteti i fermave në sektorin e derrit variojnë në mënyrë domethënëse. Disa prej fermave më të mëdha kanë stalla të reja me teknika automatike të ushqyerjes dhe prodhim të integruar, përfshirë prodhimin e ushqimit të kafshëve, therjen, përpunimin dhe tregtinë me pakicë.

*Prodhimi i mishit të shpendëve* është rritur nga 13,000 ton në 2007 në 17,000 ton në 2012. Në 2012 prodhimi vendas mbulonte 41% të tregut dhe plotësimi i nevojave me prodhim vendas ka pasuar rënie. Me përjashtim të tufave të oborrit, prodhimi i shpendëve është i përqendruar në stabilimentet industriale. Ekzistojnë rreth 40 ferma prodhimi të mishit të shpendëve, 17 prej të cilave mbajnë më shumë se 10,000 krerë. Qarqet më të rëndësishme janë Fieri me përafërsisht 30% të prodhimit, dhe Tirana me 18%. Kushtet e ambienteve dhe ato sanitare janë të kënaqshme me pajisje dhe menaxhim të përshtatshëm. Në mbarështimin e shpendëve ekziston një tendencë për të ndërtuar një zinxhir operacionesh të integruara dhe të kompletuara, nga pularitë, në mullinjtë e ushqimit të tyre, deri në tregun e pakicës. Këto pulari të reja, të tipit stabiliment agrobiznesi, përdorin ushqim shpendësh të lirë, që shpesh prodhohet në mullinjtë e tyre, gjë që përmirëson eficienten. Disa prej pularive kanë investuar në thertore moderne. Por, këto pulari kanë mungesë të praktikave të duhura të menaxhimit të mbetjeve. Me shumë pak përjashtime, këto pulari nuk kanë ambiente për depozitimin dhe trajtimin e plehut.

*Spektori i thertoreve* në Shqipëri është i përbërë nga një numër i madh njësisish të vogla, kryesisht me pajisje të vjetra, pjesë e të cilave nuk janë as në funksion. Janë vetëm më pak se 20 thertore të cilat përbushin tërësisht ose pjesërisht standardet kombëtare. Kapaciteti i këtyre thertoreve varion nga 10-40 gjedh dhe nga 20-100 të imta në ditë. Në 5 qarqe nuk ka asnjë thertore që përbush standardet minimale kombëtare.

Në shumicën e rasteve janë Bashkitë ato që kanë pronësinë e thertoreve ekzistuese të cilat nuk menaxhohen siç duhet. Në disa raste, bashkitë i japin me qira ambientet e tyre tek sektori privat. Përgjithësisht këto ambiente janë të vjetruara dhe në shumicën e rasteve ato nuk përbushin kërkesat e ligjit Shqiptar. Për rrjedhojë, standardet e BE-së mbi higjienën, gjurmueshmërinë dhe HACCP-in nuk zbatohen dhe mbetjet e lëngshme apo të ngurta thjesht hidhen në landfill-e apo largohen me ujine lumit më të afërt. Kushtet e disa thertoreve janë kaq të këqija sa që ato as nuk mund të modernizohen dhe investimet për mbrojtjen e mjedisit janë të domosdoshme.

Thertoret ekzistuese punojnë me kapacitet shumë më të ulët nga se sa ç'kanë mundësi si pasojë e zbatimit jo të duhur të ligjit. Shpesh kafshët theren në ferma dhe në të ashtuquajturat pika therjeje me pajisje primitive. Këto pika nuk janë të regjistruara dhe nuk kontrollohen nga qeveria vendore. Thertoret punojnë shumë më pak nga se sa ç'kanë kapacitet për shkak se tregtarët dhe kasapët nuk detyrohen të therin atje.

Numri i përgjithshëm i kompanive të përpunimit të mishit në vend është 63, nga të cilat 10 kanë ambiente dhe pajisje moderne. Dhjetë kompanitë më të mëdha të përpunimit zotërojnë



rreth 80% të tregut. Industria e përpunimit të mishit mbulon prodhimin e varieteteve të gjera të sallameve dhe salsiçeve me mish vici, lope dhe derri.

Ambientet dhe pajisjet e kompanive kryesore të përpunimit të mishit janë moderne dhe përmbushin standardet kombëtare. Këto kompani mbajnë dokumentim të saktë të prodhimit të tyre, përfshirë gjurmueshmërinë, si dhe aplikojnë sistemin HACCP. Këto kompani janë rentabël dhe synojnë të kryejnë investime të tjera.

Marrëdhëniet e industrisë së përpunimit të mishit me bujqësinë vendase janë të dobëta. Afërsisht 90% e mishit të përpunuar në Shqipëri importohet. Disa prej përpunuesve importojnë edhe kafshë të gjalla, kryesisht nga BE-ja. Preference për mishin e importit lidhet me çmimet e ulëta, furnizimin e rregullt, cilësinë e standardizuar dhe aspektet logjistike më të thjeshta. Një numër i vogël i përpunuesve të mishit blejnë mish të freskët vendi në treg me qëllim për ta shitur atë në dyqanet e tyre.

Një dobësi e veçantë e industrisë së përpunimit të mishit është largimi i mbetjeve. Mungojnë sistemet e largimit të mbetjeve të lëngshme dhe të ngurta. Në përgjithësi, mbetjet e lëngshme apo të ngurta nga therjet nuk trajtohen në përputhje me kërkesat e higjienës dhe ato mjedisore, por largohen direkt në kanalet e ujërave të zeza dhe depozitohen në landfill-e. Një nga shqetësimet më të mëdha mjedisore në Shqipëri është mungesa e stabilimenteve të përpunimit të mbetjeve të thertoreve (rendering plants).

#### *Prodhimi dhe Përpunimi i Qumështit*

Në 2012 numri i lopëve të qumështit ishte 358,000, i deleve të qumështit 1,390,000 dhe i dhive të qumështit 614,000<sup>11</sup>. Deri në 2008 numri i lopëve të qumështit ishte në rënie por në vitet e fundit tufat janë stabilizuar. Një rritje e vogël paraqitet në numrin e deleve të qumështit. Prodhimi i qumështit të lopës bëhet kryesisht përgjatë ultësirës dhe kodrave të buta; mbarështimi i deleve për qumësht është i përqendruar në jug të vendit, ku ndodhen edhe baxhot e specializuara të djathit.

Prodhimi vendas i qumështit ka arritur në 1.1 milion ton në 2012, duke shënuar një rritje prej 9% krahasuar me vitin 2007. Prodhimi i qumështit dominohet nga prodhimi i qumështit të lopës (87%), ndërsa pjesa tjetër është e ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë mes atij nga delet dhe dhitë.

Megjithëse rendimenti i qumështit është rritur në mënyrë domethënëse përgjatë dekadës së fundit, ai gjithsesi mbetet i ulët. Rendimenti mesatar vjetor i qumështit të lopës është 2,698 litra për lopë, i qumështit të deles 60 litra dhe i qumështit të dhisë 110 litra (2012). Nga qarku në qark këto rendimente kanë ndryshime të mëdha.

Shumica e *njësive të prodhimit të qumështit të lopës janë tepër të vogla*, me 1 ose 2 lopë për fermë me një mesatare prej 1.7 lopësh. Në 2011 rezultonin vetëm 3,400 ferma me më shumë se 5 lopë. Shumica e prodhuesve të qumështit të lopës janë ferma shtëpiake të gjysmë subsistencës. Fermat më të vogla shesin më pak se gjysmën e qumështit tek industria përpunuese, ndërsa fermat me më shumë se 3 lopë shesin 95% të qumështit tek përpunuesit.

Në fermat e vogla të qumështit lopët zakonisht milen me dorë, gjë që ndikon negativisht higjienën dhe sigurinë ushqimore. Vetëm ato ferma qumështi, të specializuara në prodhimin e

---

<sup>11</sup>*Studim i Sektorit të Qumështit*, Studimi u përgatit në 2010 dhe u azhornua në 2013 nga Projekti “Përgatitja e strategjisë ndër-sektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri”, financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga FAO.

tij (me normalisht më shumë se 6 lopë) kanë filluar të blejnë pajisje të thjeshta mjeljeje gjatë viteve të fundit. Fermat me më shumë se 50 lopë zakonisht kanë tankera për ruajtjen e qumështit me sisteme ftohjeje dhe salla mjeljeje.

Cilësia e qumështit të papërpunuar ndikohet nga kushtet e papërshtatshme higjieno-sanitare të fermës, pajisjet e papërshtatshme të mjeljes, ruajtjen dhe transporti itij, mungesa e njohurive, informacionit dhe aftësive të lidhura me higjienën e qumështit, teknikat e mjeljes, ruajtjen dhe ftohjen e tij, si dhe standardet e sigurisë ushqimore. Nxitjet financiare me qëllim rritjen e cilësisë së qumështit, duke qenë se çmimet përcaktohen kryesisht nga sasia, si dhe përmbajtja e lëndës së thatë dhe e yndyrës janë ose të kufizuara ose jo-ekzistente.

Shumica e prodhuesve të qumështit nuk kanë informacion lidhur me situatën mikrobiologjike të qumështit që ata prodhojnë. Në Shqipëri mungon një sistem profesional i marrjes së mostrave, transportit të tyre në laborator, kryerjes së analizave laboratorike dhe i raportimit të rezultateve tek fermerët, përpunuesit apo autoritet e sigurisë ushqimore.

Fermat e *sektorit të imtave* janë gjithashtu të vogla. Numri mesatar i kafshëve në mjelje është 24 për çdo fermë. Rreth 12,000 ferma (15 % e të gjitha fermave të prodhimit të qumështit) kanë më shumë se 50 dele ose dhi në fermë. Vërehet një tendencë për shtimin e shpejtë të fermave me numër më të madh delesh.

Në sektorin e të imtave, dominojnë racat e vendit duke qenë se ato janë përshtatur mirë me kushtet lokale klimaterike dhe praktikat e menaxhimit. Nga ana tjetër, potenciali prodhimit të tyre është i kufizuar, megjithëse duhet theksuar se është ende jo i shfrytëzuar plotësisht. Fermerëve u mungojnë mjetet financiare për përmirësimin racor të tufave të tyre.

Mjelja në fermat e të imtave në Shqipëri bëhet me dorë. Kova e qumështit është e ekspozuar në mënyrë konstante ndaj kushteve mjedisore gjatë procesit të mjeljes. Shumica e tufave milen në vend qëndrimet e tyre, gjë që paraqet rrezik për kontaminimin e qumështit. Në zonat malore, qumështi kryesisht ruhet duke përdorur ujë të ftohtë të rrjedhshëm. Ruajtja e qumështit në frigorifer pothuajse nuk përdoret .

Ky sektor vuan gjithashtu edhe nga emigrimi në rritje nga zonat rurale dhe mungesës së nxitjes që ky sektor i ofron të rinjve. Cilësia e infrastrukturës është gjithashtu problematike – ku mund të përmenden cilësia e keqe e rrugëve dhe kufizimet në mundësinë për furnizimin me ujë në zonat malore.

Qumështi i të imtave kryesisht përdoret për prodhimin e djathit dhe shumë pak për konsum direkt. Konsumi direkt shkon kryesisht për nevojat e vetë familjes fermere. Fermerët të cilët e tregtojnë qumështin e tyre, furnizojnë përgjithësisht baxhot e vogla tradicionale. Organizimi i grumbullimit dhe përpunimit të qumështit të të imtave është i dobët dhe bëhet më së shumti përmes rrjeteve informale.

Tregu (kryesisht ai i qumështit të lopës) karakterizohet nga ekzistenca e kanaleve tregtare informale (tregtimi direkt nga ana e fermerëve) dhe formale (grumbullimi dhe shpërndarja nga përpunuesit). Përgjithësisht nuk ekziston sistemi i kontratave mes prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit.

Një nga pikat më të dobëta të zinxhirit të vlerës është grumbullimi dhe transporti i qumështit. Grumbullimi i qumështit është i organizuar kryesisht nga përpunuesit dhe nga grumbulluesit jo-përpunues. Shpesh ky qumësht nuk ruhet në tankera ftohës as përgjatë gjithë periudhës së qëndrimit në fermë dhe as gjatë transportit për në stabilimentin e përpunimit. Për më tepër, shumica e enëve mbajtëse të qumështit, kova dhe bidona transporti, të cilat janë në kontakt të drejtë për drejtë me qumështin, nuk janë të prodhuara me materiale plastike apo çeliku të

përshtatshme për kontakt me ushqimin. Prodhuesit e qumështit rëndom i pastrojnë apo dezinfektojnë këto enë në mënyrë të papërshtatshme.

*Industria e përpunimit të qumështit* duket se po tregon progres së fundmi me ndërtimin e stabilimenteve të reja moderne, veçanërisht në zonat e ulëta; por pavarësisht kësaj, kjo industri ende mbetet e fragmentarizuar. Numri total i stabilimenteve të përpunimit të qumështit në Shqipëri është 430<sup>12</sup>.

Në 2012 nga kjo industri janë prodhuar 110,500 hl qumësht, 33,936 ton kos, dhe 13,264 ton djathë. Gjatë periudhës 2007-2012 u regjistrua edhe rritja më e madhe në prodhimin e qumështit 87% dhe kosit 130%. Rritja në prodhimin e djathit ishte e vogël me vetëm 3%.

Janë 330 njësi sezonale ose të vogla që përpunojnë djathë nga qumështi i të imtave, me teknologji të thjeshtë tradicionale dhe që funksionojnë me sezone. Kushtet e higjienës të shumicës së këtyre njësive nuk i përmbushin kërkesat e legjislacionit Shqiptar dhe ato të standardeve të BE-së.

Ekzistojnë rreth 25 kompani moderne përpunimi të cilat aplikojnë teknologji të avancuara, me kapacitet përpunimi nga 10-50 ton qumësht në ditë. Këto kompani kanë kapacitete përpunimi optimale, diversitet të lartë produktesh dhe po zënë një përqindje gjithnjë e në rritje të tregut vendas.

Në tërësi ky sektor vazhdon të operojë me teknologji të vjetruar, gjë që kufizon përmirësimin e cilësisë dhe diversifikimin e produkteve. Djathi kryesisht prodhohet në stabilimentete vogla të përpunimit me pajisje elementare dhe kapacitete të vogla prodhuese. Janë vetëm pak stabilimente të mëdha dhe të pajisura mirë që prodhojnë djathë kryesisht nga qumështi i të imtave.

Shumica e këtyre stabilimenteve të prodhimit të djathit nuk kanë procedura standard funksionimi si dhe pajisje për monitorimin e parametrave teknikë (temperaturës, fermentimit, pajisjet e duhura për pasterizim, skremim, filtrim, ftohje, stazhonim), të paketimit, marketingut dhe etiketimit të djathit. Duke qenë se rreth 70% e stabilimenteve të djathit nuk kanë kapacitete të përshtatshme ruajtje, qumështi përpunohet çdo ditë. Shkeljet e parametrave të cilësisë dhe higjienës përgjatë zinxhirit të prodhimit dhe përpunimit ndikojnë negativisht cilësinë e produktit.

Vetëm një numër i vogël stabilimentesh përpunimi kanë future në përdorim ose zbatojnë plotësisht sistemet menaxhimit të sigurisë ushqimore. Vetëm disa nga përpunuesit e mëdhenj të djathit kanë sisteme të brendshme të kontrollit të cilësisë, përfshirë kontrollin e qumështit bruto. Kompanitë nuk kanë burime për futjen në përdorim të sistemeve të sigurisë ushqimore duke qenë se kjo kërkon investime domethënëse për rehabilitimin e mjediseve dhe blerjen e pajisjeve të kontrollit dhe atyre laboratorike.

Industria e përpunimit të qumështit nuk posedon ambiente të përshtatshme apo praktika për trajtimin dhe përdorimin e mbetjeve. Trajtimi i ujërave të mbetjeve nga pastrimi dhe nga procesi i përpunimit në shumicën e kohës nuk bëhet në përputhje me standardet.

Kuadri ligjor mbi rregullat e higjienës për sa i përket hedhjes së produkteve me origjinë shtazore në treg është pjesërisht i përafëruar më *acquis-in e* BE-së. Kontrollat në lidhje me zbatimin e legjislacionit vendas nuk janë plotësisht efektive si pasojë e mungesës së pajisjeve të inspektimit, mungesës së sistemeve të informacionit për bërjen e identifikimit, kontrollit dhe ndjekjes në vijimësi, si dhe kapaciteteve laboratorike të pamjaftueshme etje.

---

<sup>12</sup>Burimi i të dhënave: ADAMA.

*Fruta - Perimet*

Sektori i fruta perimeve përfiton nga kushtet e favorshme klimaterike që mundësojnë prodhimin e hershëm të disa lloje frutash dhe perimesh, gjë që përbën një potencial të rëndësishëm eksportesh<sup>13</sup>. Ka pasur rritje të investimeve në ngritjen e serave të reja dhe pemëtoreve, të investimeve në fushën e pas-vjeljes, kryesisht në ambiente frigoriferike për frutat me mbështetjen e skemave kombëtare dhe donatorëve, të cilët e kanë orientuar mbështetjen e tyre drejt zhvillimit të zinxhirit të vlerës. Rritja e përvojës së fermave dhe tregtarëve ka ndikuar në mënyrë pozitive zhvillimin e sektorit.

**Tabela 3.2: Dinamika e prodhimit të perimeve gjatë viteve 2007 – 2012**

Përshkrimi	2007	2012
Sipërfaqe me perime, përfshirë shalqi dhe pjepër (000 ha)	28.1	31
Në sipërfaqe të mbrojtura (ha)	683	940
Prodhim perimesh (000 t)	671	914
<i>Nga të cilat: perime serash (000 t)</i>	56.3	78.5
Sipërfaqja totale me patate (000 ha)	8.2	9.3
Prodhim patatesh (000 t)	154	233
Sipërfaqja totale me fasule (000 ha)	14.6	14.6
Prodhim fasulesh (000 t)	20.8	27.2

Burimi: MBZHRAU 2011 dhe INSTAT 2013

në prodhimin e perimeve në sera.

Baza e prodhimit konsiston në rreth 31,000 ha tokë të kultivuar me perime në fushë, dhe bostanorë, 9,300 ha e kultivuar me patate, 14,600 ha e kultivuar me fasule dhe rreth 730 ha e kultivuar në sipërfaqe të mbrojtura (Tabela 3.2). Gama e perimeve të prodhuara në Shqipëri është relativisht e gjerë, me rreth 30 lloje perimesh të ndryshme, ku dominojnë domatet, kastravecët dhe specat.

Totali i volumit të prodhimit vendas të perimeve në 2012 arriti 914,000 ton, me një rritje prej gati një të tretën krahasuar me 2007, duke përfshirë 254,400 ton shalqinj dhe pjepër, 233,000 ton patate dhe 27,200 ton fasule.

Tregu vendas dominohet nga prodhimi në vend, me përjashtim të muajve të dimrit, kryesisht për shkak se kostoja e lartë e lëndës djegëse për ngrohjen e serave zvogëlon konkurrueshmërinë kundrejt produkteve të importit. Ekziston një kërkesë në rritje për fruta-perime të freskëta ku preferenca e konsumatorëve anon qartë nga prodhimi vendas.

Prodhimi i frutave është i shpërndarë mirë në të gjithë vendin në përputhje me kushtet klimaterike dhe traditën lokale. Pemët më të rëndësishme janë mollët, ku vendin kryesor të prodhimit e zë Korça. Rreth 152,000 ferma, ose 43% i numrit total të fermave, prodhojnë fruta të ndryshme nga rrushi.

Specializimi rajonal është gjithashtu i lartë për sa i përket kumbullës, qershive dhe fiqve. Në këto fusha specializimi ekziston edhe një përqendrim i shërbimeve të know-how; cilësia e

<sup>13</sup>Studim i Sektorit të Fruta-Perimeve, Studimi u përgatit në 2010 dhe u azhurnua në 2013 nga Projekti "Përgatitja e strategjisë ndër sektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri", financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga FAO.

produkteve është e dallueshme edhe nga konsumatorët vendas, duke u dhënë kështu prodhuesve të këtyre zonave një avantazh konkurrues.

Prodhimi i frutave të freskëta është rritur me 73.3% që nga viti 2007, duke arritur 208,000 ton në 2012. Në rastin e mollëve (fruti kryesor vendas), prodhimi pothuajse është dyfishuar në krahasim me vitin 2007.

Edhe prodhimi i arrorëve është rritur ndjeshëm dhe pritet që të rritet edhe më tej si rezultat i mbjelljeve të kohëve të fundit të nxitura nga skemat e mbështetjes kombëtare, ku që nga 2007 janë mbjellë 1,268 ha.

Aktualisht, kostoja e prodhimit dhe çmimi në fermë i fruta perimeve është i lartë dhe jo konkurrues si pasojë e mungesës së infrastrukturës së pas-vjeljes, mungesës së investimeve në teknologji, veçanërisht në sistemet e ujitjes, pajisje trajtimi dhe vjeljeje dhe mungesës së ekonomive të shkallës.

Kostoja e prodhimit të perimeve është e lartë si pasojë e mungesës së ekonomive të shkallës, kostot e larta dhe cilësisë së dobët të input-eve, investimeve të pakta në mekanizimin dhe ujitjen në shkallë të vogël, veçanërisht në fermat e vogla tradicionale. Gjer më sot, konkurrueshmëria e perimeve të freskëta Shqiptare në tregun vendas është ndihmuar nga: (i) preferenca e fortë e konsumatorëve për prodhime vendase, (ii) zinxhiri i shkurtër i shpërndarjes, (iii) mungesa e ambienteve frigoriferike në tregjet përfundimtare dhe veçanërisht në ato të Tiranës, duke e bërë kështu biznesin e importit të perimeve shumë më të vështirë dhe më pak fitimprurës, dhe (iv) efica e ulët e sektorit të shpërndarjes. Konkurrueshmëria e prodhimeve të importit pritet që të rritet në paralel me shtimin e zinxhirit të supermarketeve dhe përmirësimin e infrastrukturës logjistike.

Sistemi i shërbimeve të zinxhirit të vlerës vazhdon të mos jetë i zhvilluar. Pjesa më e madhe e asistencës teknike e marrë nga fermerët vjen në formën e këshillave nga tregtarët e input-eve, dhe për pasojë e ndërthurur në koston e tyre. Furnizimi me input-e bujqësore është përmirësuar, veçanërisht në lidhje me materialin shumëzues, por kostoja e input-eve vazhdon të jetë e lartë krahasuar me vendet fqinje dhe praktika mashtruese raportohen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me tregtimin e PMB-ve (produkte për mbrojtjen e bimëve) dhe plehrave.

Shumica e produkteve të freskëta grumbullohen përmes grumbulluesve/tregtarëve lokalë të shumicës dhe shiten në tregjet bujqësore dhe ato me pakicë. Ndërtimi i një rrjeti tregjesh shumice ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetin e prodhuesve të vendosur larg nga zonat kryesore urbane për të tregtuar prodhimet e tyre.

Operatorët komercialë të integruar, të ashtu quajturit “konsolidues” janë duke dalë në ‘skenë’ si lojtarët kryesorë në segmentet më dinamike të zinxhirit të vlerës. Këta operatorë furnizojnë me input-e dhe u ofrojnë shërbime fermerëve, blejnë prodhimet e tyre dhe i shesin më pas ato tek tregtarëve të tjerë të shumicës ose edhe në tregjet e huaja. Këta janë operatorët që gjithashtu janë duke investuar më shumë në veprimtari të ndryshme në shërbim të prodhimit: fillimisht në prodhimin e farave dhe më pas në infrastrukturën e transportit dhe tregtimin. Së fundmi, ata kanë filluar të investojnë në ambiente të ruajtjes pas vjeljes, duke përfituar edhe mbështetje.

Infrastruktura e marketing-ut është përmirësuar në vitet e fundit dhe në zonat kryesore të prodhimit janë ndërtuar dhe funksionojnë një rrjet tregjesh shumice.

Ka mangësi në ambientet e ruajtjes frigoriferike dhe humbjet e mëdha të prodhimit si pasojë e kësaj mungese ka qenë një nga arsyet kryesore në vite të deficitit tregtar të mollëve. Megjithatë, vitet e fundit është vërejtur një shtim i kapacitetit të ruajtjes frigoriferike .

*Industria e përpunimit të fruta perimeve* është e pazhvilluar dhe e dobët nga ana strukturore. Janë 73 kompani të përpunimit ushqimor të specializuara në përpunimin e fruta perimeve (2011). Vetëm disa prej këtyre sipërmarrjeve realizojnë një xhiro vjetore më të lartë se 1 milion euro. Shumica e tyre përpunojnë si frutat ashtu edhe perimet.

Shumica e këtyre sipërmarrjeve ofrojnë një gamë të ngjashme produktesh nga përpunimi i fruta perimeve – kryesisht gogozhare, salca, reçelra. Brenda kësaj game produktesh, që synojnë segmentet e fundit të kërkesës, produktet lokale paraqiten mjaft konkurrese. Prodhuesit shqiptarë nuk janë të konkurreshëm në segmentet e larta të kërkesës (përfshirë produktet me cilësi të lartë, ato të ngrira, të gatshme për tu konsumuar, etje.) dhe në tregun e produkteve gjysmë të gatshme, të përdorura nga industritë e tjera ushqimore. Segmentet e sipër përmendura janë premtuese dhe sfida e industrisë vendase është arritja e të qenit konkurrese.

Një çështje me rëndësi për industrinë e përpunimit është disponueshëmia e furnizimit me input-et e duhura. Vështirësia në sigurimin e furnizimeve të mjaftueshme të produkteve vendase gradualisht është duke u tejkaluar, ndërsa marrëdhëniet e tregtisë dhe ato kontraktuale mes kultivuesve, tregtarëve lokalë dhe industrisë përpunuese janë duke u stabilizuar dhe konsoliduar gjithnjë e më shumë. Gjithsesi, cilësia e furnizimeve dhe çmimet e larta në fermë (për nevojat e industrisë) mbeten një problem kryesor. Çmimet e larta të energjisë/lëndës djegëse dhe materialeve të paketimit (më së shumti të importuara) përbëjnë shqetësimin kryesor të përpunuesve.

Zbatimi i kufizuar i standardeve të sigurisë ushqimore është një faktor kufizues për sektorin. Sistemet e certifikuar HACCP zbatohen nga dy kompani dhe dy të tjera janë në një fazë të avancuar të përgatitjes për këtë certifikimin. Kjo më së shumti për shkak të përdorimit të pajisjeve dhe teknologjive të vjetruara, gjë që e bën të vështirë vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Shumica e linjave të përpunimit nuk kanë as pajisjet më elementare për kontrollin e cilësisë së lëndës së parë dhe produktit përfundimtar. Parametrat e prodhimit regjistrohen, por jo në mënyrë sistematike. Vetëm në pak raste ekzistojnë të dhëna mbi gjurmueshmërinë. Etiketimi është përmirësuar, megjithëse vazhdon të jetë jo i përshtatshëm. Etiketat ndonjëherë nuk tregojnë peshën e saktë dhe nuk përmbajnë datën e prodhimit dhe atë të skadimit. Për pasojë, vetëm disa kompani kanë qenë në gjendje të garantojnë cilësi të mirë të produkteve dhe ta ruajnë të njëjtin standard cilësie për të gjitha produktet.

#### *Vreshtaria dhe përpunimi i verës*

Shqipëria ka kushte klimaterike dhe toke shumë të përshtatshme për zhvillimin e vitikulturës. Kultivimi i vreshtave është gjerësisht i përhapur dhe një burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe vetë-punësimit për një numër të madh të fermave bujqësore.

Kultivimi i rrushit bëhet në mënyrë tipike në dy lloje parcelash: me vreshta dhe pjergulla. Në 2012, 262,000 fermerë e kultivonin rrushin në pjergulla dhe 56,000 në vreshta. Rrushi i pjergullave kultivohet kryesisht për nevojat vetjake (i freskët ose i përpunuar në formën e verës dhe pijeve alkoolike).

Sipërfaqja totale me vreshta është rreth 10,000 ha. Rreth dy të tretat e fermerëve kultivojnë deri në 0.2 ha. Fermat më të vogla kanë një qasje të kombinuar – një pjesë e rrushit është i destinuar për shitje (i freskët ose i përpunuar në formën e verës apo rakisë) dhe një pjesë – për konsum vetjak. Rreth 17,000 ferma kanë vreshta me sipërfaqe mbi 0.2 ha, gjë që tregon për një lloj niveli specializimi.

Si kultivarët e pjergullave ashtu edhe sipërfaqja me vreshta kanë qenë në rritje, por shkalla e rritjes së vreshtave dhe i prodhimit përkatës është shumë më i shpejtë edhe për shkak të disponueshmërisë së skemave të mbështetjes për ngritjen e vreshtavetë reja. Gjatë periudhës 2007-2012, sipërfaqja e vreshtave është rritur me rreth 1,000 ha.

Zonat kryesore të prodhimit të rrushit gjenden mes kodrave dhe bregdetit të Shqipërisë qendrore. Fieri, Berati, Elbasani dhe Vlora, janë qarqet me përqindjen më të madhe të prodhimit; këto katër qarqe japin më shumë se gjysmën e prodhimit vendas të rrushit.

Në 2012, prodhimi i rrushit arriti në 196,000 ton, nga të cilat 115,000 ton nga vreshtat. Prodhimi i rrushit është rritur në mënyrë domethënëse me gati një të tretën krahasuar me vitin 2007, kryesisht si rezultat si rritjes së shpejtë të prodhimit nga vreshtat. Përqindja e prodhimit nga vreshtat është rritur në mënyrë të qëndrueshme dhe në 2012 përbënte 60% të prodhimit.

Prodhimi vendas dominon furnizimin e tregut vendas si me rrush tavoline ashtu edhe me atë për përpunim. Përqindja e importeve për të dy llojet e rrushit ka rënë në mënyrë domethënëse në vitet e fundit – në më pak se 5% në 2012. Si pasojë e rritjes së prodhimit vendas, importet kanë rënë në vlerë absolute.

Cilësia e verës së rrushit është e ulët si pasojë e kultivarëve të papërshtatshëm dhe heterogjenë si dhe praktikave jo efikente në fermë. Raportohet se fermerët janë të orientuar më shumë drejt sasisë se sa cilësisë.

Për prodhimin e verës përdoren si kultivarët autoktonë ashtu edhe ata të importuar. Mes kultivarëve autokton bëjnë pjesë Kallmeti, Sheshi i Zi, Sheshi i Bardhe, Vloshi, etje. Varietetet e importuara janë të shumta si Merloti, Cabernet Sauvignon, Chardonnay, Rieslingu, Petit Verdon, Shiraz (në eksperimentim), Vranac, etje. Kantinat që prodhojnë me cilësi të lartë kanë tendencën të përpunojnë më shumë kultivarët autoktonë, në veçanti Sheshin e Zi, Sheshin e Bardhë, Kallmet, etj.

Kushtet klimatike janë të përshtatshme për rritjen e kultivarëve të hershëm të tavolinës dhe ekzistojnë potenciale për eksportin e tyre. Gjithsesi, njohuritë mbi teknologjitë e kultivimit të rrushit të tavolinës janë të kufizuara dhe nevojiten investime domethënëse në mbjellje, trajtimin dhe ruajtjen pas vjeljes.

Konkurueshmëria e fermerëve zvogëlohet nga çmimet e larta dhe cilësia e ulët e input-eve. Input-et kryesore importohen dhe cilësia e tyre raportohet të jetë e ulët ndërsa çmimi i lartë si pasojë e strukturës jo konkurruese të tregut. Praktikant në fermë janë të dobëta – spërkatja bëhet pa një analizë të mirëfilltë, gjë që çon në kosto të larta të spërkatjeve dhe rendimente të ulëta.

Prodhimi, si pasojë e madhësisë së vogël të fermave dhe burimeve të pamjaftueshme të fermerëve nuk është i mekanizuar. Nevojiten investime për përmirësimin e standardeve në nivel ferme, përfshirë në ato pas vjeljes, ruajtjen, seleksionimin etje.

Një nga çështjet kryesore për zhvillimin e zinxhirit të vlerës është mungesa e lidhjeve/koordinimit mes fermerëve dhe përpunuesve, kostot e larta të prodhimit dhe mungesa e standardizimit. Shumë kantina hasin vështirësi për tu koordinuar me fermerët (kultivarë të papërshtatshëm, ujitje përpara vjeljes, etje.). Si rezultat, kantinat kanë filluar të ngrejnë vreshtat e tyre duke zbatuar prodhimin e integruar<sup>14</sup>.

---

<sup>14</sup>Studim mbi Vreshtat dhe Zinxhirin e Vlerës së Verës, Raporti përfundimtar 2014. Studimi u përgatit nga Projekti “Përgatitja e Strategjisë ndërsektoriale të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Shqipëri”, financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga FAO.

Në nivelin e agro-industrisë, ka pasur një rritje të dukshme në prodhimin e verës që në 2012 ishte 97,600 HL. Rreth 80% e verës prodhohet në nivel ferme. Prodhimi i verës, për periudhën 2005-2012, ka rënë me rreth 25% si rezultat i niveleve të prodhimit në ferma.

Prodhimi industrial i verës është rritur për periudhën 2005-2012 me 27% duke arritur në 21,800 HL në 2012. Faktori kryesor që qendron pas rritjes së prodhimit janë investimet në rritjen e kapaciteteve përpunuese. Janë ndërtuar shumë kantina të reja, disa prej tyre prej emigrantëve të rikthyer. Në total, në 2013, numëroheshin 94 kantina, shumica prej tyre të vogla.

Kantinat në Shqipëri mund të ndajmë në tre grupe si vijon: (i) kantina që prodhojnë verë me cilësi të lartë bazuar në densitet të ulët të bimëve dhe rendiment të ulët për bimë, seleksionimi kritik, vjelja dhe ndarja e rrushit; presimi dhe përpunimi dhe së fundmi, nga 24-36 muaj stazhonim në tankera çeliku/fuçi druri; (ii) kantina tipike të mëdha që prodhojnë sasi të mëdha vere standarde/tavoline dhe në një shkallë më të vogël verë bazuar mbi seleksionimin dhe stazhonim nga 12-24 muaj; dhe (iii) kantina tipikisht të vogla që prodhojnë verë tavoline standarde me pak ose aspak stazhonim për konsum të menjëhershëm.

Segmenti i verërave cilësore vazhdon të jetë pak i zhvilluar për të konsiderohet madhësia e zinxhirit të vlerës. Tregu për verën standard të tavolinës është i përbërë nga restorantet dhe dyqanet dhe për verën me cilësi të lartë nga ai i restoranteve dhe hoteleve me standarde të larta, vinotekat, etje. Eksportet e verës janë të papërfillshme.

Kantinat lokale cilësore nuk janë ende të konkureshme krahasuar me konkurentët kryesor rajonal dhe me prodhuesit kryesor të BE-së për sa i përket marrëdhënies çmim/cilësi. Për këtë arsye, importi i verërave cilësore është i lartë dhe ka qenë në rritje gjatë dekadës së fundit, duke qenë se kërkesa për verë të cilësisë së lartë është në rritje me përmirësimin e standardeve të jetesës dhe ndryshimeve në stilin e të jetuarit. Distribucionit i produkteve ushqimore është duke u konsoliduar në vazhdimësi, ku favorizohen prodhuesit e mëdhenj dhe vera e importuar, ndërkohë që në segmentin e verërave cilësore në shishe vërehet dominimi i verërave të importuara dhe konkureshmëria në rritje nga prodhuesit rajonal.

Nevojat që kantinat kanë për sa i përket prodhimit të verës janë të ndryshme. Në disa raste, kapaciteti i vreshtave është ngërçi kryesor. Në raste të tjera, kapaciteti në rritje i përpunimit të verës është pengesa kryesore. Ka gjithashtu raste kur si kapacitetet e prodhimit të rrushit ashtu edhe përpunimit të verës janë pengesa të mëdha – këtu bëjnë pjesë kantinat e vogla, të cilat planifikojnë të rriten.

Sfidë të madhe paraqet edhe rritja e cilësisë për të përmbushur rritjen e brendshme të kërkesës për verë me cilësi të lartë. Vërehet një proces i ngadaltë i përmirësimit të cilësisë, në të njëjtën kohë me restaurimin e vreshtave dhe investimeve në teknologjitë e reja.

Studimi sektorial ka identifikuar si prioritet investimet në qilarë, linja përpunim dhe mbushjeje, si dhe në pajisje laboratorike. Prioritet është gjithashtu hartimi i skemave cilësore për verën, përfshirë Treguesit e Mbrojtur Gjeografikë dhe skema të tjera, që kërkojnë plotësime të kuadrit ligjor, njohjen ndërkombëtare të varieteteve autoktone të rrushit, zhvillim të produktit (verës) bazuar në varietet lokale/autoktone të rrushit, hartimi i një Kodi të Praktikave për prodhuesit e verës që do të mbulonte të gjithë procesin nga vreshti - në gotë si dhe nxitja e veprimeve kolektive.



Standardet e sigurisë ushqimore në fushën e përpunimit të verës janë të ulëta. Shumica e kantineve nuk kanë certifikim HACCP. Standardet mjedisore për sa i përket largimit të ujërave të ndotura janë të gjithashtu të ulëta.

### 3.3. Menaxhimi mjedisit dhe i tokës

Shqipëria ka një *diversitet biologjik dhe peizazhi* të pasur. Janë rreth 3200 specie bimësh vaskulare dhe rreth 800 specie vertebrorë. Nga bimët vaskulare, 27 janë endemike 180 gjysmë-endemike, dhe me shumë se 300 lloje janë bimë medicinale dhe aromatike, të cilat përbëjnë një burim natyror me rëndësi ekonomike i pashfrytëzuar plotësisht. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdha brenda vendit janë të rëndësishme për dimërimin e shpendëve migratore. Rreth 70 shpendë ujorë dhe specie të zogjve të ujit me një popullatë të përgjithshme prej 180 000 individësh vërehen çdo vit gjatë dimrit në Shqipëri, duke qenë se vendi është gjithashtu i një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakuriqëve të natës dhe insekteve. Në pyjet e larta gjenden popullata të gjitarëve të mëdhenj, si ujçërve, arinjve, rrëqebullit, dhivetë egra dhe zogjve.

Në nivel botëror janë rreth 91 specie në rrezik, mes të cilave: Pelikani Kaçurrel (*Pelecanus crispus*), Vrancit i vogël (*Phalacrocorax pygmeus*), dhe Blini Evropës Perëndimore (*Acipenser sturio*) për të cilat Shqipëria është një vend me rëndësi të madhe.

Arsyeja kryesore e humbjes dhe degradimit të habitateve është shpyllëzimi në zonat e larta malore si dhe shkretimi i tokës bujqësore. Shndrimi i tokës bujqësore në troje ndërtimi ka çuar gjithashtu në degradimin e habitateve. Ndikime negative mbi biodiversitetin janë vërejtur edhe në zonat bregdetare ku faktorët kryesorë shkaktarë janë përmytjet e sipërfaqeve të mëdha dhe erozioni, shkarkimi i mbetjeve ujore të patrajuara në lumenj dhe gjuetia e paligjshme.

Tabela 3.3: Zonat e mbrojtura sipas llojeve

Kategoria e Zonës së Mbrojtur	Nr.	ha
Rezervë natyrore/rezervë shkencore	2	4,800
Park Kombëtar	15	210,501
Monument Natyre	750	3,470
Rezervë natyrore e menaxhuar/park natyror	22	122,974
Peizazh i mbrojtur	5	95,864
Zonë e Mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me shumë përdorime	4	18,245
<b>Totali</b>	<b>798</b>	<b>455,855</b>

Burimi: Ministria e Mjedisit

Hapësira e mbrojtur është rreth 456,000 ha. Pjesa e territorit të mbrojtur është rritur nga 5.8 % në 2005 në 15.8% në 2012, dhe synimi për 2010 është të arrihet deri në 17%.

Rreziqet kryesore të *braktisjes së tokës* në Shqipëri lidhen me: relievin kodrinor të vendit, largësia dhe densiteti i ulët i popullsisë në disa pjesë të vendit, pjelloria e ulët e tokës, erozioni nga reshjet, struktura e sistemit

bujqësor, pronësia mbi tokën dhe zhvillimi i tregu të tokës. Studimet e kohëve të fundit vlerësojnë se përqindja e braktisjes së tokës bujqësore përbën rreth 12-13% e totalit.

Në 2013 janë raportuar 51 operatorë organikë, nga të cilët 27 prodhues/përpunues, 19 prodhues/eksportues, 1 eksportues dhe 4 importues. Sipërfaqja me prodhim organik është 909 ha (0.1% e UAA). Certifikimi organik është më i zakonshëm për BMA-të, ku 330,677 ha janë

të certifikuara kryesisht për mbledhjen e bimëve të egra në zonat rurale<sup>15</sup>. Tendenca në rritje e bujqësisë organike vërehet edhe në nën-sektorë të tjerë si perimet (6 ha), ullishtet (70 ha), vreshtat (20 ha) dhe pemëtoret (113 ha).

Në vend funksionojnë tetë organe certifikuese (nga të cilat vetëm 1 është Shqiptar). Duke filluar nga 2008, MBZHRAU ka dhënë mbështetje për certifikimin e produkteve bujqësore nga bimët e kultivuara, respektivisht për produktet e destinuara për tregun vendas. Disa donatorë (USAID, GIZ, Swiss Development Cooperation) gjithashtu kanë mbështetur projekte me synim zhvillimin e bujqësisë organike në vend<sup>16</sup>.

Në legjislacionin për bujqësinë organike ekzistojnë hapësira, dhe kapaciteti i shërbimeve këshillimore vendase për sa i përket standardeve të prodhimit organik është i pamjaftueshëm. Mungesa e zhvillimit në zinxhirin e vlerës dhe lidhjet e dobëta mes prodhuesve, përpunuesve/eksportuesve dhe konsumatorëve pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë organike në Shqipëri.

*Erozioni i tokës* është rritur, në formën e erozionit sipërfaqësor, erozionit bregdetar, atij të anëve të lumenjve, transportimit të lymit dhe varfërimit të tokës. Më shumë se 20% e tokave Shqiptare janë në rrezik nga erozioni në një shkallë prej më shumë se 5 t/ha/vit; 70% e territorit pëson erozion në masën 20/ha/vit; vetëm 10% e sipërfaqes së tokës është më pak e ndikuar nga ky fenomen. Intensiteti mesatar vjetor i procesit të erozionit nga uji varion në përputhje me përdorimin e tokës, por humbjet e tokës vlerësohen të jenë mesatarisht 16.4 t/ha në vit (2010). Faktorët kryesorë që shkaktojnë erozion janë ata klimaterikë (lartësia, terreni malor, reshjet dhe shpatet e zhveshura), veprimtaria njerëzore, si shpyllëzimi, ujitja me rrjedhje të lirë, investimet e pakta në mirëmbajtjen e tokës bujqësore, dhe djegia e pyjeve dhe kullotave.

Reduktimi i lëndës *organike në tokë* është i lidhur me praktikën gjerësisht të aplikuar në Shqipëri të djegies së mbetjeve të të korrave. Teknikat e papërshtatshme bujqësore, mos zbatimi i qarkullimit bujqësor, rënia e numrit të kultivimeve të tokës, përdorimi i ulët dhe i ç'balancuar i plehrave organike dhe minerale dhe masat jo efektive të mbrojtjes së bimëve kontribuojnë gjithashtu në degradimin e vazhdueshëm të tokës bujqësore. Ka pasur tendencë në rritje të sasisë së plehrave të përdorura për ha të tokës bujqësore gjatë periudhës 2004-2008 e cila është zvogëluar disi gjatë periudhës 2009-2013 në 83.3 kg për ha.<sup>17</sup>

Shqipëria është e pasur në *burime ujore* (liqene, lumenj, burime, laguna), me sasi të mëdha të ujit të disponueshëm, të cilat mbulojnë 65% të totalit të sipërfaqes ujore prej 43,900 km<sup>2</sup>. Më shumë se 152 përrenj dhe lumenj të vegjël nga 8 lumenjtë e mëdhenj rrjedhin nga ju-lindja në veri-perëndim në drejtim të brigjeve të Adriatikut. Fluksi mesatar vjetor është 1308 m<sup>3</sup> s<sup>-1</sup>, që i korrespondon një volume uji vjetor prej 42.25x10<sup>9</sup> m<sup>3</sup> nga i cili 30% i përkasin ujërave nëntokësore. Kjo është e barabartë me më shumë se 13,000 m<sup>3</sup>ujë për person në vit.

Rreth 91% e popullsisë Shqiptare dhe vetëm 57 % e asaj rurale furnizohen me ujë.<sup>18</sup>Në zonat rurale të cilat nuk mbulohen nga furnizimi me ujë, pusët janë burimi kryesor i këtij furnizimi.

Në përgjithësi, rreth 80% e rrjedhës së lumenjve përmbush standardet kombëtare të cilësisë së ujit. Paraqiten gjithashtu edhe niveletë larta të humbjeve të ujit, si dhe rreziku i ndotjes dhe

<sup>15</sup>MBZHRAU & Albinspekt (publikuar në MOAN-Rrjeti Mesdhetar i Bujqësisë Organike).

<sup>16</sup>Instituti Bujqësisë Organike [www.ibb.al](http://www.ibb.al); Organizmi Certifikues dhe Inspektues Shqiptar, [www.albinspekt.com](http://www.albinspekt.com).

<sup>17</sup>Banka Botërore - të dhëna mbi plehëruesit <http://data.worldbank.org/indicator/AG.CON.FERT.ZS>

<sup>18</sup>Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017.

rënia e cilësisë. Burimi kryesor i ndotjes së ujit lidhet me derdhjet e patrajtuara të ujërave urbane dhe depozitimin jo të përshtatshëm të mbetjeve të ngurta urbane. Rrjedhjet e ujërave të ndotura nga vend-grumbullimet e tyre përbëjnë një tjetër burim të madh ndotjeje.

Në zonat rurale, mbetjet nuk mblidhen dhe hidhen në mënyrë të pakontrolluar. Në ferma mungojnë vendet e mbrojtura për depozitimin e plehut dhe sistemet e kanalizimeve në shumë vende paraqesin rrezik jo vetëm për mjedisin por edhe për shëndetin e njerëzve.

Zbatimi i standardeve të menaxhimit të ujërave është i dobët. Nuk ekziston akoma një bazë të dhënash informuese mbi nivelin e azotit në liqene dhe në ujërat nëntokësore. Legjislacioni kombëtar dhe planet e veprimit për përafrimin e legjislacionit me Direktivën Kuadër të Ujit dhe atë të Nitrateve si dhe Direktivën e Ujërave të Ndotura Urbane janë hartuar dhe presin të miratohen.

Bujqësia, pas sektorit energjetik, është sektori më i madh që përdor më shumë ujë (kryesisht ujërat sipërfaqësore). Gjatë verës bien rreth 20% e totalit të reshjeve, gjë që e bën të domosdoshme *ujitjen* gjatë verës si dhe drenazhimin dhe mbrojtjen nga përmytja gjatë dimrit

Infrastruktura ekzistuese e ujitjes, drenazhimit dhe mbrojtjes nga përmytjet mundëson ujitjen e rreth 360,000 ha dhe garanton drenazhimin e 280,000 ha të tjerë. Për ujitje përdoren, 560 milion m<sup>3</sup> ujë nga 626 rezervuarë ujitjeje dhe 450 milion m<sup>3</sup> ujë nga lumenjtë, ndërsa përdorimi i ujërave nëntokësorë është i kufizuar. Fermerët mund të ujin rreth 200,000 ha, dhe të drenazhojnë rreth 230,000 ha nga një sipërfaqje potencialisht e drenazhueshme prej 280,000 ha.

Pas vitit 1990, një përqindje e madhe e sistemeve të ujitjes dhe drenimit u shkatërruan për shkak të mungesës së investimeve, alokimeve të pamjaftueshme të buxhetit për funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre si dhe kuadrit të papërshtatshëm institucional për menaxhimin e ujitjes. Përmes projekteve të financuara nga donatorët si dhe burimeve të buxhetit të shtetit është rehabilituar infrastruktura e ujitjes për 150,000 ha dhe ajo e drenimit për përafërsisht 180,000 ha toke bujqësore, 60 rezervuarë si dhe me kilometra argjinatura mbrojtëse lumenjsh dhe detare. Sipërfaqja e ujitur ka kaluar nga shteti tek Shoqatat e Përdoruesve të Ujit (WUA). Gjithsesi, në praktikë, pjesëmarrja e fermerëve në menaxhimin e ujitjes përmes WUA-ve nuk ka dhënë rezultatet e duhura duke qenë se kapaciteti i fermerëve në dhënie të shërbimeve të ujitjes ka qenë i kufizuar dhe në shumë raste fermerët nuk kanë arritur të mbulojnë kostot e funksionimit dhe të mirëmbajtjes. Për momentin pronësia e 315 rezervuarave dhe 640 stacioneve të pompimit të përdorura për ujitjen e rreth 100,000 ha toke bujqësore i është transferuar komunave dhe bashkive me qëllim përmirësimin e përdorimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të ujitjes.

Sipërfaqja totale e llogaritur të jetë e rrezikuar nga *përmytjet* është më shumë se 40,000 ha. Ekziston një reaksion zinxhir që nga kullotja pa kriter, shpyllëzimi dhe erozioni që kulminon me përmytjet, situatë, e cila përshpejtohet nga mungesa e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese dhe stacioneve të pompimit. Njëkohësisht, efektetë dëmshme në ultësira kanë edhe marrja e inerteve nga shtratet e lumenjve, mbetjet e pakontrolluara dhe mosfunksionimi i sistemeve të drenazhimit.

Shqipëria është e rrezikuar nga *ndryshimet klimaterike* si pasojë e ekspozimit të madh ndaj temperaturave ekstreme (thatësira, valët e te nxehtit, përmytjet) dhe ndjeshmëria e lartë (varësia nga hidrocentralet, ujitja dhe përqindja e lartë e popullsisë në zonat e ulëta bregdetare). Kjo, e kombinuar me kapacitetin e ulët për tu përshtatur si pasojë e PBB-së së

ulët për person dhe e kapaciteteve të kufizuara institucionale mund të shkaktojë efekt mbi burimet ujore, prodhimin e energjisë, turizmin, ekosistemet, bujqësinë dhe zonat bregdetare.<sup>19</sup>

Skenari klimaterik i së ardhmes për Shqipërinë parashikon ndryshime, të tilla si: rritje e temperaturave, thatësira të tejzgjatura, rritje të rrezikut të shkarjeve të dheut nga përmytjet dhe zjarret, zvogëlim i reshjeve dhe reduktim i resurseve ujore dhe të tokës bujqësore me ndikime negative mbi bujqësinë, pyjet dhe biodiversitetin.<sup>20</sup> Ndikime ndryshimeve klimaterike në sektorin e bujqësisë priten të jenë të kombinuara – me rritje të prodhimit të grurit dhe jonxhës dhe zvogëlim të prodhimit të rrushit, ullinjve dhe blegtorisë. Shqipëria i është përgjigjur nevojave për mbrojtje dhe përshtatje ndaj këtij fenomeni përmes Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimaterike, që përmban një grup veprimesh prioritare me qëllim integrimin e sfidave të ndryshimeve klimaterike në planet e tjeratë zhvillimit ekonomik<sup>21</sup>.

Konsumi i energjisë në Shqipëri për person dhe shkarkimet CO<sub>2</sub> për person janë të ulëta; ato vlerësohen mesatarisht në 9,4 milion ton/vit CO<sub>2</sub> etje.

Shkarkimet GHG-ve në Shqipëri kapën shifrën e 7956 – 8540 tonëve CO<sub>2</sub> gjatë 2005-2006. Kontributi i bujqësisë në shkarkimin e GHG-ve vlerësohet të jetë 35%. Metani përfaqëson 78% të këtij totali kryesisht për shkak të fermentimit enterik të blegtorisë. Në fakt, 95% këtij metani nga fermat çlirohet nga blegtoaria (73%) dhe delet (16%) ndërsa pjesa tjetër nga menaxhimi i plehut dhe djegia e mbetjeve bujqësore.<sup>22</sup>

Prodhimi i *energjisë nga burimet e rinovueshme*, veçanërisht nga sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë, vazhdon të mos jetë i zhvilluar në Shqipëri, megjithëse ekzistojnë potenciale për përdorimin e biomasës për prodhimin e energjisë nga burimet e mëposhtme kryesore: drutë pyjore, mbetjet urbane, mbetjet e bujqësisë, mbetjet pyjore, dhe mbetjet me orgjinë shtazore. Lloji aktual i biomasës që përdoret është kryesisht ai i druve të zjarrit.

Nga të dhënat del se mundësia vjetore për shfrytëzim të qëndrueshëm të kësaj biomase është rreth 1,152,000 m<sup>3</sup>. Konsumi i druve të zjarrit vlerësohet të jetë rreth 2 milion m<sup>3</sup> si pasojë e prerjeve të paligjshme që janë shumë më të larta se të dhënat nga statistikat zyrtare. Potenciali për prodhim bio-energjie është më i lartë nëse do të merret në konsideratë lënda drusore e përftuar nga rrallimi (35,000 m<sup>3</sup>/vit) dhe ajo nga kultivimi i specieve me cikël prodhimi të shkurtër, si shelgu, eukalipti, plep, akacia, tamariksi.

Një burim tjetër i rëndësishëm i biomasës, i përftuar nga pemëtoret, llogaritet që të jetë rreth 457,000 tonë në vit. Biomasa potencialisht e përdorshme është më e vogël se sa totali i biomasës, për shkak se një pjesë e mbetjeve digjen për arsye të ndryshme. Biomasa nga bimët energjetike nuk është akoma e përhapur në Shqipëri. Numri i instalimeve të bio-gazit, bio-etanolit dhe bio-dizelit në vend është i kufizuar.

Strategjia Energjitike e Shqipërisë mbështet zhvillimin e stabilimenteve energjitike të vogla, dhe veçanërisht ato të bazuara mbi mbetjet e industrisë së përpunimit të drurit dhe veprimtarive bujqësore, të cilat konsiderohen një burim i rëndësishëm i energjisë alternative.

---

<sup>19</sup>Komunikimi i Dytë Kombëtar i Shqipërisë në konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimaterike, 2009

<sup>20</sup>Raporti Kombëtar mbi Ndryshimet Klimaterike, 2008.

<sup>21</sup>Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të OKB-së mbi Ndryshimet Klimaterike (UNFCCC) si dhe Protokollin e saj Kyotos me statusin e Palës Jashtë-Aneksit 1. Në bisedimet Ndërkombëtare mbi Ndryshimet Klimaterike Shqipëria ka përkrahur pozicionin e BE-së brenda kufizimeve që i imponon statusi i Palës Jashtë-Aneksit, e angazhuar për të zbatuar 'Veprimet e Duhura për Zvogëlimin e Riskut'-NAMAs.

<sup>22</sup>Komisioni i OKB-së për Evropën 'Second Environmental Performance Review', 2012.

Pyje të mbrojtura janë 162,000 ha, ose rreth 14.0% e pyjeve në vend 2010. Rreth 80% e tyre shërbejnë për mbrojtjen e tokës dhe ujërave ndërsa 20% për ruajtjen e biodiversitetit.<sup>23</sup>


Shpyllëzimi konsiderohet një problem i madh mjedisor në Shqipëri. Sipërfaqet me pyje janë zvogëluar gjatë dekadave të shkuara si pasojë e prerjes për dru zjarri dhe për përfitim të tokës bujqësore. Gjendja e pyjeve ka degraduar në mënyrë domethënëse për shkak të shfrytëzimit dhe kullotjes pa kriter, gjë që ka sjellë ndryshime në strukturën e moshës së pyjeve, përbërjen e specieve dhe ka reduktuar aftësinë rigjeneruese të tyre. Për vite me radhë rënia e pemëve ka kaluar rritjen neto vjetore të tyre, duke rezultuar në zvogëlim të sasisë së disponueshme të lëndës drusore na pemët në rritje.

*Djegia e pyjeve*, shpesh e bërë nga njeriu, është një rrezik serioz për ekosistemet. Zjarret kanë bërë dëme të mëdha në pyje dhe livadhe. Në 2012, 158 vatra zjarri shkatërruan një total prej 54,130.7 ha (nga të cilat 43 795 ha ishin pyje dhe pjesa tjetër zona me drurë ndërsa 9,305 ha sipërfaqe të tjera natyrore).<sup>24</sup>

### 3.4. Ekonomia rurale dhe cilësia e jetës

Në 2013 popullsia e zonave kryesisht rurale llogaritej në 634,000 banorë ndërsa në ato mesatarisht rurale në 1,121,000.

Emigracioni i lartë nga zonat rurale ka rezultuar në *braktisjen graduale të zonave rurale*. Në periudhën e ndërmjetme të censusit 2001-2011 popullsia e zonave kryesisht dhe mesatarisht rurale pësoi një rënie me 20%. Rënia më e lartë e popullsisë është regjistruar në Gjirokastrë (36%), Dibër (27.8%) dhe Berat (26.5%).



Ka pasur një përkeqësim domethënës të strukturës së moshës së popullsisë rurale në periudhën 2001 dhe 2011. Popullsia nën moshën 15 vjeç ra me 44%, popullsia në grupmoshën nga 15-64 vjeç ra me 14% dhe popullsia me moshë 65 e lart u rrit me 28.2%.

Në vitin 2011 popullsia në zonat rurale të grupmoshës 20-64 vjeç ishte 1.203.400 (432.000 në zona kryesisht rurale dhe 771.400 në zona {mesatarisht rurale}). Niveli i arsimit të fuqisë punëtore në rajone kryesisht dhe mesatarisht rurale është shumë më i ulët se në zonat urbane. Pjesa e popullsisë në grupmoshën nga 20-64 vjeç me arsim të mesëm dhe të lartë në zonat rurale është 44%, në krahasim me 60% të popullsisë në zonat kryesisht urbane (të dhënat e Censusit të vitit 2011). Ka një hendek gjinor domethënës në fushën e arsimit. Përqindja e femrave me arsim të mesëm dhe të lartë në zonat rurale është 41% në krahasim me 48% të meshkujve.

Rajonet kryesisht rurale kontribuojnë me 17,5% të PBB-së në Shqipëri dhe rajonet mesatarisht rurale me 35,2 (të dhënat e vitit 2009). PBB për frymë, në rajone kryesisht dhe mesatarisht rurale, është 20 % më e ulët se mesatarja e vendit.

Zonat rurale në Shqipëri janë shumë të varura nga bujqësia. Ajo krijon shumicën e vendeve të punës në zonat rurale dhe është burimi kryesor i të ardhurave për ekonomitë familjare rurale.

<sup>23</sup>FAO, *Vlerësimi Global i Resurseve Pyjore 2010: Country Report Albania*, 2010.

<sup>24</sup>Të dhëna nga EFFIS.


Rreth 55% e vendeve të punës në zonat kryesisht dhe mesatarisht rurale krijohen nga bujqësia në krahasim me 22% në zonat kryesisht urbane. Sektorë të tjerë të rëndësishëm të ekonomisë rurale janë industria dhe ndërtimi, duke kontribuar secili me 7-8% të punësimit. Midis shërbimeve, më i rëndësishëm është sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë . Rreth 10% e vendeve të punës i përkasin administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë.

Në 2012 kanë qenë rreth 51.000 kompani aktive në zonat kryesisht dhe mesatarisht rurale, që përbëjnë rreth gjysmën e kompanive aktive në Shqipëri. Rreth 96% janë mikrosipërmarrje me deri në 10 punonjës. Në pjesën më të madhe (70%) të mikrosipërmarrjeve vetëm një person është i punësuar. Në 2012, ishin vetëm 1760 kompani të vogla me nga 10-49 të punësuar dhe 330 kompani me 50 e më shumë punonjës. Shkalla e krijimit të kompanive të reja ishte 12%, e cila është e përafërt me mesataren e vendit.

Regjistrimi i stabilimenteve, i realizuar në vitin 2010, tregoi se 45% e të gjitha kompanive në zonat kryesisht dhe mesatarisht rurale merreshin me tregti dhe 38% operonin në sektorë të tjerë të shërbimeve. Kompanitë në zonat kryesisht rurale përbënin 16% të punësimit në sektorin e stabilimenteve dhe 30% në zonat mesatarisht rurale. Mungesa e mundësive të punësimit jashtë sektorit bujqësor dhe të ardhurat e ulëta nga bujqësia kontribuojnë masivisht në varfërinë rurale. Sondazhi i fundit mbi matjen e standardit të jetesës (LSMS) nxori në pah se varfëria është rritur në Shqipëri; nga 12.4% në 2008, në 14.3% në 2012 ndërsa varfëria e skajshme nga 1,2% në 2,2%<sup>25</sup>.

Shkalla e varfërisë në zonat kryesisht rurale është 14,8%, që është e përafërt me mesataren e vendit, por ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga 10,7% në Gjirokastrë, në 21,8% në Kukës. Në zonat tërësisht rurale, shkalla e varfërisë është më e ulët se mesatarja e vendit, ose 13,8%. LSMS-ja nxori në pah një reduktim të ndjeshëm të varfërisë në rajonet malore (nga 26,6% në 15,3%), që mund të jetë një rezultat i zhvendosjes së popullsisë dhe vazhdim i lëvizjeve nga zonat malore në rajonet e tjera. Zonat bregdetare kanë rritjen më të madhe të varfërisë, në 2012, përqindja e popullsisë së varfër ishte 17.6%, në krahasim me 13% në 2008. Të dhënat janë të ngjashme për zonën e Tiranës, që tregon për një zhvendosje të varfërisë në zonat urbane.<sup>26</sup>

Zonat rurale kanë një infrastrukturë të pazhvilluar dhe të pamirëmbajtur (rrugë, energji elektrike, furnizim me ujë dhe kanalizime), si në aspektin e shtrirjes dhe në atë të cilësisë. Një problem i madh për hyrjen në treg dhe zhvillimin ekonomik dhe social nt zonave rurale është cilësia e dobët e infrastrukturës rrugore. Shqipëria ka një rrjet rrugor prej 12.000 km, që përfshin 9500 km rrugë rurale, nga të cilat 5.000 km bëjnë pjesë në rrjetin rrugor rural lokal të menaxhuar nga qeverisja vendore dhe rreth 4500 km rrugë rajonale të administruara nga 12 qarqet. Një pjesë e konsiderueshme e rrjetit rrugor lokal është e pashtuar dhe është raportuar të jetë në një gjendje të keqe - me disa segmente të



<sup>25</sup>Popullsi e varfër konsiderohet ajo me konsum real mujor për person nën 50 USD; popullsi në varfëri ekstreme konsiderohet ajo që me vështirësi plotëson nevojat bazë të ushqyerjes. INSTAT, Shqipëri: *Tendencat e Varfërisë2002-2005-2008-2012*.

<sup>26</sup>INSTAT, Shqipëria: *Tendencat e Varfërisë2002-2005-2008-2012*.

pakalueshme gjatë pjesës më të madhe të vitit. Mirëmbajtja e rrugëve lokale është një problem për shkak të burimeve të kufizuara të qeverisjes vendore.

Infrastruktura e rrugëve rurale është përmirësuar në vitet e fundit si rezultat i zbatimit të një programi në shkallë të gjerëtë disa donatorëve, përfshirë grantin e IPA-s prej 51 milionë Eurosh dhe 140 milionë Eurove kredi nga BERZH, BEI, BKE, që mbështetën rehabilitimin e 1500 km rrugësh dytësore dhe rurale në Shqipëri, i cili po zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Megjithatë cilësia e dobët e rrugëve mbetet një problem i madh që ndikon në ofrimin e shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore të popullsisë rurale dhe në aksesin e tregjeve.

Furnizimi me energji elektrike është përmirësuar që nga fundi i vitit 2000. Mungesat e energjisë elektrike (të cilat ishin një problem, jo vetëm për jetën e përditshme të familjeve, por edhe për aktivitetet bujqësore dhe agro-përpunuese), janë më pak të zakonshme në zonat rurale. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 treguan se ka dallime në aksesin ndaj infrastrukturës bazë. Pjesa e popullsisë që ka akses në ujën e pijshëm në zonat rurale është rreth 85%, por ajo është shumë më e ulët në qytete të vogla dhe fshatra, rreth 59%. Rreth 87% e familjeve në zonat kryesisht rurale dhe 61% në zonat mesatarisht rurale përdorin drurin si burimin kryesor të energjisë, kundrejt vetëm 35% në zonat urbane.

Depërtimi i internetit është i ulët në Shqipëri. Vetëm 8% e familjeve në zonat kryesisht dhe mesatarisht rurale kanë akses në internet, në krahasim me 19% në rajonet kryesisht urbane. Përqindja e familjeve rurale me kompjutera është 14%, në krahasim me 30% në rajonet kryesisht urbane.

Infrastruktura sociale dhe shërbimet, veçanërisht në zonat rurale dhe zonat e thella, është e pamjaftueshme. Ka boshllëqe dhe nevoja për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore si dhe të infrastrukturës arsimore në zonat rurale, veçanërisht në zonat e disavantazuara / zonat rurale malore.

Studimi i thelluar mbi diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale në Shqipëri nënvizon sektorët kryesorë që kanë potenciale për të krijuar vende të reja pune dhe të ardhura shtesë në zonat rurale<sup>27</sup>. Këto janë përshkruar shkurtimisht më poshtë.

Bimët mjekësore dhe aromatike (BMA-të) janë një sektor tradicionalisht i orientuar nga eksporti, me tregje të zhvilluara dhe potencial të mirë për rritje (më shumë se 95% e BMA-ve të mbledhura / prodhuara eksportohen). Shqipëria bën pjesë në grupin e 25 eksportuesve kryesorë të BMA-ve në botë. Eksporti i BMA-ve është rritur dhe ka arritur në 9.780 ton në 2012, duke arritur në 18.5 milionë Euro ose 20% të totalit të eksporteve bujqësore të Shqipërisë. Produktet më të rëndësishme të eksportit janë sherebela, rigoni, trumza, livando, etje. Është regjistruar një fluks i vogël, por në rritje i eksportit të vajrave esenciale si edhe një rritje e kapacitetit përpunues në vend.

Baza e prodhimit përbëhet kryesisht nga BMA-të e egra që gjenden në të gjithë vendin. Biodiversiteti i pasur në Shqipëri përfaqëson një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të BMA-ve. Më shumë se 400 specie janë identifikuar si BMA të florës shqiptare, nga të cilat më shumë se 200 specie mblidhen dhe tregtohen.

BMA-të janë një sektor i rëndësishëm i ekonomisë rurale. Sondazhet tregojnë se në disa zona rurale pothuajse të gjitha familjet marrin një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tyre

---

<sup>27</sup>Analizë Sektoriale për Diversifikimin e Ekonomisë Rurale në Shqipëri, Raporti final, 2014. Studimi është përgatitur nga Projekti "Përgatitja e strategjisë ndër-sektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga FAO .

nga grumbullimi i BMA-ve. Mbledhja e BMA-ve të egra është më e zhvilluar dhe e organizuar në zonat malore. Në disa zona të Shqipërisë së Veriut (Malësi e Madhe, Kukës dhe Dibër), mbledhja dhe kultivimi i BMA-ve përbën rreth 30% - 40% të të ardhurave të familjeve rurale. Rritja e qëndrueshme e furnizimit dhe cilësisë së BMA-ve të egra kërkon zgjerimin dhe përmirësimin e ambienteve dhe të teknologjisë për seleksionimin, kalibrim, tharjen dhe magazinimin. Promovimi i metodave të qëndrueshme të mbledhjes, përmirësimi i gjurmueshmërisë së BMA-ve të egra dhe administrimi më i mirë i sektorit janë gjithashtu të nevojshme për të parandaluar shfrytëzimin pa kriter të burimeve natyrore.

Konkurrenca për furnizim me lëndë të parë dhe reduktimi i mbledhjes së BMA-ve të egra, për shkak të braktisjes të zonave rurale, ka shtyrë kompanitë tregtare të stimulojnë kultivimin e BMA-ve. BMA-te më të kultivuara janë sherebela, rigoni, trumza dhe livanda. Numri i përafërt i fermerëve kultivues në nivel vendi është pak mbi 4000 (më i lartë në Shkodër).

Është vlerësuar se prodhimi i BMA-ve të kultivuara mund të rritet në mënyrë të konsiderueshme, favorizuar nga disponueshmëria e tokës së përshtatshme, kraut të punës dhe kërkesës së lartë të tregut. Zhvillimi i BMA-ve të kultivuara kërkon rritjen e investimeve të fermerëve, furnizime me input-e cilësore (farëra dhe fidanë të certifikuara), specializim të prodhimit në funksion të përdorimit të produktit, përmirësim të kultivimit dhe praktikave të pas-vjeljes. Edhe investimet në shërbimet e specializuara këshillimore (trajnim, extension materiale, etj), për kultivimin e BMA-ve janë gjithashtu të nevojshme për përmirësimin e praktikave të menaxhimit të tokës dhe cilësisë.

Zinxhiri i vlerës së BMA-ve përbëhet nga grumbulles në nivelin rrethi/qarku, të cilët kryejnë disa operacione të thjeshta si: tharje, pastrim etje. Janë rreth 30 grumbullues në nivel rrethi/qarku, që shesin tek përpunuesit, të cilët kryejnë aktivitete me vlerë të shtuar, si pastrim, bluarje dhe paketim. Janë rreth 20 përpunues-eksportues të vegjël që veprojnë në sektorin e BMA-ve në Shqipëri, si dhe 10 përpunues-eksportues të mesëm deri të mëdhenj<sup>28</sup>.

Aktualisht Shqipëria prodhon çdo vit mes 35 ton dhe 40 ton vajra esenciale, që prodhohen nga një numër në rritje i kompanive përpunuese të vogla, të mesme dhe të mëdha. Secila prej këtyre kompanive ka një distilues, i cili funksionon përmes teknologjisë me avull. Vajrat esenciale kryesore që prodhohen, përfshijnë ato nga sherebela, dëllinja, rigoni, trumza dhe dimrit.

Kapacitetet e prodhimit dhe prodhimi i mjaltit kanë qenë gjithashtu në rritje. Numri i zgjojeve është rritur nga 171.000 në vitin 2007 në 239,000 në vitin 2012 (40%) dhe prodhimi i mjaltit - nga 2071 ton në vitin 2007 në 3084 ton në vitin 2012 (49%). Rreth gjysma e sasisë së mjaltit prodhohet në 3 qarqe - Vlorë, Korçë dhe Elbasan. Bletarët e rajonit të Vlorës, veçanërisht ata të Sarandës, janë më të konsoliduar dhe më të orientuar drejt tregut.

Në shumicën e rajoneve të tjera të Shqipërisë, prodhimi i mjaltit mbetet një komponent i jetesës bujqësore me sisteme të kombinuara prodhimi. Vetëm 15% e prodhimit bazohet në prodhues të cilët kanë më shumë se 50 zgjoje bletësh. Teknologjitë e prodhimit janë të vjetra (zgjojet e bletëve) dhe ka nevojë për investime në krijimin e koshereve moderne, si dhe në pajisjet e nxjerrjes, filtrimit dhe dhe paketimit. Ekziston nevoja për të udhëzuar fermerët, në mënyrë që të veprojnë në përputhje me standardet për nxjerrjen, trajtimin dhe përpunimin e mjaltit.

---

<sup>28</sup>Bimët mjekësore dhe aromatike. Studimi Mini-Sektorial, Raporti final, 2014. Studimi është përgatitur nga Projekti "Përgatitja e strategjisë sektoriale ndërkombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga FAO.



Mjaliti prodhohet kryesisht për tregun vendas dhe eksportohet në sasi të vogla. Produktet më të vlefshme janë mjalti i gështenjës dhe mjalti me bazë lulet e ndryshme si dhe bimët mjekësore. Ka furnizim të pakët dhe treg të kufizuar të qumështit të bletës, polenit të bletës, dyllit, dhe propolisit. Tregu kryesor i mjaltit shqiptar janë qytetet e mëdha. Një pjesë tjetër e mjaltit blihet nëpër ferma në sasi të mëdha nga tregtarët ose bletari e transporton mjaltin e papërpunuar nga ferma deri tek shitësit vendas. Kriteret e kontrollit dhe sigurisë së tregut pothuajse nuk zbatohen dhe gjurmueshmëria e dobët pengon promovimin e produkteve lokale dhe rajonale.

Prodhimi i *kërpudhave* ka qenë mes 100-130 ton në periudhën 2007-2011. Gjatë viteve të fundit janë bërë investime të reja me mbështetjen e donatorëve, të cilat kontribuan në rritjen e prodhimit dhe kapacitetet e përpunimit. Sektori ka potencial për rritje bazuar në rritjen e kërkesës së tregut vendas.

*Akuakultura* është një aktivitet i rëndësishëm dhe ka potencial për zhvillim, e cila gërsheton aspekte sociale, ekonomike, biologjike, ekologjike dhe mjedisore. Krahasuar me sektorë të tjerë të bujqësisë, nënsektorët e akuakultures kanë rëndësi dhe peshë modeste ekonomike, por në rast të përhapjes së gjerë të impianteve të kontrolluara bazuar në kulturat e liçensuara, prodhimi mund të jetë të paktën 2-2,5 herë më i lartë se për momentin, gjë që mund të sigurojë të ardhura të arsyeshme për individët, sipërmarrjet dhe komunitetet.

Shumëllojshmëria e burimeve ujore në Shqipëri, duke përfshirë liqenet, lumenjtë, rezervuarët e ujitjes, lagunat bregdetare dhe vijën bregdetare, jep mundësi për kultivimin e llojeve të ndryshme, duke përdorur metoda të ndryshme të kultivimit<sup>29</sup>. Krapa prodhohet në liqenet natyrore dhe rezervuarët, trofta ylber rritet në sisteme intensive në vaska, ndërsa levreku dhe merluci kultivohen në kafaze përgjatë bregdetit Jon.

Në 2012 prodhimi akuakultures arriti në 2020 ton, nga të cilat 38% janë midhje. Akuakultura është rritur ndjeshëm nga 85 ton në 2001 në rreth 2.472 ton në 2007, por nga atëherë prodhimi ka rënë me gati 23% me ndryshime të mëdha në prodhimin vjetor.

Prodhimi i midhjeve ka tradita të gjata në Shqipëri, por prodhimi i tyre është ulur në mënyrë të konsiderueshme në vitet 1990 për shkak të ndalimit të eksportit të molusqeve bivalve. Në fillim të viteve 2000, prodhimi u rrit me rreth 1,400-1,500 ton por në vitet e fundit ka pasur luhatje të mëdha në prodhim. Problemet kryesore kanë të bëjnë me standardet e higjienës, sidomos për midhjet dhe molusqet bivalve, e cila pengon eksportet nga ky sektor.

Zhvillimi i akuakultures është favorizuar nga rritja e kërkesës për produktet e peshkut që lidhet me rritjen e të ardhurave dhe zhvillimin e industrisë së turizmit. Konsumi i peshkut dhe produkteve të peshkut është gati dyfishuar, megjithëse ende mbetet i ulët (5,2 kg për frymë në vit).

*Përpunimi në ferma i produkteve bujqësore* është shumë i zakonshëm dhe siguron një pjesë të rëndësishme të të ardhurave të ekonomive familjare rurale. Të ardhurat nga përpunimi në fermë u vlerësuan të jenë rreth 59 milionë Euro në 2012, nga të cilat 28% janë nga përpunimi i produkteve blegtorale. Produktet tradicionale blegtorale përfshijnë kosin, gjalpin, gjizën dhe lloje të ndryshme të djathërash nga lopa, delja dhe qumështi i dhisë. Përpunimi në fermë kontribuon në mbështetjen e bujqësisë dhe shfrytëzimin e objekteve të fermave në zonat e

---

<sup>29</sup>*Rishikimi i Peshkimit Shqiptar dhe Nënsektorëve të Akuakultures*, Raporti Final 2014. Studimi është përgatitur nga Projekti "Përgatitja e strategjisë sektoriale ndërkombëtare për bujqësinë dhe zhvillim rural në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga FAO.

thella malore, të cilat kanë mungesë të infrastrukturës. Kështu, qumështi i deleve dhe dhive përpunohet në male, për shkak të mungesës së infrastrukturës për transportin e qumështit të freskët në pikat e grumbullimit.

Prodhimit është kryesisht për vetëkonsum ose tregtohet në tregjet lokale. Prodhimi dhe marketingu karakterizohen nga informaliteti i lartë. Përpunimi në ferma vuan nga zbatimi i dobët i standardeve të higjienës, për shkak të ambienteve dhe të pajisjeve bazë të papërshtatshme, dhe të nivelit të ulët të njohurive të fermerëve mbi teknologjitë dhe standardet e reja të higjienës.

Konsumatorët shqiptarë kanë një prirje të fortë për produktet tradicionale, veçanërisht të mishit, por edhe për produktet e bëra nga qumështi, frutat dhe perimet. Tregjet ekzistuese lokale kanë potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm, nëse objektet dhe pajisjet modernizohen dhe prodhuesit fillojnë të promovojnë dhe shpërndajnë produktet e tyre me një qasje profesionale, duke i dhënë vlerë avantazhit të tyre konkurrues. Ka mundësi për të zhvilluar skemat e cilësisë, bazuar në origjinën gjeografike dhe specialitetet tradicionale, duke rritur në këtë mënyrë vlerën e shtuar. Mungesa e standardeve të ndryshme minimale të sigurisë së ushqimit (më të ulta) për përpunimin në fermë dhe marketingun e drejtpërdrejtë, ashtu si në shumë Shtete Anëtare, kërcënon qëndrueshmërinë e sektorit.

*Turizmi* është rritur në mënyrë të konsiderueshme në Shqipëri gjatë viteve të fundit. Industria e turizmit gjeneron drejtpërdrejt 6,1% të PBB-së dhe 35% të të ardhurave të eksportit dhe drejtpërdrejt ose tërthorazi ka siguruar pothuajse 20% të punësimit të përgjithshëm në vitin 2012. Numri i vizitorëve të huaj në Shqipëri është rritur me rreth 3.5 milion në 2012. Rreth 80% e vizitorëve në Shqipëri vijnë nga Kosova (46%), ish Jugosllavia, Republika e Maqedonisë dhe Evropa Jugore. Shqipëria është shumë e varur nga sezoni i verës, duke qenë se 50% e prurjeve turistike përqendrohen në Korrik dhe Gusht.

Turizmi bregdetar ka qenë produkti kryesor në Shqipëri. Ai përkufizohet nga plazhi dhe dielli dhe karakterizohet nga sezonaliteti i lartë. Shumica e turistëve me destinacion bregdetin janë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

Zonat rurale në Shqipëri ofrojnë mundësinë për zhvillimin e aktiviteteve të turizmit rural, ekoturizmit dhe aktiviteteve në natyrë (rafting në lumë, paragliding, ecjet me biçikletë, peshkim, ecjet në natyrë, alpinizëm, ngjitjet në mal, udhëtime me kalë, ture studimore, etje). Zonat rurale kanë edhe potencial për zhvillimin e turizmit kulturor, të bazuar në vendet e Trashëgimisë Botërore si në parkun arkeologjik të Butrintit, në Berat dhe Gjirokastrë dhe gjithashtu produktet kulturore turistike të specializuara (festivale folklorike, mënyra e jetesës rurale, festimet e fshatit, etje).

Turizmi natyror me një lidhje të fortë me Parqet Kombëtare dhe zona të tjera të mbrojtura ka potencial të mirë për zhvillim si përtregun e brendshëm dhe atë të huaj.

Në bazë të studimeve të ndryshme, vlerësimet tregojnë se rreth 60% e NUTS-ve në 3 qarqe kanë burime dhe aktive të mjaftueshme natyrore për të zhvilluar *turizmin e natyrës, turizmin rural dhe kulturor*. Disa prej tyre tashmë kanë përfshirë zhvillimin e turizmit si një prioritet strategjik në planet e tyre të zhvillimit. Aktualisht turizmi rural është i përqendruar në një numër të kufizuar rajonesh, kryesisht (i) në pjesën jugore të vendit (Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastrë); (ii) në Alpet e Veriut (Vermosh, Theth dhe Valbonë, në rajonet e Shkodrës dhe Kukësit) dhe (iii) në rajonin e Korçës (Dardhë, Voskopojë dhe Vithkuq).

Spektori i turizmit të natyrës dhe atij rural deri tani është i vogël por në rritje. Strategjitë për zhvillimin e turizmit rural në nivel qarku ose lokal janë përgatitur me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm dhe është ofruar asistencë për zbatimin e projekteve të integruara. Ka projekte të zbatuara suksesshëm në Shkodër dhe Kukës, të mbështetura nga GIZ, të cilat

ndërthurin përmirësimin e akomodimit, zhvillimin e shërbimeve dhe promovimin aktiv. Nisma për zhvillimin e turizmit të natyrës dhe atij rural, realizuar me mbështetjen e GTZ në 2007 dhe përfshirja e komunitetit të fshatit Theth rezultuan me ngritjen e një rrjeti bujtinash dhe shënimin e shtigjeve të ecjeve në natyrë, të cilat çuan në një rritje domethënëse të fluksit të turistëve.

Turizmi i natyrës, ai kulturor dhe rural kombinohen në shumë raste. Rrethet e Përmetit dhe Gjirokastrës kanë zhvilluar një gamë shërbimesh turistike, si oferta shtesë për turizmin kulturor në zonat që janë nga destinacionet turistike më të frekuentuara të vendeve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si Butrinti, Gjirokastra dhe Berati. Rajoni i Korçës si dhe disa rajone të tjera japin një shembull të mirë për zhvillimin e suksesshëm të turizmit, bazuar në bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendore dhe sektorit privat për konsolidimin e përpjekjeve të zhvillimit të turizmit, p.sh. Pogradeci, qyteti i Korçës, Liqenet e Prespës, si dhe me krijimin e parkut ndërkufitar kombëtar dhe sistemin e ecjes në natyrë rreth fshatrave malore të Voskopojës, Vithkuqit dhe Dardhës.

Zonat rurale pranë bregdetit jugor kanë një potencial të madh për të tërhequr turistë, duke siguruar aktivitete turistike në ferma dhe mjedise për kohën e lirë dhe argëtimin, kështu qarku i Vlorës është fokusuar në integrimin e turizmit detar me agro / turizmin rural dhe turizmin kulturor bazuar në vendin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, në Butrint.

Ekzistojnë mundësi për të zhvilluar turizmin rekreativ dhe turizmin c'lodhes në zonat rurale, të cilat janë gjithashtu afër qendrave urbane, si dhe duke u mbështetur në interesin në rritje të popullsisë urbane për eksperiencë të kombinuar me natyrën, jetën rurale dhe ushqimin tradicional.

Zhvillimi i turizmit rural është i kufizuar nga mungesa e cilësisë adekuate të akomodimit dhe kateringut dhe moszhvillimit të atraksioneve turistike. Në disa rajone janë bërë investime në mjedisete strehimit, duke filluar nga rindërtimi i shtëpive tradicionale, përmirësimeve të vogla të kushteve sanitare, deri te hotelet dhe pensionet e ndërtuara rishtazi. Investimi në ndërtesat tradicionale ka një avantazh të madh për ruajtjen e trashëgimisë dhe përmirësimin e atraktivitetit të përgjithshëm të zonës, sepse shumë ndërtesa të vjetra janë lënë pas dore ose janë braktisur.

Një problem i rëndësishëm është qasja e vështirë e disa zonave rurale me potencialet e turizmit për shkak të infrastrukturës së dobët rrugore. Në disa zona atraktivitetin e peizazhit dhe të natyrës e kanë dëmtuar landfill-et, problemet me furnizimin me ujë dhe kanalizimet.

Turizmi rural mund të gjejë avantazhe në mikpritjen e popullit shqiptar, por ka mungesë përvoja, aftësish dhe kapacitetesh për të ofruar shërbime cilësore për turistët. Zhvillimi i turizmit rural kërkon gjithashtu forcimin e bashkëpunimit mes partnerëve të ndryshëm në nivel lokal – mes autoriteteve vendore, organizatave jo-qeveritare dhe biznesit dhe mund të përfitojë në mënyrë të konsiderueshme nga qasja LEADER për zhvillimin e territorit.

*Strategjia e Turizmit 2014-2020* ka për qëllim zhvillimin e Shqipërisë si një destinacion tërheqës, autentik dhe mikpritës të turizmit në Evropë, bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike. Ajo është e fokusuar në konsolidimin dhe dizenjimin e destinacioneve të reja konkurruese, duke u dhënë prioritet zonave turistike të zhvilluara, vendeve dhe atraksioneve në Shqipëri.

Sipas Strategjisë së turizmit, zhvillimi i turizmit shqiptar do të fokusohet në katër produkte kryesore: në turizmin kulturor dhe të trashëgimisë, në turizmin e natyrës, në turizmin rural dhe në turizmin bregdetar. Shqipëria do të promovohet në tregjet ndërkombëtare si një destinacion i vetëm - vend me kombinime të shumta të aktiviteteve të ndryshme të turizmit, në një zonë të vogël gjeografike.

Strategjia e turizmit përcakton se destinacioni i turizmit do të jetë thelbi dhe pika kryesore e zhvillimit të turizmit. Kjo do të kërkojë që zhvillimi i produktit të jetë i përqendruar dhe të lidhet me zhvillimin e destinacionit. Projektet që mbështesin zhvillimin e turizmit do të kenë prioritet dhe do të përqendrohen në destinacionet prioritare turistike. Strategjia vë si qëllim zhvillimin e 30 destinacioneve (10 projekte me theks te kultura, 10 projekte me theks te natyra, 10 projekte me theks te bregdeti) me produkte të tregtueshme, struktura, plane, mekanizma zbatimi dhe buxheti; 200 atraksione turistike (nga të cilat 100 kulturë, 50 natyrë). Destinacionet prioritare dhe atraksionet do të specifikohen në Master Planin e Turizmit.

Punimet artizanale të dorës kanë traditë të gjatë dhe mund të pasurojnë përvojën e turizmit, ruajtjen dhe zhvillimin e traditave kulturore, artistike dhe historike, si dhe krijimin e të ardhurave në zonat rurale, nëse integrohen me zhvillimin e turizmit. Ka disa organizata joqeveritare aktive të cilat mbështesin zhvillimin dhe marketing-un e zejeve lokale<sup>30</sup>. Këto artizanate kanë potencial për eksporte në qoftë se marketin-gu është i mirë organizuar.

Ka gjithashtu mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të tjera fitimprurëse në zonat rurale bazuar në burimet vendase, si dhe të kërkesës vendase ose të eksportit.

### **3.5.Pergatitja dhe zbatimi i Strategjive Lokale te Zhvillimit – Leader**

Zhvillimi territorial rural u prezantua për herë të parë si një prioritet me Strategjinë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural 2007-2013, megjithëse veprimet e synuara nga MBZHRAU nuk u zbatuan.

Forca kryesore lëvizëse për Zhvillim Ekonomik Lokal (LED), përmes mobilizimit të resurseve të zonave endogjene ishin donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat në mbështetje të komunitetit, të cilat, në bashkëpunim me sektorin privat dhe autoritetet vendore hartuan strategji lokale dhe zbatuan iniciativa në shkallë të vogël për zhvillimin e komuniteteve bazuar në objektiva të përbashkëta prioritare. Donatorët më aktivë në këtë fushë ishin IFAD, DFID<sup>31</sup> (përmes Oxfam, e cila krijoi 3 LAG-e), SNV, PNUD-i, Qeveria Gjermane (përmes GIZ), Banka Botërore, etje.

Në disa prej këtyre iniciativave, zhvillimi rural ishte objektivi kryesor - më i lidhur me zbutjen e varfërisë, mbrojtjen e mjedisit, barazinë gjinore dhe zhvillimin e sektorit privat, edhe pse shpesh zbatohet në zonat rurale dhe të largëta. Kjo qasje çoi në ngritjen e Grupeve Lokale të Veprimit (LAG-et) që zbatuan projekte në territorin e tyre dhe iniciuan aktivitete kombëtare të rrjeteve rurale, përmes një serie të ngritjes së kapaciteteve, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit dhe trajnimeve.

Programi *Zhvillimi Qendrueshëm i Zonave Rurale Malore Shqiptare* mbështetur nga IFAD dhe zbatuar nga MADA promovoi ngritjen e LAG-ve në zonat malore të Shkodrës, Lezhës, Kukësit, Dibrës dhe në rajonet e Korçës, Librazhdit, Gramshit dhe Pogradecit.

Oxfam-i, përmes OJQ-së të vendosur në nivel lokal QuoDev, ka mbështetur krijimin e 3 LAG-ve: LAG Drini-Dibër (në verilindje të Shqipërisë); LAG Maranaj-Shkodër (në veriperëndim të Shqipërisë) dhe LAG AdriJon Vlora (në jugperëndim të Shqipërisë), e cila në total mbulon 11 komunitete (58 fshatra dhe më shumë se 120,000 banorë), me qëllim

<sup>30</sup>Organizata për Zhvillim dhe Ruajtjen e Gjirokastrës, Shoqata e Artizanatit Tradicionale dhe Tregtisë - Pogradeci, Fondacioni Rozafa, etj

<sup>31</sup>Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Mbretërisë së Bashkuar.

forcimin e rolit të grave në zonat rurale në përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit lokal dhe stimulimin e rritjes ekonomike të territorit.

Iniciativa e mbështetur nga SNV-ja në themelimin e Rrjetit të Organizave Rurale Shqiptar për prodhimin e frutave, te imtave, sektorin e bimëve dhe erëzave, ku si qëllim është mbështetja e krijimit të rrjeteve ndërmjet anëtarëve, duke i inkurajuar ata që të bëhen aktorë aktivë në iniciativat e zhvillimit rural, përmes ndërgjegjësimit, krijimit të rrjeteve dhe ngritjes së kapaciteteve.

PNUD-i me Programin GOLD ART në rajonet e Durrësit, Gjirokastrës, Shkodrës dhe Vlorës ka promovuar edhe qasjet gjithëpërfshirëse LED, nëpërmjet përpilimit dhe zbatimit të Planeve Strategjike të Zhvillimit, me vëmendje të veçantë te grupet më të prekshme që adresojnë: qeverisjen, mbrojtjen e mjedisit, shërbimet sociale dhe kujdesin shëndetësor, kulturën dhe çështjet e arsimit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe nxitjen e dialogut kulturor dhe procesit të integritit evropian.

Strategjitë për zhvillim ekonomik lokal (LED) të Beratit, Bashkisë së Durrësit, Korçës, Lezhës dhe Shkodrës janë zhvilluar në kuadër të mbështetjes së Programit DELTA<sup>32</sup> me qëllim që të ndikojnë në ristrukturimin e ekonomisë lokale përmes zhvillimit të sektorit privat. Programi ka kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve, si dhe në rritjen e përgjegjshmërisë së ndërsjellë me zhvillimin e strategjive lokale dhe me zbatimin e projekteve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në këto fusha.

IDM<sup>33</sup>, një bazë think-tank-u në Tiranë, promovoi qasjen LEADER përmes aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit, publikimit të sondazheve dhe dokumenteve të politikave, organizimit të seminareve, konferencave dhe advokacisë.

LAG-et e ngritura në kuadër të ashkëpunimit ndërkuftar u mbështetën përmes projektit "Mjedisi për Njerëzit në Harkun Dinarik", i cili mbështeti krijimin e LAG-eve dhe nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes LAG-eve të Shqipërisë dhe Malit të Zi, në lidhje me bashkëpunimin për mbrojtjen e mjedisit, turizmit, rekreacionit dhe për zhvillimin e qëndrueshëm në territoreve të dy bashkësive kufitare, në Bjeshkët e Namuna / Malet Prokletije.

### 3.6. Tabela e treguesve të kontekstit

	Treguesi	Njësia	Vlera	Viti	Komente/ Burimi
<b>I. Indikatorët social-ekonomikë</b>					
<b>1</b>	<b>Popullsia</b>				
	Totali	Banorë	2,898,782	2013	Komente ne fund te tabelës
	kryesisht rurale (KR)	% i totalit	22.7%	2013	MA
	i ndërmjetëm (N)	% % i totalit	40.2%	<b>2013</b>	MA
	kryesisht urbane (KU)	% % i totalit	37.1%	<b>2013</b>	MA
<b>2</b>	<b>Struktura e moshës</b>				
	totali < 15 vjeç	% e popullsisë totale	20.6 %	2013	MA

<sup>32</sup>Programi DELTA (Zhvillimi i Ndërmarrjeve Lokale përmes Aleancës dhe Aksionit), të mbështetur nga WB dhe Instituti për Shoqëri të Hapur.

<sup>33</sup>Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

	<b>Treguesi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Vlera</b>	<b>Viti</b>	<b>Komente/ Burimi</b>
	totali 15 - 64 vjeç	% e popullsisë totale	68 %	2013	MA
	totali > 64 vjeç	% e popullsisë totale	11.4 %	2013	MA
	KR < 15 vjeç	% e popullsisë KR	21.6 %	2013	MA
	KR 15 - 64 vjeç	% e popullsisë KR	66.6 %	2013	MA
	KR > 64 vjeç	% e popullsisë KR	11.8 %	2013	MA
	N < 15 vjeç	% e popullsisë N	20.3 %	2013	MA
	N 15 - 64 vjeç	% e popullsisë N	67.7 %	2013	MA
	N > 64 vjeç	% e popullsisë N	12 %	2013	MA
	KU < 15 vjeç	% e popullsisë KU	20.4 %	2013	MA
	KU 15 - 64 vjeç	% e popullsisë KU	69.2 %	2013	MA
	KU > 64 vjeç	% e popullsisë KU	10.4 %	2013	MA
<b>3</b>	<b><i>Territori</i></b>				
	Totali	km <sup>2</sup>	28,748	2013	
	kryesisht rurale (KR)	% e sipërfaqes totale	45.8%	2013	MA
	i ndërmjetëm (N)	% e sipërfaqes totale	45.8%	2013	MA
	kryesisht urbane (KU)	% e sipërfaqes totale	8.4%	2013	MA
<b>4</b>	<b><i>Dendësia e Popullsisë</i></b>				
	Totali	banorë / km <sup>2</sup>	101	2013	
	kryesisht rurale (KR)	banorë / km <sup>2</sup>	48	2013	MA
	i ndërmjetëm (N)	banorë / km <sup>2</sup>	85	2013	MA
	kryesisht urbane (KU)	banorë / km <sup>2</sup>	427	2013	MA
<b>5</b>	<b><i>Shkalla e punësimit</i></b>				
	totali (15-64 vjeç)	% e popullsisë së të njëjtit grup-moshe dhe gjinie	50.2	2013	
	meshkuj (15-64 vjeç)		57.5	2013	
	femra (15-64 vjeç)		43.6	2013	
	totali (20-64 vjeç)		57.2	2013	
	meshkuj (20-64 vjeç)		65.1	2013	
	femra (20-64 vjeç)		49.9	2013	
	Zonat rurale (totali, meshkuj, femra)	%	:		
<b>6</b>	<b><i>Shkalla e papunësisë</i></b>				
	totali (15-64 vjeç)	% e popullsisë të të njëjtit grup-moshe dhe gjinie	16.1	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore
	meshkuj (15-64 vjeç)		18.1	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore
	femra (15-64 vjeç)		13.5	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore
	të rinj (15-29 vjeç)		26.7	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore
	totali (15+)	% e popullsisë të të njëjtit grup-moshe dhe gjinie	15.6	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore
	meshkuj (15+)		17.5	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore

	<b>Treguesi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Vlera</b>	<b>Viti</b>	<b>Komente/ Burimi</b>
	femra (15+)		13.2	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore
	të rinj (15-29 vjeç)		26.7	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore
	Zonat rurale	%	:		
<b>7</b>	<b><i>PBB për frymë</i></b>				
	PBB kombëtare për frymë	EUR/banorë	3,312.5	2012*	Të dhënat gjysmë finale
		PPS/ banorë	7,512.7	2012*	Të dhënat gjysmë finale
		Indeksi PPS (EU-27 = 100)	29.5	2012**	Të dhënat gjysmë finale Indeksi i PPS shprehet ( EU-28=100)
	Zonat rurale		:		
<b>8</b>	<b><i>Struktura e ekonomisë</i></b>				
	Totali GVA	EUR milion	8,326.5	<b>2012*</b>	Të dhënat gjysmë finale
	Parësor	EUR milion	1,817.3	<b>2012*</b>	Të dhënat gjysmë finale
	Dytësor	EUR milion	2,213.0	<b>2012*</b>	Të dhënat gjysmë finale
	Terciar	EUR milion	4,296.1	<b>2012*</b>	Të dhënat gjysmë finale
	parësor	% e totalit	21.8	2012*	Të dhënat gjysmë finale
	Dytësor	% e totalit	26.6	2012*	Të dhënat gjysmë finale
	Terciar	% e totalit	51.6	2012*	Të dhënat gjysmë finale
<b>9</b>	<b><i>Struktura e punësimit</i></b>				
	Totali	1000 persona	992	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore
	Parësor	1000 persona	453	<b>2013</b>	Seksioni A, B e NACE rev 1,1; Anketa e Fuqisë Punëtore, 2013
	Dytësor	1000 persona	160	<b>2013</b>	Seksioni A, B e NACE rev 1,1; Anketa e Fuqisë Punëtore, 2013
	Terciar	1000 persona	379	<b>2013</b>	Seksioni A, B e NACE rev 1,1; Anketa e Fuqisë Punëtore, 2013
	Parësor	% e totalit	45.6	2013	Seksioni A, B e NACE rev 1,1; Anketa e Fuqisë Punëtore, 2013
	Dytësor	% e totalit	16.1	2013	Seksioni A, B e NACE rev 1,1; Anketa e Fuqisë Punëtore, 2013
	Terciar	% e totalit	38.2	2013	Seksioni A, B e NACE rev 1,1; Anketa e Fuqisë Punëtore, 2013

	Treguesi	Njësia	Vlera	Viti	Komente/ Burimi
10	<b>Produktiviteti i punës nga sektori ekonomik</b>				
	Totali	EUR/person	Llogarit #8/#9		
	Parësor	EUR/person	Llogarit #8/#9		
	Dytësor	EUR/person	Llogarit #8/#9		
	Terciar	EUR/person	Llogarit #8/#9		
<b>II. Treguesit sektorial</b>					
11	<b>Punësimi sipas aktivitetit ekonomik</b>				
	totali	1000 persona	992	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore 2013
	Bujqësi	1000 persona	439	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore 2013
	Bujqësi	% e totalit	44.3	2013	Anketa e Fuqisë Punëtore 2013
	Pylltari	1000 persona	:		
	Pylltari	% e totalit	:		
	industria ushqimore	1000 persona	:		
	industria ushqimore	% e totalit	:		
	Turizmi	1000 persona	:		
	Turizmi	% e totalit	:		
12	<b>Produktiviteti i punës në bujqësi</b>				
	GVA për person të punësuar me kohë të plotë në bujqësi	EUR/AWU	:		
13	<b>Struktura e prodhimit bujqësor</b>				
	Drithëra	% të prodhimit të përgjithshëm	9.1	2012	
	Mish	% të prodhimit të përgjithshëm	18.3	2012	
	Qumësht	% të prodhimit të përgjithshëm	20.6	2012	
	prodhimi i frutave dhe perimeve	% të prodhimit të përgjithshëm	14.7	2012	
14	<b>Produktiviteti i punës në industrinë ushqimore</b>				
	GVA për person të punësuar në industrinë ushqimore	EUR/person	:		
15	<b>Ndërmarrjet bujqësore</b>				
	Numri total i fermave	1000 ndërmarrje	351	2012	
	madhësia mesatare	ha UAA/ ndërmarrje	:		
	madhësia e fermës <2 Ha	1000 ferma	302	2012	
		% e totalit	86	2012	
	madhësia e fermës 2-4.9 Ha	1000 ndërmarrje	49	2012	Në të dhënat tona kemi ferma me madhësi 2 dhe më shumë Ha
		% e totalit	14	2012	:=
	madhësia e fermës 5-9.9 Ha	1000 ndërmarrje	:	2012	:=
		% e totalit	:	2012	:=
	madhësia e fermës 10-19.9 Ha	1000 ndërmarrje	:	2012	:=
		% e totalit	:	2012	:=
	madhësia e fermës 20-29.9 Ha	1000 ndërmarrje	:	2012	:=
		% e totalit	:	2012	:=



	<b>Treguesi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Vlera</b>	<b>Viti</b>	<b>Komente/ Burimi</b>
	madhësia e fermës 30-49.9 Ha	1000 ndërmarrje	:	2012	:=
		% e totalit	:	2012	:=
	madhësia e fermës 50-99.9 Ha	1000 ndërmarrje	:	2012	:=
		% e totalit	:	2012	:=
	madhësia e fermës >100 Ha	1000 ndërmarrje	:	2012	:=
		% e totalit	:	2012	:=
<b>16</b>	<b>Zona bujqësore</b>				
	totali UAA	Ha	1,201,000	2012	
	Arrë	Ha	619,100	2012	
		% e totalit UAA	51.5	2012	
	tokë e përhershme me bar dhe livadh	Ha	505,303	2012	
		% e totalit UAA	42.1	2012	
	kulturat e përhershme	Ha	76,900	2012	
		% e totalit UAA	6.4	2012	
<b>17</b>	<b>Zona bujqësore nën bujqësinë organike</b>				
	e certifikuar	Ha			:=
	në konvertimin	Ha			:=
	e certifikuar dhe në konvertimin	% e totalit UAA			:=
<b>18</b>	<b>Toka e ujitur</b>				
	Totali i tokës së ujitur	Ha	204,735	2012	
		% e totalit UAA	17	2012	
<b>19</b>	<b>Blegtori</b>				
	Bagëti- total	1000 krerë	498	2012	
	Lopë për qumësht	1000 krerë	358	2012	
	Dele – total	1000 krerë	1,809	2012	
	Dhi	1000 krerë	810	2012	
	Derra	1000 krerë	159	2012	
	Shpendët - broilers	1000 krerë	9,494	2012	
	Pula	1000 krerë	5,938	2012	
<b>20</b>	<b>Fuqia punëtore në fermë</b>				
	totali i fuqisë punëtore të rregullt	1000 persona ose 1000 AWU			:=
	fuqia mashkullore punëtore e rregullt në fermë	1000 persona ose 1000 AWU			:=
		% e totalit			:=
	fuqia femërore punëtore e rregullt në fermë	1000 persona ose 1000 AWU			:=
		% e totalit			:=
	fuqia punëtore familjare	1000 persona ose 1000 AWU			:=
		% e totalit të forcës punëtore të rregullt			:=
	Pronarët e vetëm që punojnë në fermë	1000 persona ose 1000 AWU			:=
		% e totalit të forcës punëtore të rregullt			:=
	- anëtarë të familjes së pronarit të vetëm që punojnë në fermë	1000 persona ose 1000 AWU			:=
		% e totalit të forcës punëtore të rregullt			:=
	fuqia punëtore jo e familjes	1000 persona ose 1000 AWU			:=
		% e totalit të forcës			:=

	Treguesi	Njësia	Vlera	Viti	Komente/ Burimi
		punëtore të rregullt			
	fuqia punëtore jo e rregullt	1000 persona ose 1000 AWU			: =
21	<b>Struktura e moshës së menaxherëve të fermës</b>				
	Numri total i menaxherëve të fermës	1000 persona			: =
	35 vjeç ose më pak	1000 persona			: =
		% e totalit			: =
	35-55 vjeç	1000 persona			: =
		% e totalit			: =
	55 vjeç ose më shumë	1000 persona			: =
% e totalit				: =	
raporti <35 / >= 55 vjeç				: =	
21	<b>Trajnimi në bujqësi i menaxherëve të fermës</b>				
	<b>Numri total i menaxherëve të fermës</b>	<b>1000 persona</b>			: =
	Totali me trajnim bazë	1000 persona			: =
		% e totalit			: =
	Totali vetëm me përvojë praktike	1000 persona			: =
		% e totalit			: =
	Totali me trajnim të plotë në bujqësi	1000 persona			: =
		% e totalit			: =
	<b>Numri i menaxherëve të fermës - 35 vjeç ose më pak</b>	<b>1000 persona</b>			: =
	35 vjeç ose më pak me trajnim bazë	1000 persona			: =
		% e grupit të moshës			: =
	35 vjeç ose më pak vetëm me përvojë praktike	1000 persona			: =
		% e grupit të moshës			: =
	35 vjeç ose më pak me trajnim të plotë në bujqësi	1000 persona			: =
		% e grupit të moshës			: =
	<b>Numri i menaxherëve të fermës - 35-55 vjeç</b>	<b>1000 persona</b>			: =
	35-55 vjeç me trajnim bazë	1000 persona			: =
		% e grupit të moshës			: =
	35-55 vjeç vetëm me përvojë praktike	1000 persona			: =
		% e grupit të moshës			: =
35-55 vjeç pak me trajnim të plotë në bujqësi	1000 persona			: =	
	% e grupit të moshës			: =	
<b>Numri i menaxherëve të fermës - 55 vjeç ose më shumë</b>	<b>1000 persona</b>			: =	
55 vjeç ose më shumë me trajnim bazë	1000 persona			: =	
	% e grupit të moshës			: =	
55 vjeç ose më shumë vetëm	1000 persona			: =	

	<b>Treguesi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Vlera</b>	<b>Viti</b>	<b>Komente/ Burimi</b>
	me përvojë praktike	% e grupit të moshës			: =
	55 vjeç ose më shumë me trajnim të plotë në bujqësi	1000 persona			: =
		% e grupit të moshës			: =
<b>23</b>	<b>Formimi i kapitalit fiks bruto në bujqësi</b>				
	GFCF	milion EURO	63.9	2012*	Të dhënat gjysmë finale
	Pjesa e GVA në bujqësi	% e GVA në bujqësi	21.8	2012*	Të dhënat gjysmë finale
<b>24</b>	<b>Pyll dhe tokë tjetër e pyllëzuar (FOWL)</b>				
	Totali	1000 ha	1,041	2013	
	pjesa e sipërfaqes së përgjithshme të tokës	% e sipërfaqes së përgjithshme të tokës	36	2013	
	Pyll dhe tokë tjetër e pyllëzuar	1000 ha	197	2013	
	pjesa e sipërfaqes së përgjithshme të tokës	% e sipërfaqes së përgjithshme të tokës	7	2013	
<b>25</b>	<b>Infrastruktura e turizmit</b>				
	Numri i krevateve në qendrat turistike akomoduese kolektive	Numri i krevateve	32,004	2012	Anketa Strukturore e Biznesit Vjetor
<b>26</b>	<b>Mbulimi i tokës</b>				
	pjesa e zonës bujqësore	% e sipërfaqes së përgjithshme			
	pjesa e tokës natyrore me bar	% e sipërfaqes së përgjithshme	15		Ministria e Mjedisit
	pjesa e tokave pyjore	% e sipërfaqes së përgjithshme	74		Ministria e Mjedisit
	pjesa e përkohshme e shkurre pyjore	% e sipërfaqes së përgjithshme	25		Ministria e Mjedisit
	pjesa e zonës natyrore	% e sipërfaqes së përgjithshme	87		Ministria e Mjedisit
	pjesa e tokës artificiale	% e sipërfaqes së përgjithshme	10		Ministria e Mjedisit
	pjesa e zonave të tjera	% e sipërfaqes së përgjithshme	3		Ministria e Mjedisit
<b>27</b>	<b>Zogjtë e fermave</b>				
	totali (indeksi)	Indeksi 2000 = 100	:		
<b>28</b>	<b>Zona me bar dhe statusi i ruajtjes së tyre</b>				
	Sipërfaqja e përgjithshme e me bar	ha dhe % e sipërfaqes me bar nën çdo status të mbrojtjes	Kërko të dhëna nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve		: =
<b>29</b>	<b>Pyje të mbrojtura</b>				
	1 Klasë 1 'konservimi i biodiversitetit'	% e zonës FOWL	3.8	2013	Të dhëna administrative
	klasa 1.1 Jo ndërhyrje aktive	% e zonës FOWL	20	2013	Të dhëna administrative
	klasa 1.2 ndërhyrje minimale	% e zonës FOWL	9.2	2013	Të dhëna administrative
	klasa 1.3 Konservimi përmes menaxhimit aktiv	% e zonës FOWL	12.2	2013	Të dhëna administrative

	<b>Treguesi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Vlera</b>	<b>Viti</b>	<b>Komente/ Burimi</b>
	klasa 2 Mbrojtja e peizazheve '	% e zonës FOWL	1.8	2013	Të dhëna administrative
<b>30</b>	<b>Cilësia e ujit</b>				
	1. Bilanci i lëndëve ushqyese bruto (mesatarisht 4 vjet): 1.a) Tepricë potencial i azotit (Gns) mbi tokën bujqësore 1.b) Tepricë potencial i fosforit në tokë bujqësore	1.a) kg N/ha/vit (azot) 2.b) Kg P/ha/vit (fosfor)			: =
	2. Nitrate në ujë të freskët 2.a) Ujëra nëntokësore 2.b) Ujëra sipërfaqësore	% faqeve të monitorimit në 3 klasat e cilësisë së ujit të (të lartë - të moderuar - e ulët)	Klasë cilësi së moderuar të ujit	2013	e
<b>31</b>	<b>Erozioni i tokës nga uji</b>				
	shkalla e humbjes së tokës nga erozioni i ujit	ton/ha/vit	9.51	2013	
	zona bujqësore të prekura mesatarisht dhe shumë rëndë nga erozioni i ujit (>11 t/ha/vit)	ha % i zonës bujqësore			: = : =
	are dhe toke me kultura përhershëm e prekur	ha % i zonës bujqësore			: = : =
	livadhet e përhershme kullotat e prekura	ha % i zonës bujqësore			: = : =
<b>32</b>	<b>Prodhimi i energjisë së rinovueshme nga bujqësia dhe pylltaria</b>				
	nga bujqësia	kToe % e prodhimit total të energjisë së rinovueshme	: - 0.02	: 2013	: Ministria e Mjedisit
	nga pylltaria	kToe % e prodhimit total të energjisë së rinovueshme	206.5 12.32	2012 2012	Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore Koment: Të dhënat i referohen Biomassës (dru zjarri)

Shënim: : = jo në dispozicion; e = vlera e parashikuar; p = i përkohshëm; PR 2013 = Raporti i Progresit për Shqipërinë 013 (SWD(2013) 414 finale)..

#### 4. Analiza SWOT – Përmbledhje e analizave të mësipërme

##### 4.1. Bujqësia, pyjet, industria ushqimore (tabela të veçanta për çdo sektor të përzgjedhur për mbështetje)

*Mishi dhe përpunimi i mishit*

<b>Mishi</b>	
<b>Forca</b>	<b>Dobësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zonë e gjerë me kullota dhe livadhe, të cilat janë të përshtatshme për kullotje;</li> <li>• Sezoni i gjatë i foragjereve ;</li> <li>• Traditëe gjatëe mbarështimit e e të imtave dhe prodhimit blegtoral në përgjithësi;</li> <li>• Ekzistenca e strukturave bazë të ekstensionit dhe transferimit të teknologjisë;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Probleme me menaxhimin e kullotave në aspektin e bimësisë, biodiversitetit, kullotjes pa kriter, etje;</li> <li>• Struktura e fermës në shkallë të vogël dhe mbizotërimi i bujqësisë së subsistencës;</li> <li>• Aktive afatgjata të papërshtatshme (ndertesandërtesa/pajisje), nivel i ulët i mekanizimit në fermë dhe zbatim i kufizuar i teknologjive moderne, i ruajtjes dhe menaxhimit të plehut organik;</li> <li>• Rendimente të ulëta të prodhimit foragjer / mungesa e mekanizimit;</li> <li>• Mbarështimi i bagëtive jo i përshtatshëm për prodhimin e mishit/ produktivitet i ulët i racave;</li> <li>• Plakja e popullsisë që merret me bujqësi dhe mungesa e interesit dhe motivimit të të rinjve për ta konsideruar bujqësinë si profesionin e tyre kryesor;</li> <li>• Njohuritë, informacioni dhe aftësitë e pamjaftueshme, për menaxhimin modern të fermës, standardet kombëtare dhe të BE-së; përmbushje e dobët e standardeve;</li> <li>• Zbatueshmëria e dobët e legjislacionit të sigurisë ushqimore dhe atij mjedisor;</li> <li>• Vështirësitë për aksesin në kredimarrje/kosto e lartë e kreditimit;</li> <li>• Kapacitete të kufizuara për trajnimin profesional. Gama dhe cilësia e pamjaftueshme e shërbimeve të specializuara këshilluese;</li> <li>• Infrastrukturë publike ruralee pazhvilluar;</li> </ul>
<b>Përpunimi i mishit</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sektor dinamik dhe i konsoliduar i përpunimit të mishit;</li> <li>• Korniza ligjore për sigurinë ushqimore në pjesën më të madhe e përafuar me standardet e BE-së;</li> <li>–</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilësi jo e besueshme dhe e paqëndrueshme e produkteve vendore. Sasi të pamjaftueshme dhe kosto e lartë e furnizimeve;</li> <li>• Informaliteti i lartë në sektorin e therjes. Mungesa e zbatimit dhe pajtueshmërisë me standardet e therjes (higjiena, mirëqenia e kafshëve dhe trajtimi i mbeturinave / menaxhim i dobët i thertoreve bashkiake/komunale; teknologjive dhe ndërtesave të vjetruara ndërtesatë prodhimit;</li> <li>• Mungesa e kapaciteteve të përpunimit të mbetjeve të thertoreve;</li> <li>• Mungesa ose dobësia e sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore, pajisjeve, laboratorëve, si dhe e njohurive dhe aftësive të krahut të punës dhe menaxhimit;</li> <li>• Praktika / objekte dhe teknologji të dobëta për largimin dhe trajtimin e mbeturinave, si dhe shfrytëzim i ulët i</li> </ul>

	nënprodukteve të mbetjeve.
<b>Mundësitë</b>	<b>Kërcënimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritje e kërkesës në vend për mish dhe e preferencave të konsumatorëve për produkte të prodhuara në vend;</li> <li>• Rritje e ndërgjegjësimit të konsumatorit për çështjet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore;</li> <li>• Përmirësimi i aksesit në tregjet evropiane;</li> <li>•</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsolidimi dhe zhvillimi i sektorit të shpërndarjes, i cili favorizon prodhuesit e mëdhenj dhe produktet e importit;</li> <li>• Rritja e konkurrencës nga produktete importit me cilësi të lartë</li> </ul>

*Qumështi dhe përpunimi i qumështit*

<b>Prodhimi i qumështit</b>	
<b>Forca</b>	<b>Dobësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zonë e gjerë me kullota dhe livadhe, të cilat janë të përshtatshme për kullotje;</li> <li>• Sezon i gjatë i foragjereve;</li> <li>• Në disa qarqe, prodhim i qumështit të deles gjatë gjithë vitit</li> <li>• Ekzistenca e kornizës ligjore dhe institucionale për sigurinë ushqimore;</li> <li>• Ekzistenca e strukturave bazë të ekstensionit dhe transferimit të teknologjisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mirëmbajtje e dobët e kullotave dhe livadheve;</li> <li>• Shkallë e ulët e strukturës së fermës dhe mbizotërim i bujqësisë së subsistencës;</li> <li>• Higjienë e jo e mirë e qumështit/nxitje të pakta për prodhimin e qumështit me cilësi të lartë</li> <li>• Aktive afatgjata të pamjaftueshme (frigorifer, pajisje për mjelje, ndërtesandërtesa dhe mekanizim);</li> <li>• Rendimente të ulëta të prodhimit foragjer / mungesë e mekanizimit / magazinim i pamjaftueshëm i ushqimit për bagëti;</li> <li>• Produktivitet i ulët i racave;</li> <li>• Menaxhim i papërshtatshëm i shëndetit të kafshëve / përhapje e disa sëmundjeve të kafshëve;</li> <li>• Praktika jo të përshtatshme të largimit të plehut organik;</li> <li>• Lidhje të dobëta ndërmjet aktorëve në zinxhirin e vlerës, veçanërisht midis fermerëve dhe përpunuesve (sistemet e grumbullimit të qumështit);</li> <li>• Informacion dhe aftësi të pamjaftueshme për standardet kombëtare dhe të BE-së; Përputhshmëri e dobët me standardet;</li> <li>• Informalitet i lartë i sektorit;</li> <li>• Infrastruktura publike rurale e pazhvilluar;</li> </ul>
<b>Përpunimi i qumështit</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e investimeve në stabilimentet e përpunimit të qumështit - për të përmirësuar ndërtesat dhe pajisjet për të shmangur kontaminimin e kryqëzuar;</li> <li>• Tendencë për modernizimin dhe konsolidimin e prodhimit të qumështit/kosit;</li> <li>• Ekzistenca e kornizës ligjore dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sasi dhe cilësi e pamjaftueshme dhe e paqëndrueshme e furnizimit të qumështit;</li> <li>• Grumbullimi i qumështit - ferma të vogla, mungesë e pajisjeve të përshtatshme, e automjeteve të specializuara dhe e pajisjeve laboratorike për të kontrolluar dhe ruajtur cilësinë e qumështit;</li> <li>• Teknologji dhe pajisje jo të përshtatshme të përpunimit (sidomos në prodhimin e djathit); Mungesa e punës së kualifikuar (teknologjisë së përpunimit të qumështit, laboratorëve, etje.) në zonat</li> </ul>

<p>institucionale për sigurinë e ushqimore;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i kapacitetit të shoqatave të industrisë dhe konsulentëve privatë, për të këshilluar mbi sistemet GMP/HACCP;</li> </ul>	<p>rurale;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Mungesa e sistemeve ose sistema të pazhvilluara të menaxhimit të sigurisë ushqimore, pajisjeve, laboratorëve, si dhe e njohurive dhe aftësive të krahut të punës dhe atyre menaxheriale;</li> <li>•Mungesa e ambienteve dhe praktikave të përshtatshme për trajtimin dhe përdorimin e mbetjeve;</li> <li>•Infrastrukturë publike rurale e pazhvilluar (rrugët, furnizimi me energji elektrike).</li> </ul>
<p><b>Mundësitë</b></p>	<p><b>Kërcënimet</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Rritje e ndërgjegjësimit të konsumatorit për çështjet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore;</li> <li>•Mundësi për të përfituar ekspertizë të jashtme - përkrahje nga donatorë të ndryshëm dhe kontakte me partnerët e BE-së.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Konsolidimi dhe zhvillimi i sektorit të shpërndarjes, i cili favorizon prodhuesit e mëdhenj dhe produktet e importit;</li> <li>•Rritja e konkurrencës nga produkteve të importit me cilësi të lartë</li> </ul>

*Prodhimi dhe përpunimi i frutave dhe perimeve*

<p><b>Prodhimi i frutave dhe perimeve</b></p>	
<p><b>Forca</b></p>	<p><b>Dobësitë</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Kushte shumë të mira natyrore / prodhim i hershëm i disa llojeve të frutave dhe perimeve / sezon i gjatë i kultivimit;</li> <li>•Rritja e hapësirave me kultura të mbrojtura;</li> <li>•Klastera të reja në fruta dhe perime, si dhe në kultura të mbrojtura;</li> <li>•Eksperiencë teknikat moderne të prodhimit;</li> <li>•Funksionim i mirë i sistemit të tregtimit me shumicë të frutave dhe perimeve;</li> <li>•Sistemi i disponueshëm i informacionit mbi tregun;</li> <li>•Ekzistenca e strukturave bazë të ekstensionit dhe transferimit të teknologjisë;</li> <li>•Preferencë e lartë e konsumatorëve për prodhimet vendit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Prodhim në shkallë të ulët;</li> <li>•Bashkëpunim i pazhvilluar ndërmjet fermerëve (për ambiente pas-vjeljes, makineri, skemat e menaxhimit të ujit).</li> <li>•Lidhje/koordinim i dobët midis prodhuesve dhe përpunuesve për intensifikimin e prodhimit;</li> <li>•Mungesë e mekanizimit të specializuar në ferma dhe pajisjeve të korrjes;</li> <li>•Praktikat e pazhvilluara të pas-vjeljes/mungesa e pajisjeve dhe ambienteve të ruajtjes;</li> <li>•Mungesë ose sisteme të vjetruara të ujëtjes;</li> <li>•Mungesë e njohurive të prodhuesve mbi kërkesat e cilësisë dhe specifikimet e perimeve të papërpunuara për industrinë ushqimore / Prodhimi nuk është në përputhje me GAP globale (global GAP). Asnjë organ i akredituar për të certifikuar fermat me kosto të arsyeshme;</li> <li>•Kontrolle të pamjaftueshme mbi nivelin e pesticideve dhe mbetjeve të PMB-ve.</li> </ul>
<p><b>Përpunimi i frutave dhe perimeve</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Rritja e sasisë së furnizimit me lëndë të parë vendase;</li> <li>•Rritja e investimeve (kryesisht nga kompanitë e mëdha) në fushën e sigurisë/cilësisë ushqimore, ndertesave dhe pajisjeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Cilësi e ulët/e paqëndrueshme e lëndëve të para për përpunim;</li> <li>•Mungesë e specializimit në industrinë e përpunimit;</li> <li>•Mungesë e kapaciteteve të mjaftueshme për ruajtjen frigoriferike;</li> <li>•Teknologji të vjetruara;</li> <li>•Standarde të dobëta të sigurisë ushqimore – ndertesa jo</li> </ul>

	<p>të përshtatshme, mungesa e pajisjeve për sigurinë e ushqimit dhe kontrollit të cilësisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Nuk ka trajtim të ujërave të zeza dhe mbetjeve;</li> <li>•Informalitet i lartë dhe konkurrencë e pandershme nga funksionimi i stabilimenteve të palicencuara.</li> </ul>
<b>Mundësitë</b>	<b>Kërcënimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Përmirësimi i aksesit në tregjet e BE-së;</li> <li>•Mundësi për të përfituar ekspertizën e jashtme përmes mbështetjes së donatorëve të ndryshëm dhe kontakteve me partnerët e BE-së.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Ndryshimet e klimës, ndikojnë negativisht në prodhimin primar (thatësitrat, përmytjet);</li> <li>•Konsolidimi dhe zhvillimi i sektorëve të shpërndarjes, favorizon prodhuesit e mëdhenj dhe produktet e importit;</li> <li>•Rritja e konkurrencës nga produkteve e importit me cilësi të lartë;</li> </ul>

*Kultivimi i rrushit dhe përpunimi i verës*

<b>Kultivimi i rrushit</b>	
<b>Forca</b>	<b>Dobësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Terren dhe kushte klimatike të favorshme për prodhimin e rrushit, duke lejuar prodhimin e hershëm të rrushit të tavolinës;</li> <li>•Traditë në kultivimin e rrushit;</li> <li>•Rritje e sipërfaqes dhe prodhimit të vreshtave të rrushit;</li> <li>•Rritje e plantacioneve me varietete autoktone të rrushit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Kultivarë të papërshtatshëm për prodhimin e verës;</li> <li>•Njohuri të pakta për teknologjitë moderne të kultivimit të rrushit;</li> <li>•Mungesë e specializimit në prodhimin e rrushit të tavolinës;</li> <li>•Specializim i ulët i mekanizimit të fermës;</li> <li>•Shkallë e ulët e prodhimit;</li> <li>•Mungesë e infrastrukturës së vjeljes, pas-vjeljes, seleksionimit dhe ruajtjes;</li> <li>•Infrastrukturë e pamjaftueshme frigoriferike;</li> <li>•Çmime të larta dhe cilësi e ulët e produktit / praktika inefficente bujqësore;</li> <li>•Menaxhim i ujit - sistemi publik i ujitjes dhe kullimit është jofunksional. Mungesë e teknologjive eficientë të ujitjes së fermës.</li> </ul>
<b>Përpunimi i verës</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Rritja e bazës së prodhimit;</li> <li>•Rritja e fluksit të investimeve në kantinat e verës cilësore dhe e kompanive të integruara;</li> <li>•Njohuritë e emigrantëve të kthyer në atdhe, mbi prodhimin e verërave;</li> <li>•Ekspertizë e mirë teknologjike në kantinat që prodhojnë verë të cilësisë së lartë;</li> <li>•Fillesat e prodhimit bio ose të integruar;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Cilësi e dobët dhe sasi e pamjaftueshme e rrushit për verë;</li> <li>•Përdorim i pamjaftueshëm i varieteteve autoktone të rrushit për zhvillimin e skemave cilësore;</li> <li>•Lidhje/ koordinimi dobët midis kultivuesve dhe përpunuesve;</li> <li>•Përqindje e lartë e prodhimit informal, që çon në konkurrencë të pandershme, standarde të ulëta të sigurisë dhe cilësisë;</li> <li>•Mungesë e specializimit dhe prodhim i pazhvilluar i verërave cilësore;</li> <li>•Teknologji dhe pajisje të vjetruara, siç janë</li> </ul>



	<p>tankerat e ruajtjes dhe fermentimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Standardet e ulëta të sigurisë (HACCP dhe ujërat e përdorura);</li> <li>•Infrastrukturë e dobët e laboratorëve të brendshëm/të integruar;</li> <li>•Ekspertizë e ulët teknologjike në kantinat informale dhe të vogla;</li> <li>•Mungesë e njohurive mbi markat tregtare dhe mbrojtjes së tyre;</li> <li>•Marketing i dobët - raporti cmim/cilësi i verërave të cilësisë jo i favorshëm;</li> <li>•Promovim i kufizuar i verërave të vendit me cilësi të lartë nga ana e prodhuesve të verës dhe shoqatave të tyre.</li> </ul>
<b>Mundësitë</b>	<b>Kërcënimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Rritje e kërkesës për verë cilësore si pasojë e ndryshimeve në mënyrën e jetesës së konsumatorëve dhe zhvillimin e turizmit;</li> <li>•Përmirësim i aksesit në tregjet e BE-së;</li> <li>•Fuqizim i politikave të qeverisë për përmirësimin e standardeve të higjienës dhe mbrojtjes së konsumatorit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Konsolidimi i shpërndarjes favorizon prodhuesit e mëdhenj dhe produktet e importuara;</li> <li>•Rritja e çmimeve të input-eve.</li> </ul>

#### 4.2. Administrimi i tokës dhe mjedisi

<b>Forca</b>	<b>Dobësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Diversitet i pasur biologjik dhe peizazhi;</li> <li>•Shumëllojshmëri e pasur dhe e madhe e burimeve ujore;</li> <li>•Variatet i madh i tokave</li> <li>•Burime të ndryshme për energjinë e rinovueshme;</li> <li>•Mbështetje e BE-së për përafrimin e legjislacionit, politikave dhe veprimeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Humbjet e vazhdueshme e biodiversitetit;</li> <li>•Përdorimi i pakontrolluar dhe ineficient i burimeve natyrore, duke përfshirë shfrytëzimin pa kriter;</li> <li>•Degradimi i tokës bujqësore dhe erozionit të tokës në disa zona të vendit, për shkak të teknikave bujqësore të papërshtatshme, mos-aplikimi i qarkullimit bujqësor, përdorim i ulët dhe i ç'ekuilibruar i plehrave organike dhe minerale. Masa jo efektive për mbrojtjen e bimëve;</li> <li>•Ndotje e shkaktuar nga sistemet dobëta të menaxhimit të mbetjeve;</li> <li>•Shpyllëzimi</li> <li>•Ndërgjegjësimi i ulët i fermerëve për mjedisin dhe ndryshimet klimatike;</li> <li>•Mungesa e njohurive dhe aftësive mbi praktikën e qëndrueshme bujqësore;</li> <li>•Zbatueshmëri e ulët e legjislacionit.</li> </ul>
<b>Mundësitë</b>	<b>Kërcënimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>•Rritja e ndërgjegjësimit mbi ushqimin e shëndetshëm dhe mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>•Kërkesë në rritje për turizmin alternativ – rural, turizmin e aventurës dhe turizmin "e gjelbër".</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Ndryshimet klimatike dhe kërcënim i sistemeve natyrore;</li> <li>•Shpopullimi i zonave rurale dhe braktisja e tokave.</li> </ul>

### 4.3. Ekonomia rurale dhe cilësia e jetës

Forca	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diversitet i gjerë dhe atraktivitet i peizazhit dhe natyrës;</li> <li>• Burime natyrore të bollshme dhe kushte të favorshme për BMA-të, bletari, akuakulturë, turizëm;</li> <li>• Burime të mjaftueshme për prodhimin e energjisë së rinovueshme diellore, hidrike, nga mbetjet, termike;</li> <li>• Përqindje e lartë e popullatës së re në zonat rurale;</li> <li>• Motivim i fortë për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe të ardhurat;</li> <li>• Emigrantët që kthehen sjellin aftësi dhe njohuri të reja;</li> <li>• Kosto e ulët e punës;</li> <li>• Traditë e gjatë në BMA dhe mjaltë. Prodhimi i ushqimit dhe produkteve artizanale tradicionale;</li> <li>• Ndjenja e fortë e mikpritjeje;</li> <li>• Zhvillimi i iniciativës private në ofrimin e ushqimit dhe akomodimit;</li> <li>• Rritja e numrit të turistëve ndërkombëtarë në vend;</li> <li>• Preferencat e konsumatorëve për prodhimet vendase në tregun e brendshëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëmet mjedisore ekzistuese si erozioni dhe ndotja (mbeturina, ujë) dëmtojnë imazhin e vendit dhe ndikojnë negativisht në potencialin e turizmit, BMA-ve, bletarisë, akuakulturës, ndërgjegjësimin i ulët mjedisor;</li> <li>• Shpopullimi i zonave rurale dhe rënia e fuqisë punëtore;</li> <li>• Varësi e madhe nga bujqësia si një burim të ardhurash dhe punësimi;</li> <li>• Kërkesa e ulët për punë / mundësitë e kufizuara të punësimit në zonat rurale;</li> <li>• Menaxhimi i dobët i biznesit dhe aftësive të marketing-ut;</li> <li>• Njohuri dhe aftësi të kufizuara në sektorë të rinj (turizëm, BRE, etj);</li> <li>• Nivel i ulët i njohurive për teknologjitë e reja dhe standardeve të higjienës;</li> <li>• Pajisje përpunimi dhe teknologji për përpunimin në fermë të produkteve bujqësore të vjetruara;</li> <li>• Mungesë e hapësirave të mjaftueshme për tharje / ruajtjen për përpunim primar dhe tharjen e BMA-ve / kërpudhave-t;</li> <li>• Shërbime/ atraksionet turistike të kufizuara dhe mungesa e ambienteve adekuate turistike në zonat rurale;</li> <li>• Burime të brendshme financiare të kufizuara për të mbështetur investimet në cilësi dhe teknologji të reja. (vështirësi për të marrë kredi/kosto e lartë e kredisë);</li> <li>• Mundësi e kufizuar për ekspertizë së jashtme për fermerët dhe SME-të;</li> <li>• Marrëdhëniet e dobëta përgjatë zinxhirit të vlerës (BMA, mjaltë, turizëm);</li> <li>• Gjurmueshmëria e ulët pengon promovimin e produkteve lokale;</li> <li>• Përqindja e lartë e sektorit informal;</li> <li>• Infrastruktura rurale rrugët, linjat e komunikimit, shërbimet e biznesit e pazhvilluar;</li> <li>• Përkeqësimi i cilësisë së shërbimeve për popullsinë rurale (shëndetësi, arsim, shërbime sociale);</li> <li>• Zbatimi i dobët i standardeve të sigurisë së mjedisit dhe ushqimit, si dhe e zbatimit të ligjit.</li> </ul>
Mundësitë	Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritje e ndërgjegjësimin në lidhje me përfitimet e ushqimit të shëndetshëm dhe mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>• Rritja e kërkesës për turizëm alternativ - rural, turizëm aventuresk dhe turizëm "të gjelbër";</li> <li>• Legjislacion i ri për promovimin e energjisë së rinovueshme;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vazhdimësia e stanjacionit ekonomik në Shqipëri dhe në tregjet e mëdha ndikojn kërkesën;</li> <li>• Ndikimet negative të ndryshimeve klimaterike mbi bujqësinë, pyjet dhe biodiversitetin;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndhimë financiare dhe mundësi për të marrë ekspertizën e jashtme nëpërmjet mbështetjes së donatorëve të ndryshëm dhe kontakteve me partnerët e BE-së;</li> </ul>	
---	--

#### 4.4. Përgatitja dhe zbatimi i Strategjive Lokale të Zhvillimit– Leader

Forca	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërgjegjësimi mbi qasjen territoriale të zhvillimit rural, diskutuar në disa pjesë të vendit;</li> <li>• Aktorë aktivë në nivel lokal në disa pjesë të vendit;</li> <li>• Ndërgjegjësimi mbi nevojat e krijimit të rrjeteve për zhvillimin e territorit;</li> <li>• Ekzistenca e kapaciteteve modeste për të zhvilluar strategji lokale dhe për të zbatuar projekte të vogla.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e traditës bashkëpunimit dhe përfshirjësë komunitetit në nivel lokal;</li> <li>• Aftësi dhe ekspertizë e kufizuar për mobilizimin e aktorëve lokalë për gjallërimin e territorit;</li> <li>• Varësia e lartë ndaj mbështetjes së donatorëve;</li> <li>• Pamjaftueshmëri e njohurive kritike mbi qasjen LEADER, zhvillimin e strategjive lokale, si dhe zbatimin, mobilizimin e komunitetit, etj, si në nivel kombëtar ashtu dhe lokal.</li> </ul>
Mundësitë	Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e angazhimit të qeverisë për decentralizimin dhe mbështetjen e iniciativave territoriale;</li> <li>• Interes aktiv nga bashkësia ndërkombëtare e donatorëve, për promovimin e komunitetit të udhëhequr për zhvillimin lokal;</li> <li>• Rrjetet aktive rurale të BE-së, të hapura për bashkëpunimin dhe transferimin e përvojës</li> </ul>	

#### 4.5.Sinteza e analizës SWOT në lidhje me objektivat e zhvillimit rural dhe bujqësor të IPA II


<b>Forca</b>	<b>Dobësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkallë e lartë e diversitetit; peizazh dhe natyrë tërheqëse; biodiversitet i pasur;</li> <li>• Kushte shumë të mira natyrore / sezon i hershëm prodhimi / sezon i gjatë vjeljeje për frutat dhe perimet;</li> <li>• Përvojë teknikat moderne të prodhimit;</li> <li>• Preferencë e fortë e konsumatorëve për prodhimet vendase;</li> <li>• Potencial i mirë për prodhim energjie të rinovueshme.</li> <li>• Kapacitete modeste për hartim dhe zbatim strategjish lokale të zhvillimit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bujqësi në shkallë të vogël; subsistence;</li> <li>• Menaxhim i paqëndrueshëm i tokës dhe praktika bujqësore që çojnë në degradim të tokës dhe erozion, ndotje të ujit dhe humbje të biodiversitetit;</li> <li>• Teknologji të vjetruara, mungesë mekanizimi në ferma;</li> <li>• Moszhvillimi sa duhet i sigurisë ushqimore, sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe infrastrukturës në sektorin e agro-përpunimit ushqimor;</li> <li>• Moszbatimi si duhet e standardeve mjedisore, sigurisë ushqimore dhe mirëqenies së kafshëve;</li> <li>• Lidhje të dobëta horizontale dhe vertikale përgjatë zinxhirit të vlerës;</li> <li>• Shkallë e lartë informaliteti dhe konkurrencë e pandershme nga veprimtaria e sektorit informal;</li> <li>• Varësi e lartë nga bujqësia si burim të ardhurash dhe punësimi në zonat rurale;</li> <li>• Kërkesë e ulët për punë/mundësi të kufizuara punësimi në zonat rurale;</li> <li>• Eksodi i brezit të ri nga zonat rurale;</li> <li>• Mungesë tradite për bashkëpunim dhe përfshirje të komunitetit në nivel vendor;</li> <li>• Moszhvillimi sa duhet i infrastrukturës rurale, rrugëve, linjave të komunikimit dhe shërbimeve të biznesit;</li> <li>• Rënia e cilësisë së shërbimeve për popullatën rurale (shëndetësi, arsim, shërbime sociale);</li> </ul>
<b>Mundësitë</b>	<b>Kërcënimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i aksesit në tregjet e BE-së;</li> <li>• Mundësi për të marrë ekspertizë të huaj me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm dhe kontaktet me partnerët e BE-së.</li> <li>• Rritja e ndërgjegjësimit rreth përfitimeve nga ushqimi i shëndetshëm dhe mbrojtja e mjedisit;</li> <li>• Kërkesë në rritje për turizëm alternativ - rural, turizëm aventuror dhe turizëm “të gjelbër”;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimet klimatike me ndikim negativ në bujqësi, pyje dhe biodiversitet;</li> <li>• Ngadalësim i rritjes ekonomike në Shqipëri dhe në tregjet kryesore, që ndikojnë te kërkesa;</li> <li>• Konsolidimi i shpërndarjes ushqimore, duke favorizuar prodhuesit e mëdhenj dhe prodhimet e importuara;</li> </ul>

## 5. REZULTATET KRYESORE TË NDËRHJRJEVE TË MËPARSHME

### 5.1. Rezultatet kryesore të ndërhyrjeve kombëtare të mëparshme: Shumat e disbursuara, përmbledhje e vlerësimeve, mësimet e nxjerra.

Skemat kombëtare për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural u prezantua në 2007 me miratimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Ai rregullon programimin e masave të politikës që lidhen me bujqësinë dhe zhvillimin rural, ofron shërbime këshilluese publike për bujqësinë, hulumtime dhe trajnime, si dhe ngritjen e një baze të dhënash informacioni. Ai gjithashtu siguron bazën ligjore për institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave bujqësore, përmes themelimit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), për zbatimin e skemave mbështetëse kombëtare dhe prezanton parimin e monitorimit dhe vlerësimit të skemave mbështetëse kombëtare.

Masat kombëtare janë të programuara çdo vit në Planin Kombëtar të Veprimit dhe zbatohen me një Vendim të Këshillit të Ministrave. Plani i Veprimit përcakton masat për zbatimin e politikës bujqësore dhe zhvillimit rural në vitin përkatës, planin financiar, kriteret e pranueshmërisë dhe shkallën e mbështetjes. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit është përgjegjësi e AZHBR-së dhe Drejtorisë së Zhvillimit Rural në MBZHRAU nën mbikëqyrjen e Komitetit Ndërmnistror për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.



Skemat e mbështetjes kombëtare janë rritur në numër, nga 3 në vitin 2007 në 23 në vitin 2013. Deri në vitin 2010 buxheti vjetor i skemave kombëtare ka ardhur në rritje, duke arritur maksimumin prej 11.5 milionë euro në vitin 2010. Për shkak të kufizimeve buxhetore, buxheti alokuar është reduktuar në rreth 7 milionë euro në 2012 dhe 2013. Në vitin 2012 numri i aplikimeve ishte 11.340 dhe numri i përfituesve 7729.

Skemat kombëtare sigurojnë lloje të ndryshme mbështetjesh: mbështetje të investimeve bazuar në kostot standarde, mbështetje të prodhimit dhe subvencione të normave të interesit. Në total në periudhën 2007-2012 rreth 43 milionë euro janë alokuar për skemat e mbështetjes kombëtare. Rreth 75% e kësaj shume është mbështetje për investimet, 15% - është mbështetje për prodhimin dhe 10% - subvencione të normave të interesit.

Pjesa më e madhe (87%) e mbështetjes për investime u alokuan në skemat e investimeve për krijimin e plantacioneve me kultura të reja shumëvjeçare si: ullishte (47% e mbështetjes së investimeve), drufrutorë (21%), vreshta (11%), arrorë (7%). Nga viti në vit ka pasur ndryshime për sa i përket sektorëve të mbështetur (p.sh. fillimisht prioritet i lartë u është dhënë vreshtave, ndërsa kohët e fundit mbështetja është zgjeruar në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Mbështetja e mbetura shkoi kryesisht për investimet në përmirësimin e ujitjes në fermë (puse dhe ujitja me pika).

Mbështetja e prodhimit u dha sektorëve të qumështit dhe të imtave, mjaltit, përpunimit të ullirit dhe prodhimit organik. Mbështetja ishte për prodhimin e qumështit, bazuar në pagesat për litër të fermave blegtorale për qumështin që dorëzonin tek grumbulluesit; mbështetje për krrerë për lopët dhe dhitë e qumështit. Mbështetje për mbarështimin e dhenve për zhvendosjet sezonale. Mbështetje për mbarështimin e lepurit, për prodhimin e vajit të ullirit ekstra të virgjër paguar për litër prodhim, si dhe mbështetja për bletarinë dhe prodhimin e mjaltit.

Skemat mbështetëse të investimeve kanë kontribuar në rritjen e sipërfaqes së mbjellë dhe rritjen e prodhimit në sektorët prioritarë. Në periudhën 2007 - 2012 MBZHRAU ka mbështetur mbjelljen e pothuajse 15.000 ha të kulturave shumëvjeçare, nga të cilat fruta dhe agrume (3193 ha), ullinj (8565 ha), pemë arrore (1268 ha) dhe vreshta (1135 ha).

Vlerësimi i skemave kombëtare të investimit në pemëtari dhe ullinj tregoi se mbështetja kontribuoi në rritjen e produktivitetit të fermës, kryesisht për shkak të rritjes së zonës së prodhimit. Mbështetja kontribuoi sa duhet për konsolidimin dhe rritjen e madhësisë së fermës, futjen e teknologjive të reja dhe praktikave të përmirësuara bujqësore. Efekti shumëfishimit (leverage effect) ishte i vogël. Skemat kishin pak ndikim në veprimin kolektiv midis fermerëve dhe ndërmjet fermerëve dhe bizneseve të tjera të zinxhirit të vlerave<sup>34</sup>.

Mësimet e dala nga zbatimi i skemave kombëtare nxjerrin ne pah nevojën për prezantimin e programimit shumëvjeçar dhe rritjen e konsistencës dhe parashikueshmërisë së mbështetjes. Përvoja tregon rëndësinë e monitorimit dhe rishikimin e rregullt të skemave për t'u përshtatur me nevojat e reja, duke u përqendruar në sektorët prioritarë me potencial për zhvillimin e një prodhimi konkurrues të produkteve të cilësisë për tregun e brendshëm dhe atë të eksportit. Suksesi i skemave në adresimin e nevojave prioritare për ristrukturimin e strukturave bujqësore dhe rritjen e produktivitetit është shumë i varur nga zhvillimi i shërbimeve mbështetëse për futjen e teknologjive të reja dhe transferimin e njohurive, forcimin e lidhjeve vertikale dhe horizontale përgjatë zinxhirit të vlerave.

## **5.2 Rezultatet kryesore të asistencës së BE-së, shumate disbursuara, përmbledhje e vlerësimeve, mësimet e nxjerra**

Nën komponentin IPA I, BE-ja ka ofruar mbështetje të konsiderueshme për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri. Në përgjithësi, mbështetja e IPA-s për sektorin arriti në 90 milionë Euro. IPA I ka kontribuar në rritjen e kapacitetit të MBZHRAU për projektimin, zhvillimin dhe implementimin e politikave të zhvillimit rural; në ngritjen e kapaciteteve në fushën e sigurisë ushqimore dhe shërbimeve veterinarë, që përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës laboratorike lokale dhe kombëtare, si dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së në fushat e sigurisë ushqimore, statistikën, luftimin e sëmundjeve zoonotike; forcimin e monitorimit, kontrollit dhe sistemit të mbikëqyrjes në peshkim. IPA I ka ofruar gjithashtu mbështetje për përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve të popullsisë rurale dhe biznesit përmes rehabilitimit të rrugëve dytësore dhe atyre lokale.

Me mbështetjen e IPA I, Shqipëria ka bërë një përparim të rëndësishëm në përgatitjen për implementimin e IPARD-it. Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e IPARD-it u ngritën dhe kapacitetet e tyre u zhvilluan gradualisht. Projekti IPA 2011, 'Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural' (SARD), përfshin një skemë grantesh pilote, masat IPARD-Like për investime në bujqësi, në përpunim dhe tregtim, duke shënjestruar sektorët e qumështit, mishit, frutave dhe perimeve, që synojnë modernizimin dhe përafrimin gradual me standardet e BE-së. Në 2012-2013 janë hapur tre thirrje për dorëzimin e aplikimeve, në të cilat janë dorëzuar 255 aplikime për investime që arrijnë vlerën e 46 milionë eurove.

Një mësim i rëndësishëm i skemës së granteve IPARD-Like është se ka kërkesë të madhe për mbështetje, gjë që konfirmon nevojat e identifikuara, siç tregohet edhe nga fakti se vlera e

---

<sup>34</sup>Vlerësimi i ndikimit të subvencionit të qeverisë në Shqipëri, Raporti Final 2014. Studimi u përgatit nga Projekti "Përgatitja e strategjisë sektoriale ndërkombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga FAO.

grantit të aplikimeve të dorëzuara e tejkalon tri herë buxhetin në dispozicion të të gjitha thirrjeve. Informaliteti i lartë në sektorin e agro-përpunimit dhe kapaciteti i kufizuar i aplikantëve për të përmbushur kërkesat e procedurave të përcaktuara në bazë të legjislacionit kombëtar, kanë ndikuar negativisht në përthithjen e fondeve.

Aplikimet për investime në ndërmarrjet bujqësore llogariten rreth dy të tretat e totalit të skemës së grantit IPARD-Like. Ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të aplikimeve mes thirrjes 1 dhe thirrjes 3 të skemës së grantit<sup>35</sup>. Ka pasur kërkesë për mbështetje për projekte të madhësive të ndryshme<sup>36</sup>. Aplikimet në industrisë e përpunimit të ushqimit ishin më të vogla (një e treta) në numër, por ato llogariten në gati dy të tretat e shumës së investimeve.

Kapacitetet e aplikantëve për të përmbushur kërkesat formale dhe administrative janë në rritje, por në total ai mbetet i ulët. Në të gjitha thirrjet ka pasur një numër të konsiderueshëm të mangësive të mëdha në aplikime, të cilat përfundojnë në refuzime të projekteve të investimeve potencialisht të suksesshme. Prandaj rritja e kapacitetit absorbues kërkon përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar njohuritë e aplikantëve potencialë nga ana organizatave mbështetëse mbi procedurat e aplikimit dhe pagesës në mënyrë që të ndërtohet një kulturë e zbatimit të standardeve. Gjithashtu thjeshtimi i procedurave për grante të vogla mund ta përmirësojë përthithjen e fondeve.

Zbatimi i projektit SARD-IPARD tregoi që fushatat publicitare gjithë-përfshirëse dhe të mirë organizuara janë të rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin e fermerëve dhe kompanive të përpunimit lidhur me mundësitë për mbështetje dhe mbi rregullat e pranueshmërisë. Mobilizimi i bashkëbiseduesve, nga shërbimi publik këshillimor, organizatat në mbështetje të biznesit dhe nga konsulentët e sektorit privat me përvojë në bujqësi, kontribuojnë në përmirësimin e efektivitetit të komunikimit.

Shërbimi këshillimor publik dhe konsulentët e sektorit privat luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e kërkesës për mbështetje dhe në përmirësimin e cilësisë së aplikimeve. Projekti SARD ka trajnuar 90 stafe të shërbimit këshillimor dhe 40 konsulentë privatë në përgatitjen e aplikimeve. Për të siguruar përfshirjen efektive të shërbimit këshillimor publik, ka nevojë që të përmirësohen më tej njohuritë dhe aftësitë e tyre mbi procedurat e aplikimit dhe të pagesave, por edhe mbi çështje teknike dhe ekonomike, akordimi i resurseve të mjaftueshme që integrojnë mbështetje për aplikantët dhe përfituesit në planet e punës vjetore të shërbimit këshillimor, duke përfshirë vendosjen e objektivave të qarta si dhe kërkesa raportimi.

Zbatimi i skemës së grantit IPARD-Like tregoi se trupat teknike kanë kapacitete të caktuara teknike për të verifikuar përputhshmërinë me standardet kombëtare. Megjithatë ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi standardet e BE-së, kanë mungesa për të zhvilluar procedurat dhe burimet për ekzekutimin e kontrolleve. Në mënyrë të ngjashme, një problem i madh është mungesa e regjistrimit të fermës. Ka dobësi në funksionimin e regjistrave të tjerë bujqësorë. Kjo mund të krijojë rreziqe të konsiderueshme për procesin e akreditimit të IPARD II dhe

---

<sup>35</sup>Në total, gjatë tre thirrjeve, numri i aplikimeve për investime në fermat bujqësore ishte 174 (68% e totalit) me shpenzimet e pranueshme për investime në shumën prej 17.700.000 euro (37%). Aplikimet për investime në industrinë e përpunimit ishin 81 (32% e totalit) dhe shpenzimet e pranueshme për investime ishin 30.700.000 EUR (63% e totalit).

<sup>36</sup>Madhësia mesatare e investimeve (të shpenzimeve të pranueshme) të aplikimeve në fermat bujqësore ishte 113.000 euro dhe në ndërmarrjet e përpunimit - 379,000 EURO. Rreth 40% e aplikimeve për investime në fermat bujqësore ishin për investime me vlerë më pak se 50.000 EURO.

pengesa në zbatimin e programit IPARD II, si dhe kërkon masa të menjëhershme për ngritjen e kapaciteteve. Bashkëpunimi dhe komunikimi i institucionalizuar ndërmjet Strukturës Operative IPARD dhe ZKA/NAO duhet të forcohet më tej, po ashtu dhe zyra mbështetëse e NAO-s si dhe procedurat dhe kapacitetet e Fondit Kombëtar për menaxhimin dhe kontrollin e IPARD.

### **5.3. Rezultatet kryesore nga asistenca shumëpalëshe, shumat e disbursuara, përmbledhje e vlerësimeve, mësimet e nxjerra**

Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD) ka mbështetur ‘*Programin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Zonave Malore*’ (SDRMA), i cili ka qenë aktiv në të 21 rrethet në Shqipëri, me synim rritjen e të ardhurave familjare në zonat malore të Shqipërisë, veçanërisht mes popullsisë më të varfër rurale. Vlera totale e këtij programi të zbatuar në periudhën 2007-2013 ka qenë 23.35 milion USD. Ky program kishte në përbërje të tij disa komponentë, objektivat e të cilëve ishin zhvillimi i sektorit privat, disa segmente të vogla të infrastrukturës ekonomike dhe planifikimi i zhvillimit vendor. Përmes mbështetjes së 17 Programeve Investimesh Strategjike në 8 zinxhirë të ndryshëm vlere dhe përmes ngritjes së kapaciteteve të fermerëve, përpunuesve, sipërmarrësve dhe të 21 forumeve të komuniteteve në zonat malore, SDRMA ka trajtuar në mënyrë pozitive kufizimet kryesore ekonomike, lidhjen e prodhuesve me përpunuesit dhe tregjet si dhe forcimin e strukturës institucionale të zinxhirit të vlerës (integrimin vertikal dhe horizontal të zinxhirit të vlerës). Në kudër të programit janë zbatuar gjithashtu, 44 projekte të infrastrukturës ekonomike në shkallë të vogël, të tilla si rrugë, ura dhe sisteme të furnizimit me ujë për familje, që kanë kontribuar në afrimin me tregjet dhe shërbimet si dhe në uljen e kostove të transportit, veçanërisht për produktet blegtorale dhe bujqësore që nuk rezistojnë<sup>37</sup>. Gjatë periudhës 2009-2014 IFAD ka mbështetur gjithashtu ‘*Programin e Tregjeve Malore*’, me një vlerë prej 6.8 milion eurosh, si dhe një sërë masash për reduktimin e varfërisë bazuar mbi identifikimin e bërë me pjesëmarrje të gjerë dhe në mënyrë sistematike të mundësive për investime në zonat e varfra malore. Synimi ka qenë rritja e të ardhurave të personave të varfër në zonat rurale në veriun e Shqipërisë, si zona më pak të favorizuara të vendit.

Mbështetja e agjencive të OKB-së për bujqësinë dhe zhvillimin rural kanë përfshirë gjithashtu dhënien e asistencës teknike në drejtim të prodhimit bujqësor dhe rural si dhe në krijimin e lehtësirave për pjesëmarrjen e Shqipërisë në veprimtaritë e rrjeteve rajonale. Këto agjenci kanë bashkëpunuar me MBZHRAU për sa i përket kapaciteteve institucionale lidhur me teknikat moderne të rritjes së prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale, ku theksi është vendosur në kontrollin e dëmtuesve si dhe konstatimin e hershëm të sëmundjeve ndërkufitare të kafshëve. OKB-ja ka zhvilluar një seri projektesh pilot për përmirësimin e kapaciteteve të nëpunësve dhe atyre të shërbimit këshillimor. Një sërë iniciativash pilot janë promovuar për futjen në përdorim të praktikave të mira dhe krijimin e lehtësirave për transferimin e teknologjive tek punonjësit e shërbimit këshillimor, shoqatat e fermerëve dhe institutet kërkimore<sup>38</sup>.

*Banka Botërore* ka mbështetur bujqësinë në Shqipëri përmes një sërë projektesh. Sipas vlerësimeve të BB-së këto projekte kanë pasur një ndikim pozitiv në reduktimin e varfërisë përmes rritjes së të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe krijimin e mundësive të punësimit në

<sup>37</sup>IFAD, Programi për Zhvillimin e Qëndrueshëm në zonat Malore, Raporti Përfundimtar, Digest, 2014.

<sup>38</sup>Programi Bashkëpunimit i Qeverisë Shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016.



fermat e zonave rurale. Disa projekte kanë kontribuar në qëndrueshmërinë e investimeve për ujitje dhe drenazhim përmes pjesëmarrjes së fermerëve në vënien së tyre në punë dhe mirëmbajtjes, menaxhimit me eficence të sistemit dhe rikuperimit të kostove të larta. Janë rehabilituar ose përmirësuar më shumë se 335,000 hektarë të sistemit të ujitjes dhe drenazhimit si dhe 33 diga ujëmbledhësish. Në 2012 mori miratimin Projekti i ri mbi Burimet Ujore dhe Ujitjen, me vlerë prej 27,3 milion eurosh më synimin për të forcuar kapacitetet e qeverisë për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar, vendor si dhe në basenet e lumenjve; për të përmirësuar performancën dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të ujitjes në basenet e lumenjve Drin-Bunë dhe Seman, si dhe për të nxitur e orientuar partneritetin publik privat për vënien në funksionim dh mbarëvajtjen e sistemeve të ujitjes në këto tre zona.

Projekti i BB-së mbi *'Burimet Natyrore dhe Zhvillimin'* ka ndihmuar në reduktimin e erozionit përmes përmirësimit të menaxhimit të ligatinave, pyjeve, kullotave, si dhe ndërtimit të ujëmbledhësve. Projekti ka përmirësuar produktivitetin dhe të ardhurat përmes përmirësimit të menaxhimit nga ana e komunitetit të burimeve natyrore në 251 komuna të zonave malore me prirje për erozion<sup>39</sup>. Projekti në vijim i *'Shërbimeve Mjedisore'* (16.8 milion euro) filloi zbatimin e tij në vitin 2014 dhe synon të përmirësojë dhe promovojë vlerën e shërbimeve të ekosistemit.

Programi i Bashkëpunimit Italian për *'Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri'* është në funksionim që nga viti 2009 duke iu ofruar SME-ve mundësimin e huamarrjes me kushte të favorshme me qëllim forcimin e konkureshmërisë së tyre në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar përmes novacionit teknologjik dhe përmirësimit të standardeve të prodhimit. Ky projekt ka dy instrumente financiare: Linjën e Huadhënies me vlerë 25 milion euro dhe Fondin e Garancisë me vlerë 2.5 milion euro. Përafërsisht, çereku i huave janë dhënë industrisë së përpunimit ushqimor. Programi për modernizimin e bujqësisë financiar nga Bashkëpunimi Italian për Zhvillim përfshin tre iniciativa me një vlerë totale prej 10 milion euro. Dy ndërhyrje, me synim, në njërën anë, forcimin e kuadrit institucional përmes përafrimit të menaxhimit dhe kontrollit të subvencioneve në bujqësi me standardet e KE-së, dhe në anën tjetër, përmes ngritjes së sistemit të sigurimeve për mbulimin e riskut bujqësor, praktikë që për momentin nuk ekziston në Shqipëri. Iniciativa e tretë ka për synim përmirësimin në mënyrë të qëndrueshme të gjithë procesit të prodhimit të vajit të ullirit, i cili përbën një potencial të madh zhvillimi duke pasur parasysh traditën dhe karakteristikat e Shqipërisë.

Në fushën e zhvillimit rural, Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ)<sup>40</sup> ka zbatuar *'Programin e Zhvillimit Ekonomik dhe Nxitjes së Punësimit'*, i cili përfshinte komponentë mbi modernizimin e sektorëve të agro-biznesit dhe përpunimit ushqimor në kuadër të përafrimit me BE-në. Kompanitë në fushat e sektorëve prioritarë janë mbështetur për të vënë në përdorim procese dhe sisteme moderne të sigurisë ushqimore. GIZ ka mbështetur gjithashtu iniciativa vendore zhvillimore si dhe veprimtari për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Është zbatuar gjithashtu një projekt për ngritjen e kapaciteteve të konsulentëve për përgatitjen e aplikimeve të Programit IPARD.

*'Programi i Konkureshmërisë së Bujqësisë'* (2007-2013) të USAID përfshinte tre komponentë: forcimin e kapaciteteve të prodhuesve në kuadër të fermave konkuresive të orientuara nga tregu; forcimin e kapaciteteve për zhvillimin e tregjeve dhe përmirësimi i aksesit në informacionin e besueshëm të tregut. Programi përqendrohej në pesë zinxhirë

<sup>39</sup>Banka Botërore. 2012. Shqipëria-Projekti Zhvillimit të Burimeve Natyrore. Washington, DC: BB.

<sup>40</sup>Financuar nga Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim (BMZ).

vlerash strategjike dhe veprimtaritë e tyre përkatëse si: drufrutorët; bimët e serave; bimët e arave; bimët medicinale dhe aromatike; si dhe produktet e përpunuara. Në total programi kishte një buxhet prej 10.5 milion USD dhe përdori instrumente të ndryshme si: trajnime, demonstrime të teknologjive të reja, grante, krijimin e lehtësive për huadhënie, si dhe dialogun mbi reformat e politikave dhe atë mbi aspektet rregullatore. Programi ka dhënë një kontribut domethënës për zhvillimin e zinxhirëve të vlerës së përzgjedhur dhe një ndikim të prekshëm tek përfituesit<sup>41</sup>.

Gjatë periudhës 2009-2013 Organizata Holandeze e Zhvillimit dhe Qeveria Daneze kanë mbështetur projektin ‘Zinxhiri Vlerës për Jetesë të Qëndrueshme në Shqipëri’ (prej 5 milion eurosh), i cili ka nxitur gjenerimin e punësimit dhe të ardhurave përmes zhvillimit të zinxhirëve të vlerës së bimëve mjekësore dhe erëzave, drufrutorëve dhe bagëtive të imta në zonat malore të Veriut dhe Lindjes së Shqipërisë. Një projekt i ri Gjermano-Danez për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në zonat më pak të avantazuara malore të Shqipërisë ka filluar në 2014 (10 milion euro). Projekti ka si synim zhvillimin e disa qarqeve dhe mbështet zinxhirët e vlerës së shtuar të druve frutorë, bagëtive, bimëve mjekësore dhe erëzave, si dhe turizmin rural.

Mësimet kryesore të nxjerra nga mbështetja e dhënë për bujqësinë dhe zhvillimin rural të dala nga raportet e vlerësimeve si dhe nga ato të projekteve të zbatuara janë:

- Pavarësisht kushteve të vështira dhe kufizimeve, mbështetja për sektorin agro-ushqimor ka qenë efektive, nëse, mbështeten kompanitë me potencial për gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe shitjeve në mënyrë që të shërbejnë si model për SME-të e tjera. Mbështetja në nivel subjektsh është dhënë nga donatorët përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe fermave, grumbulluesve dhe përpunuesve rentabël të cilët kanë demonstruar vullnet sipërmarrës për tu përshtatur me kushtet në ndryshim të vazhdueshëm të tregut.
- Përmirësimi i konkurrencës së bujqësisë kërkon forcimin e të gjithë zinxhirit të vlerës nga ferma në treg. Mbështetja ndaj grumbulluesve dhe përpunuesve është e rëndësishme për rritjen e të gjithë zinxhirit të vlerës duke qenë që përmes industrisë dhe grumbulluesve njohuritë teknike u transferohen edhe prodhuesve, gjë që lehtëson përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe mundësojnë furnizim më të rregullt të tregut vendas dhe të huaj.
- Zhvillimi i klasterave agro-ushqimorë të specializuara në bazë territori ka qenë i rëndësishëm për bujqësinë në shkallë të vogël në Shqipëri duke qenë se ka përbërë një mundësi: për të transferuar dhe shpërndarë njohuri, për konsolidimin e kontakteve mes prodhuesve bujqësorë, grumbulluesve, dhe përpunuesve dhe për të vendosur lidhje me tregjet.
- Eksperienca me krijimin e grupeve të prodhuesve të fermerëve dhe shoqatave të fermerëve si promovimi i veprimtarive kolektive nga ana e fermerëve nuk ka qenë shumë inkurajuese. Projektet kanë hasur probleme si pasojë e mungesës së besimit dhe vullnetit për të bashkëvepruar. Kjo ka rezultuar në qëndrueshmëri të ulët të projekteve të mbështetura. Për këtë arsye, ndërhyrjet në masë gjithnjë e më të madhe kanë filluar të synojnë zhvillimin e organizatave të shërbimeve mbështetëse dhe mbështetjen e vendosjes së kontakteve afatgjata në zinxhirin e vlerës.

---

<sup>41</sup>USAID, Vlerësimi Performancës së Programit të konkurrencës së Bujqësisë Shqiptare, Raporti Përfundimtar, 2014.

- Ndërhyrjet në përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore në nivel ferme dhe kompanie kanë pasur nevojë për më shumë përpjekje dhe kohë për krijimin e ndërgjegjësimit dhe për të demonstruar përfitimet. Projektet e zbatuara në këtë fushë kanë qenë të suksesshme, sa herë që kanë mbështetur sipërmarrje apo ferma të mëdha rentabël dhe me potencial për rritje. Në të njëjtën kohë me përpjekjet për modernizimin e industrisë, projektet në sigurinë ushqimore kanë synuar gjithashtu edhe zhvillimin e kapaciteteve dhe ristrukturimin e administratës përgjegjëse për sigurinë ushqimore. Nga administrata përgjegjëse për sigurinë ushqimore kërkohet punë efikase për zbatimin e legjislacionit përkatës dhe si rrjedhojë të nxiten investimet në sigurinë ushqimore.
- Aftësia huamarrëse është një problem serioz për shumicën e fermave dhe kompanive në këtë sektor. Për më tepër, njohuria mbi hartimin e planeve të biznesit dhe mundësive për të përfituar konsulencë të jashtme për planifikimin e projekteve është e kufizuar. Projekte të ndryshme kanë hartuar strategji të ndryshme – mbështetje për përgatitjen e planeve të biznesit, zhvillimin e skemave të mikro-financimit, etje. Faktor suksesi i projekteve ka qenë dhënia e asistencës ndaj kompanive për hartimin e planeve të fizibilitetit/biznesit, identifikimin e teknologjive të përshtatshme, pjesëmarrja në panairët tregtare të teknologjive, dhe hartimi i planeve të biznesit.
- Mbështetja ndaj shërbimeve këshillimore lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, përfshirë identifikimin dhe aplikimin e teknologjive, si dhe hartimin e sistemeve të sigurisë ushqimore, ka qenë një tjetër faktor suksesi në ndërhyrjet e bëra nga donatorët.
- Zbatimi i ndërhyrjeve në mbështetje të zhvillimit rural – duke filluar nga përgatitja e politikave deri tek mbështetja direkte – ka mundësuar akumulimin e një eksperiencë të konsiderueshme dhe krijimin e strukturave të cilat kanë filluar të ndërtojnë kapacitetet për të vënë në zbatim asistencën e parazgjerimit IPARD. Gjithsesi, në të ardhmen do të nevojitet mbështetje për të ngritur kapacitetet e njohurive dhe të ekspertizës për zbatimin e programeve/projekteve në përputhje me rregullat dhe procedurat e BE-së si në nivel programi ashtu edhe projekti.
- Qarkullimi i lartë i stafit në administratën publike ka penguar dhënien e shërbimeve publike si dhe ka ndikuar ritmin e reformave. Në të ardhmen, ndërhyrjet duhet të theksojnë rëndësinë e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm dhe të mbështesin forcimin e institucioneve, instrumenteve dhe mekanizmave që dhënia e këtyre shërbimeve të jetë efektive dhe e barabartë.
- Përfshirja e palëve të interesuara vendore ka qenë përcaktori kryesor i këtij suksesi. Kjo ka qenë e rëndësishme për marrjen e informacionit mbi kushtet e vendit si çështje të tjera specifike për një komunë. Një ndërgjegjësim i fortë dhe masa që vendosim marrëdhëniet e komunikimit dhe besueshmërisë në plan të parë janë të nevojshme për marrjen e konsensusit të komunitetit dhe duhet të jenë pjesë e të gjitha projekteve me bazë komunitetin.

## PËRSHKRIMI I STRATEGJISË

### 6.1. Përshkrim i strategjisë ekzistuese kombëtare të zhvillimit rural

Strategjia ndërsektoriale e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Shqipëri për periudhën 2014-2020 (ISARD)<sup>42</sup> përcakton këtë vizion për zhvillimin bujqësor dhe rural:

*“Sektor agro-ushqimor eficient, novator dhe i qëndrueshëm, i aftë për të përballuar presionin konkurrues dhe për të përmbushur kërkesat e tregut të BE-së përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zonave të qëndrueshme rurale që ofrojnë mundësi për aktivitete ekonomike dhe punësim, përfshirje sociale dhe cilësi jetese për banorët ruralë”.*

ISARD parashikon ndërhyrje në tre fusha: i) politika e zhvillimit rural; ii) skema kombëtare mbështetëse për fermerët, zhvillim të infrastrukturës rurale dhe garantim të mundësive të barabarta; iii) zhvillim institucional dhe zbatim të kërkesave rregullatore të BE-së.

*Politika e zhvillimit rural ka katër prioritetet për periudhën 2014-2020:*

*1. Forcimin e qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së fermave bujqësore dhe industrisë agro-përpunuese, duke përmbushur në vazhdimësi standardet e Bashkimit Evropian*

Kjo do të arrihet përmes mbështetjes së ristrukturimit të sektorit bujqësor, duke përmirësuar përdorimin e tokës dhe duke forcuar orientimin dhe pjesëmarrjen në treg me fokus në:

- Zhvillimin e pjesës rentabël të sektorit primar dhe sektorit agro-përpunues, përmes përmirësimit të ambienteve dhe metodave të prodhimit, cilësisë së prodhimit dhe përmbushjes së standardeve të BE-së;
- Sektorët bujqësorë me potencial për zhvillimin e produkteve cilësore konkurruese;
- Optimizimin e përdorimit të burimeve bujqësore duke nxitur dhe duke forcuar bashkëpunimin dhe SHBB-të për përdorimin dhe menaxhimin eficient të tokës bujqësore dhe burimeve.

*2. Rikuperimi, ruajtja dhe forcimi i ekosistemeve që varen nga bujqësia dhe pylltaria*

Objektivi është arritja e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe masave klimaterike përmes menaxhimit të pyjeve dhe burimeve ujore, si dhe futjes së metodave të prodhimit bujqësor që mbrojnë mjedisin dhe që zbusin dhe u përshtaten ndryshimeve klimaterike. Qëllimi është që gradualisht të futen politika dhe qasje të BE-së për menaxhimin e burimeve natyrore dhe aktivitetit klimaterik, duke u fokusuar te përdorimi i qëndrueshëm i tokës, pyjeve, burimeve ujore dhe menaxhimit të mbetjeve në planin afatshkurtër.

---

<sup>42</sup>ISARD është përgatitur në 2012-2014 nga MBZHRAU me mbështetjen e projektit “Përgatitja e Strategjisë ndërsektoriale të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga FAO.

### *3. Zhvillimi i ekuilibruar territorial i zonave rurale, që nxit përfshirjen sociale, uljen e varfërisë dhe zhvillimin e ekuilibruar ekonomik në zonat rurale.*

Objektivi është arritja e një zhvillimi të ekuilibruar territorial të zonave rurale duke rritur diversifikimin e aktiviteteve ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përfshirjen sociale, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale.

Fokusi do të jetë tek mundësimi i diversifikimit të aktiviteteve ekonomike dhe krijimi i vendeve të reja të punës dhe bizneseve të vogla të reja, përmirësimi i shërbimeve vendore, rinovimi i fshatrave dhe infrastrukturës rurale, rritja e mundësisë së përdorimit të sistemeve moderne të informacionit dhe komunikimit, si dhe forcimi i kapaciteteve për zhvillimin e qasjeve nga poshtë-lart dhe pjesëmarrjes vendore në planifikimin dhe zhvillimin në nivel vendor, përmes zhvillimit të Grupeve Lokale të Veprimit.

### *4. Transferimi i njohurive dhe novacionit më bujqësi, pylltari dhe në zonat rurale*

Objektivi është rritja e mundësive të të gjithë aktorëve kryesorë në zonat rurale për të kontribuar në zhvillimin qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe krijimi i komuniteteve rurale funksionale nëpërmjet:

- Rritjes së transferimit të novacionit dhe njohurive në sektorin bujqësor në zonat rurale përmes shërbimeve këshillimore dhe qendrave të transferimit të teknologjisë bujqësore;
- Forcimit të të nxënimit gjatë gjithë jetës përmes formimit profesional dhe përfutimit të aftësive profesionale në zonat rurale;
- Forcimit të lidhjeve midis bujqësisë, akuakulturës, pylltarisë, kërkimit dhe novacionit, përmes rritjes së bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm.

## **6.2. Identifikimi i nevojave dhe përmbledhja e strategjisë së përgjithshme**

### **6.2.1 Identifikimi i nevojave**

#### *Rritja e investimeve në aktivet afatgjata në fermat bujqësore (1)*

Konkurueshmëria e fermave kufizohet nga prodhimtaria dhe efienca e ulët për shkak të investimeve të pamjaftueshme në aktivet afatgjata që nevojiten për futjen e produkteve dhe teknologjive të reja, mekanizimit dhe pajisjeve, si dhe rritjes së shkallës së prodhimit. Po kështu, fermat kanë probleme në përmbushjen e standardeve mjedisore dhe të mirëqenies së kafshëve, për shkak të burimeve të pamjaftueshme për modernizimin e ambienteve për përmirësimin e higjienës dhe menaxhimit të mbetjeve.

***Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve këshillimore për fermerët (2)***

Efikasiteti i sistemeve të ekstensionit kërkon përmirësimin e infrastrukturës, forcimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e komunikimit me fermerët. Nevojitet përmirësimi i cilësisë dhe rritja e gamës së shërbimeve të ofruara, sidomos në fushat e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjes mjedisore, mbrojtjes së burimeve gjenetike autoktone dhe respektimit të standardeve (siguria, mbrojtja mjedisore, cilësia, etj.), marketingut dhe menaxhimit të fermave, teknologjive të reja në hortikulturë dhe mbarështimit të kafshëve, etje. Për sa i përket Programit IPARD II, duhet të krijohen ose të forcohen kapacitetet për hartimin e planeve të biznesit, vlerësimin e nevojave të fermerëve për teknologji të reja dhe përmbushjen e standardeve kombëtare minimale. Ekziston edhe nevoja për përmirësimin e kapaciteteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, si një pjesë e rëndësishme e funksionit kërkimor dhe këshillimor, si dhe e komunikimit në rrjet. Ekstensioni kërkon lidhje më të forta me kërkesën vendase dhe me kapacitetet kërkimore kombëtare dhe në mënyrë të veçantë, përmirësimin e kuadrit institucional të komunikimit të gjithë aktorëve, duke përfshirë universitetin bujqësor, ofruesit e kontributeve kërkimore, etje.

***Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (3)***

Ndryshimet klimaterike pritet të ndikojnë ndjeshëm në ekuilibrin ujor në Shqipëri dhe një nga masat e rëndësishme të përballimit të këtyre ndryshimeve është modernizimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit për të rritur efikasitetin e përdorimit të burimeve ujore. Përmirësimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit i shërben edhe rritjes së rendimentit të kulturave. Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit do të adresohet me fondet kombëtare dhe fondete donatorëve.

***Përmirësimi i konkurrueshmërisë së industrisë së përpunimit ushqimor (4)***

Industria ushqimore duhet të përgatitet për anëtarësimin e ardhshëm të vendit në BE, që do të krijojë mundësi për zgjerimin e tregut, por që paraqet edhe kërcënime për shkak të rritjes së konkurrencës në tregun e brendshëm. Industria ka një sërë dobësish strukturore që lidhen me ambientet dhe teknologjitë e vjetruara të prodhimit, të cilat ndikojnë tek cilësia, produktiviteti dhe kostot. Një pjesë e madhe e sipërmarrjeve në industrinë ushqimore kanë nevojë për investime për modernizim të ndërtesave dhe të linjave të prodhimit. Industria ushqimore duhet të konsolidojë grumbullimin dhe ruajtjen e lëndës së parë, për të reduktuar mbetjet dhe për të garantuar sigurinë ushqimore. Investime kërkohen edhe për të përshtatur gamën dhe cilësinë e produkteve sipas kërkesave të tregut dhe mundësive të ofruara nga tregjete reja.

***Përmirësimi i kapitalit fizik në industrinë ushqimore për përmbushjen e standardeve të Bashkimit Evropian (5)***

Procesi i harmonizimit të legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së kërkon nga industria ushqimore investime të konsiderueshme për përmirësimin e ambienteve të prodhimit dhe pajisjeve të kontrollit. Ky proces kërkon edhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi standardet e reja,

zhvillimin e aftësive për respektimin e tyre siç duhet, si dhe përmirësimin e kapaciteteve njerëzore.

***Rritja e bashkëpunimit mes aktorëve kryesorë në zinxhirin agro-ushqimor (6)***

Ngurimi i fermerëve për të bashkëpunuar dhe lidhjet e dobëta mes aktorëve të zinxhirit ushqimor (studiuësve, ofruesve të input-eve, fermerëve, kompanive të përpunimit ushqimor dhe tregtareve) çon në një shpërndarje të kufizuar të njohurive dhe novacionit dhe të investimeve afatgjata në sektorin agro-ushqimor. Prandaj, nevojitet nxitja e bashkëpunimit horizontal dhe vertikal mes aktorëve të ndryshëm të zinxhirit ushqimor.

Bashkëpunim më i madh nevojitet për zhvillimin e produkteve, praktikave, proceseve dhe teknologjive të reja në sektorin bujqësor dhe atë ushqimor.

***Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore dhe efikasitetit të tyre (7)***

Nevojitet përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore dhe efikasitetit të tyre, për të siguruar qëndrueshmëri mjedisore dhe shfrytëzime mundësive të tregjeve të reja. Gjithashtu, duhet të ndalet tendenca e degradimit të mjedisit natyror (erozionit të tokës, ndotjes së ujit dhe humbjes së biodiversitetit), për shkak të menaxhimit të tokës dhe praktikave bujqësore të paqëndrueshme. Ekzistojnë mundësi shumë të mira që lidhen me kërkesën në rritje për produkte organike dhe për turizëm ekologjik e bujqësor; por, të dyja varen nga ruajtja e mjedisit dhe nga kontributi i dhënë për ruajtjen e natyrës.

***Diversifikimi i aktiviteteve dhe burimeve të të ardhurave për fermerët (8)***

Ekzistojnë mundësi për rritjen e të ardhurave të fermave dhe punësimit rural përmes shfrytëzimit të potencialit dhe burimeve për prodhimin e bimëve mjekësore dhe aromatike, kërpudhave, bimëve dekorative, mjaltit dhe kërmijve. Zhvillimi i qëndrueshëm i këtyre sektorëve kërkon rritjen ose përmirësimin e kapitalit fizik të prodhimit dhe përpunimit primar, shtimin e njohurive dhe aftësive të fermerëve, si dhe forcimin e zinxhirit të vlerave. Duhet të forcohen politikat kombëtare dhe të përmirësohen kontrollet për të siguruar mbrojtjen mjedisore dhe ruajtjen e specieve vendase.

Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i qumështit, mishit, frutave dhe perimeve ka traditë të hershme në zonat rurale dhe shërben si një burim i rëndësishëm të ardhurash për fermerët. Zhvillimi i tij favorizohet edhe nga preferenca e konsumatorëve për produkte tradicionale vendase. Përpunimi në nivel ferme i produkteve bujqësore përballet me vështirësinë e përmirësimit të standardeve të sigurisë ushqimore, që do të rezultonte në cilësi më të mirë dhe më shumë vlerë të shtuar.

***Zhvillimi i sektorëve jobujqësorë të ekonomisë rurale (9)***

Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale përballet me një risk që është varësia e lartë nga numri i vendeve të punës dhe nga të ardhurat që siguron bujqësia. Rritja e ngadaltë e sektorëve jobujqësorë të ekonomisë rurale dhe kërkesa e pamjaftueshme për punë, rritin varfërinë rurale dhe migrimin; prandaj, duhet të mbështetet zhvillimi i sektorëve jobujqësorë

të ekonomisë rurale. Analiza SWOT evidenton mundësi për zhvillimin e natyrës, turizmit rural dhe prodhimit të energjisë së rinovueshme. Edhe zhvillimi i prodhimit në shkallë të vogël, artizanateve tradicionale dhe shërbimeve vendore, ofron mundësi për zhvillimin e biznesit në zonat rurale.

***Përmirësimi i infrastrukturës rurale, aksesit dhe cilësisë së shërbimeve bazë në zonat rurale (10)***

Zonat rurale kanë infrastrukturë të pazhvilluar dhe të mirëmbajtur dobët (rrugët, linjat e energjisë elektrike, ujësjellësit dhe kanalizimet), si për nga mbulimi, ashtu edhe nga cilësia.

Aksesi në zonat rurale është përmirësuar, por për shumë rajone rurale mbetet problematik. Nevojitet rikonstrukcion dhe mirëmbajtje sistematike e rrugëve rurale për përmirësimin e transportit të njerëzve dhe mallrave, për të thithur investime, për zhvillimin e turizmit, mundësinë e përfitimit të shërbimeve sociale, si dhe për mundësitë për punësim të njerëzve në zonat rurale. Gjithashtu, duhet të zhvillohet rrjeti i furnizimit me energji elektrike, infrastruktura e ujësjellësve dhe kanalizimeve, si dhe grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve.

Cilësia e dobët e shërbimeve bazë (shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore) në zonat rurale përbën një faktor të rëndësishëm që çon në emigrim, sidomos të popullatës në moshë të re, si dhe rrit riskun e përjashtimit social të grupeve vulnerabel.

***Përmirësimi i qeverisjes vendore dhe zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e qasjes LEADER (11)***

Nevojitet pjesëmarrja aktive e aktorëve vendorë dhe partneritet në planifikimin dhe zbatimin e nismave të zhvillimit territorial për rritjen dhe shfrytëzimin e plotë të potencialit social-ekonomik të zonave rurale. Kjo kërkon përmirësimin e qeverisjes vendore, përmes inkurajimit të pjesëmarrjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të autoriteteve vendor, organizatave joqeveritare, biznesit dhe banorëve ruralë në një partneritet për hartimin dhe realizimin e nismave vendore.

Në vend janë krijuar disa kapacitete për aplikimin e qasjes LEADER nga projektete financuara nga donatorët, por nevojitet rritje më e madhe e ndërgjegjësimit të publikut, zhvillim i kapaciteteve për zbatimin e masave të përbashkëta vendore, si edhe krijim/forcim i partneriteteve për hartimin dhe realizimin e strategjive të zhvillimit vendor të tipit LEADER.

## **6.2.2 Përshkrimi i strategjisë së programit IPARD II**

Programi IPARD II fokusohet tek objektivat e strategjisë ISARD për zhvillimin e një sektori agro-ushqimor ekonomikisht të qëndrueshëm dhe zonave rurale dinamike, në përputhje me objektivat e përcaktuar në politikat e zhvillimit rural dhe bujqësor të Dokumenti Strategjik Kombëtar.



Në linjë me objektivat e Rregullores së IPA II<sup>43</sup>, Programi synon forcimin e kapaciteteve të sektorit agro-ushqimor për t'u përballur me presionin e konkurrencës, si dhe harmonizimin e vazhdueshëm me standardet e Bashkimit Evropian. Për arritjen e këtyre objektivave, Programi do të mbështesë investimet në aktive afatgjata të sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimin e shërbimeve këshillimore.

Masa *'Investime në aktive afatgjata të fermave bujqësore'* do të inkurajojë dhe do të mbështetë investimet në përmirësimin e produktivitetit dhe cilësisë së produkteve, si dhe arritjen e standardeve të BE-së (nevoja 1). Masa do të fokusohet në sektorët që kërkojnë investime të konsiderueshme për arritjen e standardeve të BE-së: sektorët primarë të qumështit dhe mishit. Kjo masë do të mbështetë edhe investimet në sektorët e frutave, perimeve dhe vreshtave, ku Shqipëria ka një potencial të mirë agro-mjedisor për rritjen e prodhimit për tregun vendas dhe për eksport. Shpenzimet e parashikuara publike për këtë masë përbëjnë 44% të ndihmës publike totale në kuadrin e Programit IPARD II, që reflekton nevojat për modernizimin e sektorit primar dhe kapacitetin e tij përthithës. Shuma e parashikuar në buxhet përfshin edhe një fond për masat e Paketës 2 që do të fillojnë të zbatohen në një fazë të mëvonshme.

Programi IPARD II do të adresojë nevojën për përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve këshillimore për fermerët (nevoja 2), përmes zbatimit të *'Shërbimeve këshillimore'*. Përmes kësaj mase, do të forcohet kapaciteti dhe cilësia e shërbimeve këshillimore për fermerët. Struktura/organet e përzgjedhura këshillimore do të trajnohen për t'u përgatitur për hartimin e planeve të biznesit dhe kërkesave për pagesa të marrësve të mbështetjes, në kuadër të masave për investime në aktive afatgjata. Zhvillimi i kapacitetit këshillimor do të mbështetet edhe nga ndërhyrjet e IPA II, të cilat do të fokusohen në sektorë specifikë, masat kombëtare dhe mbështetjen e donatorëve.

Masa *'Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit'* do të mbështetë investimet në aktive afatgjata që nevojiten për rritjen e konkureshmërisë së përpunimit ushqimor (nevoja 4) dhe në përmbushjen e standardeve të BE-së (nevoja 5). Duke marrë parasysh nevojat për përmbushjen e standardeve të BE-së nga industria përpunuese, kësaj mase i janë caktuar 37% të shpenzimeve publike në kuadrin e Programit.

Ndërhyrjet në favor të zhvillimit të sektorit agro-ushqimor në kuadrin e masave të Programit IPARD II do të plotësohen me projekte kombëtare dhe projekte me mbështetje të donatorëve, për forcimin e bashkëpunimit horizontal dhe vertikal nëpër të gjithë zinxhirin e furnizimit agro-ushqimor (nevoja 6) dhe për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të prodhuesve vendas, duke përmirësuar infrastrukturën e tregut dhe sistemet e informacionit për tregjet. IPA II do të ofrojë asistencë për përshtatjen dhe forcimin e kapacitetit kombëtar për përmirësimin e legjislacionit mjedisor, sigurisë ushqimore, fitosanitar, veterinar dhe të mirëqenies së kafshëve, një menaxhim dhe mbrojtje më të mirë të burimeve të peshkimit, etj. Fondet

---

<sup>43</sup>Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 11 mars 2014 që përcakton Instrumentin për Asistencën Para-zgjerimit (IPA II).

kombëtare dhe projektet e Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFN) do të jenë burimi kryesor për financimin e përmirësimeve të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Programi IPARD II do të adresojë nevojën (7) për përmirësimin menaxhimin e burimeve natyrore dhe eficientë e përdorimit të burimeve përmes mbështetjes së investimeve në teknologjitë eficientë të burimeve dhe prodhimin e energjisë së rinovueshme. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore do të promovohet nga Programi IPARD II përmes zhvillimit të kapacitetit të shërbimeve të ekstensionit dhe ofrimit të informacioneve dhe këshillave fermerëve. *Masa agro-mjedisore-klimaterike dhe e bujqësisë organike* do të aplikohet për operacionet pilot, me qëllim ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin dhe kontrollin e ndërhyrjeve agro-mjedisore në kuadrin e Programeve të Zhvillimit Rural në vendet anëtare. Skema(t) specifike pilot, do të përcaktohen në bazë të një analize të hollësishme mjedisore në konsultim me të gjithë aktorët e përfshirë.

Programi do të mbështesë edhe zhvillimin e ekuilibruar territorial, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përfshirjen sociale përmes masës *‘Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit’*. Kjo masë do të mbështesë investimet në aktivet afatgjata që nevojiten për diversifikimin dhe rritjen e të ardhurave të fermave (nevoja 8). Kjo masë do të konsistojë në investime për zhvillimin e sektorëve jobujqësorë në zonat rurale dhe në zhvillimin e sipërmarrjes, sidomos për të rinjtë dhe për gratë, gjë që kërkohet për krijimin e mundësive të reja për punë në zonat rurale dhe për përmirësimin e aksesit në shërbime të popullsisë rurale (nevoja 9). Kjo masë do të inkurajojë investimet në të gjitha aktivitetet jobujqësore ekonomikisht të qëndrueshme të biznesit në zonat rurale – turizmi i qëndrueshëm natyror dhe rural, shërbimet për popullatën dhe biznesin rural, artizanatet dhe industrinë e prodhimit. Kësaj mase i është caktuar 16% e shpenzimeve publike.

Programi IPARD II do të mbështesë zhvillimin e kapacitetit kombëtar për zhvillim vendor, bazuar në qasjen LEADER. Masa e Asistencës Teknike do të përdoret për ngritjen fillestare të kapaciteteve të Grupeve Lokale të Veprimit dhe për përgatitjen e strategjive të tyre, kurse masa *‘Zbatimi i strategjive të zhvillimit vendor – qasja LEADER’* do të mbështesë veprimet për gjallërimin e territorit, ndërtimin e mëtejshëm të kapaciteteve dhe zbatimin e projekteve të vogla (nevoja 11). Qasja LEADER do të promovohet edhe përmes aktiviteteve të rrjetit kombëtar të zhvillimit rural.

Një pjesë e nevojave të identifikuara për zhvillimin e zonave rurale do të adresohet përmes ndërhyrjeve të tjera të IPA II. Fonde nga IPA II dhe fonde kombëtare dhe asistencë nga donatorët do të ofrohen edhe për përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe aksesit në shërbimet bazë të popullsisë rurale (nevoja 10).

**Tabela 6.1: Përmbledhje e nevojave kryesore për zhvillim dhe e masave operuese**

Nevojat e identifikuara	IPARD	IPA	Asistencë shumëpalëshe e donatorëve të tjerë	Kombëtare
1. Rritja e investimeve në aktive afatgjatë të fermave	‘Investime në aktive afatgjata të fermave		✓	✓

Nevojat e identifikuar	IPARD	IPA	Asistencë shumëpalëshe e donatorëve të tjerë	Kombëtare
bujqësore'	bujqësore'			
2. Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve këshillimore për fermerët	'Shërbime këshillimore'		✓	✓
3. Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit			✓	✓
4. Përmirësimi i konkurueshmërisë së industrisë së përpunimit ushqimor	'Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve		✓	✓
5. Rritja e kapitalit fizik në industrinë ushqimore për përmbushjen e standardeve të BE-së	bujqësore dhe të peshkimit		✓	
6. Rritja e bashkëpunimit mes aktorëve kryesorë në zinxhirin agro-usqimor			✓	✓
7. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore dhe efikasitetit të burimeve	'Masa agro-mjedisore, klimaterike dhe bujqësisë organike' 'Shërbimet këshillimore'	✓	✓	✓
8. Diversifikimi i aktiviteteve dhe burimeve të të ardhurave për fermerët	'Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit'	✓	✓	✓
9. Zhvillimi i sektorëve jobujqësorë të ekonomisë rurale	'Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit'	✓	✓	✓
10. Përmirësimi i infrastrukturës rurale, aksesit dhe cilësisë së shërbimeve bazë në zonat rurale	'Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit'	✓	✓	✓
11. Përmirësimi i qeverisjes vendore dhe zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e qasjes LEADER	'Asistencë teknike' 'Zbatimi i strategjive të zhvillimit vendor – LEADER'		✓	✓

Programi IPARD II përfshin shtatë masa, të shpërndara në dy paketa që nga fillimi i zbatimit. Paketa e parë përfshin katër masa që do të fillojnë të zbatohen në vitin 2016, pasi autoriteteve shqiptare t’iu besohen detyrat e zbatimit të buxhetit (Tabela 6.2). Përvoja e fituar nga Agjencia IPARD në zbatimin e masave që mbështesin investimet në aktivet afatgjata dhe Paketën 1 përfshijnë tre masa në mbështetje të investimeve në sektorin agro-ushqimor dhe ekonominë rurale. Edhe kjo masë planifikohet të fillojë të zbatohet në vitin 2016, për të garantuar zbatimin normal si dhe monitorim e vlerësim efikas të Programit të masës ‘Asistencë teknike’.

Paketa 2 përfshin tre masa që do të miratohen dhe do të fillojnë të zbatohen pas ngritjes së kapaciteteve të mjaftueshme të Ministrisë së Bujqësisë dhe Agjencisë IPARD për zbatimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre masave. Duke pasur parasysh rëndësinë e zbatimit efikas të masave të Paketës 1, masa e ‘Shërbimeve Këshillimore’ programohet që të fillojë në vitin 2017. Dy masat e tjera të Paketës 2 kërkojnë një përgatitje më të gjatë dhe ngritje kapacitetesh, prandaj janë programuar të fillojnë në vitin 2018.

**Tabela 6.2: Masat e programit IPARD II sipas fillimit të parashikuar të zbatimit**

Masa	Fillimi i zbatimit
<b>Masat e paketës 1</b>	
1. ‘Investimet në aktive afatgjata të fermave bujqësore’	2016
2. ‘Investimet në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit’	2016
3. ‘Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit’	2016
4. ‘Asistenca teknike’	2016
<b>Masat e paketës 1</b>	
5 ‘Shërbimet këshillimore’	2017
6. ‘Zbatimi i strategjive të zhvillimit vendor – LEADER’	2018
7. ‘Masa agro-mjedisore, klimaterike dhe e bujqësisë organike’	2018

### **6.3. Bashkëveprimi mes ndërhyrjeve të propozuara të IPARD dhe Dokumentit Strategjik Kombëtar**

Objektivi kryesor i Dokumentit Strategjik për Shqipërinë në lidhje me sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural është ‘mbështetja e Shqipërisë në zhvillimin e një sektori agro-ushqimor eficient, të qëndrueshëm dhe novator, që konkurren në tregun e BE-së dhe që ofron punësim, përfshirje sociale dhe cilësi jete për popullatën rurale’.

Objektivat dhe prioritetet të masave të përzgjedhura të Programit IPARD II janë në konsistencë me objektivat e Dokumentit Strategjik dhe kontribuojnë për:

- Mbështetje investimeve në sektorin agro-ushqimor, me synim përmirësimin e konkureshmërisë, përmbushjen e standardeve të BE-së dhe respektimin e standardeve për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit;
- Mbështetje investimeve në zonat rurale, me synim diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e bizneseve që çojnë në përmirësim të mundësive për punësim dhe të përfshirjes sociale.

Zbatimi i masave do të kontribuojë drejtpërdrejtë në arritjen e pesë rezultateve të shënjestruara prej Dokumentit Strategjik Kombëtar.

**Tabela 6.3: Kontributi i programit IPARD II në arritjen e rezultateve të Dokumentit Strategjik**

Rezultatet e shënjestruara të Dokumentit Strategjik	Kontributi i Programit IPARD II
‘Aplikim i përmirësuar i standardeve mjedisore dhe të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin agro-ushqimor, sidomos për produktet e mishit dhe qumështit, si edhe produktet për eksport’.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështetje me investime në standardet mjedisore dhe ato të sigurisë ushqimore</li> <li>- Sensibilizim të sektorit agro-ushqimor për standardet dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, përmes masave informuese dhe përgatitjes së projekteve;</li> <li>- Forcim i përvojës së trupave teknike për sa i përket verifikimit të respektimit të standardeve të BE-së.</li> </ul>
Përballim më i mirë i efekteve negative të ndryshimeve klimaterike	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështetje me investime në teknologji eficiente;</li> <li>- Rritje të sensibilizimit mbi ndikimet e ndryshimeve klimaterike;</li> <li>- Investime në prodhimin e energjisë së rinovueshme;</li> <li>- Krijimi i kapaciteteve për zbatimin e masave agro-mjedisore;</li> </ul>
Rritje e të ardhurave të gjeneruara prej grave dhe sipërmarrësve të rinj në zonat rurale.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësim i mundësive të punësimit për gratë dhe të rinjtë në zonat rurale;</li> <li>- Mbështetje me investime për gratë dhe sipërmarrësit e rinj në zonat rurale.</li> </ul>
Përmirësim i shërbimeve këshillimore bujqësore.	Rritja e cilësisë dhe rrezes së shërbimeve këshillimore, falë zbatimit të Masës ‘Shërbimet këshillimore’.
Strukturat kombëtare të ngritura dhe besimi / ngarkimi i detyrave të zbatimit të buxhetit për asistencën e zhvillimit bujqësor dhe rural (zbatimi i programeve të zhvillimit rural IPA – IPARD).	<p>Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD kanë fituar përvojë në zbatimin e IPARD II;</p> <p>Procedurat janë përmirësuar bazuar në mësimet e nxjerrja dhe rezultatet e kontrolleve;</p> <p>Partneritet aktiv me organet dhe aktorët përkatës.</p>

**6.4. Përmbledhje e logjikës së ndërhyrjeve, duke treguar masat e përzgjedhura për IPARD, objektivat sasiorë**

Masa	Objektivi sasior	Objektivat e programit
Investime në aktive afatgjata në fermave bujqësore	<p>Numri i projekteve të mbështetura – 430</p> <p>Numri i fermave bujqësore që zbatojnë projekte modernizimi – 430</p> <p>Numri i fermave bujqësore që përafrohen gradualisht me standardet e BE-së – 300</p> <p>Numri i fermave bujqësore që investojnë në prodhimin e energjisë së rinovueshme – 20</p> <p>Numri i fermave bujqësore që investojnë me menaxhimin e blegtorisë, me synim reduktimin e N20 dhe të shkarkimeve të metanit – 40</p> <p>Investimi total në kapital fizik nga fermat bujqësore – 52 milion EURO</p>	<p>Numri i projekteve që kanë marrë mbështetje IPA në sektorin agro-ushqimor dhe zhvillimin rural – 760</p> <p>Investimi total i gjeneruar nga IPA në sektorin agro-ushqimor dhe zhvillimin rural – 145,5 milion EURO</p>
Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	<p>Numri i projekteve të mbështetura – 180</p> <p>Numri i fermave bujqësore që zbatojnë projekte modernizimi – 180</p> <p>Numri i fermave bujqësore që përafrohen gradualisht me standardet e BE-së – 180</p> <p>Numri i fermave bujqësore që investojnë në prodhimin e energjisë së rinovueshme – 15</p> <p>Investimi total në kapital fizik nga sipërmarrjet – 71 milion EURO</p> <p>Numri i vendeve të punës të krijuara (bruto) - 600</p>	<p>Numri i njësive ekonomike që zbatojnë projekte modernizimi në sektorin agro-ushqimor – 610</p> <p>Numri i njësive ekonomike që përafrohen gradualisht me standardet e BE-së – 480</p> <p>Numri i vendeve të punës të krijuara (bruto) 1 100</p>
Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit	<p>Numri i projekteve të mbështetura – 150</p> <p>Numri i fermave bujqësore / sipërmarrjeve që zhvillojnë burime shtesë apo të diversifikuara të ardhurash në zonat rurale – 150</p> <p>Numri i përfituesve që investojnë në energji të rinovueshme – 20</p> <p>Investimi total në kapital fizik nga përfituesit – 22,5 milion EURO</p> <p>Numri i vendeve të punës të krijuara (bruto) - 500</p>	<p>Numri i përfituesve që investojnë në promovimin e efikasitetit të burimeve dhe në mbështetje të kalimit drejt ekonomisë me karbon të ulët dhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimaterike, në sektorin bujqësor, ushqimor dhe pylltarisë - 95</p>
Shërbimet këshillimore <sup>1</sup>	Numri i përfituesve të shërbimeve këshillimore	

Masa	Objektivi sasior	Objektivat e programit
	Numri i këshilltarëve të trajnuar Numri i ditëve të trajnimit dhënë këshilltarëve	
Masa agro-mjedisore-klimaterike dhe bujqësia organike <sup>1</sup>	Numri i kontratave Toka bujqësore (ha) nën kontrata mjedisore Numri i tipit të operacioneve të mbështetura Sipërfaqja totale për tip operacioni Numri i fermave bujqësore të mbështetura nën tipin e operacionit 'bujqësi organike'	
Zbatimi i strategjive zhvillimit vendor LEADER <sup>1</sup>	Numri i Grupeve Lokale të Veprimit (LAG) që veprojnë në zonat rurale Popullsia që mbulojnë LAG-et Numri i vendeve të punës të krijuara (bruto) Numri i projekteve të rekomanduara Numri i projekteve të vogla	
Asistenca Teknike	Numri i takimeve të Komitetit Monitorues të IPARD II të mbështetura- 10 Numri i raporteve të vlerësimit të Programit të mbështetura - 2 Numri i workshop-eve, konferencave dhe seminareve – 70 Numri i studimeve për hartimin dhe zbatimin e masave të Programit – 10 Numri i materialeve promovuese për informim të përgjithshëm të të gjitha palëve të interesuara 35 000 (kopje) Numri i masave për formim rrjetesh rurale të mbështetura – 30 Numri i LAG-eve potenciale të mbështetura - 10	

Shënim: 1) Objektivat e treguesve do të shtohen pas miratimit të masave.

## 7.7. TABELA E PËRGJITHSHME FINANCIARE

### 7.1 Maksimumi i kontributit të BE-së për fondet IPARD për vitet 2014-2020, në EURO

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
<b>Totali</b>	-	-	13,000,000	14,000,000	12,000,000	16,000,000	16,000,000	71,000,000

## 7.2 Plani financiar sipas masave në EURO, 2014-2020

Masat	Totali mbështetjes publike (EURO)	Kontributi BE-së (EURO)	Përqindja e kontributit të BE-së (%)	Kontributi kombëtar (EURO)	Përqindja e Kontributit Kombëtar (%)
Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore	41,866,667	31,400,000	75%	10,466,667	25%
Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	35,333,333	26,500,000	75%	8,833,333	25%
Masa agro-mjedisore-klimaterike dhe bujqësisë organike	-	-	-	-	-
Zbatimi strategjive lokale të zhvillimit – LEADER	-	-	-	-	-
Diversifikimi fermës dhe zhvillimi biznesit	14,666,667	11,000,000	75%	3,666,667	25%
Asistenca teknike	2,470,588	2,100,000	85%	370,588	15%
Shërbimet këshillimore	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>94,337,255</b>	<b>71,000,000</b>	<b>-</b>	<b>23,337,255</b>	<b>-</b>



### 7.3 Shpërndarja e buxhetit paraprak sipas masave për periudhën 2014-2020

Masat	Totali mbështetjes publike (EURO)	Kontributi privat (EURO)	Totali shpenzimeve (EURO)
Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore	41,866,667	23,550,000	65,416,667
Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	35,333,333	35,333,333	70,666,667
Masa agro-mjedisore-klimaterike dhe bujqësisë organike	-	-	-
Zbatimi strategjive lokale të zhvillimit – LEADER	-	-	-
Diversifikimi fermës dhe zhvillimi biznesit	14,666,667	7,897,436	22,564,103
Asistenca teknike	2,470,588		2,470,588
Shërbimet këshillimore	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>94,337,255</b>	<b>66,780,769</b>	<b>161,118,024</b>

**7.4. Monitorimi i buxheti paraprak i kontributit të BE-së sipas masave për periudhën 2014-2020, në EURO**

Masat	Kontributi i BE-së (EURO)							
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore	-	-	5,150,000	5,680,000	5,410,000	7,070,000	8,090,000	31,400,000
Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	-	-	5,300,000	5,570,000	4,410,000	6,080,000	5,140,000	26,500,000
Masa agro-mjedisore-klimaterike dhe bujqësisë organike	-	-	-	-	-	-	-	-
Zbatimi strategjive lokale të zhvillimit – LEADER	-	-	-	-	-	-	-	-
Diversifikimi fermës dhe zhvillimi biznesit	-	-	2,200,000	2,200,000	1,830,000	2,500,000	2,270,000	11,000,000
Asistenca teknike	-	-	350,000	550,000	350,000	350,000	500,000	2,100,000
Shërbimet këshillimore	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	-	-	<b>13,000,000</b>	<b>14,000,000</b>	<b>12,000,000</b>	<b>16,000,000</b>	<b>16,000,000</b>	<b>71,000,000</b>

**7.5 Shpërndarja në përqindje e kontributit të BE-së sipas masave për periudhën 2014-2020**

Masat	Kontributi i BE-së (%)							
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore	-	-	39,62%	40,57%	45,08%	44,19%	50,56%	44,23%
Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	-	-	40,77%	39,79%	36,75%	38,00%	32,13%	37,32%
Masa agro-mjedisore-klimaterike dhe bujqësisë organike	-	-	-	-	-	-	-	-
Zbatimi strategjive lokale të zhvillimit – LEADER	-	-	-	-	-	-	-	-
Diversifikimi fermës dhe zhvillimi biznesit	-	-	16,92%	15,71%	15,25%	15,63%	14,19%	15,49%
Asistenca teknike	-	-	2,69%	3,93%	2,92%	2,19%	3,13%	2,96%
Shërbimet këshillimore	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	-	-	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>

## **8. PËRSHKRIM I SECILËS MASË TË PËRZGJEDHUR**

### **8.1.Kërkesat në lidhje me të gjitha apo disa masa**

#### **8.1.1. Standardet kombëtare minimale që aplikohen për Programin**

- Legjislacioni i brendshëm i zbatueshëm për standardet kombëtare minimale tregohet në Aneksin 7.

#### **8.1.2. Përkufizimi i zonave rurale**

Zonat rurale përfshijnë territorin e të gjitha bashkive me popullsi nën 50 000 banorë, sipas censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011.

Lista e zonave rurale jepet në Aneksin 3.

#### **8.1.3. Kriteret e pranueshmërisë të aplikueshme për të gjitha apo disa masa**

##### ***1. Për masat e investimeve<sup>44</sup>, shpenzimet e pranueshme do të konsiderohen vetëm:***

- i) ndërtimi apo rindërtimi i pasurive të paluajtshme, deri në masën e vlerës së tregut të pasurisë;
- ii) blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, përfshi programe kompjuterikë, deri në masën e vlerës së tregut të pasurisë;
- iii) kostot e përgjithshme që lidhen me shpenzimet e investimet (i) dhe (ii), si p.sh. tarifatat e konsulencës së arkitektëve, inxhinierëve etj., studimet e fizibilitetit, përgatitja e planit të biznesit, do të rimburohen deri në tavanin 12% të kostove të përcaktuara në pikat (i) dhe (ii). Shpenzimet për përgatitjen e planit të veprimit nuk duhet të tejkalojnë 4% ose 5 000 EURO, cilado të jetë më e ulët. Kostot e përgjithshme konsiderohen të pranueshme nëse projekti të cilit i përkasin është përzgjedhur dhe është kontraktuar prej Agjencisë IPARD. Shuma e pranueshme e kostove të përgjithshme nuk duhet të tejkalojë masën e arsyeshme.

*Investimet në një pronë me qira janë të pranueshme. Nëse ndertesa, ambientet apo toka nuk është në pronësitë aplikantit, atëherë ky i fundit duhet të ketë një kontratë qiramarrjeje me afat të paktën 7 vjeçar që nga data e dorëzimit të aplikimit. Në rastin e investimeve të ndërtimit/rindërtimit,*

---

<sup>44</sup>Masat: 'Investimet në aktive afagjata të fermave bujqësore'; 'Investimet në aktive afagjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit'; 'Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit';

permirësimin të ujitjes ose ringritjes së parcelave me bimë shumevjecare, aplikanti duhet të provojë pronësinë mbi tokën /ndërtesat e lidhura me investimin ose të drejtën e përdorimit të tyre për një periudhë të paktën 10 vjet nga data e dorëzimit të aplikimit.

Kosto të pranueshme janë ato shpenzime të lindura pas besimit / ngarkimit të detyrave të zbatimit të buxhetit .

Projektet e investimeve mbeten të pranueshme për financim të BE-së, me kusht që të mos i nënshtrohen modifikimeve thelbësore brenda pesë vitesh nga pagesa e fundit e Agjencisë IPARD të tilla si:

- ndërprerje apo zhvendosje e aktivitetit prodhues jashtë zonës gjeografike që mbulon programi IPARD II;
- ndryshim në pronësi, që i jep një shoqërie apo organi publik një avantazh të padrejtë;
- ndryshim thelbësor që cenon natyrën, objektivat apo kushtet e zbatimit, që do të rezultojnë në dëmtimin e objektivave fillestarë.

Kur llogaritet shpenzimi publik si përqindje e kostot totale të pranueshme të investimit, nuk merret parasysh mbështetja nga skema kombëtare që synon lehtësimin e aksesit në huamarrje dhënë pa pjesëmarrjen e kontributit të BE-së në kuadër të Rregullores (BE) Nr. 231/2014.

## ***2. Rregullat e origjinës për shpenzimet e pranueshme që vlejnë për të gjitha masat***

Të gjitha furnizimet e blera në bazë të një kontrate prokurimi apo marrëveshjeje granti financiar nga ky program, duhet ta kenë origjinën nga një prej vendeve të mëposhtme:

- (a) Shtetet Anëtare, Përfituesit IPA II, palët kontraktuese të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendet partnere që mbulon Instrumenti Evropian i Fqinjësisë, si edhe
- (b) Vendet për të cilat Komisioni ka miratuar aksesin reciprok në asistencën e jashtme. Aksesin reciprok mund të jepet për një periudhë të kufizuar, të paktën një vit, kurdo që një vend u akordon të njëjtën njohje subjekteve nga BE-ja dhe nga vendet përfituesi në kuadrin e IPA II. Para se Komisioni konsultohet me Përfituesin IPA II, para se të marrë vendim për aksesin reciprok dhe kohëzgjatjen e tij.

Megjithatë, furnizimet mund të vijnë nga çdo vend kur sasia e furnizimeve që do të blihet është nën pragun e procedurës së prokurimit konkurrues. Termi “origjinë” përkufizohet në nenin 23 dhe 24 të Rregullores së Këshillit (KEE) Nr. 2913/92<sup>45</sup>.

---

<sup>45</sup>Rregullorja e Këshillit (KEE) Nr. 2913/92 e datës 12 tetor 1992 që përcakton Kodin Doganor Komunitar dhe legjislacionin Komunitar që disiplinon origjinën jo-preferenciale (GZ L 302, 19 Tetor 1992, f. 1).

Komisioni mund të pranojë ofertuesit, aplikantët dhe kandidatët që nuk janë nga vendet e pranueshme më lart, apo mallrat me origjinë jo të pranueshme, në rast urgjence apo mungese të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve në fjalë, ose në raste të tjera të justifikuara kur aplikimi i rregullave të pranueshmërisë do ta bënte realizimin e një projekti, programi apo aksioni të pamundur apo tejet të vështirë.

### ***3. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme për mbështetje nga programi IPARD II***

- taksat, përfshi tatimin mbi vlerën e shtuar;
- tarifat doganore dhe tarifat e importit, ose tarifa të tjera me efekt të barasvlershëm;
- blerja, dhënia ose marrja me qira e tokës ose ndertesave ekzistuese, pavarësisht faktit nëse qiraja rezulton në transferim të pronësisë të qiramarrësi;
- gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet për padi gjyqësore;
- kostot operative;
- pajisjet dhe makineritë e përdorura;
- tarifat bankare, kostot e dorëzaneve dhe tarifa të tjera të ngjashme;
- kostot e këmbimit, tarifa apo humbje nga këmbimi valutor që lidhet me llogarinë në EURO të IPARD, si edhe shpenzime të tjera tërësisht financiare;
- kontribute në natyrë;
- blerja e të drejtave mbi prodhimin bujqësor, e kafshëve, e bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
- çfarëdo mirëmbajtjeje, zhvlerësimi apo kosto qiraje;
- çfarëdo kostoje apo pagese që bën administrata publike gjatë menaxhimit dhe zbatimit të asistencës, përfshi ato të strukturës menaxhuese dhe strukturës operuese dhe, sidomos, shpenzimet e përgjithshme, qiratë dhe pagat e personelit të punësuar për aktivitetet e menaxhimit, zbatimit, monitorimit dhe kontrollit, përveç rasteve të justifikuara siç duhet që imponon natyra e masës së programit IPARD II.

### ***4. Qëndrueshmëria ekonomike***

Pranohen për mbështetje vetëm investimet që janë ekonomikisht të qëndrueshme në fund të periudhës së investimit. Kriteret që përdor Agjencia IPARD për vlerësimin e qëndrueshmërisë ekonomike të investimeve paraqiten në Aneksin 2.

#### ***8.1.4. Kontrolli dhe verifikueshmëria e masave***

Kontrolli dhe verifikueshmëria e masave do të garantohet në këtë mënyrë:

- Përcaktimi dhe aplikimi i kriterëve të pranueshmërisë dhe përzgjedhjes të qarta, sasiore dhe transparente, që mund të maten dhe të kontrollohen;
- Proces përzgjedhës bazuar në kriteret të parapërcaktuara dhe të publikuara sipas procedurave transparente dhe të mirë dokumentuara (me gjurmë auditi) dhe me kapacitete administrative, duke garantuar respektim të parimit të menaxhimit të shëndoshë financiar, përfshi në përzgjedhjen e aplikimeve, kontrollin administrativ dhe në vend të pranueshmërisë së shpenzimeve, verifikimin e respektimit të parimit të

“marrjes së vlerës së parasë” dhe të legjislacionit për prokurimin publik dhe sistemeve adekuate të teknologjisë së informacionit (TI).

- Kostot e propozuara duhet të jenë të arsyeshme; ato vlerësohen nga një sistem i përshtatshëm vlerësimi, si p.sh. kostot referencë, kostot për njësi standard, krahasimi i ofertave të ndryshme, apo nga një komision vlerësues.
- Dokumentim, menaxhim dhe verifikim i duhur i dokumenteve; aplikantit do t'i kërkohej të regjistrojë operacionet, faturat dhe të dhënat kontabël.
- Kontrollë *ex-post* të operacioneve të investimit, për të verifikuar respektimin e angazhimeve të përcaktuara në programin IPARD II. Kontrollët *ex post* bëhen brenda 5 vitesh nga data kur aplikanti merr pagesën e fundit. Të gjitha investimet duhet të kontrollohen të paktën një herë gjatë periudhës pesëvjeçare.

Risku i gabimeve do të reduktohet me këto masa:

- Sistemi kontrolli i brendshëm solid, që garanton se kontrollet e përshkruara në manualët e procedurës kryhen në mënyrën që janë akredituar dhe se personeli mbikëqyrës shqyrton funksionimin e kontrolleve;
- Përdorim i kostove të thjeshtuara, bazuar në referenca adekuate dhe të sakta, si edhe të miratuara paraprakisht mbi bazën e një llogaritjeje të drejtë, të barabartë dhe të verifikueshme. Llogaritjet do të verifikohen për mjaftueshmëri dhe saktësi, si dhe konfirmohen nga një organ i pavarur funksionalisht prej autoriteteve përgjegjëse për programin IPARD II. Dokumentet përkatëse i paraqiten Komisionit para zbatimit të metodës me kosto të thjeshtuara.
- Publikimi dhe përhapja e gjerë e dokumenteve orientuese të aplikantët potencialë, ku përfshihen qartë kriteret e pranueshmërisë dhe kërkesat e aplikimit, kriteret e përzgjedhjes, rregullat e zbatimit të projekteve si edhe përgatitja e kërkesave për pagesë;
- Trajnimi dhe miratimi i udhëzimeve për aplikantët mbi pranueshmërinë, zbatimin dhe përgatitjen e kërkesave për pagesë;
- Trajnim periodik i stafit të Agjencisë IPARD dhe i organeve teknike mbi procedurat e verifikimit të pranueshmërisë së aplikantëve, aplikimeve dhe kërkesave për pagesë, si edhe mbi parandalimin dhe zbatimin e parregullsisë.

Kontrolli dhe verifikueshmëria e masave është vlerësuar bashkërisht *ex-ante* nga Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD gjatë procesit të përgatitjes së programit; vlerësimi do të përditësohet gjatë zbatimit, bazuar në kontrollet, gjetjet e auditit apo pas modifikimit të masave apo përfshirjes së masave të reja.

#### **8.1.5. Shënjestrimi i masave**

Shënjestrimi i masave arrihet përmes:

- Krieteve të pranueshmërisë që përcaktojnë mbështetje vetëm për sektorët prioritarë dhe grupet e shënjestruara (target) bazuar në studime sektoriale;
- Krieteve përzgjedhëse që synojnë mbështetje për prioritetet e programit IPARD dhe për objektivat e masave.

Kriteret e pranueshmërisë dhe të përzgjedhjes synojnë të garantojnë trajtim të barabartë të aplikantëve, transparencë dhe përdorim më të mirë të burimeve financiare si edhe minimizim të

investimeve pa të ardhme. Në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë dhe të përzgjedhjes, merret parasysh parimi i proporcionalitetit në lidhje me grantet e vogla.

### **8.1.6. Procedura administrative për përzgjedhjen e projekteve të investimit**

Projektet nën masat e investimeve<sup>46</sup> do të përzgjidhen përmes thirrjeve të hapura për projekt-propozime. Autoriteti Menaxhues do të hartojë çdo vit një Program Pune Vjetor (PPV) për Thirrjet për Aplikime, ku përcakton numrin e thirrjeve, kohën e shpalljes dhe afatet për dorëzimin e aplikimeve për çdo thirrje, buxhetin e planifikuar për secilin masë nën secilën thirrje për aplikime. Programi vjetor do të publikohet në faqen e internetit të Programit jo më vonë se data 31 janar e vitit "n". Në rast ndryshimesh thelbësore / nevoje për ndryshime të kushteve të sipërcituara gjatë vitit, do të publikohet programi i punës vjetor i përditësuar.

Për çdo thirrje për aplikime do të publikohet Udhëzuesi për Aplikantët që do të specifikojë: objektivat e masave, kriteret e pranueshmërisë (pranueshmërinë e aplikantëve, investimeve dhe shpenzimeve) dhe kriteret e përzgjedhjes; buxhetin total të thirrjes dhe për çdo masë, intensitetin e ndihmës si dhe listën e dokumenteve mbështetëse për aplikimet dhe kërkesat për pagesë; afatet për dorëzimin e aplikimeve, procedurën për dorëzimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve. Procedura për përzgjedhjen e projekteve dhe pagesat do të përshkruhet në Udhëzuesin Për Aplikantët. Për informim, aty do të paraqitet një kontratë granti standard dhe një kërkesë për pagesë standard. Udhëzuesi për Aplikantët do të respektojë rigorozisht të gjitha dispozitat (kriteret e pranueshmërisë dhe përzgjedhjes) të parashikuara në programin IPARD II, Marrëveshjen Kuadër dhe Marrëveshjen Sektoriale IPARD.

Udhëzuesi për Aplikantët përfshin anekset që paraqesin modele për formularin e aplikimit, kërkesën për pagesë dhe dokumentet e tjera që duhet të plotësohen prej aplikantëve. Gjithashtu, Udhëzuesi do të ketë edhe modele plani biznesi:

- Nëse kostoja totale e pranueshme për investimin është 50 000 EURO ose më pak, aplikantët duhet të dorëzojnë një projekt-propozim teknik me parashikime të thjeshtuara për të ardhura-shpenzimet dhe fluksin e parasë.
- Nëse kostoja totale e pranueshme për investimin është mbi 50 000 EURO, aplikantët duhet të dorëzojnë një plan biznesi.

Agjencia IPARD do të shpallë thirrjet për aplikime brenda afateve të miratuara në Programin Vjetor dhe do të kryejë fushata informuese në bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues.

Të gjitha aplikimet e dorëzuara regjistrohen dhe ato që dorëzohen para mbarimit të afatit të Thirrjes për Aplikime, vlerësohen dhe kontrollohen për përputhshmëri administrative dhe pranueshmërisë, duke u nisur nga dokumentet mbështetëse të dorëzuara. Në rast mungesash të vogla në dokumentet mbështetëse, aplikantëve u kërkohet t'i korrigjojnë ato.

---

<sup>46</sup>Masat: 'Investimet në aktive afagjatanë fermat bujqësore'; 'Investimet në aktive afagjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit'; 'Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit';

Aplikimet që e kanë kaluar kontrollin e parë administrativ dhe të pranueshmërisë, vlerësohen për qëndrueshmërinë ekonomike dhe nëse kostot e propozuara janë të arsyeshme.

Të gjithë aplikantët që përmbushin rregullat administrative dhe të pranueshmërisë, do të kontrollohen në vend për të verifikuar saktësinë e informacionit të paraqitur prej tyre në formularin e aplikimit dhe në dokumentet mbështetëse.

Aplikimet e suksesshme do të renditen në bazë të kriterëve të përzgjedhjes dhe do të financohen deri në limitin e buxhetit të thirrjes për aplikime. Nëse buxheti nuk është i mjaftueshëm për të financuar dy apo më shumë propozime të renditura njësoj, granti do t'i jepet aplikimit që është dorëzuar i pari. Procedura e renditjes nuk aplikohet kur shuma totale e granteve të kërkuara prej aplikimeve të dorëzuara nuk e kalon buxhetin total të akorduar për këtë thirrje për aplikime.

Gjithashtu, hartohet edhe një listë rezervë. Nëse pas përfundimit të kontraktimit të të gjitha aplikimeve të përzgjedhura, buxheti total i thirrjes për aplikime nuk kontraktohet për çfarëdo arsye, do të kontraktohen projektet nga lista rezervë.

Të gjitha dispozitat e përcaktuara më lart janë objekt akreditimi dhe mund të ndryshojnë. Dispozitat përfundimtare do të përcaktohen në procedurat e Agjencisë IPARD.

## **8.2 Përshkrimi i Masave**

### **8.2.1 Masa 'Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore'**

#### **8.2.1.1. Titulli Investimit**

'Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore'

#### **8.2.1.2. Baza ligjore**

- Neni 2 (1) i Rregullores IPA (EU) Nr. 236/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 Mars 2014 e cila përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e veprimeve të jashtme;
- Neni 27 (1) (1) i Marrëveshjes Sektoriale;
- Aneksi 4 i Marrëveshjes Sektoriale.

#### **8.2.1.3 Përshkrim i Përgjithshëm**

Investimet në aktivet afatgjata janë të nevojshme për të përmirësuar produktivitetin në përgjithësi, rentabilitetin ekonomik si dhe arritjen e standardeve të BE-së për sa i përket fermave bujqësore. Ekziston një mungesë kapitali në ferma, dhe si rrjedhojë, për të nxitur investimet është e nevojshme dhënia e mbështetjes publike.

*Prodhimi i qumështit* është një nga sektorët më të rëndësishëm në Shqipëri. Me qëllim përmirësimit e konkureshmërisë lidhur me cilësinë dhe higjienën e qumështit të papërpunuar, mirëqenies së kafshëve dhe trajtimit të mbetjeve është e nevojshme që këto ferma të mbështeten. Për këtë arsye, është e nevojshme mbështetja publike për të nxitur dhe bërë të mundur kryerjen e



investimeve në ambiente në nivel ferme për mjeljen e qumështit, ruajtjen e ftohtë të tij dhe magazinimin, përmirësimi i ndërtesave dhe ambienteve për të përmbushur kërkesat e lidhura me mirëqenien e kafshëve, depozitimin e plehut dhe pajisjeve për largimin e tij.

Kjo masë do të mbështesë fermat me potencial rentabiliteti ekonomik në *sektorin e mishit*. Në sektorin e prodhimit të mishit nga të imtat praktikohet gjerësisht lëvizja e bagëtive, me qëllim shfrytëzimin e kullotave malore dhe cilësisë së lartë të mishit përmes mbarështimit të racave lokale në kushte natyrale malore. Gjithsesi, mungesa e ujit është një shqetësim serioz gjatë periudhës së qëndrimit në kullota malore. Gjithashtu çështje që përbëjnë shqetësim janë edhe strehimi i të imtave gjatë dimrit, ruajtja e ushqimit dhe trajtimi i tyre në përgjithësi. Fondet kullimore, përfshirë kullotat dhe tokën bujqësore, janë thelbësore për mbarështimin e bagëtive, por të cilat gjatë viteve të fundit kanë pësuar një degradim domethënës. Mundësitë për zgjerimin e kullotave natyrore janë të kufizuara. Për këtë arsye, sasia e ushqimit të nevojshëm duhet të sigurohet përmes shtimit të prodhimit të foragjereve, dhe përmirësimit të përdorimit të nën-produkteve industriale, të tillave si pelletë bërshish, krundeve të drithërave dhe sojëve.

Ekziston nevoja për rritjen e standardeve në mbarështimin e derrave dhe shpendëve për sa i përket përmirësimit të kushteve të mirëqenies së kafshëve (strehimit, ajrosjes, etje.), përgatitjes dhe ruajtjes së foragjereve, depozitimit e largimit të plehut, trajtimit dhe manovrimit në mënyrë që të arrihet nga fermerët përmbushja e standardeve të BE-së në lidhje me mjedisin dhe mirëqenien e kafshëve.

Rritja e konkurrenshëmisë në sektorin e *fruta-perimeve* kërkon dhënien e mbështetjes për reduktimin e kostove të prodhimit si dhe përmirësimin e cilësisë për rritjen e shkallës së prodhimit, futjen në përdorim të teknologjive të reja, përmirësimin e praktikave të kultivimit si dhe makinerive për vjelje dhe infrastrukturën e pas-vjeljes.

Shqipëria ka kushte shumë të mira toke dhe klimaterike për zhvillimin e *vitikulturës* dhe kultivimi i rrushit është i përhapur gjerësisht dhe përbën një burim të rëndësishëm të ardhurash dhe vetë-punësimi për një numër të lartë fermash bujqësore. Dhënia e mbështetjes bujqësore është e nevojshme për të inkurajuar konsolidimin e prodhimit të verës dhe rrushit të tavolinës, futjes në prodhim të varieteteve për të cilët ka kërkesë nga industria dhe tregu si dhe rritja e cilësisë dhe e prodhimit.

Sipas analizës SWOT, struktura e moshës së personave që drejtojnë ferma është shumë e pafavorshme. Për këtë arsye, fermerëve të rinj do të inkurajohen përmes dhënies së mbështetjes për të modernizuar dhe novatorizuar sistemin bujqësor. Migrimi nga zonat malore rurale drejt zonave rurale apo edhe jashtë vendit ka pasuar rritje domethënëse gjatë viteve të fundit. Për këtë arsye, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të situatës, përparësi do tu jepet fermerëve të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zonat malore. Bujqësia organike ka tendencën për të kërkuar inpute të larta të krahut të punës dhe të sjelli marzhe më të larta fitimi dhe në të njëjtën kohë ajo ndihmon në ruajtjen e mjedisit. Për këtë arsye, duke pasur parasysh kushtet aktuale të Shqipërisë, përmes kësaj mase i jepet përparësi bujqësisë organike. Përparësi u jepet gjithashtu edhe investimeve për prodhimin e energjisë së rinovueshme për nevojat e fermës dhe trajtimit të mbetjeve.

#### **8.2.1.4. Objektivat e përgjithshëm dhe ato të veçantë**

*Objektivat e përgjithshëm* të kësaj mase janë:

- Dhënia e mbështetjes për përafrimin gradual me standardet, rregullat, politikat, praktikat e BE-së në kuadër të anëtarësimit në BE;
- Dhënia e mbështetjes për zhvillimin ekonomik, social dhe të territorit, për një rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, përmes shtimit të aktiveve afatgjata.

- Adresimi i sfidave të ndryshimeve klimaterike përmes promovimit të përdorimit me efikasitet të burimeve dhe energjisë së rinovueshme.

*Objektivat e veçantë të kësaj mase janë:*

- Përmirësimi i performancës së përgjithshme të fermave bujqësore në prodhimin e produkteve parësore bujqësore;
- Përbushja e standardeve të BE-së lidhur me mbrojtjen mjedisore dhe mirëqenien e kafshëve;
- Nxitja e investimeve në aktive afatgjata në sektorët e qumështit, mishit, frutave, perimeve dhe rrushit me qëllim:
  - Përmirësimin e kushteve të higjienës së qumështit dhe mishit të papërpunuar në ferma përmes modernizimit të prodhimit, teknologjive dhe praktikave të ruajtjes dhe transportit;
  - Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve përmes investimeve në ambientet e strehimit dhe manovrimit të kafshëve;
  - Mbështetjen e futjes në përdorim të ambienteve përkatëse që mbrojnë mjedisin dhe klimën për depozitimin, trajtimin dhe largimin e plehut;
  - Përmirësimin e teknikave dhe teknologjive të prodhimit, si dhe prodhimin e farave dhe fidanëve të certifikuar që ju mundësojnë fermerëve prodhimin e fruta perimeve dhe rrushit cilësor që mund të konkurrojnë në tregun Shqiptar dhe që përmbushin standardet e BE-së, e në veçanti ato në lidhje me ruajtjen dhe përdorimin e kimikateve për mbrojtjen e bimëve dhe plehrave të ndryshme, si dhe me ato të lidhura me nivelin e mbetjeve kimike;
  - Reduktimi i ruajtjes pas vjeljes përmes investimeve në nivel ferme në teknologji dhe infrastrukturën e ruajtjes dhe pajisjeve të pas vjeljes, përfshirë kapacitete frigoriferike, dhe linja seleksionimi e paketimi.

#### **8.2.1.5. Lidhja me masat e tjera të programit IPARD**

Kjo masë lidhet me masën "Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe atyre të peshkimit". Masa do të mbështesë investimet në fermat rentabël bujqësore, gjë që do të çojë në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore të lëndës së parë të nevojshme për industrinë përpunuese si dhe për përafrimin e zinxhirit ushqimor me standardet e BE-së.

#### **8.2.1.6. Lidhja me skemat kombëtare**

Skemat kombëtare sigurojnë mbështetje në formën e investimeve për sektorët/investimet që nuk mbështeten nga IPARD, por që janë me rëndësi për modernizimin e bujqësisë dhe për fermat e vogla në mënyrë që të ristrukturohen dhe të arrijnë të jenë rentabël (shiko Pjesën 10.3).

#### **8.2.1.7. Marrësit e mbështetjes**

Marrësit e mbështetjes nga kjo masë janë fermerët individualë, personat fizikë apo juridikë dhe të tjera subjekte bujqësore, të përfshirë në regjistrin kombëtar të fermave.

Marrësit e mbështetjes kanë përgjegjësinë për të financuar dhe zbatuar investimet.

#### **8.2.1.8. Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë**

- Projekti investimit duhet të lidhet me prodhimin e produkteve parësore bujqësore nga sektorët e përzgjedhur – si qumështi, mishi, fruta-perimet, rrushi, të renditura në Aneksin I të Traktatit të BE-së.
- Në fund të investimit, *e gjithë ferma bujqësore* duhet të përmbushë standardet minimale kombëtare në fuqinë lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve. Marrësi i mbështetjes duhet të dorëzojë së bashku me kërkesën përfundimtare për pagesë një

certifikatë nga shërbimi veterinar dhe autoritetet mjedisore ku vërtetohet se ferma e marrësit të mbështetjes përmbush të gjitha standardet përkatëse minimale kombëtare. Në rastin kur standardet minimale kombëtare janë të përafërta me ato të BE-së, sa herë që është e justifikueshme, nga Komisioni mund të miratohet një përjashtim nga ky rregull.

- Investimi i përfunduar duhet të përmbushi standardet përkatëse të BE-së në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve.
- Marrësi i mbështetjes, në rastet kur është fermer individual ose person fizik ose punonjësi në nivel menaxherial apo përfaqësuesi ligjor në rastet e personave juridik, duhet të ketë diplomë universitare apo arsimit profesional në një fushë të lidhur me bujqësinë (agronomi ose veterinari, ekonomi bujqësore) ose të paktën 3 vite përvojë pune në bujqësi;
- Aplikantët duhet të paraqesin një projekt propozim teknik ose plan biznesi përmes së cilit vërtetohet rentabiliteti ekonomik i projektit të investimit në përfundim të tij (shiko Aneksin 2);
- Aplikanti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e lidhura me pagesën e taksave, përfshirë taksën e tokës, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk duhet të jetë në listën e borxhit të AZHBR-së.
- Masa mbështet vetëm investimet e lidhura me prodhimin e energjisë së rinovueshme (në nivel ferme) për konsum në fermë.
- Për investimet në sistemet e ujitjes në nivel ferme aplikanti duhet të jetë mbajtës i licencës, autorizimit, ose koncesionit të për përdorimin e ujit në përputhje me ligjin Shqiptar në fuqi për 'Burimet Ujore' përpara dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- Materiali shumëzuesi fruta-perimeve dhe/ose farat/fidanët duhet të jenë të certifikuara në përputhje me legjislacionin Shqiptar përkatës në fuqi.
- Një aplikant nuk mund të dorëzojë një aplikim të rinë të njëjtën masë përpara marrjes së pagesës përfundimtare mbi bazën e një kontrate granti ekzistuese.

#### **8.2.1.9. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë (sipas sektorëve)**

Në përfundim të investimit (përpara marrjes së pagesës përfundimtare) ferma bujqësore e marrësit të mbështetjes duhet të ketë madhësinë e mëposhtme përkatëse:

##### **Spektori qumështit:**

- të paktën 10 lopë të regjistruara në regjistrin e kafshëve;
- të paktën 100 dele dhe/ose dhi të regjistruara në regjistrin e kafshëve.

##### **Spektori i mishit:**

- 10 gjedhë të regjistruar në regjistrin e kafshëve;
- 100 dele dhe/ose dhi të regjistruara në regjistrin e kafshëve;
- 1,000 shpendë (broilera dhe pula pjellëse).

##### **Spektori i fruta-perimeve në fushë të hapur**

- të paktën 0.5 ha tokë e kultivuar me perime ose të paktën 0.5 ha tokë të kultivuar me fruta në një ose disa parcela me mundësinë e qarkullimit në fermë.

##### **Për bimët e mbrojtura**

- të paktën 0.2 ha në ambiente të mbrojtura në formës e serave (plastmasë, xham) ose tuneleve.

### **Vreshta**

- të paktën 0.5 ha vreshta.

#### **8.2.1.10. Shpenzimet e pranueshme**

Shpenzimet e pranueshme kufizohen në shpenzimet e lidhura me investimet në aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale të përshkruara në Pjesën 8.1.3 pika 1. Investimet e pranueshme për tu mbështetur duhet të përmbushin të gjitha përcaktimet në Pjesën 8.1.3.

#### **Shembuj të tipeve të pranueshme të investimeve**

##### **Sektori i qumështit dhe mishit**

- Pajisje mjeljeje, ambiente ruajtje dhe frigoriferike;
- Ndërtimi dhe/ ose rindërtimi përshirë instalimin e ambienteve të parafabrikuara për strehimin e kafshëve, hangarëve magazinuese ose atyre për makineritë;
- Përgatitja, manovrimi, sistemi i shpërndarjes dhe mjedise për ruajtjen në nivel ferme të ushqimit të kafshëve;
- Përgatitja, manovrimi, dhe mjedise ruajtje në nivel ferme të silazhit;
- Mjedise për depozitimin e plehut dhe mbetjeve, mjedise për largimin/trajtimin e plehut;
- Gardhe dhe porta, gardhe për mbrojtjen e ushqimit, elementet mbajtës-lidhës të gardhit (shtylla, bandiera etje), sistemi i peshimit të kafshëve, njësitë e dezinfektimit, platformë për ngarkim, gardhe (me materiale te lehta) për rregullimin/orientimin e lëvizjes së kafshëve në fermë (rrugë-kalime), stativë për matrikullimin me djegie të kafshëve dhe bërjen e injeksioneve;
- Sisteme për ujëpirjen e kafshëve;
- Teknologji të energjisë së rinovueshme (si panele diellore ose teknologji të tjera, me përjashtim të sistemeve me bio-gaz për ngrohje, ventilim, gardhet elektrike ose pompa uji vetëm për përdorim në nivel ferme);
- Pajisje dhe programe kompjuterike (hardëare dhe softëare) për menaxhimin e tufës, regjistrin të qumështit dhe menaxhimin e përgjithshëm të fermës.

Për nën-sektorin e pulave pjellëse – të pranueshme janë vetëm mjediset për depozitimin e plehut dhe mbetjeve, mjediset për manovrimin/largimin dhe trajtimin e plehut.

##### **Sektori frutave, perimeve dhe vreshtave**

- Investime për krijimin ose ristrukturimin (rehabilitimin) pemëtoreve dhe vreshtave ekzistuese, përfshirë kostot e materialist shumëzues të certifikuar; mbjelljen, krasitjen, thurjen e tyre dhe shërbime të tjera të kryera nga një palë e tretë, me përjashtim të plehërimit të tokës;
- Blerja e sistemeve të reja ose modernizimi i atyre ekzistuese të ujitjes më pika, dhe shi-hedhje në ferma si dhe shërbimeve për hapjen e puseve, në rastin kur ujitja primare nuk është e disponueshme;
- Blerja e makinerive apo pajisjeve të specializuara për hortikulturën (të tilla si traktorë ose kultivatorë të specializuar, pompave spërkatëse, lesave, rimorkiove ose pajisjeve të tjera të specializuara);

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i serave/tuneleve, përfshirë instalimet e teknologjive për energjinë e rinovueshme për ngrohje dhe sistemet e ujitjes;
- Investime në pajisje dhe mjedise të specializuara për vjeljen dhe pas vjeljen në nivel ferme (të tilla si: mjedise për ruajtjen e përkohshme, mjete ose pajisje për para-ftohjen, pastrimin, seleksionimin, kalibrimin, linja paketimi, njësi dhe mjedise frigoriferike, dhe ambienteve për ruajtjen e patates në kushte natyrale);
- Prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë vetëm për konsum në nivel ferme për: ngrohje, ftohje, ventilim, pompa uji/ujtjeje (të tilla si: panele diellore ose teknologji të tjera me përjashtim të impianteve me bio-gaz).

Shpenzimet e pranueshme sipas sektorëve do të detajohen më tej në 'listën e shpenzimeve të pranueshme'.

#### **8.2.1.11. Përqindja e mbështetjes publike dhe e kontributit të BE-së**

Minimumi i totalit të kostove të pranueshme të investimit për projekt është 25,000 EURO ndërsa maksimumi 500,000. EURO. Një aplikant mund të paraqesë më shumë se një projekt, por totali i vlerës së investimit për aplikant, për këtë masë, nuk duhet të kalojë vlerën prej 1,500,000 EURO për të gjithë kohë zgjatjen e periudhës së programit.

Përqindja e mbështetjes publike është e barabartë me:

- deri në 60% të totalit të kostove të pranueshme të investimit;
- deri në 65% në investimi bëhet nga një fermer i ri (nën 40 vjeç në datën e marrjes së vendimit për dhënien e mbështetjes);
- deri në 70% për investimet në zona malore (shiko listën e zonave malore në Aneksin 4).

Përqindja e mbështetjes publike mund të rritet me 10% në rastin e investimeve për depozitimin e lëngshëm të plehut të cilat mbrojnë mjedisin.

Përqindja e kontributit të BE-së është e barabartë me 75 % të totalit të mbështetjes publike.

#### **8.2.1.12. Kriteret e përzgjedhjes**

Kriteret		Pikët
1	Investimi është kryer në një nga zonat malore të renditura në Aneksin 4	15
2	Investim për depozitimin, trajtimin, dhe/ ose manovrimin/largimin e plehut	15
3	Investime në prodhimin e energjisë së rinovueshme	15
4	Ferma bujqësore e aplikantit është e certifikuar për prodhime organike ose në proces shndërrimi në përputhje me ligjin në fuqi për bujqësinë organike	15
5	Aplikanti është shoqëri bashkëpunimi bujqësore themeluar në bazë të ligjit nr. 38 datë 05.04.2012	15
6	Aplikanti është fermer i ri (nën 40 vjeç në momentin e dorëzimit të aplikimit)	15
7	Aplikanti është femër	10
<b>Totali (maksimumi)</b>		<b>100</b>

**8.2.1.13. Indikatorët dhe objektivat**

Treguesit	Objektivat 2020
Numri i projekteve të mbështetura	430
Numri fermave investimet e të cilave janë bërë për modernizimin e tyre	430
Numri i fermave që janë përafuar gradualisht me standardet e BE-së si pasojë e investimit	300
Numri i fermave investimi i të cilave është në lidhje me prodhimin e energjisë së rinovueshme	20
Numri i fermave investimi i të cilave është në lidhje me menaxhimin e bagëtive me qëllim reduktimin e imisioneve të N20 dhe të metanit (depozitim plehu)	40
Totali i vlerës së investimeve në aktive afatgjata në fermat e mbështetura (EURO)	52,000,000

**8.2.1.14. Procedura administrative**

Përzgjedhja e projekteve bëhet në përputhje me procedurën administrative të përshkruar në Seksionin 8.1.6.

**8.2.1.15. Shtrirja gjeografike e masës**

Masa zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

**8.2.1.16. Informacione të tjera në lidhje me masën**

N/A

**8.2.1.17. Buxheti paraprak i masës**

Viti	Totali i kostove të pranueshme	Mbështetja publike						Kontributi privat	
		Totali		Kontributi BE-së		Kontributi Kombëtar		(EURO)	(%)
(EURO)	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)	(EURO)		
2014	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2015	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2016	10,729,167	6,866,667	100%	5,150,000	75%	1,716,667	25%	3,862,500	36%
2017	11,833,333	7,573,333	100%	5,680,000	75%	1,893,333	25%	4,260,000	36%
2018	11,270,833	7,213,333	100%	5,410,000	75%	1,803,333	25%	4,057,500	36%
2019	14,729,167	9,426,667	100%	7,070,000	75%	2,356,667	25%	5,302,500	36%
2020	16,854,167	10,786,667	100%	8,090,000	75%	2,696,667	25%	6,067,500	36%
<b>Totali</b>	<b>65,416,667</b>	<b>41,866,667</b>	<b>100%</b>	<b>31,400,000</b>	<b>75%</b>	<b>10,466,667</b>	<b>25%</b>	<b>23,550,000</b>	<b>36%</b>

## **8.2.2 Masa ‘Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit’**

### **8.2.2.1. Titulli i Masës**

#### **‘Investime në aktive afatgjata për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit’**

### **8.2.2.2. Baza Ligjore**

- Neni 2 (1) i Rregullores IPA (EU) Nr. 236/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 Mars 2014 e cila përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e veprimeve të jashtme;
- Neni 27 (1) (3) i Marrëveshjes Sektoriale;
- Aneksi 4 i Marrëveshjes Sektoriale.

### **8.2.2.3 Përshkrim i Përgjithshëm**

Për të konkuruar me sukses në një treg gjithnjë e më të hapur, industria e përpunimit të ushqimit kë nevojë për modernizimin e teknologjisë dhe përmirësimit të sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore. Industria e ushqimore duhet të adoptojë praktikrat që mundësojnë grumbullimin e sigurt, transportin dhe ruajtjen e lëndës së parë në mënyrë që të zvogëlojë mbetjet dhe të garantojë sigurinë ushqimore.

Sektori i përpunimit të *qumështit dhe nën produkteve të tij* ka nevojë për investime domethënëse me qëllim modernizimin e teknologjive, përmirësimin e cilësisë dhe përmbushjes së standardeve të BE-së. Mbyllja e zinxhirit ftohës nga prodhuesi tek konsumatori vazhdon të jetë në nivele shumë të ulta. Mungojnë qendrat e grumbullimit të qumështit dhe mjetet e përshtatshme motorike për transportin frigoriferik të qumështit. Në përgjithësi, standardet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore të BE-së pothuajse nuk janë ekzistuese dhe ngarkesa mikrobiologjike e qumështit të papërpunuar rrallë kontrollohet. Është e nevojshme që kjo situatë të ndryshojë përmes investimeve në pajisje për marrjen e mostrave të qumështit nga ana e përpunuesve, çfarë do ti nxiste ata në marrjen e mostrave të qumështit dhe zbatimin të sistemeve të kontrollit të cilësisë. Këto investime janë të nevojshme për të diversifikuar dhe përmirësuar cilësinë dhe sigurinë si dhe për reduktimin e kostove. Është e nevojshme që industria ushqimore të mbështetet me qëllim përmirësimin e praktikave të menaxhimit të mbetjeve.

Për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe praktikrat e mbrojtjes së mjedisit të *sektorit të përpunimit të mishit* është e nevojshme që të jepet nxitje përmes mbështetjes së investimeve që përmbushin standardet e BE-së dhe përmirësojnë menaxhimin e mbetjeve dhe përpunimin e nën-produkteve. Vazhdon të jetë i nevojshëm modernizimi i *Thertoreve* dhe përmbushja e standardeve të mirëqenies së kafshëve dhe sigurisë ushqimore. Shqipërisë i mungojnë stabilimentet për përpunimin e mbetjeve të thertoreve, gjë që përbën një rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve dhe është pengesë për zbatimin e standardeve të BE-së për mbledhjen dhe trajtimin e nën-produkteve shtazore.

Masa ka në objektivin e saj të gjitha stabilimentet e *përpunimit të fruta-perimeve* dhe synon rritjen e investimeve për përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore dhe reduktimin e humbjeve gjatë procesit të përpunimit. Futja në përdorim i sistemeve të sigurisë ushqimore kërkon kryerjen e investimeve për modernizimin e teknologjisë dhe përmirësimin e kushteve të prodhimit në këto stabilimente si dhe blerjen e pajisjeve dhe sistemeve IT për kontrollin e cilësisë. Një rëndësi të veçantë për garantimin e cilësisë në zinxhirin e vlerës së perimeve kanë edhe ambientet e përshtatshme për ruajtjen pas-vjeljes si dhe ambientet e ruajtjes së zinxhirit frigoriferik. Për këtë

arsye, përmes kësaj mase do të mbështetet përmirësimi trajtimit dhe ruajtjes pas-vjeljes dhe paketimi.

*Spektori i verës* në Shqipëri mund të përfitojë nga mundësi të që vijnë si rezultati rritjes së kërkesës vendase për verëra cilësore, me kusht që të jepet mbështetje për kryerjen e investimeve në përmirësimin e cilësisë, modernizimin e teknologjive, modernizimin e pajisjeve, veçanërisht tankerave ruajtës dhe fermentues pajisjeve laboratorike dhe prodhimi i verërave cilësore bazuar në varietetet lokale/autoktone të rrushit.

Kjo masë u jep përparësi investimeve në ngritjen e sistemeve të sigurisë ushqimore, të cilat janë të një rëndësie jetike për sa i përket furnizimit të tregut vendas me produkte të sigurta ushqimore dhe konkurrueshmërinë në tregjet vendase dhe ato të huaja. Për të nxitur industrinë përpunuese drejt përbushjes së standardeve mjedisore, në këtë masë përparësi do ti jepet investimeve që synojnë trajtimin e mbetjeve, pastrimin e ujit dhe përdorimin e produkteve nga mbetjet, si dhe zgjidhje të ndryshme lidhur energjinë e rinovueshme dhe përdorimit me efikasitet të produkteve.

#### **8.2.2.4. Objektivat e përgjithshme dhe të veçanta**

*Objektivat e përgjithshme* të masës janë:

- Rritja e aftësisë së sektorit agro-ushqimor për tu përballur me konkurrencën dhe faktorët e tregut dhe dhënia e ndihmesës për këtë sektor në mënyrë që gradualisht të përafrohet me standardet e BE-së përmes mbështetjes së rritjes së aktiveve afatgjata;
- Adresimi i sfidave të ndryshmeve klimaterike përmes promovimit të përdorimit me efikasitet të burimeve dhe energjisë së rinovueshme.

*Objektivat e veçanta* të masës janë:

- Modernizimi i aktiveve afatgjata të sektorëve prioritarë të përzgjedhur të përpunimit ushqimor me synim përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe përafrimin gradual me standardet e BE-së në fushat e mbrojtjes mjedisore, sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mirëqenies së kafshëve, dhe mbrojtjes në mjediset e punës;
- Nxitja e investimeve në stabilimentet e përpunimit të qumështit, mishit, frutave-perimeve dhe verës me synim:
  - Përmirësimin e higjienës së qumështit në pikat e grumbullimit përmes mbështetjes së investimeve në tankerat ftohës të qumështit dhe mjeteve të specializuara për transportin e qumështit;
  - Nxitja e futjes në përdorim dhe përmirësimin e teknologjive dhe praktikave në stabilimentet e përpunimit ushqimor, duke kontribuar në këtë mënyrë në prodhimin e produkteve që gradualisht përbushin standardet e BE-së dhe që përmirësojnë konkurrueshmërisë;
  - Nxitjen e investimeve në thertore, të cilat përbushin standardet e BE-së;
  - Nxitjen e investimeve në stabilimentet e përpunimit të mbetjeve të thertoreve në vend, të cilat përbushin standardet e BE-së;
  - Reduktimi i humbjeve pas vjeljes dhe përmirësimi i teknikave dhe kapaciteteve të ruajtjes së fruta-perimeve, dhe rrushit;
  - Dhënia e mbështetjes për futjen në përdorim dhe përmirësimin e sistemeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore;
  - Përmirësimi i trajtimit dhe manovrimit/largimit të mbetjeve dhe përdorimit nën-produkteve.



#### **8.2.2.5. Lidhja me masat e tjera të programit IPARD**

Masa synon mbështetjen e investimeve në qumësht dhe bulmet, thertoret dhe përpunimin e mishit, fruta-perimeve dhe përpunimit të verës. ajo është hartuar që të plotësojë ndërhyrjet në masën 'Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore', me qëllim rritjen e furnizimit me prodhime bujqësore të sigurta dhe që mbrojnë mjedisin.

#### **8.2.2.6. Lidhja me skemat kombëtare**

Zbatimi kësaj mase mbështetet nga skemat kombëtare që synojnë përmirësimin e aftësisë huamarrëse të industrisë ushqimore.

Pas fillimit të zbatimit të programit, skemat kombëtare të mbështetjes së investimeve nuk duhet të mbivendosen me sektorët dhe investimet e pranueshme të kësaj mase. Informacione të tjera mbi bashkëveprimin (komplementaritetin) dhe demarkacionin mes tyre jepet në Pjesën 10.3.

#### **8.2.2.7. Marrësit e mbështetjes**

Marrësit e mbështetjes janë stabilimentet e përpunimit ushqimor të cilët kanë përgjegjësinë për kryerjen e investimit në stabilimentin e tyre ushqimor, të cilat kanë të punësuar më pak se 250 persona xhiroja vjetore e të cilave nuk e kalon vlerën 50 milion EURO, dhe/ose me një bilanc vjetor totali i të cilit nuk e kalon vlerën 43 milion EURO, që korrespondon me përshkrimin e SME-ve të dhënë në Aneksin 1, të cilat janë:

- Persona juridik ose fizik, me jo më shumë se 25% të kapitalit të tyre në pronësi publike ose Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor, të cilat janë,
- Themeluar, regjistruara në QKR dhe, sipas rastit të licensuara nga QKL, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për aktivitetin e pranueshëm të përpunimit të (investimet e pranueshme) kësaj mase.

#### **8.2.2.8. Kriteret të përgjithshme të pranueshmërisë**

- *I gjithë stabilimenti* duhet të përmbushi standardet përkatëse minimale kryesore kombëtare në fuqinë lidhje me mbrojtjen e mjedisit, shëndetit publik, mirëqenies së kafshëve, dhe mbrojtjes në mjediset e punës, jo më vonë se në fund të projektit të investimit (përpara marrjes së pagesës përfundimtare).
- Përpara dorëzimit të aplikimit në Agjencinë IPARD, çdo projekt analizohet nga autoritetet përkatëse kombëtare për të kuptuar mundësinë që stabilimenti i marrësit të mbështetjes ka për të përmbushur standardet kryesore minimale kombëtares në përfundim të projektit të investimit.
- Investimet e mbështetura duhet të jenë në lidhje me përpunimin dhe/ose tregtimin e produkteve të Aneksit I të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe /ose zhvillimin e produkteve, proceseve dhe teknologjive të reja të lidhura me produktet pjesë të Aneksit I të TFBE-së.
- Marrësi i mbështetjes duhet të dorëzojë së bashku me kërkesën përfundimtare për pagesë një vërtetim nga autoritetet përkatëse ku të konfirmohet se *stabilimenti* përmbush standardet minimale kombëtare përkatëse dhe se *investimi* përmbush standardet përkatëse të BE-së.
- Marrësi i mbështetjes, përfaqësuesi i tij ligjor ose punonjësi në nivel menaxheria duhet të kenë diplomë universiteti ose diplomë arsimit profesional në njërin nga fushat si: inxhinieri, kimi ushqimore, teknologji ushqimore, ekonomik/juridik ose të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e përpunimit.
- Aplikantët duhet të paraqesin një plan biznesi cili demonstroi rentabilitetin ekonomik (në përputhje me Aneksin 2) të projektit në përfundim të investimit.

- Aplikantët duhet të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre për sa i përket pagesës së taksave, përfshirë taksën e tokës, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk duhet të jenë në listën e borxhit të AZHBR-së.
- Një aplikant nuk mund të paraqesë një aplikim të ri në këtë masë përpara marrjes së pagesës përfundimtare në bazën e një kontrate granti të mëparshme.

#### **8.2.2.9. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë (sipas sektorëve)**

Kjo masë mbështet vetëm investimet në teknologjitë e energjisë së rinovueshme për përdorim brenda stabilimenteve.

Në fund të investimit, i gjithë stabilimenti i përpunimit të mishit dhe ato të përpunimit të mbetjeve të thertoreve duhet të përmbushin standardet e BE-së.

#### **8.2.2.10. Shpenzimet e pranueshme**

Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara në ato shpenzime që lidhen me investime në aktive afatgjata materiale he jo-materiale të përshkruar në Pjesën 8.1.3 pika 1. Për të qenë të pranueshëm për tu mbështetur investimet duhet të përmbushin të gjitha përcaktimet e Pjesës 8.1.3.

### **Shembuj të tipeve të investimeve të pranueshme**

#### **Grumbullimi dhe ruajtja e qumështit**

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i pikave të grumbullimit të qumështit;
- Tankera dhe pajisje ftohëse për qumështin, mjeteve të specializuara për transportin e qumështit;
- Pajisje përgatitjen e produkteve të ndërmjetme ose përfundimtare të qumështit për konsum;
- Pajisje dhe teknologji për përmirësimin dhe kontrollin e cilësisë dhe higjienës së qumështit të papërpunuar;
- Investime për futjen në përdorim dhe/ose përmirësimin e sistemeve të sigurisë ushqimore;
- Pajisje dhe programe kompjuterike (hardëare dhe softëare) për regjistrin dhe monitorimin e qumështit, kontrollin dhe menaxhimin.

#### **Përpunimi qumështit**

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i stabilimenteve të përpunimit të qumështit;
- Investime në homogjenizimin, sterilizimin, pasterizimin, paketimin, ftohjen, si dhe ruajtjen e qumështit dhe produkteve të përpunimit të qumështit;
- Pajisje dhe teknologji për përmirësimin dhe kontrollin e cilësisë dhe higjienës së produkteve;
- Futja në përdorim dhe/ose përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë;
- Pajisjeve për kontrollin e cilësisë, përfshirë laboratorët brenda stabilimenteve;
- Investime për futjen në përdorim dhe/ose përmirësimin e sistemeve të sigurisë ushqimore;
- Investime në teknologji për kursimin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Mjedise dhe pajisje për përpunimin e produkteve të ndërmjetme dhe mbetjeve; trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve;
- Pajisje kompjuterike (hardëare dhe softëare) për menaxhimin e produkteve dhe proceseve (regjistrimi i qumështit, menaxhimin e përgjithshëm të stabilimentit).

*Thertoret:*

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i thertoreve;
- Pajisje për thertoret;
- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i dhomave frigoriferike, mjediseve të ruajtjes, mjediseve për ruajtjen në akull/ ngrirje si dhe mjediset për larjen e konteniervë;
- Kamionë frigoriferikë të specializuar për transportin e mishit;
- Pajisje për trajtimin e mbetjeve dhe nën-produkteve;
- Investime për futjen në përdorim dhe/ose përmirësimin e sistemeve të sigurisë ushqimore;
- Investime për futjen në përdorim dhe/ose përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë;
- Pajisje kompjuterike (hardëare dhe softëare) për monitorim, kontroll dhe menaxhim.

*Stabilimentet e përpunimit të mbetjeve të thertoreve (rendering plants):*

- Ndërtimi i kapaciteteve të reja përfshirë pajisje të cilat përmbushin plotësisht standardet përkatëse të BE-së.

*Stabilimentet e përpunimit të mishit:*

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i stabilimenteve të përpunimit të mishit;
- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi dhe pajisje për mjedise të ruajtjes frigoriferike;
- Investime për futjen në përdorim dhe/ose përmirësimin e sistemeve të sigurisë ushqimore;
- Investimin për rritjen e mbrojtjes mjedisore, impianteve të trajtimit ose pastrimit të ujit, pajisje për trajtimin/eliminimin e mbetjeve, dhe shtimit të vlerës së nën-produkteve.

*Spektori i përpunimit të fruta-perimeve:*

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i stabilimenteve të përpunimit ushqimor;
- Pajisje për konservimin, linja pasterizimi për fruta-perimet, tunele për tharje, etje.;
- Ambienteve dhe pajisjeve për ruajtjen dhe manovrimin pas-vjeljes së lëndës së parë, ruajtjes për paketim;
- Pajisje paketuese/etiketuese, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjelljes, etiketimi dhe pajisje të tjera të specializuara;
- Pajisje të zinxhirit ftohës, përfshirë ruajtjen e ftohtë dhe atë në ngrirje të thellë, tunele për ngrirje, mjete për transportin frigoriferik dhe pajisje të tjera të nevojshme për të garantuar vazhdimësinë e zinxhirit ftohës;
- Ambiente dhe pajisje për kontrollin e cilësisë, përfshirë laboratorët brenda stabilimenteve;
- Futja në përdorim dhe/ ose përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore;
- Investime për mbrojtjen e mjedisit, pajisje për trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve si dhe shtimit të vlerës së nën produkteve;
- Mjete të specializuara motorike frigoriferike ose jo, përfshirë transportin e lëndës së parë dhe produkteve përfundimtare;
- Sisteme kompjuterike përfshirë programe për menaxhimin e produkteve dhe proceseve.

*Sektori i verës:*

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i stabilimenteve të përpunimit;
- Pajisje për pranimin presimin e rrushit, sisteme për ruajtjen dhe bërjen e verës, sisteme për mbushje dhe paketimin;
- Mjedise dhe pajisje për kontrollin e cilësisë, përfshirë laboratorët brenda stabilimenteve;
- Futja në përdorim dhe/ose përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore;
- Investime për rritjen e sigurisë ushqimore, pajisje për trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve dhe shtimit të vlerës së nën-produkteve;
- Teknologjitë e energjisë së rinovueshme për qëllime të kursimit të energjisë;
- Sisteme kompjuterike përfshirë programe për menaxhimin e produkteve dhe proceseve.

Shpenzime të pranueshme do të detajohen më tej në 'listën e shpenzimeve të pranueshme'.

**8.2.2.11. Përqindja e mbështetjes publike dhe e kontributit të BE-së**

Minimum i totalit të kostove të pranueshme të investimit për një projekt është 70,000 EURO ndërsa maksimumi 2,000,000. EURO. Një aplikant mund të paraqesë më shumë se një projekt, por totali i vlerës së investimit për aplikant, për këtë masë, nuk duhet të kalojë vlerën prej 3,000,000 EURO për të gjithë kohëzgjatjen e periudhës së programit.

Përqindja e mbështetjes publike është e barabartë me 50% të totalit të kostove të pranueshme të investimit. Në rastet e investimeve për depozitimin e plehut të lëngshëm të cilat mbrojnë mjedisin mbështetja shkon deri në 60% të totalit të kostove të pranueshme të investimit.

Përqindja e kontributit të BE-së është e barabartë me 75 % të totalit të mbështetjes publike.

**8.2.2.12. Kriteret e përzgjedhjes**

Kriteret		Pikët
1	Investimi ka të bëjë me vendosjen e sistemeve të standardeve të sigurisë ushqimore	30
2	Investimi ka të bëjë me trajtimin e mbetjeve, pastrimin e ujit, dhe/ose përdorimin e produkteve nga mbetjet	30
3	Investimi përfshin teknologjive të energjisë së rinovueshme	20
4	Investimi synon përafrimin e të gjithë stabilimentit me të gjitha standardet përkatëse të BE-së	20
<b>Totali (maksimumi)</b>		<b>100</b>

**8.2.2.13. Treguesit dhe objektivat**

Treguesit	Objektivat 2020
Numri i projekteve të mbështetura	180
Numri i stabilimenteve me projekte modernizimi	180
Numri stabilimenteve duke u përafruar gradualisht me standardet e BE-së	180
Numri i stabilimenteve me investime në prodhimin e energjisë së rinovueshme	15
Totali i investimeve në aktive afatgjata i stabilimenteve të mbështetura (EURO)	71,000,000

Numri i vendeve të punës së hapura (bruto)	600
--	-----

**8.2.2.14. Procedura administrative**

Përzgjedhja e projekteve bëhet në përputhje me procedurën administrative të përkrahur në Pjesën 8.1.6

**8.2.2.15. Shtrirja gjeografike e masës**

Kjo masë zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

**8.2.2.16. Informacione të tjera të veçanta në lidhje me masën**

N/A

**8.2.2.17. Buxheti paraprak i masës**

Viti	Totali i kostove të pranueshme	Mbështetja publike						Kontributi privat	
		Totali		Kontributi BE-së		Kontributi Kombëtar		(EURO)	(%)
	(EURO)	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)		
2014	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2015	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2016	14,133,333	7,066,667	100%	5,300,000	75%	1,766,667	25%	7,066,667	50%
2017	14,853,333	7,426,667	100%	5,570,000	75%	1,856,667	25%	7,426,667	50%
2018	11,760,000	5,880,000	100%	4,410,000	75%	1,470,000	25%	5,880,000	50%
2019	16,213,333	8,106,667	100%	6,080,000	75%	2,026,667	25%	8,106,667	50%
2020	13,706,667	6,853,333	100%	5,140,000	75%	1,713,333	25%	6,853,333	50%
<b>Totali</b>	<b>70,666,667</b>	<b>35,333,333</b>	<b>100%</b>	<b>26,500,000</b>	<b>75%</b>	<b>8,833,333</b>	<b>25%</b>	<b>35,333,333</b>	<b>50%</b>

**8.2.3 Masa ‘Diversifikimi Fermave dhe Zhvillimi Biznesit’****8.2.3.1. Titulli Masës****‘Diversifikimi Fermave dhe Zhvillimi Biznesit’****8.2.3.2. Baza Ligjore**

- Neni 2 (1) i Rregullores IPA (EU) Nr. 236/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 Mars 2014 e cila përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e veprimeve të jashtme;
- Neni 27 (1) (7) i Marrëveshjes Sektoriale;
- Aneksi 4 i Marrëveshjes Sektoriale.

**8.2.3.3 Përshkrim i përgjithshëm**

Diversifikimi dhe rritja e nivelit të veprimtarisë ekonomike në zonat rurale duhet të inkurajohet në mënyrë që të mbështetet hapja e vendeve të reja të punës dhe ruajtja e atyre ekzistuese si dhe rritja e të ardhurave të popullsisë rurale. Pamjaftueshmëria e burimeve financiare private të fermerëve dhe bizneseve të vogla, fitimet e ulta dhe risku i lartë që shoqëron investimet në zonat rurale kërkojnë orientimin e mbështetjes publike për sa i përket investimeve në aktive afatgjata.

Përmes dhënies së mbështetjes për kryerjen e investimeve në ferma me qëllim angazhimin e plotë dhe të qëndrueshëm të potencialeve të vendit dhe mundësive të ofruara nga tregu për *kultivimin e bimëve medicinale dhe aromatike, kërpudhave, mjaltit, bimëve dekorative dhe kërmijve* mund të

rriten të ardhurat dhe të ruhet punësimi. Zhvillimi i këtyre veprimtarive parësore duhet që të mbështetet gjithashtu përmes nxitjes për të investuar në *përmirësimin e përpunimit dhe tregtimit të këtyre produkteve*, me synimin për të rritur kapacitetet, cilësinë, vlerën e shtuar dhe sigurinë ushqimore.

*Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i drejtpërdrejtë në ferma i produkteve bujqësore* ka një traditë të gjatë dhe produktet lokale janë të mirëpranuara në treg, por është e nevojshme kryerja e investimeve për përmirësimin e standardeve të higjienës dhe sigurisë ushqimore dhe zhvillimi i produkteve cilësore.

ekzistojnë burime të bollshme natyrore për zhvillimin e *akuakulturës* dhe rritjes së kërkesës vendase për produkte peshku. Kapacitetet ekzistuese të fermave të akuakulturës janë të pakta dhe teknologjitë e vjetruara. Zhvillimi i këtij sektori kërkon mbështetjen me investime për futjen në përdorim të teknologjive moderne të akuakulturës dhe modernizimin e aktiveve afatgjata, përfshirë ambientet e infrastrukturës dhe tregtimit që përmbushin standardet kombëtare dhe ato të BE-së. Zhvillimi i këtij sektori mund të gjenerojë vende pune dhe të ardhura shtesë në zonat rurale si dhe të mbështet si furnizimin me peshk të kultivuar të tregut vendas dhe të industrisë së turizmit.

Diversiteti natyrës, peizazhi, kultura dhe historia përbëjnë një potencial të mirë për zhvillimin e *turizmit rural dhe atij të natyrës*, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga rritja e fluksit të turistëve në Shqipëri, rritja e kërkesave për turizëm dhe shërbime argëtimi alternative si e klientëve vendas ashtu edhe atyre të huaj. Turizmi rural mund të krijojë ose ruajë vende pune që kërkojnë nivele të ndryshme aftësish si edhe të përmirësojë kushtet e jetës në zonat rurale. Kjo masë do të mbështesë investimet në ngritjen e ambienteve akomoduese, shërbimeve dhe tërheqjeve turistike të cilat përmbushin përparësitë e përcaktuara nga Strategjia Kombëtare e Turizmit 2014-2020.

Është i nevojshëm përmirësimi i ofrimit dhe cilësisë së shërbimeve *për popullsinë dhe biznesit rurale* në mënyrë që të frenohet tendenca e braktisjes së zonave rurale. Kjo masë do të ofrojë mbështetje për rritjen e ofertës nga sektori privat me shërbime sociale dhe të kujdesit parashkollor të fëmijëve si edhe shërbime IT-je dhe të tjera shërbime të ngjashme për biznesin.

Kjo masë do të mbështesë gjithashtu zhvillimin e *artizanatit tradicional si dhe industrinë e prodhimit në shkallë të vogël*, si p.sh. tekstilet, përpunimin e drurit, të cilat ofrojnë potenciale për krijimin e vendeve të punës në zonat rurale.

Shqipëria ka potenciale të konsiderueshme për *prodhimin e energjisë së rinovueshme* (diellore, nga era, biomasa apo të tjera). Kjo masë do të sigurojë mbështetje për rritjen e prodhimit të energjisë, gjë që do të kontribuojë në diversifikimin e ekonomisë rurale si dhe në zvogëlimin e pasojave të ndryshimeve klimaterike dhe përshtatjen me këto ndryshime.

Gjatë përzgjedhjes së projekteve, përparësi do tu jepet projekteve që krijojnë vende të reja pune në zonat rurale. Në përputhje me rezultate të pritshme të përcaktuara në Dokumentin Strategjik, përparësi do ti jepet promovimit të sipërmarrjeve të grave dhe të rinjve, me qëllim shfrytëzimin e mundësive që ofron përqindja e lartë e popullsisë me moshë të re në Shqipëri dhe motivimi që ajo ka për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe nivelin e të ardhurave. Masa do të promovojë gjithashtu bashkë-punimin mes fermerëve dhe investimet në zonat malore përmes dhënies së përparësisë gjatë përzgjedhjes së projekteve. Përparësi do tu jepet gjithashtu investimeve në prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe atij organike, duke promovuar kështu ruajtjen e mjedisit dhe biodiversitetit si dhe zvogëlimin e pasojave të ndryshimeve klimaterike dhe përshtatjen me këto ndryshime.

#### **8.2.3.4. Objektiva të përgjithshme dhe të veçanta**

*Objektivat e përgjithshme* të masës janë nxitja e punësimit përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mbajtjes së atyre ekzistuese duke zhvilluar veprimtari biznesi, duke rritur në këtë mënyrë nivelin e veprimtarive ekonomike të zonave rurale, duke rritur drejtë për së drejti të ardhurat e familjeve fermere dhe shmangur braktisjen e zonave rurale duke kontribuar në një balancë më të mirë territoriale, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social.

*Objektivat e veçanta të masës janë* nxitja e krijimit, diversifikimit dhe zhvillimit të veprimtarive rurale përmes mbështetjes së investimeve në diversifikimin e fermave dhe zhvillimi e veprimtarive jo-bujqësore në sektorët e mëposhtëm:

1. Prodhimi i bimëve medicinale aromatike, kërpudhave, mjaltit, bimëve dekorative dhe kërmijve;
2. Përpunimi dhe tregtimi i bimëve medicinale dhe aromatike të egra dhe të kultivuara, kërpudhave dhe mjaltit;
3. Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore;
4. Akuakultura;
5. Turizmi i natyrës dhe ai rural;
6. Shërbime për popullsinë dhe bizneset rurale;
7. Industria e artizanatit dhe punishtet e prodhimit;
8. Prodhimi dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme.

#### **8.2.3.5. Lidhja me masat e tjera të programit IPARD**

Kjo masë kontribuon në drejtim të masës "Investime në aktive afatgjata në fermat bujqësore" duke mbështetur veprimtari shtesë të cilat gjenerojnë të ardhura për fermerët dhe në këtë mënyrë rentabilitetin në ferma.

Ajo kontribuon gjithashtu në drejtim të objektivave të masës "investime në aktive afatgjata lidhur me përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore dhe të peshkimit" përmes mbështetjes së investimeve në nivel ferme për përpunimin e produkteve bujqësore. Vija e demarkacionit përcaktohet nga lloji i marrësit të mbështetjes: vetëm fermerët janë të pranueshëm për të marrë mbështetje sipas nën-masës së përpunimit në nivel ferme të produkteve bujqësore.

#### **8.2.3.6. Lidhja me skemat kombëtare**

Pas fillimit të zbatimit të programit, skemat e investimeve kombëtare për sektorin agro ushqimor do të rikonceptohen për të shmangur mbivendosje me investimet e pranueshme të kësaj mase. Në rastin kur skemat kombëtare do të parashikojnë ndërhyrje edhe në sektorët jo-bujqësorë, ndërhyrjet e tyre nuk duhet të krijojnë mbivendosje me masat e IPARD, por vetëm plotësim përmes efektit të sinergjisë.

Një informacion më i plotë lidhur me bashkëveprimin (komplementaritet) dhe demarkimin jepet në Pjesën 10.3.

#### **8.2.3.7. Marrësit e mbështetjes**

Marrësit e mbështetjes janë:

- i) Fermerët qofshin individë, persona fizikë apo persona juridike si dhe subjekte të tjera në fushën e bujqësisë të përfshira në regjistrin kombëtar të fermerëve, si dhe Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- ii) Mikrosipërmarrjet dhe sipërmarrjet e vogla private jo-bujqësore;

- Sipërmarrjet private, të themeluara dhe/ ose që kryejnë veprimtarinë e tyre në zonat rurale, të regjistruara si persona fizikë ose juridik, janë të pranueshme për të gjithë sektorët me përjashtim të sektorit "Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i produkteve bujqësore";
- Vetëm fermerët janë të pranueshëm për tu mbështetur sipas nën-masës "Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i produkteve bujqësore";

Subjektet që janë të vendosura jashtë zonave rurale, gjithashtu mund të jenë të pranueshëm, nëse investimet për të cilat kërkohet mbështetje do të kryhen në zonat rurale.

Marrësit e mbështetjes kanë përgjegjësinë e zbatimit dhe të financimit të investimit.

#### **8.2.3.8. Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë**

- Të gjithë projektet e mbështetura duhet të përmbushin standardet minimale përkatëse kombëtare maksimumi deri në përfundimin e investimit.
- Aplikanti duhet të ketë aftësitë përkatëse profesionale, në rastin kur ato përcaktohen në legjislacionin përkatës.
- Aplikanti duhet të paraqesë një projekt propozimi teknik ose plan biznesi që vërteton rentabilitetin ekonomik (sipas përkufizimit të Aneksit 2) të investimit në përfundim të realizimit të investimit.
- Për investime në sistemet e ujitjes në nivel ferme aplikanti duhet të paraqesë licencën, autorizimin, ose koncesionin e përdorimit të ujit në përputhje me ligjin Shqiptar në fuqi për Burimet Ujore përpara dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- Materiali shumëzues i fruta dhe/ ose perimeve dhe/ose farat dhe/ose fidanët duhet të jenë të certifikuar në përputhje me ligjin përkatës në fuqi.
- Investimet në sektorët e mëposhtëm nuk janë të pranueshëm – tregtia me pakicë, me përjashtim të dyqaneve të specializuara në shitjen e сувенире dhe artizanatit tradicional, ose dyqaneve të specializuara për shitjen e prodhimeve bujqësore dhe produkteve nga përpunimi i prodhimeve bujqësore, të cilat janë në pronësi të fermerëve.
- Aplikantët duhet të kenë përmbushur të gjitha detyrimet në lidhje me pagesat e taksave, përfshirë taksën e tokës, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk duhet të jenë në listën e borxhit të AZHBR-së;
- Aplikanti nuk mund të dorëzojë një aplikim të rinë këtë masë përpara marrjes së pagesë përfundimtare në bazë të një kontrate granti të mëparshme.

#### **8.2.3.9. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë**

Për sa i përket përpunimit në nivel ferme të prodhimeve bujqësore, të paktën 30% e lëndës së parë të përpunuar duhet që të jetë e prodhuar nga aplikanti.

Lidhur me sektorin e turizmit të natyrës dhe atij rural, investimet në ambientet e akomodimit kufizohen deri në 10 dhoma për qëllime akomodimi në total.

Investimet për ngritjen e akomodimeve turistike janë të kufizohen në ndërtimin dhe/ose rindërtimin e shtëpive dhe ndërtesave sipas stilit tradicional.

ne rastet e investimeve në impiantet e energjisë së rinovueshme, përmes kësaj mase do të mbështeten vetëm projektet kapaciteti vjetor i prodhimit të cilëve i kalon nevojat vetjake të marrësit të mbështetjes.



#### 8.2.3.10. Shpenzimet e pranueshme

Shpenzimet e pranueshme kufizohen në ato shpenzimet e lidhura me investime në aktive afatgjata materiale dhe jomateriale në përputhje me Pjesën 8.1.3 pika 1. Për të qenë të pranueshëm për tu mbështetur investimet duhet të përmbushin të gjitha parashikimet e përcaktuara në Pjesën 8.1.3.

#### Shembuj të investimeve të pranueshme

1. Prodhimi i bimëve medicinale dhe aromatike, kërpudhave, mjaltit, bimëve dekorativ edhe kërmijve:

- *Bimët medicinale dhe aromatike:* blerja e pajisjeve bujqësore dhe të hortikulturës për kultivimin e bimëve medicinale dhe aromatike, farave dhe fidanëve; mbjellja e bimëve shumëvjeçare, ambienteve dhe pajisjeve për ruajtje/ruajtjen frigoriferike, tharjen dhe tregtimin e bimëve medicinale dhe aromatike;
- *Mjalti:* pajisje për prodhimin, menaxhimin dhe mirë mbajtjes së koshereve të bletëve, ndërtimi i strehëve dhe ndërtesave për ruajtje ose përpunimin e mjaltit dhe nën-produkteve të tjera;
- *Kërpudhat:* ndërtimi dhe/ ose rindërtimi mjediseve të kultivimit të kërpudhave, përfshirë prodhimin e kompostos plehëruese; blerjen e pajisjeve për kultivimin, ruajtjen dhe paketimin.

2. Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi direkt produkteve bujqësore (qumështi, mishi, frutat dhe perimet, ullinjve, verës, etje.):

- Ndërtimi dhe/ ose rindërtimi i ambienteve të përpunimit në nivel ferme dhe pajisjeve për fruta perimet, bulmetit, mishit, vajit të ullirit, verës, mjaltit, etje.);
- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi si dhe blerja e pajisjeve të pikave të shitjes në ferma për tregtimin e drejtpërdrejtë në ferma të prodhimeve bujqësore të fermës.

3. Përpunimi dhe tregtimi bimëve medicinale dhe aromatike të egra apo të kultivuara, kërpudhave dhe mjaltit:

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i qendrave të grumbullimit të bimëve medicinale aromatike dhe kërpudhave;
- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i ambienteve dhe blerja e pajisjeve për ruajtjen/ruajtjen e frigoriferike, tharjen, përpunimin dhe tregtimin e bimëve medicinale dhe aromatike, kërpudhave (makineri tharëse, pajisjeve për seleksionimin, ventilimin si dhe linja të pastrimi primar, pajisje për paketim);
- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i ambienteve dhe blerja e pajisjeve për prodhimin e vajrave esenciale;
- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i ambienteve dhe blerja e pajisjeve për përpunimin dhe paketimin e mjaltit.

4. Akuakultura:

- Krijimi i fermave të reja ose zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të fermave ekzistuese të akuakulturës:
  - Ndërtimi dhe/ose rindërtimi rezervuarve dhe liqeneve të vogla;
  - Pajisje për rritjen e efikasitetit të procesit të prodhimit, optimizimit të ushqyerjes, pajisje për ushqyerjen e peshqve ose pajisje automatike për ushqyerjen e tyre, pajisje për ndërtimin e sistemit të qarkullimit të ujit;
  - Ndërtimi dhe/ose rindërtimi si dhe blerja e pajisjeve për prodhimin e vezëve dhe rasatit të peshkut;

- Pajisje për përmirësimin e kushteve të cilësisë dhe higjienës së prodhimit dhe 'vjeljes' së peshkut;
- Sisteme për menaxhimin e mbetjeve, pajisje për pastrimin e ujërave të dala nga rezervuarët dhe liqenet e vogla si dhe ato për monitorimin e karakteristikave të parametrave të cilësisë së ujit;
- Ngritja e mjediseve të vogla për ruajtjen frigoriferike .

#### 5. Turizmi i natyrës dhe ai rural:

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi, përfshirë shndërrimin e shtëpive tradicionale, i ndërtesave të stilit tradicional për veprimtari turistike – akomodim, katering, çlodhje, etje;
- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i mjediseve dhe blerja e pajisjeve për veprimtari sportive, veprimtari çlodhjeje dhe argëtuese si: kampingje, kasolle, kënde lojërash, hipizëm, peshkim çlodhës/argëtues në ujëra të brendshme, shëtitjeve, rafting, ngjitjeve në mal, ecjes me biçikleta të tipit mountain bike, hangarëve me lodra, etje.

#### 6. Shërbime për popullsinë dhe bizneset rurale:

- Kopshte/çerdhe private fëmijësh, shërbime përkujdesi për të moshuarit dhe personat e paaftë, arsimimi dhe trajnim, qendra shërbimesh në lidhje me teknologjinë e informacionit, etje.;
- Shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeve të makinerive/mekanikës bujqësore, shërbime elektromekanike/elektro-auto, etje.;

#### 7. Punimet e artizanatit dhe punishtet e prodhimit të tilla si:

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i ambienteve dhe blerja e pajisjeve për punimet artizanatit (qilima/sixhade, argjendari, punime druri, punime guri, pëlhurat dekorative, shportave/kanistrave me thupra, kostumeve popullore, statujave të drurit ose alabastrës, mermerit, si dhe veglave muzikore, etje.), përfshirë shërbimet që mundësojnë pjesëmarrjen e klientëve në veprimtari të tillë artizanati;
- Punishtet e prodhimit në shkallë të vogël, të tilla si ato të: tekstileve, përpunimit të drurit, etje.

#### 8. Prodhimi energjisë së rinovueshme:

- Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i impianteve të prodhimit të energjisë së rinovueshme (të tilla si ato me bio-dizel, bio-gaz, ere, fotovoltaike dhe të tjera).

Shpenzimet e pranueshme do të detajohen më tej në 'listën e shpenzimeve të pranueshme'.

#### **8.2.3.11. Përqindja e mbështetjes publike dhe e kontributit të BE-së**

Minimum i totalit të kostove të pranueshme të investimit për një projekt është 10,000 EURO; ndërsa maksimumi 400,000 EURO. EURO. Një aplikant mund të paraqesë më shumë se një projekt, por totali i vlerës së investimit për aplikant, për këtë masë, nuk duhet ta kalojë vlerën prej 600,000 EURO për të gjithë kohëzgjatjes periudhës së programit.

Përqindja e mbështetjes publike është e barabartë me 65% të totalit të kostove të pranueshme të investimit.

Kontributi i BE-së është i barabartë me 75 % të totalit të mbështetjes publike.

**8.2.3.12. Kriteret e mbështetjes**

Kriteret		Pikët
1	Investimi është kryer në një nga zonat malore të renditura në Aneksin 4	15
2	Investime në prodhimin e energjisë së rinovueshme	10
3	Aplikanti (ferma bujqësore) është e certifikuar për prodhim organik ose në proces shndërrimi në përputhje me ligjin në fuqi për bujqësinë organike	15
	Aplikanti është femër ose subjekti cili të paktën 30% të të punësuarve i ka femra	15
5	Aplikanti është fermer i ri (jo më shumë se 40 vjeç në momentin e dorëzimit të aplikimit)	15
6	Në bazë të planit të biznesit projekti parashikon hapjen e vendeve të reja të punës	30
	<b>Totali (maksimumi)</b>	<b>100</b>

**8.2.3.13. Tregues dhe objektiva**

Treguesit	Objektivat 2020
Numri i projekteve të mbështetura	150
Numri i fermave bujqësore/subjekteve të cilët zhvillojnë burime shtesë ose të diversifikuara të ardhurash në zonat rurale	150
Numri i marrësve të mbështetjes me investime në energjinë e rinovueshme	20
Totali i vlerës së investimeve në aktive afatgjata të fermave bujqësore /subjekteve të mbështetura (EURO)	22,500,000
Numri i vendeve të punës së krijuara (bruto)	500

**8.2.3.14. Procedura administrative**

Procedura administrative përshkruhet në Pjesën 8.1.6.

**8.2.3.15. Shtrirja gjeografike e masave**

1. Investimet duhet të zbatohen në zonat rurale, sipas përcaktimeve të Pjesës 8.1 dhe Aneksit 3.

**8.2.3.16. Informacione të tjera të veçanta në lidhje me masat (në përputhje me përkufizimet në fishën e masave)**

N/A

**8.2.3.17. Buxheti paraprak i masës**

Viti	Totali i kostove të pranueshme	Mbështetja publike						Kontributi privat	
		Totali		Kontributi BE-së		Kontributi Kombëtar			
	(EURO)	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)

2014	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2015	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2016	4,512,821	2,933,333	100%	2,200,000	75%	733,333	25%	1,579,487	35%
2017	4,512,821	2,933,333	100%	2,200,000	75%	733,333	25%	1,579,487	35%
2018	3,753,846	2,440,000	100%	1,830,000	75%	610,000	25%	1,313,846	35%
2019	5,128,205	3,333,333	100%	2,500,000	75%	833,333	25%	1,794,872	35%
2020	4,656,410	3,026,667	100%	2,270,000	75%	756,667	25%	1,629,744	35%
<b>Totali</b>	<b>22,564,103</b>	<b>14,666,667</b>	<b>100%</b>	<b>11,000,000</b>	<b>75%</b>	<b>3,666,667</b>	<b>25%</b>	<b>7,897,436</b>	<b>35%</b>

## 8.2.4 Masa ‘Asistencë Teknike’

### 8.2.4.1. Titulli Masës

#### ‘Asistencë Teknike’

### 8.2.4.2. Baza Ligjore

- Neni 2 (1) i Rregullores IPA(EU) Nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 Mars 2014 në të cilën përcaktohen rregullat dhe procedurat e përgjithshme për vënien në zbatim të instrumenteve të Bashkimit për financimin e veprimeve të jashtme;
- Neni 27 (1) (9) i Marrëveshjes Sektoriale;
- Aneksi 4i Marrëveshjes Sektoriale.

### 8.2.4.3 Përmbledhje

Mbështetja sipas kësaj mase është e nevojshme për të garantuar monitorim dhe vlerësim të rregullt dhe efektiv të Programit, përgatitja ose konturimi i zbatimit të masave, duke kontribuar në zbatimin efektiv dhe të pandërprerë të Programit.

Veprimtaritë në kuadër të kësaj mase janë po ashtu të nevojshme për zbatimin dhe monitorimin e veprimeve të lidhura me dhënien e informacionit, publicitetin dhe vizibilitetin.

Veprimtaritë e kësaj mase janë të nevojshme për të mbështetur ngritjen dhe vënien në funksionim të aktivitetit të rrjetit Kombëtar të Zhvillimit Rural dhe përgatitjeve me qëllim zbatimin e qasjes Leader.

### 8.2.4.4. Objektivat e përgjithshëm dhe të veçantë

Qëllimi i kësaj mase dhënia e ndihmës për zbatimin dhe monitorimin e programit si dhe ndryshimeve pasuese të mundshme të tij. Për arritjen e këtij qëllimi, brenda objektivave të kësaj mase përfshihen:

- Dhënia e mbështetjes për monitorimin e programit;
- Garantimi i dhënies së informacionit dhe publicitetit;
- Mbështetja e studimeve, vizitave dhe seminareve;
- Dhënia e mbështetjes për ekspertizë të jashtme;
- Dhënia e mbështetjes për vlerësimin e programit;
- Dhënia e mbështetjes për vënien në funksionim në të ardhmen të rrjetit kombëtar të zhvillimit rural.

### 8.2.4.5. Lidhja me masat e tjera të programit IPARD

Kjo masë siguron mbështetje për vënien në zbatim të të gjitha masave të tjera të Programit përmes planifikimit të veprimtarive për mbështetjen e komunikimit, monitorimit dhe vlerësimit.

#### **8.2.4.6. Lidhja me masat kombëtare**

N/A

#### **8.2.4.7. Marrësi i Mbështetjes**

Marrësi i mbështetjes në kuadër të kësaj mase është Autoriteti Menaxhues.

#### **8.2.4.8. Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë**

Kjo masë mbështet veprimtaritë që janë në përputhje me objektivat e përcaktuara të Asistencës Teknike.

Shpenzimet e pranueshme janë të bazuara në kostot reale, të cilat janë të lidhura me vënien në zbatim të veprimtarive të bashkëfinancuara dhe duhet të jenë të lidhura me pagesat e kryera nga marrësi i mbështetjes, të evidentuara mbi bazën e faturave ose pasqyrave kontabël për këtë qëllim.

Shpenzimet mund të bazohen gjithashtu mbi shuma fikse (flat rate) të tilla si *per diem* në përputhje me kushtet dhe tarifat e aplikuara në rastet e veprimtarive të ngjashme në sektorin publik në Shqipërinë rastet kur nuk ka bashkëfinancim nga BE-ja. Të gjitha shpenzimet për sa i përket ekspertëve dhe pjesëmarrësve të tjerë kufizohen në ato të lidhura me vajte-ardhjen në vendet përfituese si dhe Shtetet Anëtare.

Të gjitha projektet duhet të prokurohen në përputhje me rregullat mbi ndihmën e jashtme të dhënë nga Komisioni sipas përcaktimeve në Rregulloren e Financimit. Për këtë qëllim zbatimi i rregullave PRAG mund të përshtaten në përputhje me veçoritë e vendit.

Në kuadër të kësaj mase, veprimtaritë e financuara apo ato të parashikuara për tu financuar sipas marrëveshjeje twinning apo projekteve të tjera të mbështetura nga komponentët e tjerë të IPA-s nuk janë të pranueshme.

Mbështetja me Asistencë Teknike për ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit është e pranueshme përpara dhënies së besimit për zbatimin e detyrave buxhetore, për shpenzimet e lindura pas datës 1 Janar 2014.

Veprimtaritë dhe shpenzimet e pranueshme raportohen në kontekstin e raportit vjetor.

#### **8.2.4.9. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë (sipas sektorëve)**

N/A

#### **8.2.4.10. Shpenzimet e pranueshme**

Në kuadër të kësaj mase, janë të pranueshme veprimtaritë e mëposhtme me kusht që të jenë të parashikuara nga plani i veprimit paraprak për Asistencë Teknike:

- Shpenzime në kuadër të takimeve të Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD II, përfshirë kostot e të gjithë ekspertëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, në rastin kur pjesëmarrja e tyre konsiderohet e nevojshme për funksionimin efektiv të komitetit;
- Shpenzime të tjera të nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë të Komitetit të Monitorimit Programit IPARD të cilat përfshihen në kategoritë e mëposhtme:
  - mbështetje me ekspertizë për marrjen në shqyrtim apo rishikimin e standardeve dhe treguesit e Programit si dhe ngritjen e sistemeve të informacionit;
  - mbështetje me ekspertizë apo konsulentë të Komitetit Monitorues lidhur me zbatimin dhe funksionimin e praktikave të monitorimit;
  - shpenzimet e lidhura me organizimin e takimeve dhe detyra e tjera plotësuese të grupeve të punës;
  - seminare, vizita;

- Shpenzimet e lidhura për organizimin e fushatave informuese dhe të publicitetit, përfshirë kostot për bërjen e printimeve dhe shpërndarjes, prodhimin e videoklipeve, dokumentarëve të shkurtër dhe transmetimin e tyre, ngritjen dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit të Programit;
- Kosto përkthimi/interpretimi, të kryera në bazë të kërkesave të Komisionit;
- Shpenzimet e lidhura me vizita dhe seminare;
- Shpenzime të lidhura me "përfundimin e aftësive" për përgatitjen e LAGs për qëllime të zbatimit të masës "Zbatimi i Strategjive Vendore të Zhvillimit - LEADER";
- Shpenzime të lidhura me përgatitjen, konturimit të vënies në zbatim, të masave të Programit me qëllim garantimin e efikasitetit të tyre, përfshirë edhe ato masa zbatimi i të cilave parashikohet në një fazë të ardhshme;
- Shpenzime për vlerësimin e Programeve;
- Shpenzime të lidhura me ngritjen dhe vënien në funksionim të RKZHR-së, përfshirë shpenzimet e lidhura me pjesëmarrjen në Rrjetin Evropian të Zhvillimit Rural;
- Shpenzimet e lidhura me përgatitjen dhe programimin për periudhën 2020 e mbrapa;

Mbështetje me një nivel të caktuar page duke marrë në konsideratë nivelet e pagave në tregun e punës me qëllim mbajtjen e personelit dhe ngritjen/ruajtjen e ekspertizës (knoë-hoë) në administratë. Vënia në zbatim i këtij zëri shpenzimi do mund të bëhet vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga ana e Komisionit dhe do të jetë e kufizuar në kohe.

Shpenzimet e pranueshme jepen të detajuara në 'listën e shpenzimeve të pranueshme'.

#### **8.2.4.11. Përqindja e mbështetjes dhe shkalla e kontributit të BE-së**

Përqindja e mbështetjes e shprehur si përqindja e mbështetjes publike për shpenzimet e pranueshme është 100%.

Financim paraprak mund të jepet nga kontributi kombëtar, por ky financim në asnjë rast nuk mund të konsiderohet si kosto e rimbursueshme nga ana e Komisionit.

Përqindja e kontributit të BE-së është në masën 85 % të mbështetjes publike.

#### **8.2.4.12. Treguesit dhe objektiva**

<b>Treguesit</b>	<b>Objektivat 2020</b>
Numri i takimeve të mbështetura të Komitetit të Monitorimit IPARD II	10
Numri i raporteve të vlerësimit të Programit të mbështetura	2
Numri workshop-eve, konferencave, seminareve	70
Numri i studimeve për hartimit dhe zbatimin e masave të Programit	10
Numri i materialeve promociionale për informimin e përgjithshëm të palëve të interesuara (fletëpalosje, broshura etje.) (nr. kopjesh)	35 000
Numri i veprimtarive të mbështetura të rrjetit rural	30
Numri i LAG-eve potenciale të mbështetura	10

#### 8.2.4.13. Procedura administrative

Çdo vit, Autoriteti Menaxhues harton një Plan Veprimi paraprak për të gjitha veprimtaritë e parashikuara në kuadër të masës së Asistencës Teknike, i cili i paraqitet komitetit të Monitorimit IPARD për konsultim.

Kontratat nënshkruhen pasi të jenë ndjekur procedurat e përshtatshme të prokurimit publik për ndihmën e jashtme të cilat respektojnë parimet e Traktatit të tilla si: transparencë, proporcionaliteti, trajtimi barabartë, mos diskriminimi dhe garantimi i menaxhimit të rregullt financiar (vlera për para).

Prokurimi i masës së Asistencës Teknike kryhet nga ana e Njesisë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (CFCU) në Ministrinë e Financave mbi bazën e përcaktimeve të Marrëveshjes Operative të firmosur ndërmjet Autoritetit Menaxhues dhe CFCU-së, ku Autoriteti Menaxhues mban përgjegjësi të plotë për zbatimin teknik të këtyre veprimtarive.

#### 8.2.4.14. Shtrirja gjeografike e masave

N/A

#### 8.2.4.15. Informacione të tjera të lidhura me masën (sipas përkufizimeve në fishën e masës)

N/A

#### 8.2.4.16. Buxheti paraprak sipas masave

Viti	Totali i kostove të pranueshme		Kontributi i BE-së		Kontributi Kombëtar	
	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)	(EURO)	(%)
2014	-	-	-	-	-	-
2015	-	-	-	-	-	-
2016	411,765	100%	350,000	85%	61,765	15%
2017	647,059	100%	550,000	85%	97,059	15%
2018	411,765	100%	350,000	85%	61,765	15%
2019	411,765	100%	350,000	85%	61,765	15%
2020	588,235	100%	500,000	85%	88,235	15%
<b>Totali</b>	<b>2,470,588</b>	<b>100%</b>	<b>2,100,000</b>	<b>85%</b>	<b>370,588</b>	<b>15%</b>

## 9. RRJETI KOMBËTAR I ZHVILLIMIT RURAL

Shqipëria akoma nuk ka ngritur zyrtarisht një Rrjet Kombëtar të Zhvillimit Rural (RKZHR), megjithëse palët e interesuara në zhvillimin rural (OJQ-të dhe LAG-et, e ngritura nga donator të ndryshëm) kanë ndërtuar mekanizma për shkëmbimin e informacionit dhe krijimin e kontakteve (netëorking), të tilla si organizim i ëorkshop-eve, konferencave vjetore, dhe takimeve në nivel rajonal dhe kombëtar.

RKZHR-ja do të shërbejë si kornizë e hapur për të gjitha palët e interesuara të cilat janë aktive dhe të vullnetshme për të bashkëpunuar dhe për tu përfshirë në zhvillimin bujqësor dhe rural.

Objektivi i RKZHR-së është:

Rritja e përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara në zbatimin e zhvillimit rural;  
Informimi i publikut të gjerë marrësve potencialë të kësaj mbështetjeje mbi politikën e zhvillimit rural dhe mundësitë e financimit;

Rritja e ndërgjegjësimit dhe e njohurive të palëve të interesuara në zhvillimin rural mbi çështje të ndryshme të zhvillimit rural përmes dhënies së informacionit, trajnimeve dhe krijimit të kontakteve;

Transferimin e njohurive dhe praktikave dhe eksperiencave më të mira mbi zhvillimin rural;

Shtyrja përpara e novacionit në bujqësi, prodhim ushqimor dhe pyjor në zonat rurale;

Mbështetja e koordinimit të veprimtarive për përgatitjen dhe vënien në zbatim të strategjive vendore të zhvillimit rural;

Ndihmesa për arritjen e bashkëveprimit brenda dhe jashtë vendit;

Ndihmesa e krijimit të kontakteve për novacion ndërmjet të gjitha organizatave përkatëse që janë aktive në fushën e zhvillimit rural;

Mbështetja e pjesëmarrjes në veprimtaritë e Rrjetit Evropian të Zhvillimit Rural.

RKZHR-ja ngre strukturat e mëposhtme:

Komitetin Menaxhues të Koordinimit, i cili përfaqëson aktorët kryesorë ruralë (organizata që përfaqësojnë target-grupin e Programit, ose palë të treta të interesuara sipas objektivave të masave) si dhe administratën publike;

Sekretariati i RKZHR-së, i cili mbështet Komitetin Menaxhues të Koordinimit dhe është përgjegjës për koordinimin e veprimtarive të RKZHR-së;

Grupe pune tematike –të ngritura si organe të përkohshme dhe për arsye të veçanta, në përputhje me nevojat aktuale, puna e të cilit i nënshtrohet udhëheqjes metodologjike të Sekretariatit.

Në fillimet e zbatimit të Programit, Autoriteti Menaxhues harton një Plan Veprimi të detajuar për RKZHR-në i cili menaxhohet nga Komiteti Monitorues i IPARD-it. Në këtë Plan Veprimi përcaktohen:

Objektivat e veprimtarisë së RKZHR-së;

Kuadri organizativ i Rrjetit;

Target grupi;

Veprimtaritë kryesore të RKZHR-së – përfshirë evenimentet për krijimin e kontakteve, konferenca dhe mbledhje të anëtarëve të RKZHR-së, organizimi i seminareve tematikë dhe ëorkshop-eve, etje.;

Alokimi i burimeve financiare;

Treguesit për monitorimin e performancës së RKZHR-së.

Plani Veprimi mund të azhurnohet gjatë kohës së zbatimit të Programit dhe çdo ndryshim thelbësor duhet të marrë miratimin e Komitetit Monitorues të IPARD-it. Planet Vjetore të Zbatimit hartohen dhe miratohen nga ana e Komitetit Monitorues të IPARD-it.

Ngritja e RKZHR-së fillon menjëherë pas akreditimit të Masës së Asistencës Teknike. Për kryerjen e veprimtarisë të lidhur me ngritjen e RKZHR, përzgjidhet një ofrues shërbimi, përmes tenderimit duke ndjekur procedurat e masës së Asistencës Teknike, i cili planifikon dhe organizon komunikimet, ngre dhe mirëmban faqen e internetit dhe bazën e të dhënave, zhvillon trajnime, organizon evenimente informuese, si dhe veprimtari në kuadër të krijimit të kontakteve (networking), publikime, organizimi dhe shpërndarja e anketimeve tematike, etje. Veprimtaritë e RKZHR-së financohen nga masa e Asistencës Teknike.

Monitorimi i performancës së RKZHR-së është përgjegjësi e Autoritetit Menaxhues, i cili raporton mbi progresin, rezultatet dhe ndikimet nëpërmjet raporteve Vjetore/Përfundimtare.

## **10. INFORMACIONE LIDHUR ME BASHKËVEPRIMIN E IPARD ME MASAT E FINANCUARA NGA BURIME TË TJERA (KOMBËTARE OSE NDËRKOMBËTARE)**

### **10.1. Kriteret e demarkacionit të IPARD me mbështetjet e dhëna nga fushat e tjera të IPA-s**

Për të vendosur vijën e demarkacionit mes programit IPARD II dhe mbështetjet e nga fushat e tjera të IPA, nga strukturat operative duhet të hartohen kriteret të qarta demarkacioni në konsultim



me Departamentin e Zhvillimit të Programeve, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri nën koordinimin e përgjithshëm të KKIPA/ NIPAC. Kriteret e demarkacionit do të jenë në përputhje me:

- Dokumentin Strategjik Kombëtar 2014-2020, ku përcaktohen prioritetet dhe objektivat sipas fushave të IPA II;
- Strategjinë kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2014-2020 e cila përcakton kuadrin strategjik të punës për të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndër-sektoriale;
- Strategjia ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Strategji të tjera sektoriale ose ndërsektoriale.

Kriteret kryesore të demarkacionit që do të zbatohen pas fillimit të zbatimit të programit IPARD II përshkruhen më poshtë:

Programi i masave/llojit të asistencës IPARD II	Vija e demarkacionit me fushat e tjera të IPA
Investime në fermat bujqësore	Investimet në fermat bujqësore do të mbështeten vetëm nga programi IPARD II
Investime në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Investimet sipas sektorëve të pranueshëm në fermat dhe SME-të bujqësore do të mbështeten vetëm nga programi IPARD II
Investimet në sipërmarrjet e turizmit rural	Vija e demarkacionit do të përcaktohet gjatë programimit të ndërhyrjeve në fushat e tjera të IPA
Investime në prodhimin e energjisë së rinovueshme	
Investime në sipërmarrje të tjera në zonat rurale	

Kriteret e demarkacionit do të rishikohen dhe ndryshohen, sipas nevojës, pas ndryshimit të programit IPARD II dhe programeve të tjera IPA.

## 10.2. Bashkëveprimi i IPARD me instrumentet e tjera financiare

Programi IPARD II iu përgjigjet prioriteteve Strategjisë së Bashkimit Evropian për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR), miratuar në vitin 2014. EUSAIR është një strategji makro-rajonale, e cila mbulon katër Shtete Anëtare të BE-së (Kroacia, Greqia, Italia dhe Sllovenia) dhe katër shtete që nuk janë anëtare (Shqipëri, Bosnje Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia). Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është të promovojë mirëqenien e qëndrueshme social ekonomike të rajonit përmes rritjes dhe punësimit, si dhe përmes përmirësimit të atraktivitetit, konkurrueshmërisë dhe krijimit të lidhjeve, duke ruajtur mjedisin dhe siguruar një ekosistem detar dhe bregdetar të shëndetshëm dhe të balancuar. EUSAIR është e përbërë nga katër shtylla tematike i) Rritja Blu – rritje inovative e **detarisë dhe nga deti**; ii) Lidhja e rajonit – lidhja transportit dhe energjisë; iii) cilësi mjedisore përmes bashkëveprimit në nivel rajonal; iv) turizmi qëndrueshëm. EUSAIR do të vërë në lëvizje dhe do të përafrojë instrumentet ekzistuese financiare të BE-së dhe ato kombëtare (përfshirë IPA) në secilën nga fushat e identifikuara në katër shtyllat.

Shtylla e katërt e EUSAIR koordinohet nga Kroacia dhe Shqipëria. Objektivi kësaj shtylle është zhvillojë të gjithë potencialin e mundshëm të Rajonit për sa i përket turizmit cilësor, novator, të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm. Programi IPARD II do të kontribuojë në drejtim të objektivave të Shtyllës së katërt përmes mbështetjes së turizmit të natyrës dhe atij rural.

Programi IPARD II bashkëvepron gjithashtu me programet ndër-kufitare dhe ato të bashkëveprimit ndërmjet vendeve që do të financohen nga IPA II dhe Fondi Evropian për Zhvillimin e Rajoneve.

Institucionet Ndërkombëtare Financiare (INF-ve) – Banka Evropiane e Investimeve, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banak e Zhvillimit të Këshillit të Evropës, Banka Botërore, luajnë një rol domethënës për financimin e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e sektorëve privatë. Koherenca dhe bashkëveprimi mes veprimtarive të INF-ve dhe programeve IPA sigurohet përmes mekanizmave të ndryshëm bashkërendues të krijuara nga Komisioni. DG Enlargement ka ngritur Grupin Këshillimor mbi Institucionet Ndërkombëtare Financiare me qëllim përmirësimin e bashkërendimit mes INF-ve. Objektivi i këtij grupi është të lehtësojë veprimtaritë për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës rajonale në Evropën Juglindore të sektorëve kryesorë si energjia, transporti, mjedisi, zhvillimi burimeve njerëzore, punësime dhe mbrojtja sociale, për të cilat nevojiten investime të mëdha, dhe thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit dhe të vendeve përfituese.

Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor është një tjetër platformë bashkëveprimi përmes të cilit vendet e Ballkanit Perëndimor së bashku me ato të BE-së, INF-të donatorët bilateralë mund të identifikojnë, përgatisin dhe zbatojnë investime prioritare në fushën social ekonomike përmes bashkimit të ekspertizës dhe burimeve financiare. Këto projekte investimesh të hartuara përzgjidhen në bazën e kriterëve të rëndësishëm që ato kanë në strategjitë kombëtare dhe rajonale, procesin e anëtarësimit në BE si dhe përfitueshmërisë ekonomike.

### **10.3. Kriteret e demarkacionit dhe bashkëveprimi i masave IPARD me politikat kombëtare**

Strategjia ndër-sektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në Shqipëri për periudhën 2014-2020 parashikon një përafrim gradual të instrumenteve të politikave kombëtare me acquis-in e BE-së. Instrumentet e politikave kombëtare do të hartohen dhe zbatohen në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Do të hartohen skema të reja nacionale të mbështetjes në përputhje me parimet e kuadrit të politikave të BE-së për PBB-në (CAP), zhvillimin rural dhe parazgjerimin për periudhën 2014-2020;
- Masat kombëtare të mbështetjes të cilat nuk janë në përputhje me masa të ngjashme mbështetje të EU gradualisht do t'ia lënë vendin masave të reja, dhe asnjë masë e re kombëtare nuk do të futet e cila është e kundërshtim me PBB-në (CAP).

Me fillimin e programit IPARD II masat kombëtare do të vazhdojnë të përqendrohen tek ato prioritetet të cilat nuk mbështeten nga programi IPARD, të tilla si infrastruktura rurale shërbimet bazë, ujitja, mbështetja direkte.

Skemat nacionale për sektorin agro-ushqimor harton në baza vjetore për momentin. Me fillimin e programit IPARD II parimete mëposhtme të demarkacionit do të zbatohen gjatë programit vjetor të skemave nacionale:

- Skemat nacionale do të mbështesin sektorët, të cilët nuk janë të pranueshëm në programin IPARD (p.sh. ullinjë), ose;
- Nëse mbështeten sektorët e pranueshëm në programin IPARD II, skemat nacionale do të ofrojnë mbështetje për investimet/target grupet/rajonet e jot të pranueshme nga IPARD (p.sh. fermat nën pragun e IPARD, blerja e kafshëve, zonat urbane);

Nëse skemat nacionale hartohen për sektorët jo-bujqësorë të mbështetura nga programi IPARD II si në rastin e turizmit të natyrës dhe atij rural, energjisë së rinovueshme, gjatë hartimit të skemave duhet të parashikohen dispozita të qarta për evitimin e financimit të dyfishtë.

Agjencia IPARD do të jetë përgjegjëse për kontrollin e financimit të dyfishtë mes programit IPARD II, dhe skemave të tjerat të mbështetjes nacionale ose të BE-së. Çdo projekt në kuadër të programit IPARD, i cili shtrihet brenda fushës së skemave nacionale apo skemave të tjera mbështetëse të BE-së do të kontrollohet për financim të dyfishtë *përpara kontraktimit* dhe përpara kryerjes së pagesës.

## 11. PËRSHKRIMI STRUKTURËS OPERATIVE, PËRFSHIRË MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN

### 11.1. Përshkrimi strukturës operative (Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD) dhe funksioneve kryesore të tyre

**Struktura Operative** është përgjegjëse për menaxhimin dhe vënien në zbatim të programit IPARD II në përputhje me parimet e menaxhimit të rregullt financiar. Struktura operative e caktuar për programin IPARD II është e përbërë nga autoritetet e veçanta të mëposhtme të cilat veprojnë në bashkëpunim të ngushtë:

Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për menaxhimin e programit IPARD II dhe gjithashtu për programimin, duke përfshirë përzgjedhjen e masave, publicitetin, koordinimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin;

*Agjencia e Zhvillimit Rural IPARD (Agjencia IPARD)* është përgjegjëse për publicitetin, përzgjedhjen e projekteve, autorizimin, kontrollin dhe kontabilizimin e angazhimit financiar dhe pagesave si dhe ekzekutimin e tyre, menaxhimin e borxhit dhe auditin e brendshëm.

#### **Funksionet e Autoritetit Menaxhues dhe Agjencisë IPARD sipas përcaktimeve në Marrëveshjen Sektoriale**

Funksione të Përgjithshme	Funksione të Veçanta	Agjencia IPARD	Autoriteti Menaxhues
<b>Funksione Menaxhuese</b>	Përzgjedhja e masave		✓
	Monitorimi Programit		✓
	Vlerësimi		✓
	Raportimi	✓	✓
	Koordinimi		✓
<b>Funksione në lidhje me kryerjen e pagesave</b>	Autorizimi dhe kontrolli angazhimit financiar	✓	
	Autorizimi dhe kontrolli pagesave	✓	
	Ekzekutimi pagesave	✓	
	Kontabilizimi i angazhimeve dhe pagesave	✓	
	Menaxhimi borxhit	✓	
<b>Funksione zbatuese</b>	Përzgjedhja e projekteve	✓	
	Publiciteti	✓	✓
<b>Funksione auditit</b>	Auditi Brendshëm	✓	

**Autoriteti Menaxhues (AM)** është **Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale (DPVPR)** në MBZHRAU, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e Programit IPARD II në mënyrë korrekte, efëcente dhe efikase brenda fushës së saj të përgjegjësisë të përcaktuara në Marrëveshjen Sektoriale.

Zyrtarisht, Autoriteti Menaxhues (AM) është ngritur me anë të Urdhrit të Ministrit të MBZHRAU me Nr. 108 datë 16.04.2013. Drejtuesi i DPVPR-së është caktuar si Drejtues i AM-së me anë të Urdhrit të Ministrit të MBZHRAU me Nr. 108 i datës 16.04.2013. Organigrama e AM-së gjendet e bashkëngjitur në Aneksin 5 të Programit.

AM-ja kryen funksionet e veçanta të mëposhtme:

#### *Përzgjedhja e Masave*

Hartimi i programit IPARD II dhe masave të tij;

Përkufizimi në programin IPARD II i masave të kontrollit dhe verifikueshmërisë në bashkëpunim me Agjencinë IPARD; rishikim i rregullt i kontrollueshmërisë dhe verifikueshmërisë;

Përzgjedhja e masave për secilën thirrje për dorëzimin e aplikimeve si dhe e buxhetit për secilën thirrje;

Hartimin e ndryshimeve të Programit IPARD II dhe paraqitjen e tyre Komisionit duke njoftuar me anën e një kopjeje edhe KKIPA/NIPAC, pas konsultimit me Agjencinë IPARD, si dhe pas marrjes së miratimit nga ana e Komitetit Monitorues të IPARD II;

Siguron informimin e autoriteteve përkatëse mbi nevojën e kryerje së ndryshimeve të duhura administrative sa herë që këto ndryshime kërkohen si pasojë e vendimeve të Komisionit për të ndryshuar programin IPARD II;

Siguron që legjislacioni përkatës vendas në fuqi që shërben si bazë për zbatimin e IPARD është i plotë dhe i azhornuar sipas nevojës;

#### *Monitorimi Programit*

Ngritja e një sistemi për mbledhjen e të dhënave të kontekstit dhe monitoruese mbi progresin e programit IPARD II dhe analizimi i të dhënave të mbledhura; në përputhje me Pjesën 11.2.

#### *Vlerësimi*

Organizimi i vlerësimeve të Programit me qëllim përmirësimin e cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërinë e asistencës, në përputhje me përcaktimet e Pjesës 11.2, duke përfshirë përgatitjen e Planit të Vlerësimit, raportimi në Komitetin Monitorues të IPARD II dhe në Komision mbi progresin e bërë në zbatimin e këtij plani.

#### *Publiciteti*

Hartimi i një *Plani koherent veprimtarish vizibiliteti dhe komunikimi* në konsultim me Komisionin Komitetin Monitorues të IPARD II, dhe raportimi mbi ecurinë e zbatimit të tij Komitetit Monitorues të IPARD II, Komitetit Monitorues të IPA II dhe Komisionit në përputhje me Pjesën 15.

#### *Koordinimi*

Orientimi dhe mbështetja e punës së KM të IPARD II duke vënë në dispozicion të tij dokumentacionin e nevojshëm për monitorimin e cilësisë dhe efikasitetit të zbatimit të programit IPARD II në përputhje me Pjesën 11.2.

#### *Raportimi*

Raportimi mbi zbatimin e programit IPARD II duke përgatitur në konsultim me Agjencinë IPARD, raporte Vjetore dhe Përfundimtare mbi zbatimin e tij në përputhje me Pjesën 11.2.

#### *Të tjera:*

Harton çdo vit Planin e Veprimit për veprimtaritë e parashikuara në masën e Asistencës Teknike e cila i dorëzohet për marrjen e miratimit të Komitetit Monitorues të IPARD II.

**Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR)**, caktuar si **Agjencia IPARD** më anë të Urdhrit të Ministrit të MBZHRAU me Nr. 108 të datës 16.04.2013, është ngritur mbi bazën e

përcaktimeve të *Ligjit Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural* (Nr. 9817 datë 22.10.2007) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave në bazë të tij me Nr. 1443 i datës 31.10.2008 organ publik i pavarur, veprimtaria e të cilit i nënshtrohet drejtë për së drejti përgjegjësisë së ministrit të MBZHRAU.

Struktura organizative dhe organika e Agjencisë IPARD janë në përputhje me përcaktimet e Marrëveshjes Sektoriale. Organigrama e Agjencisë IPARD është bashkëngjitur në Aneksin 5 të Programit.

Agjencia IPARD është përgjegjëse për zbatimin e Programit IPARD II në përputhje me parimet e menaxhimit të rregullt financiar. Agjencia IPARD ushtron funksionet dhe përgjegjësitë përkatëse si më poshtë:

#### *Përzgjedhja e Projekteve*

Kryen përzgjedhjen e projekteve që do të zbatohen në përputhje me kriteret dhe procedurat e zbatueshme për programin IPARD II si dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së dhe atë vendas;

Harton me shkrim detyrimet kontraktuale të marrësve të mbështetjes, përfshirë informimin mbi sanksionet e mundshme në rastet e mos përmbushjes së këtyre detyrimeve;

#### *Publiciteti*

Shpallja e thirrjeve për dorëzimin e aplikimeve dhe publikimi i kriterëve dhe kushteve të pranueshmërisë, pas konsultimit me Autoritetin Menaxhues;

Kryerja e publicitetit dhe vizibilitetit të programit IPARD II përmes: publikimit të listët së përfituesve përfundimtarë; informimi i marrësve të mbështetjes lidhur me pjesën e kontributit të BE-së dhënë projektit të tyre; garanton dhënien e publicitetit të duhur nga ana e marrësve të mbështetjes pjesës së bashkëfinancimit të BE-së për projektet përkatëse (në përputhje me Kapitullin 15);

#### *Autorizimi dhe kontrolli i angazhimeve dhe pagesave*

*Përcakton, përmes procedurave administrative dhe sipas nevojës edhe nëpërmjet kontrolleve në vend se aplikimet e miratuara për financimin e projekteve si dhe shumat përkatëse të kërkuara për tu paguar janë të pranueshme për tu mbështetur, veçanërisht për sa i përket ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së shpenzimeve;*

#### *Ekzekutimi pagesave:*

Lëshimi i urdhrat për kryerjen e pagesës së shumës së autorizuar drejt kërkuesit (ose përfaqësuesit të tij);

#### *Kontabilizimi i angazhimeve dhe pagesave:*

Regjistrimi i të gjitha angazhimeve dhe pagesave në një libër të veçantë kontabilizimi për shpenzimet e IPARD II dhe përgatitja e përmbledhëseve të shpenzimeve periodike, duke përfshirë deklaratimet e shpenzimeve për Komisionin Evropian. Në librat kontabël regjistrohen edhe aktivet e financuara nga fondet IPARD II, veçanërisht ato në lidhje me marrësit e mbështetjes me statusin e debitorit;

#### *Menaxhimi i borxhit*

Ngrija e një sistemi për kontabilizimin e të gjitha shumave të pa arkëtuara dhe për regjistrimin në llogaritë e debitorëve të të gjitha borxheve të tilla, parregullsitë, përpara të marrjes së tyre në dorëzim;

#### *Auditi i brendshëm*

Zhvillimi i të veprimtarive të përhershme specifike me qëllim informimin e eprorëve përmes raporteve të pavarura të sistemeve në varësi;

#### *Të tjera*

Zhvillimi i veprimtarive ndjekëse që garantojnë progresin e projekteve të zbatuara;

Raportimi i progresit të zbatimit të masave përkundrejt treguesve;  
Ngritja, mirëmbajtja dhe azhurnimi i rregullti sistemit të informacionit të Programit;

*Raportimi parregullsisë*

Sigurimi i raportimit të parregullsisë.

## **11.2. Përshkrimi i sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit, përfshirë përbërjen e parashikuar të Komitetit Monitorues**

Monitorimi i programit synon garantimin e efikasitetit dhe cilësisë së zbatimit të programit IPARD II përmes vënies në dispozicion të informacioneve aktuale dhe të besueshem mbi progresin e arritjeve të objektivave të veçanta të programit.

Progresi, eficaenca dhe efikasiteti programit IPARD II do të maten përmes treguesve të përcaktuar në Program për situatën e përgjithshme, ekzekutimet e input-eve/financiare, output-et dhe rezultatet e menjëhershme të veprimeve /Programit.

Të dhënat mbi treguesit e monitorimit mblidhen nga Agjencia IPARD dhe hidhen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (MIS). Ky sistem të dhëna për çdo veprim (të dorëzuar, të vlerësuar, përzgjedhur për financim, si për veprimet e përfunduara, përfshirë karakteristikat kryesore të marrësit të mbështetjes dhe projektit), të cilat regjistrohen dhe përpunohen elektronikisht nga Agjencia IPARD.

Autoriteti Menaxhues mbledh, grupon dhe analizon informacionin/ të dhënat mbi treguesit të marra nga Agjencia IPARD, si dhe raporton dhe harton veprimtaritë ndjekëse. Sipas rastit, AM-ja rekruton ekspertizë të jashtme për të sinkronizuar treguesit dhe vlerësuar programin IPARD II.

AM-ja raporton në Komitetin Monitorues IPARD II, Komisionin, dhe organet e tjera përkatëse (KKIPA/NIPAC, ZKA/NAO) mbi progresin e përdorimit të fondeve, output-et dhe rezultatet për çdo masë dhe për Programin në tërësi si dhe për veprimet e nevojshme për përmirësimin eficaensës dhe efikasitetit të Programit. Të dhënat e monitorimit paraqiten dhe analizohen në raportet Vjetore /Përfundimtare të zbatimit.

Ky vlerësim synon përmirësimin e rëndësisë, koherencës, cilësisë, eficaensës, efikasitetit, vlerën e shtuar për BE-në, konsistencën dhe sinergjinë e programit me fushat e tjera të politikave.

Programi IPARD II i është nënshtruar vlerësimeve ex-ante, dhe ex-post. Vlerësimi i ndërmjetëm do të kryet vetëm në rastin kur konsiderohet i përshtatshëm nga ana e Komisionit. Vlerësimet mund të kryhen në nivel strategjie, tematike, sektori, dhe mase si dhe në nivel kombëtar apo qarku. Ato duhet të bëhen në përputhje me metodat e vlerësimit të hartuara nga Komisioni. Rezultatet e vlerësimeve ex-ante dhe të ndërmjetme reflektohen në ciklin e programimit dhe zbatimit.

Vlerësimet e ndërmjetme dhe ato ex-post marrin në shqyrtim shkallën e përdorimit të burimeve, efikasitetin dhe eficaencën e programimit, ndikimin e tij social-ekonomik si dhe atë mbi objektivat dhe prioritetet e përcaktuara. Ato duhet të mbulojnë gjithashtu edhe synimet e programit IPARD II me qëllim nxjerrjen e mësimave në lidhje me politikën e zhvillimit rural. Ato duhet të identifikojnë faktorët të cilët kanë kontribuar në suksesin apo dështimin e zbatimit të programit IPARD II, duke përfshirë qëndrueshmërinë e veprimeve dhe identifikimin e praktikave më të mira.

Autoriteti Menaxhues, jo më vonë se një vit pas miratimit të programit IPARD II nga Komisioni, harton, në konsultim me Komisionin, një Plan Vlerësimi për të gjithë periudhën e programimit, në të cilin pasqyrohen të gjitha veprimtaritë vlerësuese që do të zhvillohen gjatë fazave të ndryshme të zbatimit të programit,.

AM-ja i raporton çdo vit Komitetit Monitorues të IPARD II dhe Komisionit lidhur me progresin e zbatimit të Planit të Vlerësimit si dhe rezultatet e veprimtarive vlerësuese, duke informuar gjithashtu edhe Autoritetin e Auditit. AM-ja për ndjekjen në vijim të rekomandimeve të dhëna në raportet e vlerësimit dhe raporton lidhur me zbatimin e tyre në Komitetin Monitorues të IPARD II MC dhenë Komision.

Për të garantuar një cilësi të lartë të planifikimit dhe ekzekutimit të veprimtarive vlerësuese, ngrihet një *Grup Vlerësimi* i cili është pjesë e Komitetit Monitorues të IPARD. Drejtuesi i AM-së kryen funksionin e Drejtuesit të Vlerësimit në këtë grup. Grupi vlerësimit jep këshillat e tij lidhur me planifikimin dhe përmbajtjen e veprimtarive vlerësuese, formulimin e pyetjeve vlerësuese, si dhe vlerëson cilësinë e raporteve të vlerësimit të dorëzuara.

AM-ja për kryerjen e vlerësimeve të Programit, përdor ekspertizë të pavarur përmes masës së Asistencës Teknike, e cila përzgjidhet nëpërmjet procedurave konkurruese dhe transparente.

Për të garantuar llogaridhënien dhe transparencën e veprimeve, raportet e vlerësimit prezantohen para një audience të gjerësi dhe vihen në dispozicion në faqen e internetit të Programit.

Mbas miratimit të Programit ngrihet Komiteti Monitorues i Programit IPARD II, pas konsultimeve me KKIPA/NIPAC dhe Komisionin,.

Komitete Monitorues i IPARD II merr në shqyrtim në mënyrë periodike ecurinë e Programit si dhe efikasitetin, eficensën, cilësinë, koherencën, dhe koordinimin e tij dhe gjithashtu përputhshmërinë dhe konsistencën e tij me strategjinë e zhvillimit rural dhe me strategji të tjera sektoriale përkatëse. Komiteti Monitorues mund të paraqesë propozime lidhur me ndërmarrjen e veprimeve korrektuese me qëllim sigurimin e arritjes së objektivave dhe përmirësimit të eficensës, efikasitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë së asistencës.

Komitete Monitorues i IPARD II ngrihet me anën e një Urdhri të Ministrit të MBZHRAU dhe përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve dhe organeve publike përkatëse, partnerëve ekonomikë, socialë dhe mjedisorë nën kryesimin e Ministrit të MBZHRAU. Anëtarët e tij përzgjidhen mes organizatave të konsultuara gjatë përgatitjes së Programit. Përfaqësuesit e Komisionit, KKIPA/NIPAC, ZKA/ NAO dhe Struktura Operative IPARD marrin pjesë në punën e Komitetit Monitorues IPARD II MC me status këshillimor pa të drejtë vote. Përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, përfshirë institucionet ndërkombëtare financiare, donatorët bilateralë, sektori bankar, përfaqësues të fushës akademike dhe organizata të tjera, me rëndësi për programin IPARD II është e mundur të ftohen gjithashtu. Lista emërore e anëtarëve të Komitetit Monitorues të IPARD publikohet në faqen e internetit të programit.

Komitete Monitorues IPARD II harton dhe miraton në konsultim me Strukturën Operative, KKIPA/NIPAC dhe Komisionin Rregulloren e Procedurave të tij, të cilat miratohen në takimin e parë të Komitetit Monitorues.

Komitete Monitorues i IPARD II takohet të paktë ndy herë në vit; ai mund të zhvillojë gjithashtu edhe takimet ad hoc, si dhe procedura të shkruara. Konkluzionet Operacionale, përfshirë rekomandimet, përpilohen në fund të takimeve. Këto konkluzione i nënshtrohen rishikimit dhe ndjekjes në vijim gjatë takimeve pasardhëse të Komitetit Monitorues dhe do të përbëjë bazën për raportimin në Komitetin Monitorues të IPA.

Komitete Monitorues mund të ngrëjë Grupe Pune (GP) mbi çështje të veçanta sipas masave. Këto GP, sipas rastit, formohen me pjesëmarrjen e anëtarëve të Komitetit Monitorues ose ekspertëve të ftuar.

Komitete Monitorues i IPARD ka përgjegjësitë e mëposhtme:

*merr në shqyrtim* ecurinë e rezultateve të programit IPARD II, veçanërisht arritjen e objektivave të vendosura për masat e ndryshme dhe ecurinë e përdorimit të alokimeve financiare për këto masa.

Në këtë kuptim, Autoriteti Menaxhues siguron që i gjithë informacioni përkatës në lidhje me ecurinë e masave të vihet në dispozicion të Komitetit Monitorues dhe KKIPA/NIPAC;  
*rishikon në mënyrë periodike progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuar në programin IPARD II, rishqyrton informacionin mbi ato masa dhe sektorë ku paraqiten vështirësi si dhe informacionin mbi rezultatet e verifikimeve të kryera;*

*merr në vlerësim dhe miraton raportet Vjetore/Përfundimtare të zbatimit;*

*analizon veprimtaritë dhe rezultatet dala nga Vlerësimi i Programit, përfshirë Planin e Vlerësimit si dhe cilësinë dhe rekomandimet e raporteve të vlerësimit;*

*merr në shqyrtim dhe miraton, sipas rastit, propozimet e hartuara nga Autoriteti Menaxhues për bërjen e ndryshimeve në program, përpara dorëzimit të tyre në Komision duke dërguar një kopje tek KKIPA/NIPAC dhe ZKA/ NAO;*

*i propozon AM-së dorëzimin në Komision duke dërguar një kopje tek KKIPA/NIPAC dhe ZKA/ NAO, pas konsultimit me AM-në dhe Agjencinë IPARD, ndryshimet ose rishikimet e programit IPARD II për të bërë të mundur arritjet e objektivave të programit dhe përmirësimit të efikasitetit të asistencës së dhënë;*

*merr në shqyrtim dhe miraton planin paraprak vjetor të veprimit të asistencës teknike, përfshirë buxhetin paraprak për qëllime të informimit;*

*merr në shqyrtim dhe miraton Planin e veprimtarive të vizibilitetit dhe komunikimeve si dhe azhurnimit të tij.*

*merr në shqyrtim dhe miraton dhënien e një opinioni, brenda 4 muajve nga marrja e vendimit për miratimin e Programit lidhur me kriteret e përzgjedhjes, i cili mund të rishikohet në varësi të nevojave të programit;*

*i raporton Komitetit Monitorues të IPA.*

Autoriteti Menaxhues vepron si sekretariati për Komitetin Menaxhues të IPARD II dhe mbështet punën e tij duke vënë në dispozicion mbështetje logjistike, informacion dhe ndjekjen në vijimësi të vendimeve të tij.

Puna e Komitetit Monitorues IPARD II mbështetet përmes masës së Asistencës Teknike.

Autoriteti Menaxhues raporton mbi progresin e zbatimit të programit IPARD II përmes raporteve të Vjetore/Përfundimtare të zbatimit.

AM-ja përgatit, në konsultim me Agjencinë IPARD, raportet vjetore mbi zbatimin e IPARD II. Te gjithë raportet vjetore të zbatimit përgatiten në përputhje me Udhëzimet e Komisionit dhe me të gjitha përcaktimet e dispozitave të Marrëveshjes Sektoriale. Paraqet dhe diskuton:

- *ndryshimet në kontekstin rëndësishëm të zbatimit të programit IPARD II, në veçanti, tendencat kryesore social-ekonomike, ndryshimet në politikat kombëtare, në bazë qarku ose sektoriale dhe sipas rastit ndikimet përkatëse;*
- *Progresin e ekzekutimeve financiare–angazhimet financiare dhe shpenzimet sipas masave;*
- *Progresi i zbatimit të prioriteteve dhe masave në lidhje me arritjen e objektivave të programit IPARD II duke iu referuar të dhënave financiare, treguesit e përgjithshëm dhe të veçantë dhe vlerat sasiore të objektivave, përfshirë ndryshimet në vlerën e treguesve të rezultatit, nëse të disponueshëm, rezultatet e vlerësimeve të përfunduara dhe anketimeve të thelluara;*
- *Progresi në zbatimin e Planit të Vlerësimit të veprimtarive;*
- *Progresi në zbatimin e Planit të vizibilitetit dhe komunikimit;*
- *Problemet e hasura në masat korrektive të ndërmarra nga ana e AM-së, Agjencia IPARD dhe Komiteti Monitorues IPARD II në veçanti:*
  - *një përmbledhje e problemeve domethënëse të hasura në zbatimin e programit IPARD II si dhe çdo veprim tjetër të ndërmarrë;*



- një përmbledhje të rezultateve të kontroleve të kryera për çdo masë parregullsisive të gjetura;
- Përdorimi i *asistencës teknikës*;
- Hapat e ndërmarra për *përfshirjen e organeve vendore*;
- *Bashkërendimi dhe koordinimi* me politikat kombëtare dhe ato të BE-së dhe instrumentet financiare.

Në raportin vjetor të zbatimit përfshihen edhe tabelat me treguesit e monitorimit dhe ato financiare.

Raportet vjetore të monitorimit dorëzohen brenda datës 30 Qershor të vitit pasues pas një viti të plotë kalendarik të vënies në zbatim të programit. Raporti përfundimtar i zbatimit duhet të dorëzohet në rastin më të vonë gjashtë muaj pas datës së fundit shpenzimeve të pranueshme në kuadër të programit IPARD II.

## **12. PËRSHKRIM PËRMBLEDHËS I STRUKTURËS SË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT**

Funksionet dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe trupave, ë cilat janë përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e asistencës IPA II paraqiten më poshtë.

### **Koordinatori Kombëtar i IPA-s**

Koordinatori Kombëtar i IPA-s (KKIPA/NIPAC) ka përgjegjësinë e përgjithshme për planifikimin strategjik, koordinimin e programimit, monitorimin dhe zbatimin, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA II. Ministri përgjegjës për Integrimin Evropian kryen funksionin e Koordinatorit Kombëtar të IPA II (KKIA/NIPAC) për Shqipërinë. Përgjegjësitë kryesore të NIPAC janë si më poshtë:

- Koordinimi i përgjithshëm i programimit dhe zbatimit të IPA II, duke garantuar koherencë me CSP (dokumenti strategjik kombëtar), prioritetet sektoriale dhe ato kombëtare si edhe me strategjitë përkatëse makro-rajonale dhe ato të basenit detar.
- Koordinimi me ministritë e linjës dhe institucione të tjera përkatëse si edhe me donator të tjerë duke mbajtur lidhje të ngushta mes përdorimit të asistencës IPA II dhe procesit të përgjithshëm të anëtarësimit;
- Monitorimi dhe raportimi mbi progresin dhe arritjet e objektivave të asistencës IPA II.

KKIPA/NIPAC garanton se objektivat e përcaktuara në veprime apo programe për të cilat janë besuar detyra për zbatimin e buxhetit trajtohen në mënyrën e duhur gjatë vënies në zbatim të asistencës IPA II.

### **Zyrtari Kombëtar Autorizues**

Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO) ka përgjegjësinë e përgjithshme të menaxhimit financiar të fondeve të BE-së, ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e shpenzimeve, funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm të IPARD II si dhe masave efektive dhe proporcionale kundra mashtrimit financiar. ZKA/ NAO për të gjitha pyetjet lidhur me IPARD II, për sa i përket shpërndarjes së dokumenteve apo udhëzimeve të BE-së mbi sistemin e menaxhimit dhe kontrollit vepron si interlokutori i vetëm ndërmjet Komisionit dhe të gjitha strukturave e tjera përgjegjëse për zbatimin e tij, si dhe për aplikimin e harmonizuar të tij, si dhe për paraqitjen e kërkesën për marrjen e besimit për zbatimin e detyrave financiare, dhe për vënien në dispozicion të Komisionit të informacioneve të plota nga regjistrat kontabël të nevojshme për qëllime statistikore dhe kontrolli.

ZKA/ NAO është një zyrtar i lartë në Ministrinë e Financave – Zv/Ministri i Financave.

ZKA/NAO ka një strukturë menaxhimi, të përbërë nga Fondi Kombëtar dhe Zyra e ZKA/NAO.

**Fondi Kombëtar** (FK/NF) raporton tek ZKA/NAO dhe është përgjegjës për menaxhimin e llogarive dhe operacioneve financiare të IPARD II. Fondi Kombëtar (FK/NF) është organ qendror thesari në Ministrinë e Financave. FK/NF ushtron funksionet kryesore të mëposhtme të lidhura me menaxhimin dhe kontrollin e IPARD II:

*Menaxhimi i llogarive dhe operacioneve financiare të IPA II* me qëllim garantimin menaxhimit të rregullt financiar përfshirë regjistrimin e veprimtarive, transferimin e fondeve kryerjen e korigjimeve financiare në rast nevoje.

*Thesari* – organizimi i llogarive bankare, kërkimi i fondeve nga Komisioni, verifikimi dhe korrektësisë së elementeve të bashkëfinancimit, autorizimi dhe transferimi i fondeve të fondeve IPARD II nga Komisioni drejt Agjencisë IPARD ose marrësve përfundimtarë; komunikimeve financiare me Komisionin, i cili përfshin deklarin tremujor të aplikimeve të paguara si dhe deklarin vjetor.

*Kontabilizimin e fondeve të alokuara dhe pagesave* – mbajtja e regjistrave kontabël të saktë, të plotë dhe të besueshëm për çdo veprim/aktivitet/operacion që sigurojnë të gjitha të dhënat e kërkuara për hartimin e kërkesave për pagesë, raporteve ose pasqyrave financiare vjetore.

*Menaxhimi borxhit*– kryerja e korigjimeve financiare të kërkuara në lidhje me parregullsitë dhe rikuperimin kontributit të paguar të BE-së drejt marrësit përfundimtar në përputhje me procedurat kombëtare të rikuperimit të borxhit;

**Zyra e ZKA/NAO** ka përgjegjësinë për të garantuar funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm përmes kontrollit të vazhdueshëm të mbarëvajtjes së te sistemit të brendshëm të kontrollit, përfshirë vënien në dispozicion të gjetjeve të auditit dhe parregullsive të hasura. Zyra e ZKA/NAO është strukturë e veçantë në Ministrinë e Financave, në nivel sektori e cila i raporton direkt tek ZKA/NAO.

Zyra e ZKA/NAO asiston ZKA/NAO në përgjegjësitë e tij për dorëzimin në Komision të kërkesës për delegimin e detyrave të zbatimit të buxhetit, pasi është verifikuar më parë se struktura e menaxhimit dhe struktura operacionale (OS) përmbushin kërkesat e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër (FËA) dhe atë Sektoriale (SA). Zyra e ZKA/NAO monitoron në vazhdimësi performancën e strukturës së menaxhimit dhe të kontrollit (MCS) dhe në rast verifikimi të dobësive ose deficienave merr masat e përshtatshmebrojtëse, dhe informon pa vonesë Komisionin.

Zyra e ZKA/NAO vlerëson, përpara dhënies së miratimit nga ZKA/ NAO, të gjitha ndryshimet në strukturën e menaxhimit dhe kontrollit (MCS) dhe njofton Komisionin mbi çdo ndryshim domethënës lidhur me strukturën e menaxhimit dhe kontrollit (MCS) për shqyrtim dhe miratim paraprakisht zbatimit të tyre. Koordinon, sipas rastit, përgatitjen planeve të konsoliduara të veprimit të cilat trajtojnë çdo lloj dobësie të dukshme të hasur në strukturën e menaxhimit dhe të kontrollit (MCS). Vë në dispozicion ndjekjen në vazhdimësi të gjetjeve në raportet e auditimit të Autoritetit të Auditit. Zyra e ZKA/NAO harton deklaratën e menaxhimit.

### **Autoriteti Auditit**

Autoriteti Auditit (AA) është përgjegjës për kryerjen e auditimit të sistemit/sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, lidhur me veprimet, transaksionet dhe regjistrave kontabël vjetorë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditit dhe përgatitjen e opinioneve vjetore dhe përfundimtare mbi pasqyrat e shpenzimeve. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, ngritur në vitin 2009 me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1020, datë 14.10.2009 vepron si Autoriteti Auditit për IPARD. Agjencia është një institucion që funksionon në mënyrë të pavarur në aktorët e përfshirë në menaxhimin dhe zbatimin e asistencës IPA.

KKIPA/ NIPAC, ZKA/NAO, AA, SO/OS janë të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 846 datë 21/11/2012 mbi menaxhimin dhe kontrollin e IPARD I. Pas ratifikimi të Marrëveshjes Kuadër IPA II mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane, një

Vendim i ri i Këshillit të Ministrave do të miratohet i cili do të rregullojë marrëdhëniet mes strukturave dhe autoriteteve të përfshira në zbatimin e IPARD II. Akti i sipër përmendur paraqitet në KM me propozimin e Ministrit të Financave pas konsultimit me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe MBZHRAU.

### Autoritetet përkatëse të caktuara

Autoriteti	Emri autoritetit/organit, drejtorisë ose njësisë	Drejtuesi i autoritetit/organit (postit ose pozicionit)	Adresa	Telefoni	E-mail
Koordinatori Kombëtar IPA-s	Ministria e Integritimit Evropian	Znj. Klajda Gjoshaj Ministër	Papa Gjon Pali II Rruga nr. 3, 8302 Tiranë	+355-4-225399	<a href="mailto:klajda.gjoshaj@mie.gov.al">klajda.gjoshaj@mie.gov.al</a>
Zyrtari Kombëtar Autorizues	Ministria e Financave	Z. Erjon LUÇI Zv/Ministër	Blv. Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë		<a href="mailto:Erjon.luci@financa.gov.al">Erjon.luci@financa.gov.al</a>
Autoriteti Auditit	Agjencia për Zbatimin e Sistemeve të Auditit të Programeve të BE-së	Z. Safet Noka Drejtor i Komanduar i Autoritetit të Auditit	Rruga Elbasanit, Ndertesat e ish-trikotazhit, kati 4 Tiranë	+355 4 4 532 827	<a href="mailto:safet.noka@aapa.al">safet.noka@aapa.al</a>
Autoriteti Menaxhues	MBZHRAU	Drejtuesi i AM	Sheshi Skenderbej Nr. 2, Tiranë	+355 4222 3806	<a href="mailto:Grigor.gjeci@buqesia.gov.al">Grigor.gjeci@buqesia.gov.al</a>
Agjencia IPARD	AZHBR	Drejtoresha e AZHBR-së	Rruga Muhamet Gjollësia Nr. 56 Tiranë	+355 683050328	<a href="mailto:Suela.popa@azhbr.gov.al">Suela.popa@azhbr.gov.al</a>

## 13. REZULTATET E PROGRAMIMIT, PËRFSHIRJA E AUTORITETEVE DHE ORGANEVE PËRKATËSE SI DHE E PARTNERËVE TË PËRSHTATSHËMEKONOMIKË, SOCIALË DHE MJEDISORË

### 13.1. Masat për përfshirjen e autoriteteve, organeve dhe partnerëve përkatës

Shqipëria ka akumuluar një eksperiencë të madhe të parimit të partneritetit në formulimin e politikave strategjike kombëtare, përfshirë qeverinë, shoqërinë civile dhe sektorin privat si dhe palët e interesuar në nivel lokal edhe qendror. Partneriteti është aplikuar gjerësisht gjatë përgatitjes së “Strategjisë ndërsektoriale të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri”, si edhe në përgatitjen e studimeve sektoriale të programit IPARD II. Palët e interesuara përkatëse (autoritetet publike, partnerët ekonomik dhe socialë, OJQ-të) do të përfshihen në të gjitha fazat e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të programit IPARD II. Asistenca në kuadër të programit IPARD II do të zbatohet në konsultime të gjera me shërbimet e Komisionit.

Gjatë programimit procesi i konsultimeve ka kaluar në dy faza.

*Faza e parë* u krye gjatë periudhës 2013-2014 dhe përfshiu konsultime me të gjithë partnerët përkatës lidhur me identifikimin e sfidave, mundësive, nevojave dhe prioritetëve kryesorë të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri. Gjatë procesit të përgatitjes së strategjisë ndërsektoriale të bujqësisë dhe zhvillimit rural janë zhvilluar konsultime të veçanta, takime të grupeve të punës dhe në forume më të gjera. Në këtë fazë sektorët e pranueshëm në IPARD u përzgjodhën në bazë të studimeve të thelluara ose azhurnimit të studimeve ekzistuese, duke identifikuar forcën, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet si dhe nevojat zhvillimore të sektorëve të përzgjedhur. Rezultatet e këtyre konsultimeve dhe studimeve në fjalë janë përdorur për hartimin e masave të programit IPARD II.

*Faza e dytë* përfshiu konsultime lidhur me prioritetet e programit, kriteret e pranueshmërisë dhe shpërndarjes së buxhetit. Kjo fazë u zhvillua gjatë periudhës Nëntor 2014 – Janar 2015. Rezultatet e këtyre konsultimeve janë përdorur për të hartuar më me saktësi programin.

### 13.2 Partnerët e konsultuar - përmbledhje

Grupet e mëposhtme nga palët e interesuara janë identifikuar për tu përfshirë në faza të ndryshme të përgatitjes dhe zbatimit të programit IPARD II:

1. *Autoritete dhe organizma publike*, në mënyrë që të sigurohet bashkërendim i mirë brenda dhe ndërmjet ministrive:

- Drejtoritë sipas sektorëve në MBZHRAU, drejtoria e veterinarisë, autoriteti kombëtar I ushqimit, shërbimi këshillimor;
- Ministrinë e linjës – Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e Financës, Ministria e Transportit, Ministria e Zhvillimit Urban, ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, sipërmarrjes dhe Turizmit, dhe Ministrinë e tjera përgjegjëse për fushat përkatëse të IPA-s.

2. *Partnerët ekonomikë, social dhe mjedisorë*:

- *Shoqatat dhe OJQ-të* në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, degët e shoqatave në industrinë e përpunimit ushqimor, Shoqatat e Turizmit Shqiptar, Shoqata Shqiptare e Gruas, Shoqata e Fermerëve të Bashkuar të Shqipërisë, etje.
- *Përfaqësuesit e fermerëve dhe të industrisë*;
- *Autoritetet në bazë qarku dhe ato vendore – Shoqata e Bashkive*.

3. *Organizata donatore dypalëshe dhe shumëpalëshe*, si Banka Botërore, PNUD-i, USAID, GIZ, Zyra e Bashkëpunimit Italian të Zhvillimit, DANIDA, etje.

4. *Partnerë të tjerë*, anëtarët e bankave tregtare dhe institucioneve mikro-financiare, institucionet akademike dhe kërkimore, etje.

Disa prej OJQ-ve, të cilat kanë marrë pjesë në konsultime, janë të listuara më poshtë:

Emri i organizatës /institucionit	Fusha e kompetencës/ekspertizës	Emri i personit të kontaktit
Agriturizem Mrizi i Zanave	Bujqësi	Altin Prenga
Shoqata Agro-Koni	Bujqësi	Ruzhdi Koni
Këshilli Agrobiznesit Shqiptar (KASH)	Bujqësi	Gjon Gaspri
Fermë molle, lopësh, guesthouse	Bujqësi	Vehip Salkurti
Shoqata AgriNet	Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Tomi Pikuli
Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok	Bujqësi	Saimir Biti
Shoqata e Prodhuesve të Fasules Korçe	Bujqësi	Agim Veli

<b>Emri i organizatës /institucionit</b>	<b>Fusha e kompetencës/ekspertizës</b>	<b>Emri i personit të kontaktit</b>
Kooperative Fermerësh, Këmishtaj	Bujqësi	Stavri Gjini
Federata e Fermerëve të Myzeqesë (FFM)	Bujqësi	Andon Rrapushi
Shoqata Shqiptare e Biznesmenëve të Hortikulturës	Bujqësi	Ristan Janku
Shoqata Shqiptare e Sipërmarrësve në Blegtori	Bujqësi	Valbona Ylli
Shoqata Shqiptare e Qumështit dhe Mishit (ADAMA)	Industritë e përpunimit të qumështit dhe mishit	Merita Uruci
Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë	Biznes dhe tregti	Nikolin Jaka
Unioni Shqiptar i Kursim & Kreditit	Micro-financë	Zana Konini
Fondacioni Partneritet për Zhvillim	Zhvillim rajonal dhe lokal	Tom Preku
Instituti Demokracisë dhe Ndërmjetësimit	Zhvillim rajonal dhe lokal	Sotiraq Hroni
Agjencia Zhvillimit të Zonave Malore	Zhvillim rajonal dhe lokal	Hafuz Domi
Oxfam GB	Zhvillim rajonal dhe lokal	Geron Kamberi
Forumi Rural Shkodër	Zhvillim lokal	Alfred Haxhari
Fondacioni Shqiptar i Trajnimeve	Trajnim dhe arsim	Fatos Fico
Fakulteti i Bujqësisë dhe Agromjedisit	Shkencë dhe arsim	Tolkli Thomai Ndoc Faslia Fatbardh Sallaku
Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	Shkencë dhe arsim	Gani Moka Renata Kongoli
Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	Shkencë dhe arsim	Myslym Osmani Drini Imami Edvin Zhllima Etleva Dashi
Fakulteti i Shkencave Pyjore	Shkencë dhe arsim	Arsen Proko
Fakulteti Mjekësisë Veterinare	Shkencë dhe arsim	Ylli Bicoku Petrit Dobi

*Autoritetet dhe organet publike*

<b>Emri institucionit</b>	<b>Emri personit të kontaktit</b>
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Benet Beci
Instituti Sigurisë ushqimore dhe Veterinarisë	Vitor Malutaj
Instituti Shqiptar i Konservimit të Natyrës	Genti Kromidha Drejtor Ekzekutiv
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	Bashkim Sykja Drejtor i Departamentit të Politikave të Konkurrencës
Ministria e Arsimit dhe Sporteve	
Ministria e Mjedisit, dhe Administrimit të	Arsen Proko

<b>Emri institucionit</b>	<b>Emri personit të kontaktit</b>
Ujërave dhe Pyjeve	Drejtoria Kullotave dhe Pyjeve
Ministria e Integritimit Evropian	Roza Dedja Eksperte në sektorin NIPAC, Departamenti i asistencës së BE-së
Ministria e Financës	Jola Himçi Zyrtari Kombëtar Autorizues
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	Arjan Budo Kreu Politikave të Transportit Rrugor në Drejtorinë e Politikave të Transportit
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Sonia Popa Drejtori Përgjithshëm i Turizmit
AKU	Afrim Baka Drejtor i Përgjithshëm
Zyra e Kryeministrit/ Departamenti Programeve të Zhvillimit, Financimeve dhe Asistencës së Huaj	Josif Gjani Koordinator – Njësia e Programimit Financiar/PMO
Enti Shtetëror i Fara-fidanëve	Petrit Topi Drejtor Ekzekutiv

### 13.3. Rezultatet e konsultimeve – Përmbledhje

Rezultatet e konsultimeve jepen në Aneksin 6.

## 14. REZULTAETET DHE REKOMANDIMETE VLERËSIMIT EX-ANTE TË PROGRAMIT

### 14.1. Përshkrim i procesit

Vlerësimi ex-ante është kryer në periudhën Tetor-Dhjetor 2014 nga ana e Konsorciumit AETS dhe CARDNO. Procesi i vlerësimit ka kaluar në pesë faza:

- Kërkimi i të dhënave publike (Desk research);
- Misioni i mbledhjes së të dhënave në Shqipëri (intervista individuale dhe në grup me përfaqësuesit e institucioneve përkatëse, organizatave dhe palëve të interesuara);
- Analizimi dhe raportimi;
- Prezantimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve dhe diskutimi rreth zbatimit të rekomandimeve me MBZHRAU dhe Strukturën Operative IPARD.
- Përgatitja e raportit të vlerësimit *ex-ante*.

Vlerësimi ex-ante është përgatitur duke iu referuar Udhëzimeve mbi vlerësimet ex-ante të Instrumentit për programet IPARD II, i përgatitur nga Drejtoria për Bujqësinë dhe Zhvillimin

Rural (DG Agri), në Shkurt 2014, plotësuar me udhëzimet ex-ante për Programet e Zhvillimit Rural në kuder të Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) përgatitur nga DG Agri në vitin 2013.

## **14.2. Përmbledhje e rekomandimeve**

Programi dhe ndërhyrjet e parashikuara prej tij janë sa të rëndësishëm po aq edhe në përputhje me nevojat e sektorëve të përfshirë në të. Për sektorët parashikohet dhënia e mbështetjes së kombinuar me qëllim a) forcimin e konkureshëmrisë së tyre dhe b) përmbushja e standardeve të BE-së si hap i rëndësishëm për zhvillimin profesional dhe ekonomik të nën-sektorëve si dhe do të kontribuojë për rritjen e profesionalizmit të nevojshëm për tregjet e së ardhmes. Vlerësimi i ndikimeve të pritshme të programit tregon për kontributin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në veçanti në zonat rurale.

Rekomandimet kryesore të raportit të vlerësimit ex-ante të programit janë si më poshtë vijon:

### ***Analiza SWOT dhe vlerësimi nevojave***

#### *Përdorimi i treguesve të kontekstit:*

Treguesit e kontekstit, një element i detyrueshëm në të gjitha PZHR-të e Vendeve Anëtare, mund të përdoren në mënyrë aktive si instrument për strukturimin e pjesës përshkruese dhe analizës së situatës në sektorët e bujqësisë dhe ushqimit. Treguesit e kontekstit mund të përdoren edhe për analizën e situatës, ku të gjithë treguesit, për aq sa është e mundur, duhet të përdoren (së bashku me një vlerësim krahasues të treguesve të cilët janë duke u përdorur për momentin). Përdorimi i treguesve të kontekstit bën të mundur për AM-në që të evitohet harxhimi i kohës me përshkrime të temave të parëndësishme nga njëra anë dhe nga ana tjetër të sigurojë që të gjitha temat e rëndësishme janë përfshirë.

#### *Sinteza e SWOT:*

Analiza SWOT është një përmbledhje e analizës së gjendjes së sektorëve. Tabelat SWOT janë përgatitur shumë mirë por do të ishin më të përshtatshme nëse do paraqiteshin në formën e anekseve. Rekomandohet që të përgatitet një sintezë prej 1-faqeje e analizës SWOT ku do të paraqitet orientimi i përgjithshëm strategjik i konkluduar prej saj.

### ***Logjika e ndërhyrjeve***

#### *Vlerësimi i Fazës 1 dhe 2*

Të merret në konsideratë ideja e një programi IPARD II me 2 faza. Ekziston një nevojë urgjente në Shqipëri për forcimin e nivelit të njohurive të sektorëve dhe shërbimi këshillimor mund të jetë një instrument i dobishëm në këtë aspekt. Për këtë arsye rekomandohet përfshirja e një faze të dytë masash (Shërbimi Këshillimor, Agro-mjedisore klimaterike dhe, në momentin që kanë përfunduar përgatitjet e duhura ajo LEADER) në versionin që keni në dorësi dhe planifikimi i zbatimit të tyre duke filluar nga viti 2017. Periudha deri në vitin 2017 mendohet se është e mjaftueshme për përgatitjen e masave në fjalë.

#### *Përmbledhje e logjikës së ndërhyrjeve*

Tabela e përgatitur për pasqyrimin e përmbledhjes së logjikës së ndërhyrjeve mund të jetë edhe më e saktë se sa është dhënë. Rishikimi i përmbledhjes së logjikës ndërhyrjeve që përfshin të gjitha nivelet nga input-et, përmes output-eve deri tek rezultatet si dhe ndikimet duhet të përgatiten në atë mënyrë që të pasqyrojnë sa më mirë logjikën mbi të cilën është ngritur programi. Ky rekomandim shkon përtej minimumit të kërkesave të DG Agri-t, por pavarësisht kësaj është një rekomandim i rëndësishëm për MBZHRAU-n në mënyrë që logjika në bazë të së cilës do të zbatohet programi të paraqitet dhe monitorohet sa më mirë.

## ***Përcaktimi objektivave dhe shpërndarja e alokimeve financiare***

### *Argumentimi i alokimeve të planit financiar*

Në tekst nuk ka një shpjegim të mënyrës se si arrihet balanca e planit financiar ose se si lidhet shpërndarja e fondeve me nevojat dhe objektivat. Argumentimi që qëndron pas shpërndarjes së fondeve ndërmjet masave duhet që të përshkruhet dhe arsyet të bëhen transparente. Për këtë qëllim i përshtatshëm do të mund të ishte një model me shumë-kritere për analizimin e kriterëve objektivë për shpërndarjen e fondeve sipas sektorëve dhe masave, gjë që paraqitet shkurtimisht në raportin e vlerësimit ex-ante.

### *Përmirësimi i përcaktimit sasior të objektivave*

Vetëm një pjesë e objektivave janë përcaktuar nga ana sasiore në tekstin aktual. Të gjitha objektivat e përfshirë në tabelën 6.4 duhet të përcaktohen nga ana sasiore në atë masë që është e mundur duke përdorur vlerësimet e paraqitura në këtë raport dhe të dhënat nga përshkrimi i masave në draftin e tekstit të programit. Kjo do të bënte që monitorimi dhe menaxhimi i programit të ishte më i lehtë dhe më transparent.

## ***Përgatitjet për vënien në zbatim***

### *Hartimi i masave (1)*

Niveli i aftësive në sektorin e bujqësisë dhe përpunimit ushqimor konsiderohet të jetë përgjithësisht i ulët dhe mbështetja me investime është e nevojshme për të rritur kapacitetet e prodhimit, produktivitetin dhe cilësinë e produkteve. gjithsesi, transferimi i njohurive duhet të jetë pjesë e mbështetjes në mënyrë që këto investime të jenë më të qëndrueshme. Duhet të merret në konsideratë që mbështetja me investime të jetë e kushtëzuar nga pjesëmarrja në trajnimet përkatëse nga ana e marrësve të mbështetjes.

### *Hartimi i masave (2)*

Me qëllim që të përcaktohet vija e demarkacionit me programet e tjera të mbështetjes dhe të garantohet që mbështetja me investime shënjestrën fermat dhe sipërmarrjet e orientuara drejt tregut, rekomandohet rritja nivelit të pragut të mbështetjes. Të merret në konsideratë mundësia e rritjes së pragut të mbështetjes me investime për masat e përzgjedhura si dhe përshtatja e kapaciteteve minimale të prodhimit në përputhje me të.

### *Autoriteti Menaxhues (AM)*

Roli i AM-së është i rëndësishëm si për programin edhe për zbatimin e programit, përfshirë Monitorimin dhe Vlerësimin. Ekziston një nevojë urgjente si për fuqizimin e AM-së brenda MBZHRAU-t ashtu dhe te kapaciteteve e personelit të tij (për sa i përket numrit dhe aftësive).

### *Agjencia e Pagesave (AP)*

Eksperiencia e fituar gjatë zbatimit të programit IPARD Like tregon se përdorimi i burimeve është ekstensiv dhe po ashtu koha e harxhuar për përpunimin e aplikimeve dhe kërkesave për pagesë është relativisht e gjatë. Duhet të merret në konsideratë rritja e efikasitetit të procedurave të zbatimit. Një hap i parë do të ishte azhorinimi i Analizës ekzistuese të Ngarkesës së Punës (Workload Analysis) për AP-në dhe pastaj të merret në konsideratë si të përmirësohen efikasiteti i procedurave përmes Asistencës Teknike.

### *Monitorimi dhe Vlerësimi*

Monitorimi dhe Vlerësimi është i një rëndësie parësore për të garantuar shpenzimin e burimeve në mënyrë efikase dhe eficiente në përfitim të sektorëve. Në një situatë kur burimet janë të pakta kjo gjë bëhet edhe më e rëndësishme. Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit në AZHBR duhet të rikonceptohet dhe sistemi TI të përmirësohet në mënyrë që të mundësohet mbulimi i të gjitha të dhënave përkatëse brenda një sistemi të përmirësuar, përfshirë të dhënat mbi rezultatet dhe ndikimet e ndërhyrjeve të kryera.



*Masat mjedisore*

Në mënyrë që të forcohen përpjekjet e kombinuara mes MBZHRAU dhe Ministrisë së Mjedisit lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës, rekomandohet ngritja e një grupi pune të përbashkët teknik për a) koordinimin dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi përmes kontrolleve, organeve inspektuese etje., dhe b) si dhe për të përgatitur dhe zbatuar masën agro-mjedisore dhe klimaterike të IPARD II duke filluar nga 2017.

*Praktikat e mira Bujqësore dhe Mjedisore (GAEP)*

Përshkrim i rekomandimit: në vazhdim të rekomandimit të mësipërm, rekomandohet krijimi i një udhëzuesi mbi Praktikat e mira Bujqësore dhe Mjedisore si dhe të bëhet e mundur që këto udhëzime të shpërndahen për sektorin e bujqësisë. Për më tepër, trajnimi i shërbimeve këshillimore dhe i fermerëve për vënien në praktikë të këtyre udhëzimeve duhet që të përfshihet në këtë paketë në mënyrë që të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të burimeve të sektorëve të bujqësisë dhe ushqimit.

**Përmbledhje e rekomandimeve**

<b>Data</b>	<b>Tema</b>	<b>Rekomandimet</b>	<b>Si është pasqyruar rekomandimi, ose në të kundërt argumentet lidhur me mos marrjen parasysh të tij</b>
<i>Analiza SËOT dhe vlerësimi nevojave</i>			
28/11/2014	Përdorimi i treguesve të kontekstit	Përdorimi i treguesve të kontekstit si mjet strukturës i analizës së situatës. Plotësimi për aq sa është e mundur dhe të gjithë treguesve dhe vlerësimi krahasues kundrejt atyre që janë në përdorim.	Pranuar. Informacioni i munguar mbi treguesit e kontekstit u plotësua atje ku ishte e mundur.
28/11/2014	SWOT	Përgatitja e sintezës së SWOT ku përshkruhet orientimi i përgjithshëm strategjik konkluduar nga analiza SWOT.	Pranuar. Është shtuar Sinteza e analizës SWOT.
<i>Ndërtimi i logjikës së ndërhyrjeve</i>			
28/11/2014	Marrja në konsideratë e fazës 1 dhe 2	Marrja në konsideratë e idesë së një programi IPARD II me 2 faza. Fillimi i së cilës bëhet në 2017 duke lënë kohë të mjaftueshme përgatitjes së masave përkatëse.	Nuk është pranuar. Fillimi i njëkohshëm i të gjitha masave do ta bënte të vështirë për AP-në që të përgatitej për marrjen e besimit në lidhje me zbatimin e detyrave buxhetore. Programi është ndërtuar duke supozuar si vit të fillimit të zbatimit vitin 2016. Masa ‘Shërbimet Këshillimore’ është përcaktuar të fillojë në 2016 po ashtu. Masa ‘Zbatimi i Strategjive Lokale të Zhvillimit – LEADER’ ka nevojë për të paktën 1 vit ndërtim kapacitetesh të LAG-eve potenciale dhe përzgjedhje pasuese, që do të financohen nëpërmjet masës së Asistencës Teknike, pas akreditimit të saj. Për këtë arsye nuk mund të fillojnë në të njëjtën me programin.
28/11/2014	Përmbledhje e logjikës së ndërhyrjeve	Rishikim i përmbledhjes së logjikës së ndërhyrjeve ku të përfshihen të gjitha nivelet nga input-et, përmes output-eve deri	Nuk është pranuar. Pjesa 6.4 e programit është përgatitur në përputhje me udhëzimet mbi

<b>Data</b>	<b>Tema</b>	<b>Rekomandimet</b>	<b>Si është pasqyruar rekomandimi, ose në të kundërt argumentet lidhur me mos marrjen parasysh të tij</b>
		tek rezultate dhe ndikimet.	programimin e IPARD II duke përdorur të gjithë treguesit përkatës.
<i>Përcaktimi objektivave dhe shpërndarja e alokimeve financiare</i>			
28/11/2014	Plani financiar	Përshkrim i argumenteve që qëndrojnë pas shpërndarjes së fondeve ndërmjet masave si dhe bërja transparente e arsyeve të tyre.	Pranuar. Argumentimi është dhënë në Pjesën 6.2
28/11/2014	Objektivat	Përcaktimi sasior i objektivave në masën që është e mundur duke përdorur vlerësimet që gjenden në këtë raport.	Nuk është pranuar. Të gjithë objektivat në program janë përcaktuar nga ana sasiore.
<i>Zbatimi, monitorimi, vlerësimi dhe planifikimi financiar i Programit</i>			
28/11/2014	Hartimi i masave	Marrja në konsideratë e dhënies së mbështetjes për investime me kusht pjesëmarrjen në trajnimet përkatëse nga ana e marrësve të mbështetjes.	Nuk është pranuar. AM-ja do të bashkëpunojë me të gjithë institucionet përkatëse të trajnimit si dhe shërbimet këshillimore për të garantuar mundësitë e trajnimit të aplikantëve dhe marrësve potenciale të mbështetjes. Gjithësi, pjesëmarrja në trajnime nuk do të jetë e detyrueshme për marrësit e mbështetjes për investime për të evituar riskun e gabimeve dhe vonesave në zbatimin e projekteve.
28/11/2014	Hartimi i masave	Rritja e pragut të mbështetjes për investime për masat e përzgjedhura dhe përshtatja e kapaciteteve të prodhimit me këtë prag.	Pranuar. Pragu i investimeve është rritur.
28/11/2014	AM	Fuqizimi i AM-së në MBZHRAU si dhe kapaciteteve të personelit të saj (si në numër dhe në aftësi).	Pranuar. Janë planifikuar veprimtari shtesë për ngritjen e kapaciteteve. Do të bëhet azhurnimi i analizës së ngarkesës së punës dhe numri i personelit do të përshtatet në përputhje me të.
28/11/2014	AP	Azhurnimi i VNP-se (WLA) të AP-së dhe gjetja e mënyrës për rritjen e efikasitetit të procedurave të saj përmes asistencës teknike.	Pranuar. Do të bëhet azhurnimi i analizës së ngarkesës së punës. Efikasiteti i procedurave do të rivlerësohet dhe ku është e përshtatshme dhe pa rënë ndesh me Marrëveshjen Sektoriale ato do të thjeshtëzohen.
28/11/2014	Monitorimi dhe Vlerësimi	Rivlerësim i sistemit të monitorim-vlerësimit dhe përmirësimi i sistemit TI për të bërë të mundur mbulimin e të gjitha të dhënave përkatëse përmes një sistemi më të mirë Monitorimi dhe Vlerësimi.	Pranuar. Do të përcaktohen të dhënat e nevojshme për monitorimin dhe vlerësimin si dhe sistemi ekzistues do të përshtatet përpara fillimit të zbatimit të masave.
28/11/2014	Masat mjedisore	Ngritja e një grupi teknik të përbashkët me qëllim a)	Pranuar. Grupi teknik i punës parashikohet të

Data	Tema	Rekomandimet	Si është pasqyruar rekomandimi, ose në të kundërt argumentet lidhur me mos marrjen parasysh të tij
		koordinimin dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi përmes kontrolleve, trupave inspektuese etj., dhe b) përgatitjes për hartimin dhe zbatimin e masave agro-mjedisore dhe klimaterike të IPARD II duke filluar nga 2017.	ngrihet në 2015 dhe do të bëjë të mundur përgatitjen e masës ‘Agro-mjedisore, klimaterike dhe të bujqësisë organike’.
28/11/2014	Praktikat e mira Bujqësore dhe Mjedisore	Hartimi i udhëzimeve të Praktikave të Mira Bujqësore dhe Mjedisore dhe shpërndarja e tyre për sektorin e bujqësisë. Trajnimi i shërbimeve këshillimore dhe fermerëve në vënien në praktikë të këtyre udhëzimeve duhet të përfshihet në paketë me qëllim që të kontribuohet në përmirësimin e menaxhimit të burimeve në sektorin agro-ushqimor.	Pranuar.  Udhëzuesi i Praktikave të Mira Bujqësore dhe Mjedisore do të përgatitet dhe trajnimet do të organizohen.

Raporti i plotë i vlerësimit ex-ante është pjesë e Aneksit 8.

## 15. KËRKESAT E KUADRIT LIGJOR TË IPA-S MBI KOMUNIKIMIN, VIZIBILITETIN DHE TRANSPARENCËN

### 15.1. Veprimtaritë e parashikuara për informimin e marrësve potencialë të mbështetjes, organizatave profesionale, partnerëve ekonomike, socialë dhe mjedisore, organeve të përfshira në promovimin e barazisë mes grave dhe burrave si dhe OJQ-ve lidhur me mundësitë e ofruara nga programi dhe rregullat e përfitimit të financimit.

Struktura Operative e IPARD II ka përgjegjësinë për kryerjen e komunikimit dhe vizibilitetit të programit në mënyrë efektive dhe transparente. Veprimet e lidhura me vizibilitetin dhe transparencën kanë për qëllim:

- Paraqitjen e kontributit të projekteve të mbështetura për arritjen e objektivave të programit IPARD II;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerësi dhe mbështetjen për projektet e financuara;
- Nënvizimi për audiencat përkatëse i vlerës së shtuar dhe ndikimit të programeve dhe veprimeve të BE-së.
- Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve.

AM-ja është përgjegjëse për planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin e veprimtarive të lidhura me komunikimin dhe vizibilitetin. Ajo harton, në konsultim me Komisionin dhe Komitetin Monitorues të IPARD II, *Planin e vizibilitetit dhe komunikimit*. Ky plan mbulon të gjithë periudhën e programit IPARD II dhe vihet në zbatim përmes një kalendari vjetor veprimesh. Efikasiteti i zbatimit të planit do të monitorohet dhe veprimtaritë dhe rezultatet e tyre i raportohen Komitetit Monitorues të IPARD II, Komitetit Monitorues IPA II dhe Komisionit përmes raporteve Vjetore/Përfundimtare të zbatimit. Gjatë takimeve të Komitetit Monitorues të

IPARD II, kryesuesi i tij raporton mbi ecurinë e zbatimit të veprimtarive informuese dhe promovuese si dhe vë në dispozicion të anëtarëve të Komitetit shembuj nga këto veprimtari.

*Plani i vizibilitetit dhe komunikimit përmban:*

- synimet dhe target grupet;
- përmbajtjen dhe strategjinë e komunikimit dhe masat informuese;
- buxhetin paraprak;
- departamentet apo organet përgjegjëse për zbatimin e tij;
- kriteret që do të përdoren për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit të informacionit dhe masave promovuese për as i përket transparencës, ndërgjegjësimit të programit IPARD II si dhe rolit të BE-së.

Agjencia IPARD zhvillon fushatën informuese për informimin e aplikantëve potencialë, organizatave profesionale, partnerëve ekonomikë, socialë dhe mjedisore si dhe OJQ-ve përkatëse mbi:

- mundësitë për financim dhe shpalljes së thirrjes për dorëzimin e aplikimeve;
- kriteret e pranueshmërisë dhe përzgjedhjes;
- procedurat administrative që duhen ndjekur;
- procedura e përzgjedhjes së aplikimeve edhe periudha kohore e nevojshme për të;
- vënien në dispozicion të kontakteve në nivel kombëtar/vendor, për tu përgjigjur pyetjeve mbi kriteret e përzgjedhjes/shpalljes fitues, dokumenteve të aplikimit dhe përgatitjen e paketës informuese.

Fushata e informimit të aplikantëve potenciale zhvillohet përmes:

- Ngritjen dhe mirëmbajtjes së një faqe interneti të programit, në të cilin është i publikuar Programi IPARD II, informacione lidhur me periudhën e zbatimit të programit dhe çdo lloj konsultimi publik të zhvilluar, legjislacioni vendas për zbatimin e masave, udhëzuesi për aplikantët, thirrjet për dorëzimin e aplikimeve, si dhe informacione të tjera për marrësit potencialë të mbështetjes;
- Organizimin e evenimenteve informuese, seminareve dhe trajnimeve në nivel kombëtar dhe qarku;
- Përgatitjen e broshurave, fletë-palosjeve me informacione mbi mundësitë e informimit, kriteret e pranueshmërisë, procesit të aplikimit, etj.;
- Lajmërimet në mediat e shkruara dhe ato audio-vizive.

## **15.2 Veprimtaritë e parashikuara për informimin e marrësve të kontributit të BE-së**

Marrësit potencialë të kontributit të BE-së duhet të informohen mbi financimin e BE-së përmes masave informuese dhe nënvizimit të qartë të pjesës së financimit të BE-së në Kontratën e Grantit.

Kontrata e Grantit duhet të përfshijë dispozita të qarta, ku përcaktohen përgjegjësitë e marrësve të grantit lidhur me aspektet promovuese dhe ato të vizibilitetit, si dhe vënien në dijeni për faktin se lista e marrësve të financimit do të vihet në dispozicion të publikut nga Agjencia IPARD.

Agjencia IPARD informon marrësit e financimit që marrja e financimit nënkupton në të njëjtën kohë pranimin nga ana e tyre përfshirjes në listën e marrësve të financimit që do të publikohet.

### **15.3. Veprimtaritë për informimin e publikut të gjerë lidhur me rolin e BE-së në program dhe rezultatet e tij**

Struktura Operative informon publikun e gjerë lidhur me Programin IPARD II, arritjet dhe rezultatet e tij dhe rolin e BE-së, duke përdorur mjete të ndryshme, përfshirë:

- Organizimi i një aktiviteti kryesor informues përmes së cilit bëhet hapja e Programit;
- Organizimi i aktiviteti kryesor informimi çdo vit;
- Paraqitja e emblemës së BE-së në ambientet e AM-së dhe Agjencisë së Pagesave;
- Përgatitja dhe publikimi i imazheve, dhe logos së programit në mënyrë që të jetë i veçantë dhe i dallueshëm për publikun e gjerë;
- Publikimi në faqen e internetit të programit të –raporteve Vjetore/Përfundimtare të zbatimit të tij, protokolleve të takimeve të Komitetit Monitorues të IPARD II, vlerësimeve, dhe shembujve të projekteve të suksesshëm.

Veprimtaritë e vizibilitetit dhe promovuese duhet të përdorin kanalet e përshtatshme për përcjelljen e informacionit në mënyrë që të garantohet transparenca e partnerëve potencialë të ndryshëm dhe përfituesve, veçanërisht për SME-të, marrëve potencial të mbështetjes dhe partnerëve në zonat rurale.

Marrësit e mbështetjes kanë detyrimin për të informuar publikun e gjerë lidhur me kontributin e BE-së në investimin e kryer, detyrim i cili parashikohet edhe në Kontratën e Grantit. Për këtë qëllim, përgatiten Udhëzime të detajuara mbi formatet e vizibilitetit të cilat u vihen në dispozicion marrësve të mbështetjes dhe që janë në përputhje me Udhëzuesin e BE-së mbi Promovimin dhe Visibilitetin si dhe me logon e programit. Këto udhëzime përfshijnë instruksione të detajuara lidhur me formatet për këtë qëllim: tabela afishuese të vendosura në vendndodhjen e investimit si dhe pllakate të përherëshme për projektet e infrastrukturës, materiale promovuese, postera, deklarata shtypi, etje. Këto Udhëzime u jepen marrësve të mbështetjes në të njëjtën kohë me firmosjen e kontratës.

Agjencia IPARD publikon dhe mirëmban rregullisht (të paktën çdo gjashtë muaj) listën e investimeve dhe marrësve të mbështetjes nga financimi i BE-së në të cilën përfshihet informacioni minimal i mundshëm nga Marrëveshja Sektoriale duke pasur parasysh gjithmonë respektimin e kërkesave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo listë vihet në dispozicion nënë format të tillë që lejon grupimin, kërkimin dhe nxjerrjen e të dhënave si dhe krahasimin e tyre, si p.sh. në format CSV ose XML. Kjo listë vihet në dispozicion të publikut të gjerë përmes faqes së vetme të internetit të programit.

## **16. MËNYRA E PROMOVIMIT TË BARAZISË GJINORE DHE MOSDISKRIMINIMIT PËRGJATË TË GJITHA FAZAVE TË NDRYSHME TË PROGRAMIT (HARTIMIT, ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT)**

### **16.1. Përshkrim i mënyrës se sido të promovohet barazia gjinore gjatë fazave të ndryshme të programit (hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit)**

Në përputhje me Aide-Mémoire mbi Çështjet Gjinorë të KE-së (2007-2013 dhe KE), dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi mbi shanset e barabarta dhe mosdiskriminimin, AM-ja siguron që barazia gjinore dhe mosdiskriminimi gjejnë vëmendjen e duhur gjatë hartimit të programit IPARD II, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të tij duke marrë në konsideratë parimet e më poshtme:

Bashke me gjendjen aktuale, atje ku është e mundur përshkruhet edhe situata social-ekonomike duke përdorur të dhëna gjinore të disagreguara;

Strategjia e Programit respekton barazinë gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore;

Kriteret e përzgjedhjes, ne varësi të rastit, i japin përparësi projekteve të dorëzuara nga femra;

Gjatë konsultimeve të draft Programit u përfshinë organe të cilët promovojnë barazinë gjinore;

Veprimtaritë informuese dhe promovuese patën si objektiv pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave. AM-ja siguron që materialet e printuara dhe evenimentet nuk diskriminojnë/përbëjnë pengesë për pjesëmarrjen e grave dhe personave me aftësi të kufizuara;

Organizatrat që përfaqësojnë barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin do të ftohen si pjesë e Komitetit Monitorues IPARD II;

Do të organizohen trajnime për ngritjen e kapaciteteve të Strukturës Operative mbi barazinë gjinore, veçanërisht në projektet e zbatuara në zonat rurale;

Të gjithë treguesit e monitorimit dhe vlerësimit atje ku është e mundur do të disagregohen nga pikëpamja gjinore. Raportet Vjetore/ Përfundimtare të zbatimit dhe ato të vlerësimit do të përfshijnë një pjesë të veçantë mbi barazinë gjinore ku do të analizohen efektet e programit mbi barazinë gjinore.

Marrësit e mbështetjes financiare duhet të informohen mbi detyrimin për të integruar në projektet e tyre perspektivën gjinore dhe parimin e mosdiskriminimit. AM-ja përzgjedh dhe publikon shembujt e projekteve të suksesshme, të zbatuara nga fermerat apo kompanitë e drejtuara nga gra.

## **16.2. Përshkrim i mënyrës se si parandalohet diskriminimi në bazë të seksit, racës, origjinës, besimit fetar, moshës, orientimit seksual, gjatë fazave të ndryshme të zbatimit të programit.**

*Ligji mbi Mbrojtjen nga diskriminimi me nr. 10221 i datës 4.02.2010, prezanton parimin e barazisë për sa i përket gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, politik, fetar, filozofik, ekonomik, dhe gjendjes arsimore dhe sociale, shtetëzarisë, lidhjeve prindërore/përgjegjësitë, moshës, statusit familjar dhe martesor, statusit civil, rezidencës, gjendjes shëndetësore, paaftësisë për punë, përkatësia në një grupim të veçantë si dhe për sa i përket çdo lloj tjetër përkatësie. Programi IPARD II respekton të gjitha parimet dhe dispozitat e këtij ligji në të gjitha fazat e zbatimit të tij.*

Kodi i Etikës së AM-se, iniciativat e zhvillimit të komunitetit, etje.) gjithashtu edhe mbi përgatitjen e projekteve. Ato kanë nevojë për informacione dhe njohuri mbi rregullat dhe procedurat e programit IPARD II, në mënyrë që të jenë efektive në promovimin e mundësive të financimit dhe dhënien e asistencës ndaj aplikantëve potencialë.

Në *Planin e vizibilitetit dhe komunikimit* AM-ja do të parashikojë organizimin e rregullt të trajnimeve dhe seminareve informues për target grupet e sipër përmendura në lidhje me: rregullat dhe procedurat e programit, procesin/dokumentacionin e aplikimit zhvillimin/forcimin e kapaciteteve të tyre për trajnimin dhe përgatitjen e mjaftueshme të personelit për të dhënë këshilla dhe informacione ndaj aplikantëve potencialë. Veprimtaritë për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve do të japin vëmendje të veçantë mundësisë së marrjes së informacionit dhe ekspertizës në zonat e thella rurale.

Masa e ‘Shërbimeve Këshillimore’ është e planifikuar të zbatohet, dhe pas hartimit dhe përfshirjes së saj në program dhënësit e shërbimeve këshillimore të përzgjedhura të mbështesin aplikantët potencialë për identifikimin dhe planifikimin e përmirësimeve të nevojshme ekonomike dhe mjedisore në ferma dhe për përgatitjen e kërkesave për pagesë.

Agjencia IPARD do të japi përgjigje pyetjeve të aplikantëve potencialë mbi kriteret e përfitueshmërisë dhe përzgjedhjes dhe procesin e aplikimit, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë të aplikantëve. Lista e pyetjeve më të shpeshta përgatitet dhe publikohet në faqen e internetit të programit dhe azhurnohet në mënyrë të rregullt.

Nga ana e AM-së do të hartohen Udhëzues të thjeshtë për tu përdorur lidhur me zbatimin e masave, me shembuj praktikë dhe bazuar në “mësimet e nxjerra”. AM-janë bashkëpunim me Agjencinë IPARD do të përgatisin një broshurë mbi gabimet e hasura më të shpesh gjatë procesit të aplikimit dhe pagesës që do të publikohet në faqen e internetit të programit si mjet për përmirësimin e cilësisë së aplikimeve dhe kërkesave për pagesë.

## 17. SHËRBIMET TEKNIKE DHE KËSHILLIMORE

Marrësit do të mbështeten gjatë aplikimeve dhe zbatimit të programit përmes:

- Shërbimit Këshillimor Publik dhe QTTB-të me strukturat e tyre në nivel qendror dhe lokal;
- Dhomat e tregtisë dhe shoqatat profesionale;
- Kompanitë e Konsulencës Private ;
- OJQ-të.

Kapacitet e shërbimi këshillimor dhe kompanive të konsulencës janë përmirësuar gjatë zbatimit të Skemës së Granteve IPARD-like dhe këta të fundit kanë mbështetur fermerët dhe kompanitë e përpunimit me informacione/sqarime mbi kriteret e pranueshmërisë si dhe në procesin e përgatitjes së paketës së aplikimit (konsulentët privatë). Gjithsesi, fakti që përqindja e refuzimit të projekteve të dorëzuara ishte e lartësi pasojë e mangësive të mëdha në kërkesat e aplikimit sjell nevojën e ngritjes së mëtejshme të kapaciteteve në mënyrë që aplikantëve potencialë dhe vecanërisht fermerëve tu sigurohet mbështetje cilësore për përgatitjen e aplikimeve.

Evenimente trajnimi dhe informacioni do të zhvillohen edhe me Dhomat e Tregtisë, shoqatat profesionale dhe OJQ-të. Këto organizma do të informojnë stafin e tyre mbi praktikën e mira dhe zgjidhjet inovative (veçanërisht në fushën e mbarështimit të gjedhit, bujqësisë organike, iniciativave për zhvillimin e komunitetit, etje.) si mbi përgatitjen e projekteve. Ata kanë nevojë për informacione dhe njohuri mbi rregullat dhe procedura e programit IPARD II në mënyrë që të jenë efikase në promovimin e mundësive të financimit dhe në asistimin e aplikantëve potencialë.

Në *Planin e vizibilitetit dhe komunikimit* AM-ja do të parashikojë organizimin e rregullt të trajnimeve dhe seminareve informues për target grupet e sipër përmendura në lidhje me: rregullat dhe procedurat e programit, procesin/dokumentacionin e aplikimit zhvillimin/forcimin e kapaciteteve të tyre për trajnimin dhe përgatitjen e mjaftueshme të personelit për të dhënë këshilla dhe informacione ndaj aplikantëve potencialë. Veprimtaritë për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve do të japin vëmendje të veçantë mundësisë së marrjes së informacionit dhe ekspertizës në zonat e thella rurale.

Masa e ‘Shërbimeve Këshillimore’ është e planifikuar të zbatohet, dhe pas hartimit dhe përfshirjes së saj në program, dhënësit e shërbimeve këshillimore do të jenë më të aftë të mbështesin aplikantët potencialë për identifikimin dhe planifikimin e përmirësimeve të nevojshme ekonomike dhe mjedisore në ferma dhe për përgatitjen e kërkesave për pagesë.

Agjencia IPARD do të japi përgjigje pyetjeve të aplikantëve potencialë mbi kriteret e përfitueshmërisë dhe përzgjedhjes dhe procesin e aplikimit, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë të aplikantëve. Lista e pyetjeve më të shpeshta përgatitet dhe publikohet në faqen e internetit të programit dhe azhurnohet në mënyrë të rregullt.

Nga ana e AM-së do të hartohen Udhëzues të thjeshtë për tu përdorur lidhur me zbatimin e masave, me shembuj praktikë dhe bazuar në “mësimet e nxjerra”. AM-janë bashkëpunim me Agjencinë IPARD do të përgatisin një broshurë mbi gabimet e hasura më të shpesh gjatë procesit të aplikimit dhe pagesës që do të publikohet në faqen e internetit të programit si mjet për përmirësimin e cilësisë së aplikimeve dhe kërkesave për pagesë.

## **18. ANEKSET**

### **ANEKSI 1. PËRKUFIZIMI STABILIMENTEVE TË VOGLA DHE TË MESME.**

Mikrondërmarrjet, ato të vogla dhe të mesme janë përkufizuar në përputhje me ligjin nr. 10042, date 22.12.2008 ‘Mbi disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8957, datë 17.1.2002 Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të ndryshuar’

#### “Neni 4

1. Ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.
2. Kategoria e mikro stabilimenteve dhe stabilimenteve të vogla e të mesme (NVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.
3. Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.
4. Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.



**ANEKSI 2. PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË RENTABILITETIT EKONOMIK**

**A. Projektet në të cilat totali i kostove të pranueshme të investimit nuk kalon vlerën 50,000 euro.**

Projektet duhet të dorëzojnë një Projekt Propozim Teknik i cili të përmbajë pasqyrën e thjeshtuar të të ardhurave dhe parashikimet e flukseve rrjedhëse të arkës. Projektet do të vlerësohen në lidhje me fitimin dhe aftësinë likuiduese dhe projekti do të marrë mbështetje, në rast se kriteret e dhëna më poshtë përmbushen:

- Fitimi neto  $\geq 0$ ; dhe,
- Totali i flukseve rrjedhëse të arkës  $\geq 0$ .

**B. Projektet në të cilat totali i kostove të pranueshme të investimit e kalon vlerën 50,000 euro.**

Projektet duhet të dorëzojnë një plan biznesi. Plani i biznesit do të vlerësohet lidhur me fitimin dhe aftësinë likuiduese dhe projekti do të mbështetet, në rast se kriteret e dhëna më poshtë përmbushen:

- Vlera Aktuale Neto (NPV)  $\geq 0$ ; dhe,
- Norma e Brendshme e Kthimit (IRR)  $\geq$  **norma e skontuar** (norma e Bankës së Shqipërisë).

**ANEKSI3. LISTAEZONAVERURALE**

QARKU	BASHKIA /KOMUNA	
<b>BERAT</b>		
	BERAT	POLIÇAN
	BOGOVË	POSHNJË
	CUKALAT	POTOM
	ÇEPAN	QENDËR SKRAPAR
	ÇOROVODË	ROSHNIK
	GJERBËS	SINJË
	KOZARE	TERPAN
	KUÇOVË	URA VAJGURORE
	KUTALLI	VELABISHT
	LESHNJË	VENDRESHË
	LUMAS	VERTOP
	OTLLAK	ZHEPË
	PERONDI	
<b>DIBER</b>		
	ARRAS	MAQELLARË
	BAZ	MARTANESH
	BULQIZË	MELAN
	BURREL	OSTREN
	DERJAN	PESHKOPI
	FUSHË BULQIZË	QENDËR TOMIN
	FUSHË MUHUR	RUKAJ
	FUSHË ÇIDHËN	SELISHTË
	GJORICË	SHUPENZË
	GURRË	SLLOVË
	KALA E DODËS	SUÇ

Programi IPARD II për Shqipërinë

QARKU	BASHKIA /KOMUNA	
	KASTRIOT	TREBISHT
	KLOS	ULËZ
	KOMSI	XIBËR
	LIS	ZALL DARDHË
	LURË	ZALL REÇ
	LUZNI	ZERQAN
	MACUKULL	
<b>DURRËS</b>		
	BUBQ	MAMINAS
	CUDHI	MANËZ
	FUSHË KRUIJË	NIKËL
	GJEPALAJ	RRASHBULL
	ISHËM	SHIJAK
	KATUND I RI	SUKTH
	KODËR THUMANË	XHAFZOTAJ
	KRUIJË	
<b>ELBASAN</b>		
	BELSH	ORENJË
	BRADASHESH	PAJOVË
	CËRRIK	PAPËR
	FIERZË	PEQIN
	FUNARË	PËRPARIM
	GJERGJAN	PËRRENJAS
	GJINAR	PISHAJ
	GJOCAJ	POLIS
	GOSTIMË	POROÇAN
	GRACEN	QENDËR
	GRAMSH	QUKËS
	GREKAN	RRAJCË
	HOTOLISHT	RRASË
	KAJAN	SHALËS
	KARINË	SHEZË
	KLOS	SHIRGJAN
	KODOVJAT	SHUSHICË
	KUKUR	SKËNDERBEGAS
	KUSHOVË	STËBLEVË
	LABINOT FUSHË	STRAVAJ
	LABINOT MAL	SULT
	LENIE	TREGAN
	LIBRAZHD	TUNJË
LUNIK	ZAVALIN	
MOLLA		
<b>FIER</b>		
	ALLKAJ	KUMAN
	ARANITAS	KURJAN
	BALLAGAT	KUTË
	BALLSH	LEVAN
	BUBULLIMË	LIBOFSHË
	CAKRAN	LUSHNJE
	DERMENAS	MBROSTAR
	DIVJAKË	NGRAÇAN
	DUSHK	PATOS
	FIERSHEGAN	PORTËZ
	FRAKULL	QENDËR (FIER)
	FRATAR	QENDËR (MALLAKASTËR)
	GOLEM	ROSKOVEC
	GRABIAN	RREMAS
	GRADISHTË	RUZHDIË
	GRESHICË	SELITË
	HEKAL	STRUM
	HYSGJOKAJ	TËRBUF
KARBUNARË	TOPOJË	
KOLONJË	ZHARRËS	
KRUTJE		
<b>GJIROKASTËR</b>		
	ANTIGONË	LOPËS
	BALLABAN	LUFTINJË
	BUZ	LUNXHËRI
	CEPO	MEMALIAJ
	ÇARÇOVË	ODRIË

Programi IPARD II për Shqipërinë

QARKU	BASHKIA /KOMUNA	
	DISHNICË	PËRMET
	DROPULL I POSHTËM	PETRAN
	DROPULL I SIPËRM	PICAR
	FRASHËR	POGON
	FSHAT MEMALIAJ	QENDËR PISKOVË
	GJIROKASTËR	QENDËR (TEPELENË)
	KËLCYRË	QENDËR LIBOHOVË
	KRAHËS	QESARAT
	KURVELESH	SUKË
	LAZARAT	TEPELENË
	LIBOHOVË	ZAGORI
<b>KORÇË</b>		
	BARMASH	MOLLAJ
	BILISHT	MOLLAS.
	BUÇIMAS	NOVOSELË
	ÇËRRAVË	PIRG
	ÇLIRIM	POGRADEC
	DARDHAS	POJAN
	DRENOVË	PROGËR
	ERSEKË	PROPTISHT
	GORË	QENDËR BILISHT
	HOÇISHT	QENDËR ERSEKE
	HUDENISHT	QENDËR LESKOVIK
	LEKAS	QENDËR KORCE
	LESKOVIK	TREBINJË
	LIBONIK	VELÇAN
	LIQENAS	VITHKUQ
	MALIQ	VOSKOP
MIRAS	VOSKOPOJË	
MOGLICË	VRESHTAS	
<b>KUKËS</b>		
	ARRËN	KUKËS
	BAJRAM CURRI	LEKBIBAJ
	BICAJ	LLUGAJ
	BUJAN	MALZI
	BUSHTRICË	MARGEGAJ
	BYTYÇ	SHISHTAVEC
	FAJZA	SHTIQËN
	FIERZË .	SURROJ
	GJINAJ	TËRTHORE
	GOLAJ	TOPOJAN
	GRYKË ÇAJË	TROPOJË
	KALIS	UJËMISHT
	KOLSH	ZAPOD
	KRUMË	
<b>LEZHË</b>		
	BALLDREN I RI	MAMURRAS
	BLINISHT	MILOT
	DAJÇ	OROSH
	FAN	RRËSHEN
	FUSHË KUQE	RUBIK
	KAÇINAR	SELITË.
	KALLMET	SHËNGJIN
	KOLÇ	SHËNKOLL
	KTHJELLË	UNGREJ
	LAÇ	ZEJMEN
LEZHË		
<b>SHKODËR</b>		
	ANA E MALIT	PUKË
	BËRDICË	PULT
	BLERIM	QAFË MALI
	BUSHAT	QELËZ
	DAJÇ.	QENDËR .
	FIERZË.	QERRET
	FUSHË ARRËZ	RRAPË
	GJEGJAN	RRETHINAT
	GRUEMIRË	SHALË
	GURI I ZI	SHKREL
	HAJMEL	SHLLAK
	IBALLË	SHOSH
	KASTRAT	TEMAL
KELMEND	VAU I DEJËS	

Programi IPARD II për Shqipërinë

QARKU	BASHKIA /KOMUNA	
	KOPLIK	VELIPOJË
	POSTRIBË	VIG-MNELË
<b>TIRANË</b>		
	BALDUSHK	NDROQ
	BËRXULLË	PASKUQAN
	BËRZHITË	PETRELË
	DAJT	PEZË
	FARKË	PREZË
	GOLEM	RROGOZHINË
	GOSË	SHËNGJERGJ
	HELMËS	SINABALLAJ
	KASHAR	SYNEJ
	KAVAJË	VAQARR
	KËRRABË	VORË
	KRYEVIDH	ZALL BASTAR
	LEKAJ	ZALL HERR
	LUZ I VOGEL	
<b>VLORË</b>		
	ALIKO	MESOPOTAM
	ARMEN	NOVOSELË.
	BRATAJ	ORIKUM
	DELVINË	QENDËR
	DHIVËR	SARANDË
	FINIQ	SELENICË
	HIMARË	SEVASTER
	KONISPOL	SHUSHICË.
	KOTE	VERGO
	KSAMIL	VLLAHINË
	LIVADHJA	VRANISHT
	LUKOVË	XARRË
	MARKAT	

**ANEKSI 4. LISTA E ZONAVE MË PAK TË AVANTAZHUARA MALORE/ZONAT MALORE ME PËRQINDJE MË TË LARTË MBËSHTETJEJE**

Kjo listë është miratuar me anë të Udhëzimit të Ministrit të MBUMK-së (MBZHRAU) me Nr. 3 datë 10/02/2011 për përcaktimin e zonave malore më pak të avantazuara.

**Përkufizimet e përdorura janë si më poshtë vijon:**

1) Zonat më pak të avantazuara malore janë ato të cilat përballen me kufizime të mëdha lidhur me mundësinë e përdorimit të tokës si dhe kostove të larta të përdorimit të mekanikës bujqësore, si pasojë e:

- a) Kushteve të vështira klimaterike, për shkak të lartësisë së konsiderueshme mbi nivelin e detit, gjë që ndikon në mënyrë domethënëse në reduktimin e sezonit të rritjes dhe prodhimit;
- b) Në lartësitë më të ulta, prania e shpateve të pjerrëta në shumicën e sipërfaqes kufizon përdorimin eficient të mjeteve të zakonshme të mekanikës bujqësore; ose
- c) Një kombinim i të dy faktorëve të mësipërm, në rastin kur kufizimi që vjen nga secili faktor i marrë më vete është më i vogël, por bashkimi i këtyre ndikimeve negative të të dy faktorëve rezulton në të njëjtin nivel kufizimi dhe vështirësish.

2) Njësia më e vogël e “zonës më pak të avantazhuar malore” është njësia e qeverisjes vendore (komuna ose bashkia).

2.2. Në mënyrë që të konsiderohet “zonë më pak e avantazhuar malore”, njësia e qeverisjes vendore duhet të përmbushë të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

- a) të paktën 50% sipërfaqes së tokës bujqësore shtrihet në lartësinë mbi 600 metra mbi nivelin e detit;
- b) të paktën 50% sipërfaqes së tokës bujqësore ka pjerrësi mbi 20%;
- c) të paktën 50% sipërfaqes së tokës bujqësore shtrihet në lartësinë mbi 300 metra mbi nivelin e detit dhe gjithashtu mbi 50% e totalit të tokës bujqësore ka pjerrësi mbi 15%;
- d) ka relief të pjerrët, që shtrihet me devijim standard të lartësisë mbi 200 metra mbi nivelin e detit;
- e) më shumë se 50% e territorit rrethohet nga: (i) njësi të qeverisjes vendore të klasifikuara si “më pak e favorizuar” të cilat përmbushin njërin prej kriterëve të mësipërme; ose (ii) pjesërisht e kufizuar njësi të qeverisjes vendore të klasifikuara “zona më pak të avantazhuara malore” dhe pjesërisht nga kufij shtetërorë.

Nën - prefektura	NQV të klasifikuara “zonë më pak e avantazhuar malore”	NQV të tjera
<b>BERAT</b>	<b>6</b>	<b>6</b>
	ROSHNIK	BERAT
	SINJË	CUKALAT
	TËRPAN	KUTALLI
	URA VAJGURORRE	LUMAS
	VELABISHT	OTLLAK
	VËRTOP	POSHNJE
<b>BULQIZË</b>	<b>8</b>	-
	BULQIZË	
	FUSHË BULQIZË	
	GIORICË	
	KLENJË (TREBISHT)	
	MARTANESH	
	OSTREN	
	SHUPENZË	
	ZERQAN	
<b>DELVINË</b>	<b>4</b>	-
	DELVINË	
	FINIQ	
	MESOPOTAM	

Programi IPARD II për Shqipërinë

Nën - prefektura	NQVtë klasifikuara “zonë më pak e avantazhuar malore”	NQV të tjera
	VERGO	
<b>DEVOLL</b>	<b>5</b>	-
	BILISHT BILISHT QENDËR HOÇISHT MIRAS PROGËR	
<b>DIBËR</b>	<b>15</b>	-
	ARRAS FUSHË CIDHËN KALAJA E DODËS KASTRIOT LURË LUZNI MAQELLARË MELAN MUHURR PESHKOPI SELISHTË SLOVË TOMIN ZALL-DARDHË ZALL-REÇ	
<b>DURRËS</b>	-	<b>10</b>
		DURRËS GJEPALAJ ISHËM KATUND I RI MAMINAS MANËZ RRASHBULL SHJAK SUKTH XHAFZOTAJ
<b>ELBASAN</b>	<b>10</b>	<b>13</b>
	BRADASHESH FUNAR GJINAR GRACEN LABINOT FUSHË LABINOT MAL MOLLAS SHUSHICË TREGAN ZAVALINË	BELSH CËRRIK ELBASAN FIERZË GJERGJAN GOSTIMË GREKAN KAJAN KLOS PAPËR RRASË SHALËS SHIRGJAN
<b>FIER</b>	-	<b>17</b>
		CAKRAN DERMENAS FIER FRAKULL KUMAN KURJAN LEVAN LIBOFSHË MBROSTAR PATOS PORTEZ QENDËR ROSKOVEC RUZHDIE STRUM TOPOJË ZHARRËZ
<b>GJIROKASTËR</b>	<b>13</b>	-
	ANTIGONË CEPO DROPULL I POSHTËM DROPULL I SIPËRM GJIROKASTËR LAZARAT LIBOHOVË LUNXHËRI	

Programi IPARD II për Shqipërinë

Nën - prefektura	NQVtë klasifikuara “zonë më pak e avantazhuar malore”	NQV të tjera
	ODRIE PICAR POGON QENDËR LIBOHOVË ZAGORI	
<b>GRAMSH</b>	<b>10</b>	-
	GRAMSH KODOVJAT KUKUR KUSHOVË LENIE PISHAJ POROÇAN SKËNDERBEGAS SULT TUNJË	
<b>HAS</b>	<b>4</b>	-
	FAJZË GJINAJ GOLAJ KRUMË	
<b>KAVAJË</b>	-	<b>10</b>
		GOLEM GOSË HELMAS KAVAJË KRYEVIDH LEKAJ LUZ I VOGËL RROGOZHINË SINABALLAJ SYNEJ
<b>KOLONJË</b>	<b>8</b>	-
	BARMASH ÇLIRIM ERSEKË LESKOVIK LESKOVIK QENDER MOLLAS NOVOSELË QENDËR ERSEKË	
<b>KORÇË</b>	<b>16</b>	-
	DRENOVË GORE KORÇË LEKAS LIBONIK LIQENAS MALIQ MOGLICË MOLLAJ PIRG POJAN QENDËR VITHKUQ VOSKOP VOSKOPOJË VRESHTAS	
<b>KRUJË</b>	<b>3</b>	<b>3</b>
	CUDHI KRUJË NIKËL	BUBQ FUSHË KRUJË KODËR THUMANË
<b>KUÇOVË</b>	-	<b>3</b>
		KOZARE KUÇOVË PERONDI
<b>KUKËS</b>	<b>15</b>	-
	ARRËN BICAJ BUSHTRICË GRYKË CAJE KALIS KOLSH KUKËS MALZI	

Programi IPARD II për Shqipërinë

Nën - prefektura	NQVtë klasifikuara “zonë më pak e avantazhuar malore”	NQV të tjera
	SHISHTAVEC SHTIQËN SURROJ TËRTHORE TOPOJAN UJMISHT ZAPOD	
<b>KURBIN</b>	<b>1</b>	<b>3</b>
	MILOT	FUSHË KUQE LAÇ MAMURRAS
<b>LEZHË</b>	<b>2</b>	<b>8</b>
	KALLMET KOLÇ	BALLDREN I RI BLINISHT DAJÇ LEZHË SHËNGJIN SHËNKOLL UNGREJ ZEJMEJ
<b>LIBRAZHD</b>	<b>11</b>	-
	HOTOLISHT LIBRAZHD LUNIK ORENJË POLIS PRRENJAS QENDËR QUKËS RAJCË STEBLEVË STRAVAJ	
<b>LUSHNJE</b>	-	<b>16</b>
		ALLKAJ BALLAGAT BUBULLIMË DIVJAKË DUSHK FIER SHEGAN GOLEM GRABIAN GRADISHTË HYSGJOKAJ KARBUNARË KOLONJË KRUTJE LUSHNJE REMAS TËRBUF
<b>MALËSI E MADHE</b>	<b>4</b>	<b>2</b>
	GRUEMIRË KASTRAT KELMEND SHKREL	KOPLIK QENDËR
<b>MALLAKASTËR</b>	<b>6</b>	<b>3</b>
	ARANITAS FRATAR GRESHICË KUTE NGRAÇAN SELITË	BALLSH HEKAL QENDËR
<b>MAT</b>	<b>12</b>	-
	BAZ BURREL DERJAN GURRË KLOS KOMSI LIS MACUKULL RUKAJ SUÇ ULËZ XIBËR	
<b>MIRDITË</b>	<b>7</b>	-



Programi IPARD II për Shqipërinë


Nën - prefektura	NQVtë klasifikuara “zonë më pak e avantazhuar malore”	NQV të tjera
	FAN KAÇINAR KTHJELLË OROSH RRËSHEN RUBIK SELITË	
<b>PEQIN</b>	-	<b>6</b>
		GJOCAJ KARINË PAJOVË PEQIN PËRPARIM SHEZË
<b>PËRMET</b>	<b>9</b>	-
	BALLABAN ÇARÇOVE DISHNICË FRASHËR KELCYRË PËRMET PETRAN QENDËR SUKË	
<b>POGRADEC</b>	<b>8</b>	-
	BUÇIMAS ÇERRAVË DARDHAS POGRADEC PROPTISHT TREBINJË UDENISHT VELÇAN	
<b>PUKË</b>	<b>10</b>	-
	BLERIM FIERZË FUSHË ARRËZ GJEGJAN IBALLË PUKË QAFË-MAL QELËZ QERRET RRAPE	
<b>SARANDË</b>	<b>6</b>	<b>3</b>
	DHIVER KONISPOL KSAMIL LIVADHIA LUKOVË MARKAT	ALIKO SARANDË XARRË
<b>SHKODËR</b>	<b>7</b>	<b>10</b>
	POSTRIBË PULT SHALË SHLLAK SHOSH TEMAL VAU I DEJËS	ANA E MALIT BËRDICË BUSHAT DAJÇ GURI I ZI HAJMEL RRETHINË SHKODËR VELIPOJË VIG-MNELË
<b>SKRAPAR</b>	<b>10</b>	-
	BOGOVË ÇEPAN ÇOROVODË GJERBËS LESHNJE POLIÇAN POTOM QENDËR VËNDRESHË ZHEPË	
<b>TEPELENË</b>	<b>10</b>	-
	BUZ	

Programi IPARD II për Shqipërinë


Nën - prefektura	NQVtë klasifikuara “zonë më pak e avantazhuar malore”	NQV të tjera
	KRAHËS KURVELESH LOPËS LUFTINJË MEMALIAJ MEMALIAJ FSHAT QENDËR QËSARAT TEPELENË	
<b>TIRANË</b>	<b>6</b>	<b>13</b>
	BËRZHITË DAJT KRRABË SHËNGJERGJ ZALL BASTAR ZALL HERR	BALDUSHK BËRXULLË FARKË KAMËZ KASHAR NDROQ PASKUQAN PETRELË PEZË PREZË TIRANË VAQARR VORË
<b>TROPOJË</b>	<b>8</b>	<b>-</b>
	BAJRAM CURRI BUJAN BYTYÇ FIERZË LEKBIBAJ LLUGAJ MARGEGAJ TROPOJË	
<b>VLORË</b>	<b>6</b>	<b>7</b>
	BRATAJ HIMARË KOTË ORIKUM SEVASTËR VRANISHT	ARMEN NOVOSELË QENDËR SELENICË SHUSHICË VLLAHINË VLORË
<b>Total</b>	<b>240</b>	<b>133</b>

**ANEKSI 5. ORGANIGRAMA E MA-SEDHE AGJENCISE IPARD**

**Struktura Organizative e Autoritetit Menaxhues**



**Struktura Organizaive e AZHBR**



**ANEKSI 6. REZULTATET E KONSULTIMEVE - PËRMBLEDHJE**

<b>Tema e konsultimit</b>	<b>Data e konsultimit</b>	<b>Koha në dispozicion</b>	<b>Emrat e institucioneve/kompanive/personave</b>	<b>Përmbledhje e rezultateve</b>
Objektivat e masave Kushtet e përfitueshmërisë Kriteret e përzgjedhjes Buxheti	11.12. 2014	05-11.12.2014	Z. Agim Rama, Specialist i Bimëve medicinale	- Programi duhet ti japi përparësi investimeve në varietetet lokale, prodhimin të farave dhe fidanëve si dhe ruajtjes së varieteteve autoktone; - Të mbështet ngritja e laboratorëve të analizave për bimët mjekësore; - Të mbështetet ngritja e organizatave të fermerëve; - Nxitja e intensifikimit të prodhimit përmes futjes në përdorim të teknologjive të reja.
	11.12. 2014	05-11.12.2014	Z. Mark Babani, Administrator i 'Mare Adriatik',	Të përfshihet përpunimi i peshkut në Program;
	11.12. 2014	05-11.12.2014	Z. Pal Nika, Specialist në Drejtorinë e Bujqësisë	Në përzgjedhjen e projekteve tu jepet përparësi kooperativave;
	11.12. 2014	05-11.12.2014	Z. Xheladin Zeka, Fermer bimësh medicinale,	- Ulja e vlerës dysheme të mbështetjes për sektorin e perimeve, në sera dhe në fushë të hapur; - Të futet në program edhe përpunimi i frutave të egra dhe i boronicës (në Shkodër kemi 100 ha me shegë të egra);
	11.12. 2014	05-11.12.2014	Znj. Margarita Pepa (NGO)	- Të përshejtohet përgatitja dhe fillimi i zbatimit të masës LEADER; - Të shtohet numri i konsulentëve, dhe ekstensionistëve të trajnuar për përgatitjen e planeve të biznesit; - Të publikohet një listë me konsulentë të trajnuar;
	11.12. 2014	05-11.12.2014	Z. Simon Gjoka, Fermer, Lezhë Z. Luftar Moli, Blegtor	Të lehtësohet procedura për marrjen e lejeve të ndërtimit;
	11.12. 2014	05-11.12.2014	Z. Xheladin Zeka Fermer bimësh medicinale	Të paktën 25% e buxhetit të masës së Diversifikimit dhe Zhvillimit të Biznesit të jetë për bimët medicinale dhe aromatike.
Objektivat e masave Sektorët prioritarë Kushtet e përfitueshmërisë Kriteret e përzgjedhjes Buxheti	11.12. 2014	05-11.12.2014	Z. Ymer Lekaj Specialist i AZHBR-së dhe Fermer	Të mbështetet forcimi i shërbimit veterinar përmes investimeve në qendrat veterinarë në zonat rurale, duke qenë se ka mungesë infrastrukture, klinikash veterinarë, laboratorëtje.
	11.12. 2014	05-11.12.2014	Z. Francesk Toma, Shërbimi Këshillimor, Lezhë	Të mbështeten bimët e rralla/të veçanta të sjella në Shqipëri nga vendet e huaja (si p.sh. disa lloje pemësh frutore që përdoren edhe për industrinë e përpunimit të drurit)
	11.12. 2014	05-11.12.2014	Znj. Mynyre Hysa, Shefe Shërbimit Këshillimor	Të përfshihet gështenja nën masën e Diversifikimit, kumbulla, dhe frutat e pyllit por gjithashtu edhe perime si lakra e Drishtit dhe bamja.

Tema e konsultimit	Data e konsultimit	Koha në dispozicion	Emrat e institucioneve/kompanive/personave	Përmbledhje e rezultateve
	16.12.2014	9-16.12.2014	Z.Arben Malo, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Korçë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mbështeten investimet në mbrojtjen e bimëve dhe futjen në përdorim të metodave të reja të mbrojtjes nga faktorët atmosferikë (p.sh. rrjetat mbrojtëse);</li> <li>- Ti jepet prioritet projekteve që vendosin marrëdhënie afat-gjata mes konsoliduesve - përpunuesve;</li> <li>- Të mbështeten investime në përmirësimin e tokave, për të krijuar kushtet e përshtatshme për mbjelljen e kulturave;</li> <li>- Të rriten kapacitetet laboratorike për kryerjen e analizave të tokës;</li> </ul>
	16.12.2014	9-16.12.2014	Z. Spiro Fuqi, Kompani Përpunuese, Korçë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të forcohen kapacitetet për monitorimin dhe kontrollin e trupave teknike për një zbatimin më të mirë të Programit;</li> <li>- Të kryhet një vlerësim i nevojave në bazë qarku dhe të bëhet një shpërndarje e fondeve mbi bazën e këtyre nevojave;</li> <li>- Të sigurohet informacion dhe konsulencë mbi cilësinë dhe varietetet e farave dhe fidanëve, në mënyrë që të garantohe rentabiliteti i investimeve dhe të përmbushen kërkesat e tregut.</li> </ul>
	16.12.2014	9-16.12.2014	Z. Arben Mucollari, përfaqësues i 'Agrinet' dhe i unionit të prodhuesve të mollës	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ti jepen përparësi investimeve e kapaciteteve frigoriferike të mollës, sepse është një numër i madh fermerësh në qark që kanë investuar në rritjen e prodhimit.</li> <li>- Ti jepet përparësi përpunimit të produkteve vendase në raport me ato të importuara;</li> </ul>
<p>Objektivat e masave</p> <p>Sektorët prioritarë</p> <p>Kushtet e përfitueshmërisë</p> <p>Kriteret e përzgjedhjes</p> <p>Buxheti</p>	16.12.2014	9-16.12.2014	Z. Enver Duma, Përfaqësues i Kompanisë 'BOVA' Z. Agron Çakalli, Përfaqësues i Federatës Bujqësore, Elbasan	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mbështeten bletaria dhe zinxhiri i vlerës së ullirit në Program;</li> <li>- Të mbështeten investimet në përmirësimin e tokave dhe ndërtimin e rezervuarëve.</li> </ul>
	16.12.2014	9-16.12.2014	Z. Shefqet Hysa Konsulent, Elbasan,	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mbështeten skemat e infrastrukturës së ujitjes në zona të tilla si ajo e Dumres në të cilën gjenden disa liqene ndërkohë që vetë zonës i mungon ujitja;</li> <li>- Të reduktohet sipërfaqja dysheme për vreshtat nga 1 ha në 0.5 ha.</li> </ul>
	16.12.2014	9-16.12.2014	Z. Vasfi Sherifi, Prodhues farash dhe tregtar inputesh, Korçë	Cilësia e farës ka një rëndësi të madhe për shtimin e prodhimit; për këtë arsye duhet ti jepet një nxitje shtimit të kapaciteteve laboratorike.
	16.12.2014	9-16.12.2014	Z. Kujtim Gjoni, Specialist Bujqësie Z. Filip Gjini, Specialist Ushqimi, Vlorë	Të ulet numri minimal i lopëve për sektorin e qumështit.
	14.01.2015	6-14.01.2015	Z. Balil Bineri, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Gjirokastër Z. Dervish Seferi,	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ulet vlera dysheme e investimeve në masën e investimeve në ferma në 20 mijë euro;</li> <li>- Sipërfaqja dysheme e vreshtave nuk duhet të ulet.</li> </ul>

Tema e konsultimit	Data e konsultimit	Koha në dispozicion	Emrat e institucioneve/kompanive/personave	Përmbledhje e rezultateve
<p>Objektivat e masave</p> <p>Sektorët prioritarë</p> <p>Kushtet e përfitueshmërisë</p> <p>Kriteret e përzgjedhjes</p> <p>Buxheti</p>			Shef i Shërbimit Këshillimor, Vlorë	
	14.01.2015	6-14.01.2015	<p>Z. Vesaf Musaj Prodhues i vajit të ullirit, Vlorë</p> <p>Znj. Luljeta Cenaj, Fermere, Vlorë</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ulet vlera dysheme e investimeve në masën e investimeve në ferma në 20 mijë euro;</li> <li>- Të mbështeten linjat e përpunimit të vajit të ullirit;</li> <li>- Pas hyrjes në fuqi të ndarjes së re administrative të qeverisë vendore të merren masa që fshatrat pjesë e bashkive të mëdha të jenë të jenë të mos përjashtohen nga mbështetja;</li> <li>- Ti jepet përparësi më e madhe fermerëve të rinj dhe grave; të vendosen kritere të veçanta përzgjedhjeje për ta.</li> </ul>
	14.01.2015	6-14.01.2015	Z. Vangjel Fero, Ekstensionist/ Konsulent, Gjirokastër	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të krijohet një grup konsulentësh me përvojë në hartimin e projekteve të stallave në mënyrë që fermerët të ndërgjegjësohen lidhur me standardet përkatëse;</li> <li>- Të ulet numri i dhomave për hotelet e turizmit rural;</li> </ul>
	15.01.2015	6-15.01.2015	Z. Beqir Fiska, Agronom – Prodhues Vere	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mbështeten investimet në rezervuarët e ujitjes nën masën e investimeve në përpunimin dhe tregimin e produkteve bujqësore.</li> <li>- Të bëhet e mundur dhënia e paradhënies për blerjen e makinerive.</li> </ul>
	15.01.2015	6-15.01.2015	Z. Hetem Bidaj, Shërbimi Këshillimor, Fier	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në sektorin e mishit, nënsektori i shpendëve, të hiqet fjala “broilera”;</li> <li>- Të rishikohet madhësia e fermave;</li> <li>- Vlera tavan e shpenzimeve të pranueshme duhet të rritet nga 2 deri në 5 milion euro;</li> <li>- Ti jepet përparësi kooperativave.</li> </ul>
	15.01.2015	6-15.01.2015	Z. Kosta Çuedari, Prodhues i vajit të ullirit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlefshmëria e vërtetimit kadastrale është tre muaj, dhe kur vjen koha për dorëzimin e tyre kjo vlefshmëri ka përfunduar;</li> <li>- Në Program duhet të mundësohen kryerja e pagesave me këste të grantit për të gjitha investimet;</li> <li>- Autoritetet vendase duhet të krijojnë skema për përmirësimin e aftësisë huamarrëse.</li> </ul>
	15.01.2015	6-15.01.2015	Z. Muhamet Baboçi, Shërbimi Këshillimor, Fier	Sipërfaqja dysheme për vreshtat të zvogëlohet në 0.5 ha
	15.01.2015	6-15.01.2015	Znj. Izmini Omari, Shërbimi Këshillimor, Fier	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të monitorohet dhe të jepet një informacion në baza të rregullta mbi problemet e hasura gjatë procesit të aplikimeve në IPARD-like.</li> <li>- Të jepet informacion mbi problemet dhe gabimet e hasura më shpesh në aplikime;</li> <li>- Të rritet mbështetja për prodhimin e mishit të shpendëve;</li> <li>- Të mbështetet përpunimi i mbetjeve teknologjike si hirra, vaji vegjetal, etje.</li> </ul>
	15.01.2015	6-15.01.2015	Pelivan Metushi, Fermë qumështi, Fier	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zgjatet periudha për dorëzimin e aplikimeve gjatë hapjes së thirrjeve, në mënyrë që të kihet kohë mjaftueshëm për</li> </ul>

Tema e konsultimit	Data e konsultimit	Koha në dispozicion	Emrat e institucioneve/kompanive/personave	Përmbledhje e rezultateve
<p>Objektivat e masave</p> <p>Sektorët prioritarë</p> <p>Kushtet e përfitueshmërisë</p> <p>Kriteret e përzgjedhjes</p> <p>Buxheti</p>	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Qemal Memishi, Shefi shërbimit këshillimor, Kukës	<p>mbledhjen e dokumentacionit mbështetës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tu jepet përparësi fermave të qumështit.</li> <li>- Të zvogëlohet sipërfaqja dysheme për fermat e prodhimit të perimeve nga 0.5 ha në 0.2 ha, në bllok (ose në disa parcela); për frutat nga 0.5 në 0.3 ha; ndërsa për vreshtat nga 1 ha në 0.4 ha ose 0.5 ha.</li> <li>- Të hartohen dhe publikohen kostot standarde për ha ose për krerë.</li> </ul>
	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Qemal Memishi, Fermer, Kukës	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të nxiten investimet në thertore;</li> <li>- Të thjeshtohet procesi aplikimit dhe të zgjatet afati për dorëzimin e aplikimeve;</li> <li>- Të thjeshtohen procedurat ligjore dhe kërkesat mjedisore për marrjen e lejes së ndërtimit për stalla atë cilat janë shumë të vështira për ti përmbushur;</li> <li>- Çështjet e pronësisë janë edhe të pazgjydhura, për këtë arsye duhet të bëhen thjeshtime të kriteve;</li> <li>- TË mundësohen hua të përballueshme (interesat e larta përbëjnë pengesë për investimet);</li> <li>- Të decentralizohet dorëzimi i aplikimeve në zyrat e AZHBR-së në qarqe;</li> <li>- Të bëhen trajnime në qarqe për konsulentët që do të mbështesin fermerët për përgatitjen e aplikimeve.</li> </ul>
	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Dali Rexha, Ekonomist, Dibër	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të publikohen standardet minimale kombëtare në një manual;</li> <li>- Të rritet numri i konsulentëve të trajnuar;</li> <li>- Të krijohen lehtësira për huamarrje përmes ndërgjegjesimit të bankave në lidhje me Programin IPARD.</li> </ul>
	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Veip Salkurti, Fermer dhe përpunues, Dibër	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zhvillohen trajnime shtesë, ë mënyrë që të rriten kapacitetet për përgatitjen e aplikimeve;</li> <li>- Të nxiten bankat që të mbështesin fermerët me hua me interesa të ulta.</li> </ul>
	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Osman Begu, Specialist, Dibra	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sektorët e mishit dhe të qumështit të kombinohen në masën e ‘Investimeve në fermat bujqësore’</li> <li>- TË krijohet mundësia e pagesave me këste të grantit, për shkak se investimet e mëdha janë të vështira për tu zbatuar.</li> </ul>
	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Haxhi Shehu, Specialist, Dibër	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mbështetem investimet në pyllëzim;</li> <li>- Të mbështeten investimet në kanalet ujitëse.</li> </ul>
<p>Objektivat e masave</p> <p>Sektorët prioritarë</p> <p>Kushtet e përfitueshmërisë</p>	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Sherif Bisha, Shërbimi këshillimor, Dibër	Të rritet buxheti i masës “Agro-mjedisore, dhe bujqësisë organike dhe klimaterike”
	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Zyber Qokja Shoqata e bimëve mjekësore, Dibër	Të mbështetem huamarrja e përballueshme për shpenzimet operationale të bizneseve në fushën e bimëve medicinale (bimë medicinale përbëjnë prioritet për rajonin e Dibrës, por konsoliduesit, nuk disponojnë fonde të mjaftueshme për të paguar fermerët,

Tema e konsultimit	Data e konsultimit	Koha në dispozicion	Emrat e institucioneve/kompanive/personave	Përmbledhje e rezultateve
				duke qenë se shitja e produktit kërkon një afat nga 6 deri në 2 vjet. Kjo gjë pengon që të investojmë në makineri për përpunimin e bimëve medicinale).
	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Osman Xhilli Shef i shërbimit këshillimor, Dibër	Të mbështeten investimet në pyje dhe përmirësimin e kullotave; Në rastin e kullotave, nevojitet mbështetje për hapjen e rrugëve, pastrimin e atyre ekzistuese, ndërtimin e lerave; Investime në ujitje mund të mbështeten në rastin e grupeve me 3 deri 4 fermerë.
	21.01.2015	12-21.01.2015	Znj. Majlinda Hoxha, Drejtoreshë Ekzekutive e shoqatës 'Vision', Dibër	- Për sa i përket investimeve në sigurinë ushqimore, vlera dysHEME prej 70 mijë eurosh është shumë e lartë; - Masa e lidhur me përgatitjen dhe implementimin e strategjive lokale të zhvillimit do të jetë shumë e vështirë për tu zbatuar.
	21.01.2015	12-21.01.2015	Z. Novrus Jashari Drejtor i Drejtorisë Bujqësore, Dibër	- Në Program duhet të përfshihen disa parashikime të veçanta për emigrantët e kthyer në Shqipëri. - Duhet të mbështetet edhe blerja e kafshëve; - Materialet e ndërtimit duhet të përjashtohen nga TVSH-ja.
	28.01.2015	20-28.01.2015	Z. Bashkim Kazazi, Fermer, Kavajë	Për sa i përket kriterëve të madhësisë minimale të fermave – duhet të mundësohet që anëtarët e një familjeje bujqësore të bashkëpunojnë dhe në këtë mënyrë përbushin kriterin e madhësisë minimale ('duke qenë se vetëm nuk e plotësoj kriterin minimal, por së bashku me djalin po').
	28.01.2015	20-28.01.2015	Z. Nexhat Lapi, Specialist, Kashar, Tiranë	- Ka vështirësi me dokumentacionin e tokës duke qenë se pas miratimit të ligjit. 7501, toka bujqësore u fragmentarizua së tepërmi duke e bërë të vështirë marrjen e dokumenteve të pronësisë; në duam të investojmë në ngritjen e një frigoriferi, por ndihemi pa garanci ligjore për sa i përket lejeve të ndërtimit gjë që do të mbronte investimin në pasuri të paluajtshme.
	28.01.2015	20-28.01.2015	Z. Hekuran Xhani, Fermer, Lekaj Kavajë	- Ulja e vlerës dysHEME të kostove të pranueshme të investimeve nga 30,000 euro në 10,000 euro. - Të përfshihet edhe gruri si sektor i pranueshëm; - Ministria duhet të krijojë një grup pune për t'ju shpjeguar fermerëve procedurat e Programit IPARD II.
	28.01.2015	20-28.01.2015	Z. Zenel ALIU, Specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, Durrës	- Reduktimi i sipërfaqes dysHEME të vreshtave nga 1 ha në 0.5 ha, por me mundësinë që 0.5 ha të jetë në 2 ose 3 parcela; - Ulja e vlerës dysHEME të investimeve në 20 mijë euro; - Mbështetja e investimeve në zonat rurale për pyllëzime të cilat do të përfitonin



<b>Tema e konsultimit</b>	<b>Data e konsultimit</b>	<b>Koha në dispozicion</b>	<b>Emrat e institucioneve/kompanive/personave</b>	<b>Përmbledhje e rezultateve</b>
				100% grant.
Objektivat e masave Sektorët prioritarë Kushtet e përfitueshmërisë	28.01.2015	20-28.01.2015	Z. Alfred Sinakoli, Veteriner në zonën Dajt-Shëngjergj, Tiranë Z. Bahri Kokomani, Fermer, Hardhishtë, Durrës	Ulja e kriterit minimal për bagëtitë e imtanga 100 krerë në 50 krerë.
Kriteret e përzgjedhjes	28.01.2015	20-28.01.2015	Znj. Theodora Bujari, Kompania 'BUNA'	Rritja e buxhetit paraprak të masës agromjedisore.
Buxheti	28.01.2015	20-28.01.2015	Znj. Meliha Bejko, Kompania 'AGROTEK'	- Kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të tilla që të nxisin rritjen e prodhimit primar vendas (kompania jonë importon shumicën e lëndës së parë të përpunimit); - Nxitja e bashkëpunimit mes fermerëve dhe përpunuesve.
	28.01.2015	20-28.01.2015	Z. Vasip Habili, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Durrës.	Bashkëpunim i ngushtë me fermerët, për të përcjellur informacionin mbi masat e reja, mënyrat për të qenë rentabël dhe praktikatat më të mira.

## **ANEKSI 7. STANDARDET MINIMALE KOMBETARE**

### **MASA: INVESTIME NË AKTIVE FIZIKE NE FERMAT BUJQËSORE**

#### **A. Themelimi, regjistrimi dhe licensimi i subjekteve**

•

1. Ligji nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Fletorja Zyrtare nr. 60/2008, (ndryshuar me Ligjin nr. 10475/2011 dhe Ligji nr. 129/2014);
2. Ligji nr. 9723/2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Fletorja Zyrtare nr. 60/2007, (ndryshuar me Ligjin nr. 9916/2008 dhe Ligjin nr. 92/2012);
  - 2/1. Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 506/2007 "Për procedurat e publikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Fletorja Zyrtare nr. 113/2007;
3. Ligji nr. 1008/2009, "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Fletorja Zyrtare nr. 31/2009 (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009);
  - 3/1. VKM nr. 538/2009 "Për licensat dhe lejet e dhëna përmes Qendrës Kombëtare të Licensimit dhe disa akte të tjera nën ligjore", Fletorja Zyrtare nr. 80/2009, (ndryshuar me VKM nr. 1295/2009, nr. 385/2010, nr. 436/2011, nr. 421/2013);
4. Ligji nr. 38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", Fletorja Zyrtare nr. 42/2012;

5. Ligji nr. 9136/2003 “Për kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, Fletorja Zyrtare nr. 84/2013, (i ndryshuar );
6. Ligji nr. 9975/2008 “Për taksat kombëtare”, Fletorja Zyrtare nr. 128/2008 (i ndryshuar );
7. Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, Fletorja Zyrtare nr. 123/2006, (i ndryshuar );
8. Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 85/2008, (i ndryshuar );
9. Ligji nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Fletorja Zyrtare nr. 32/1998, (i ndryshuar );
10. Ligji nr. 7928/1995 “Për tatimin e vlerës së shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 12/1995, (i ndryshuar );
- 10/1. Udhëzim i Ministrit nr. 19/2014 “Për regjimin e veçante të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSh-se”.

## **B. Ndërtimi dhe Mjedisi**

1. Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Fletorja Zyrtare nr. 137/2014;
2. Ligji nr. 9244/2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, Fletorja Zyrtare nr. 49/2004, (ndryshuar me Ligjin nr. 69/2013, Ligji nr. 131/2014);
3. Ligji nr. 8752 date 26.03.2001 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave për mbrojtjen e tokës bujqësore”, Fletorja Zyrtare nr. 14/2001, (ndryshuar me Ligjin nr. 9244/2004; Ligji nr. 10257/2010; Ligji nr. 16/2012; Ligji nr. 130/2014);
4. Ligji nr. 9426/2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, Fletorja Zyrtare nr. 78/2005 (ndryshuar me Ligjin nr. 9864/2008; Ligji nr. 10137/2009; Ligji nr. 72/2013);
5. Ligji nr. 8402/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", Fletorja Zyrtare nr. 22/1998 (i ndryshuar );
6. Ligji nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Fletorja Zyrtare nr. 101/2011;
7. Ligji nr. 10448/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Fletorja Zyrtare nr. 89/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 31/2013);
8. Ligji nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Fletorja Zyrtare nr. 148/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 32/2013; Ligji nr. 156/2013);
9. VKM nr. 99/2005, “Për miratimin e katalogut të klasifikimit të mbetjeve në Shqipëri”, Fletorja Zyrtare nr. 15/2005, (ndryshuar me VKM nr. 579/2014);
10. Ligji nr. 10465/2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 143/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 70/2013);
11. Ligji nr. 9115/2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Fletorja Zyrtare nr. 78/2003, (ndryshuar me Ligjin nr. 10448/2011; Ligji nr. 34/2013);
12. Ligji nr. 10448/2011 “Për lejet mjedisore”, Fletorja Zyrtare nr. 105/2011 (ndryshuar me Ligjin nr. 44/2013; Ligji nr. 60/2014);

**C. Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve në ferma**

- 
- 1. Ligji nr. 9817/2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Fletorja Zyrtare nr. 147/2007;
- 2. Ligji nr. 10465/2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 143/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 70/2013);
- 3. Ligji nr. 9426/2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, Fletorja Zyrtare nr. 78/2005 (ndryshuar me Ligjin nr. 9864/2008; Ligji nr. 10137/2009; Ligji nr. 72/2013);
- 4. Ligji nr.10201/.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, Fletorja Zyrtare nr. 193/2009;
- 5. Ligji nr. 7802/2002 “Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve në ferma”, Fletorja Zyrtare nr. 47/2000,(ndryshuar me Ligjin n.. 66/2013);
- 6. VKM nr. 320/2008 “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave”, Fletorja Zyrtare nr. 49/2008,(ndryshuar me VKM nr. 198/2009 dhe VKM nr. 381/2009);
- 7. Rregullore nr. 1/2002 “Për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve dhe sipërmarrjeve blegtorale”;
- 8. Urdhër i Ministrit nr. 407/2008 që miraton Rregulloren.“Për zbatimin e Rregullores nr. 1/2000, në lidhje me matrikullimin, pasaportat e kafshëve dhe regjistrin e fermës ”;
- 9. Urdhër i Ministrit nr. 459/2006që miraton Rregulloren "Për identifikimin dhe regjistrimin e bagëtive të imta";

**D. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve, prodhimi primar**

- 
- 1. Ligji nr. 7802/2002 “Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve në ferma”, Fletorja Zyrtare nr. 47/2000, (ndryshuar me Ligjin nr. 66/2013);
- 
- 2. Ligji nr. 10465/2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 143/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 70/2013);
- 
- 3. Ligji nr. 9441/2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”, Fletorja Zyrtare nr. 93/2005, (i ndryshuar );
- 
- 4. VKM nr. 1132/2008 “Për miratimin e rregullave të grumbullimit të qumështit të papërpunuar”, Fletorja Zyrtare nr. 134/2008;
- 5. VKM nr. 1708/2008 “Për zbatimin e programit të mbrojtjes in-situ të bagëtive të imta autoktone”, Fletorja Zyrtare nr. 208/2008;
- 6. VKM nr. 320/2008 “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave”, Fletorja Zyrtare nr. 49/2008, (ndryshuar me VKM nr. 198/2009 dhe VKM nr. 381/2009);
- 7. Rregullore nr. 3/2006 “Për higjienën e produkteve ushqimore”, Aneksi 1 “Prodhimi Primar Pjesa A: Kushtet e përgjithshme të higjienës në subjektet e prodhimit primar”;
- 8. Urdhër i Ministrit nr. 4/2008 që miraton Rregulloren nr. “Për standardet minimale të mbarështimit të kafshëve të fermës”(gjedhi, viçat);

9. Urdhër i Ministrit nr. 3/2008 që miraton Rregulloren nr. “Për certifikimin e kafshëve racë e pastër të specieve gjedh, dele, dhi, kuaj, derra race e pastër dhe hibride dhe spermës, ovareve dhe embrioneve të tyre”;
10. Urdhër i Ministrit nr. 1/2009 që miraton Rregulloren “Për standardet e mbarështimit të derrave dhe pulave”;
11. Udhëzim i Ministrit nr. 3, Date 30.04.2009 “Për shëndetin e kafshëve”  
Rregullore “Për prodhimin, përpunimin, shpërndarjen dhe importin e produkteve me origjinë shtazore për konsum njerëzor”
12. Urdhër i Ministrit nr. 2/2008 që miraton Rregulloren “Për riprodhimin e kafshëve të fermës dhe prodhimin dhe tregtimin e materialit racor”
13. Udhëzim nr. 5/2011 “Për kërkesat e veçanta të higjienës në stabilimentet/njësitë e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”;
14. Urdhër i Ministrit nr. 354, date 21.12.2011 që miraton Rregulloren “Për mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit”;
15. Urdhër i Ministrit nr. 91/2012 “Për marrjen e disa masave mbrojtëse në lidhje me influencën aviane dhe lëvizjet e shpendëve të shoqëruar nga pronarët e tyre” (Vendim i Komisionit 2007/25/KE, 22 Dhjetor 2006);
16. Urdhër i Ministrit nr. 92/2012 që miraton Rregulloren “Për hedhjen në treg dhe administrimin e somatotrofinës së gjedhit (BST)” (Direktiva 1999/879 KE 17 Dhjetor 1999);
17. Urdhër i Ministrit nr. 24/2012 “Rregullat e veçanta për kontrollin e etheve Afrikane të derrit” (Direktiva 2005/624/KE);
18. Urdhër i Ministrit nr. 286/2012 “Mbi mbrojtjen e kafshëve të fermës”, (Direktiva e Këshillit 98/58/KE e 20 Korrikut 1998);
19. Urdhër i Ministrit nr. 363/2013 “Për procedurat e përcaktimit të kufirit të mbetjeve të substancave farmaceutike aktive në ushqimet me origjinë shtazore” (Rregullore nr. 470/2009/ KE e 6 Majit 2009, Rregullore 2006/1055/KE, Rregullore e 12 Korrikut 2006, 2006/1231/KE e 16 Gushtit 2006, Rregullore 2006/1451/KE e 29 Shtatorit 2006);
20. Udhëzim i Ministrit nr. 7/2013 “Për mbrojtjen e kafshëve gjatë therjes” (Rregullore e Këshillit (KE) nr. 1099/2009 e 24 Shtatorit 2009);
21. Urdhër i Ministrit nr. 188/2013 “për rregullat e tregtimit të gjedhit si dhe rinotrakeitin infektiv të gjedhit”, (Vendim i Komisionit 15 Korrikut 2004, 2004/558/KE).
22. Urdhër i Ministrit nr. 328/2014 që miraton Rregulloren nr. “Për manualin e diagnostikimit të etheve Afrikane të derrit” (Vendim 2003/422/KE);
23. Urdhër i Ministrit nr. 329/2014 që miraton Rregulloren “Për standardet minimale të mbrojtjes së viçave” (Direktiva 2008/119/KE);
24. Urdhër i Ministrit nr. 370/2014 që miraton Rregulloren “Për produktet mjekësore veterinarë”, (Direktiva 2001/82/KE);
25. Urdhër i Ministrit nr. 351/2014 që miraton Rregulloren “mbi masat e mbrojtjes nga sëmundja foot-and-mouth” (Direktiva 2003/85/KE);
26. Urdhër i Ministrit nr. 336/2014 që miraton Rregulloren “mbi masat e mbrojtjes dhe kontrollit të influencës Aviane”.

27. Urdhër i Ministrit nr. 370/2014, që miraton Rregulloren“Për produktet mjekësore veterinare”, (Direktiva 2001/82/KE);;

**E. Mbrojtja e bimëve**

•

1. Ligji nr. 9244/2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, Fletorja Zyrtare nr. 49/2004, (ndryshuar me Ligjin nr. 69/2013, Ligji nr. 131/2014);
2. Ligji nr. 9108/2003,“Për substancat dhe preparatet kimike”, Fletorja Zyrtare nr. 66/2003, (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009; Ligji nr. 33/2012);
3. Ligji nr. 10390/2011 “Për plehrat bimore”, Fletorja Zyrtare nr. 31/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. nr. 64/2013);
4. Ligji nr. 9362/2005, “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, Fletorja Zyrtare nr. 29/2005, (ndryshuar me Ligjin nr. 9908/2008; Ligjin nr. 10137/2009; Ligjin nr. 71/2013);
5. VKM nr. 923/2011, “Mbi përbërjen dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit dhe regjistrimit të plehrave dhe procedurat e vlerësimit dhe regjistrimit të tyre”, Fletorja Zyrtare nr. 182/2011;
6. VKM nr. 774/2012, “Për kërkesat e prodhimit, etiketimit, paketimit dhe tregtimit, si dhe përjashtimet si dhe listën e llojeve të plehrave “CE fertilizers”;
7. VKM nr. 260/2013, “Mbi përcaktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizimin dhe procedurat e komunikimit të rezultateve të analizave të plehrave”, Fletorja Zyrtare nr. 57/2013;
8. VKM nr. 612/2011, “Mbi përcaktimin e kërkesave të detajuara për plehrat me bazë nitrat amonin me përmbajtte 28% azot”, Fletorja Zyrtare nr. 139/2011;
9. VKM nr. 1188/2008 “Për miratimin e rregullave për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve”, Fletorja Zyrtare nr. 141/2008, (ndryshuar me VKM nr. 462/2012);
10. VKM nr. 1555/2008 “Për miratimin e rregullave mbi kriteret e regjistrimit vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, Fletorja Zyrtare nr. 183/2008, (ndryshuar me VKM nr. 791/2012);
11. VKM nr. 750/2010 “Për miratimin e rregullave të kontrolleve të karantinës fitosanitare”, Fletorja Zyrtare nr. 139/2010;
12. Urdhër i Ministrit nr. 1/2003 që miraton Rregulloren nr. “Për prodhimin, mbrojtjen dhe përdorimin e materialit të certifikuar të pemëve frutore dhe vreshtave”;
13. Udhëzim i Ministrit nr. 1/2007, “Mbi miratimin e rregullave lidhur me masat fitosanitare për kufizimin e aftës bakteriale (*Ervinia amylovora* (Burr.)Winsl. et al) në territorin e Shqipërisë”;
14. Udhëzim i Ministrit nr. 2/2007, “Për miratimin e rregullave në lidhje me masat fitosanitare për mbrojtjen e patates së pastër nga parazitët e karantinës”;
15. Udhëzim i Ministrit nr. 3/2007, “Për miratimin e rregullave të monitorimit, kontrollit, dhe masave të karantinës në rastin e kimit të rrënjës së misrit (*Diabrotica virgifera* Le Conte)”;
16. Udhëzim i Ministrit nr. 7/2007, “Për miratimin e rregullave të mbrojtjes fitosanitare për materialet e paketimit prej druri në tregtinë ndërkombëtare dhe brenda vendit”

17. Urdhër i Ministrit nr. 51/2009. “Për funksionimin e Komisionit Shtetëror për regjistrimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve”;
18. Urdhër i Ministrit nr. 250/2012, “Për ngritjen e komisionit të Vlerësimit dhe Regjistrimit të plehrave të përdorura në bimë që nuk janë “CE Fertilizers”;
19. Urdhër i Ministrit nr. 268/2012, “Mbi formën dhe përmbajtjen e regjistrimit të plehrave”
20. Udhëzim i Ministrit nr. 9/2012, “Mbi kushtet e transportit, ruajtjes së plehrave”.

**MASA: PËRPUNIMI DHE TREGTIMI I PRODUKTEVE BUJQËSORE**

**A. Themelimi, regjistrimi dhe licensimi i subjekteve**

1. Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Fletorja Zyrtare nr. 60/2008, (ndryshuar me Ligjin nr. 10475/2011 dhe Ligji nr. 129/2014);
2. Ligji nr. 9723 date 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Fletorja Zyrtare nr. 60/2007, (ndryshuar me Ligjin nr. 9916/2008 dhe Ligji nr. 92/2012);  
2/1. Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 506, date 1.8.2007 "Për procedurat e publikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Fletorja Zyrtare nr. 113/2007;
3. Ligji nr. 9863/2008 “Për ushqimin”, Fletorja Zyrtare nr. 17/2008, (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009; Ligji nr. 74/2013);
4. Akt Normativ nr. 4/2012 “Për miratimin e rregullave të therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit”, Fletorja Zyrtare nr. 110/2012;
5. Ligji nr. 10081 date 23.02.2009, "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Fletorja Zyrtare nr. 31/2009 (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009);  
5/1. VKM nr. 538 date 26.05.2009 "Mbi licensat dhe lejet e dhëna përmes QKL-së dhe disa akteve të tjera nën-ligjore ", Fletorja Zyrtare nr. 80/2009, (ndryshuar me VKM nr. nr. 1295/2009, nr. 385/2010, nr. 436/2011, nr. 421/2013);
6. Ligji nr. 38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", Fletorja Zyrtare nr. 42/2012;
7. Ligji nr. 9136/2003 “Për kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, Fletorja Zyrtare nr. 84/2013, (i ndryshuar );
8. Ligji nr. 9975/2008 “Për taksat kombëtare”, Fletorja Zyrtare nr. 128/2008 (i ndryshuar );
9. Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, Fletorja Zyrtare nr. 123/2006, (i ndryshuar );
10. Ligji nr. 9920/2008 “Për procedura tatimore Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 85/2008, (i ndryshuar );
11. Ligji nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Fletorja Zyrtare nr. 32/1998, (i ndryshuar );
12. Ligji nr. 7928/1995 “Për tatimin e vlerës së shtuar (TVSH) in the Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 12/1995, (i ndryshuar );

**B. Ndërtimi dhe Mjedisi**

1. Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Fletorja Zyrtare nr. 137/2014;

2. Ligji nr. 8402/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", Fletorja Zyrtare nr. 22/1998 (i ndryshuar );
3. Ligji nr. 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", Fletorja Zyrtare nr. 101/2011;
4. Ligji nr. 10448/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Fletorja Zyrtare nr. 89/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 31/2013);
5. Ligji nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", Fletorja Zyrtare nr. 148/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 32/2013; Ligji nr. 156/2013);
6. VKM nr. 99/2005, "Për miratimin e katalogut të klasifikimit të mbetjeve në Shqipëri", Fletorja Zyrtare nr. 15/2005, (ndryshuar me VKM nr. 579/2014);
7. Ligji nr. 9115/2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Fletorja Zyrtare nr. 78/2003, (ndryshuar me Ligjin nr. 10448/2011; Ligji nr. 34/2013);
8. Ligji nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", Fletorja Zyrtare nr. 105/2011 (ndryshuar me Ligjin nr. 44/2013; Ligji nr. 60/2014);
9. Ligji nr. 10138/2009, "Për shëndetin publik", Fletorja Zyrtare nr. 87/2009, (ndryshuar me Ligjin nr. 52/2013);
10. Ligji nr. 9441/2005 "Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi", Fletorja Zyrtare nr. 93/2005, (i ndryshuar );
11. Urdhër i Ministrit nr. 22/2010 "Mbi kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës në stabilimentet ushqimore".

**B. Siguria ushqimore. Qumështi, mishi dhe fruta/perimet**

1. Ligji nr. 9441/2005 "Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi", Fletorja Zyrtare nr. 93/2005, (i ndryshuar );
2. Ligji nr. 9863/2008 "Për ushqimin", Fletorja Zyrtare nr. 17/2008, (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009; Ligji nr. 74/2013);
3. Ligji nr. 10465/2011, „Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 143/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 70/2013);
4. Ligji nr. 7659/1993 "Për farat dhe fidanët", Fletorja Zyrtare nr. 1/1993;
5. Ligji nr. 7929/1995 "Për mbrojtjen e drufrutorëve", Fletorja Zyrtare nr. 12/1995;
6. Ligji nr. 10416/2011, "Mbi materialin shumëzues bimor", Fletorja Zyrtare nr. 46/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 67/2013);
7. Ligji nr. 9587/2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", Fletorja Zyrtare nr. 84, (ndryshuar me Ligjin nr. 37/2013; Ligjin nr. 68/2014);
8. VKM nr. 1132/2008 "Për miratimin e rregullave mbi grumbullimin e qumështit të papërpunuar", Fletorja Zyrtare nr. 134/2008;
9. Udhëzim i Ministrit nr. 5, date 25.03.2011 "Për kërkesat e veçanta të higjienës në stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit, dhe për produktet me baze qumështi";
10. Udhëzim i Ministrit nr. 22/2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës në stabilimentet ushqimore", Fletorja Zyrtare nr. Ekstra 80/2012;





2. Ligji nr. 9723/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Fletorja Zyrtare nr. 60/2007, (ndryshuar me Ligjin nr. 9916/2008 dhe Ligji nr. 92/2012);
  - 2/1. Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 506/2007 "Për procedurat dhe publikimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Fletorja Zyrtare nr. 113/2007;
3. Ligji nr. 1008/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Fletorja Zyrtare nr. 31/2009 (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009);
  - 3/1. VKM nr. 538/2009 "Për licencat dhe lejet e dhëna përmes Qendrës Kombëtare të Licensimit dhe disa akte te tjera nen ligjore ", Fletorja Zyrtare nr. 80/2009, (ndryshuar me VKM nr. 1295/2009, nr. 385/2010, nr. 436/2011, nr. 421/2013);
4. Ligji nr. 38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", Fletorja Zyrtare nr. 42/2012;
5. Ligji nr. 9136/2003 “Për kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, Fletorja Zyrtare nr. 84/2013, (i ndryshuar );
6. Ligji nr. 9975/2008 “Për taksat kombëtare”, Fletorja Zyrtare nr. 128/2008 (i ndryshuar );
7. Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, Fletorja Zyrtare nr. 123/2006, (i ndryshuar );
8. Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 85/2008, (i ndryshuar );
9. Ligji nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Fletorja Zyrtare nr. 32/1998, (i ndryshuar );
10. Ligji nr. 7928/1995 “Për tatimin e vlerës së shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 12/1995, (i ndryshuar );

## **B. Ndërtimi dhe Mjedisi**

1. Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Fletorja Zyrtare nr. 137/2014;
2. Ligji nr. 8402/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", Fletorja Zyrtare nr. 22/1998 (i ndryshuar );
3. Ligji nr. 9244/2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, Fletorja Zyrtare nr. 49/2004, (ndryshuar me Ligjin nr. 69/2013, Ligji nr. 131/2014);
4. Ligji nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Fletorja Zyrtare nr. 101/2011;
5. Ligji nr. 10448/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Fletorja Zyrtare nr. 89/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 31/2013);
6. Ligji nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, Fletorja Zyrtare 84/2006 (ndryshuar me Ligjin nr. 37/2013; Ligji nr. 68/2014);
7. Ligji nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Fletorja Zyrtare nr. 148/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 32/2013; Ligji nr. 156/2013);
8. VKM nr. 99/2005, “Për miratimin e katalogut të klasifikimit të mbetjeve në Shqipëri”, Fletorja Zyrtare nr. 15/2005, (ndryshuar me VKM nr. 579/2014);
9. Ligji nr. 9115/2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Fletorja Zyrtare nr. 78/2003, (ndryshuar me Ligjin nr. 10448/2011; Ligji nr. 34/2013);

10. Ligji nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, Fletorja Zyrtare nr. 105/2011 (ndryshuar me Ligjin nr. 44/2013; Ligji nr. 60/2014);
11. Ligji nr. 10138/2009, “Për shëndetin publik”, Fletorja Zyrtare nr. 87/2009, (ndryshuar me Ligjin nr. 52/2013);
12. Ligji nr. 9103/2003, “Për mbrojtjen ndërkufitare të liqeneve”, Fletorja Zyrtare nr. 65/2003 (ndryshuar me Ligjin nr. 35/2013);
13. Ligji nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, Fletorja Zyrtare nr. 157/2012;
14. VKM nr. 480/2012, “Për planin kombëtar të emergjencës së ndotjes detare ne Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 113/2012;
15. Ligji nr. 8905/2002 “Për mbrojtjen e mjedisit të ujërave detare nga ndotja dhe dëmtimi” Fletorja Zyrtare 29/202 (ndryshuar me Ligjet 10137/2009; 30/2013);
16. VKM nr. 709/2014 që miraton “Strategjinë ndërsektoriale të bujqësisë dhe zhvillimit rural”. Fletorja Zyrtare nr. 169/2014

**C. BMA-të, kërpudhat, mjalti, bimët dekorative dhe kërmijtë**

1. Ligji nr. 9244/2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, Fletorja Zyrtare nr. 49/2004, (ndryshuar me Ligjin nr. 69/2013, Ligji nr. 131/2014);
2. Ligji nr. 9587/2006 “për mbrojtjen e biodiversitetit”, Fletorja Zyrtare 84/2006 (ndryshuar me Ligjin nr. 37/2013; Ligji nr. 68/2014);
3. Ligji nr. 7659/1993 “Për farat dhe fidanët”, Fletorja Zyrtare nr. 1/1993;
4. Ligji nr. 9362/2005, “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, Fletorja Zyrtare nr. 29/2005, (ndryshuar me Ligjin nr. 9908/2008; Ligji nr. 10137/2009; Ligji nr. 71/2013);
5. Ligji nr. 9863/2008 “Për ushqimin”, Fletorja Zyrtare nr. 17/2008, (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009; Ligji nr. 74/2013);
6. VKM nr. 750/2010 “Për kontrollet e karantinës fitosanitre”, Fletorja Zyrtare nr. 139/2010;
7. Ligji nr. 10120/2009, “Për mbrojtjen e fondit të bimëve medicinale”, Fletorja Zyrtare nr. 62/2009, (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009; Ligji nr. 42/2013);
8. Urdhër i Ministrit nr. 42/2012, “Mbi speciet e bimëve varietet e të cilave duhet të regjistrohen në Katalogun Kombëtar të Bimëve”, Fletorja Zyrtare nr. 36/2012;
9. Ligji nr. 10465/2011, „Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 143/2011, (ndryshuar me Ligjin nr. 70/2013);
10. VKM nr. 1344/2008, “Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore”, Fletorja Zyrtare nr. 160/2008;
11. Udhëzim i Ministrit nr. 22/2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës ne stabilimentet ushqimore”, Fletorja Zyrtare nr. Ekstra 80/2012;
12. Udhëzim i Ministrit nr. 21/2010 “Për kushtet e veçanta të higjienës dhe kontrollet zyrtare të produkteve me origjinë shtazore”, Fletorja Zyrtare nr. Ekstra 80/2012;
13. Udhëzim nr. 20/2010 “Për zbatimin e programeve parandaluese, GMP, GHP dhe procedurat e analizës së rrezikut CCP (HACCP) në stabilimentet ushqimore”, Fletorja Zyrtare nr. Ekstra 80/2012;

14. Rregullore nr. 3/2006 „Për higjienën e produkteve ushqimore”, Aneksi 1 “Prodhimi Primar Pjesa A: Kushtet e përgjithshme të higjienës në subjektet e prodhimit primar”;
15. Urdhër i Ministrit nr. 286/2012 “Për mbrojtjen e kafshëve të fermës”, (Direktiva e Këshillit 98/58/KE e 20 Korrikut 1998);

**D. Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i produkteve bujqësore (qumështi, mishi, fruta perimet, ullinjë, vera, mjalti, etje.)**

1. Ligji nr. 9441/2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”, Fletorja Zyrtare nr. 93/2005, (i ndryshuar );
2. Ligji nr. 87/2013 “Për kategorizimin e prodhimit, etiketimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”, Fletorja Zyrtare nr. 20/2013;
3. Ligji nr. 9863/2008 “Për ushqimin”, Fletorja Zyrtare nr. 17/2008, (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009; Ligji nr. 74/2013);
4. VKM nr. 1132/2008 “Për miratimin e rregullave të grumbullimit të qumështit të papërpunuar”, Fletorja Zyrtare nr. 134/2008
5. Udhëzim i Ministrit nr. 5, date 25.03.2011 “Për kërkesat e veçanta të higjienës në stabilimentet prodhimit të qumështit, për grumbullin dhe përpunimin, dhe produktet me bazë qumështi”;
6. Udhëzim i Ministrit nr. 22/2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës në stabilimentet ushqimore”, Fletorja Zyrtare nr. Ekstra 80/2012;
7. Udhëzim i Ministrit nr. 21/2010 “Për kushtet e veçanta të higjienës dhe kontrollet zyrtare të produkteve me origjinë shtazore”, Fletorja Zyrtare nr. Ekstra 80/2012;
8. Udhëzim nr. 20/2010 “Për zbatimin e programeve parandaluese, GMP. GHP dhe procedurat e analizës së rrezikut CCP (HACCP) në stabilimentet ushqimore”, Fletorja Zyrtare nr. Ekstra 80/2012;
9. Udhëzim nr. 23/2010 “Për kërkesat specifike të higjienës së mishit dhe produkteve të mishit”, Fletorja Zyrtare nr. Ekstra 80/2012;
10. Udhëzim i Ministrit nr. 16/2011 “Për aditivët ushqimore të ndryshëm nga ngjyruarit dhe embelsuesit”, Fletorja Zyrtare nr. 134/2011;
11. VKM nr. 409/2013 “Për përcaktimin e kritereve të tregtimit të dhe certifikimit të materialit mbjellës së rrushit për vreshta”, Fletorja Zyrtare nr. 86/2013;
12. Udhëzim i Ministrit nr. 620/2005, “Për strukturën e varieteteve të farave dhe fidanëve të rrushit të vreshtave të importuara ose të prodhuara në vend”, Fletorja Zyrtare nr.(nuk është identifikuar);

**E. Akuakultura**

1. Ligji nr. 64/2012, “Për peshkimin”, Fletorja Zyrtare nr. 73/2012, (i ndryshuar Ligji nr. 29/2013);
2. Ligji nr. 9863/2008 “Për ushqimin”, Fletorja Zyrtare nr. 17/2008, (ndryshuar me Ligjin nr. 10137/2009; Ligji nr. 74/2013);
3. Ligji nr. 9251/2004, “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 55/2004, (ndryshuar me Ligjin nr. 10483/2011);

4. VKM nr. 462/2014 “Për miratimin e rregullores nr. mbi regjistrimin e anijeve në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 113/2014;
5. VKM nr. 402/2013, “Për përcaktimin e masave menaxhuese të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve të peshkimit ne det”, Fletorja Zyrtare nr. 85/2013;
6. VKM nr. 407/2013, “Për përcaktimin e regjimit të kontrolleve mbi zbatimin e rregullave të politikës së menaxhimit te peshkimit”, Fletorja Zyrtare nr. 85/2013;
7. VKM nr. 302/2013, “Për ngritjen e sistemit të kontrolleve për parandalimin, kufizimin dhe zhdukjen e veprimtarisë së peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar si dhe për ngritjen e skemës së certifikimit të peshkatarëve”, Fletorja Zyrtare nr. 65/2013;

#### **F. Turizmi rural**

1. Ligji nr. 9734/2007, “Për turizmin”, Fletorja Zyrtare nr. 63/2007, (ndryshuar me Ligjin nr. 9930/2008; Ligji nr. 76/2013);
2. Ligji nr. 9048/2003 "Për trashëgiminë kulturore”, Fletorja Zyrtare nr. 33/2003, (ndryshuar me Ligjin nr. 9592/2006; Ligji nr. 9882/2008; Ligji nr. 10137/2009; Ligji nr. 77/2013);
3. Plan Veprimi i Ministrisë së Turizmit “Strategia e Turizmit 2014-2020”;
4. Ligji nr. 9376/2005, “Për sportin”, Fletorja Zyrtare nr. 36/2005 (ndryshuar me Ligjin nr. 9816/2007; Ligjin nr. 9963/2008);

#### **G. Shërbimet për popullsinë dhe bizneset rurale**

1. Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligji nr. 8872/2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 11/2002, (ndryshuar me Ligjin nr. 10011/2008; Ligji nr. 10137/2009; Ligji nr. 10434/2011; Ligji nr. 63/2014);
3. Ligji nr. 9355/2005, “Për shërbimin e asistencës shoqërore”, Fletorja Zyrtare nr. 22/2005, (i ndryshuar );
4. Ligji nr. 10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 46/2009, (ndryshuar me Ligjin nr. 51/2013);
5. VKM nr. 564/2005, “Për licensimin e ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”, Fletorja Zyrtare nr. 66/2005, (ndryshuar me VKM nr. 349/2007);
6. VKM nr. 708/2003, “Për licencimin dhe funksionimin e agjencive private të punësimit”, Fletorja Zyrtare nr. 90/2003;
7. Udhëzim i Ministrit nr. 1590/2008, “Për procedura te licensimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari të formimit profesional”;
8. Udhëzim i Ministrit nr. 28/2009, “Për procedurën e vlerësimit dhe licensimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari të formimit profesional”, (ndryshuar me Udhëzimin nr. 1/2013);
9. Udhëzim i Ministrit nr. 1456/2009, “Për procedurat e vlerësimit dhe licensimit të subjekte që ushtrojnë veprimtari të kujdesit shoqëror”, (ndryshuar me Udhëzimin 1456 (2)/2009);

#### **H. Prodhimi energjisë së rinovueshme**

Programi IPARD II për Shqipërinë

1. Ligji nr. 9072/2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Fletorja Zyrtare nr. 53/2003, (i ndryshuar );
2. Ligji nr. 138/2013. “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, Fletorja Zyrtare nr. 83/2013;
3. Rregullore e Entit Rregullator të Energjisë, “Për certifikimin e energjisë së rinovueshme”;

**ANEKSI 8. RAPORTI VLERESIMIT EX-ANTE (DOKUMENT I VECANTE)**